- d) Reduce implementation delays and promote responsiveness by bringing detailed policy and implementation decisions under the authority of those better informed on the details; and ultimately contribute to broader participation in development and change activities by developing self-reliance, local initiative and accountability. A government task force might be organised to recommend specific functions suitable for decentralisation; these might fall within the broad areas.

References

1. Overseas Private Investment Corporation, 1100 New York Ave., NW Washington.
2. Commission of the European Communities, "Council directive of 27 June 1985 on the assessment of the effects of certain public and private projects on the environment", pg 123-129.
3. Official Journal of the European Communities, L175, pages 40-48.
4. "Towards sustainability-a European Community programmers of policy and actions in relation to the environment and sustainable development" COM(92) .
5. 23 final- volt 11 (Commission of the European Communities), 1992.
6. Leung, Hook Lin. Land Use Planning Made Plain Ronald Frayed .
7. Brawler& Sediss , The rapport Company: Kingston, Ontario, 1989.
8. Hydro Management : Department of the Environment , London 1996.
9. De Soto, Hermine; Egamberdi, Nilufar; Center for Economic and Social
10. Studies (CESS), 2006.
11. Albania: Municipal Water and Sanitation Project – Social Assessment.
12. Albanian Agricultural ministry report 2009 pg 14-18.

13. Health Care Institute , Albania “ Focus article “ pg 6-7.
14. Albanian government report 2010 pg 12,25,41,58,74.
15. BMT (Biological Mechanical Treatment),Simpoziumi, Francë 2008.
16. Water Users Association Survey Report for 2007 Irrigation Season, March.
17. Instituti i kërkimeve të Ushqimit pranë Ministrise së B.U. Buletini 2009.
18. Instituti i Shëndetit Publik pranë Ministrise së Shëndetësisë (Tiranë 24 Maj 2008).
19. Bordi i Drejtoreve të Shoqatës “Për Strategjinë e Ujit”BURIMI 2009.
20. Raporti i ministrise se Shendetesise dhe Ministrise se ushqimit,Tirane 2010.
21. Raporti i BB per Shqiperine,Tirane2011.
22. Qendra per studimet ekonomike,UFO University, Tirane 2011 (U.s. Bureau of Mines).
23. Raporti i ministrise se turizmit 2010, Ministry of tourism 2010, pp 12.
24. Raporti i ministrise se mjedisit 2010.
25. Albanian programs reporta year 2009, pp 23.
26. Albanian study, Tirana University,year 2011 pp12, International conference.
27. Albania UNICEF program year 2007 pp 123,137.
28. Brown, Stephen 1. (1993). Towards a pedagogy of confusion, Essays in Humanistic Mathematics, Alvin.
29. White (Editor), Washington, DC, Mathematical Association of America, 107 - 122.
30. Brown, Stephen 1. (1996a). towards humanistic mathematics education. In Alan Bishop et al. (Eds.).
31. International Handbook in Mathematics Education, (pp. 1289-1321). The Netherlands: Kluwer.
32. Academic Press. www.academic press, internet link
33. Brown, Stephen 1. (1996b). Posing mathematically. Portsmouth, NH: Heinemann Press.
34. Brown, Stephen 1. (1997). Math lingo vs. plain English: Multiple entendre. Humanistic Mathematics.
35. Network Journal, 15, 5-10. Brown, Stephen 1 (2001).

Parandalimi i sjelljeve devijante te të miturit

PhD (C.) Mensut Ademi

BPrAL Universitar " AAB "

Kordinator për Kërkime Shkencore ne FJU

Qendren Hulumtuse QSJKS

Ligjerues

Abstrakt

Ky punimë është pjese e hulumtimi nderkombetare I cili eshte implementuare ne shume vende te botes, ne Kosove për herë tëpare perms "ISRD-3" kemi arrite te dhena per paralajmrimin e hershem ne funksion te parandalimit dhe luftimit te sjelljeve devijante te femijeve dhe te miturve ne R.Kosovesdhe me theks te veqante ne dy qytete te Kosoves.

Si çdo vend në botë, edhe Kosova po përballet me sfida të shumta. Një ndër sfi-dat më të rënda është prania e delikuencës së të miturve si pjesë e kriminalitetit tëpërgjithshëm. Në vëllimin dhe strukturën e kriminalitetit të përgjithshëm në Kosovëdelikuenca e të miturve ka një peshë specifike të konsiderueshme si për nga format eshfaqjes dhe llojshmëria e veprave të kryera, ashtu edhe për nga pasojat e dëmshmenjerëzore, sociale, ekonomike, psikologjike e të tjera për shëndetin, mirëqenien dhepasurinë e individit, të familjeve dhe të shoqërisë në përgjithësi.Megjithëkëtë, dukuria e delikuencës së të miturve në Kosovë nuk është studi-uar, trajtuar e luftuar sa duhet e si duhet.

Fjalet kyçe: Delinkuent, Parandalim, Sanksion.

Metodologjia e hulumtimit

Trajtimi shkencor i pozites juridiko-penale dhe kriminologjike te femijeve dhe te miturve kërkon aplikimin e metodave përkatëse për realizimin e qëllimeve të cilat i parashtron punimi shkencor.

Realizimi i qëllimit të këtijë punimi domosdoshmërisht kërkon aplikimin e metodave përkatëse të cilat mundësojnë sigurimin e të dhënave të duhura. Prandaj, në hulumtimin tonë do të aplikojmë:

- metodologjisë teorike (metodën juridike, metodën historike, metodën krahasuese, sociologjike, psikologjike dhe metodën logjike); dhe
- metodologjisë empirike (metodat statistikore – metoda e ligjit të numrave të mëdhejë, metoda e modelit, metoda e korelacionit, mesatares, përqindjes; metodat e analizës dhe sintezës; metoda e vështrimit dhe metoda deskriptive, metoda e turpit , Anketes dhe intervistes).
- Studeme shkencore (Studimi i Vetakuzimit, Studimi i Viktimizimit, ISRD)

Aplikimi i ketyre metodave na mundeson ta vlersojme gjendjen si eshte, analizat dhe vlersimet e praktikave te organeve dhe institucioneve ne trajtimin e ketije fenomeni dhe perjekjeve qfare duhet te behet ne te ardhmen me qellime te zgjerimit te njohurive mbi shkaqet format dhe menyren e luftimit te sjelljeve te tilla (Delege lata, Delege ferned).

Ne kete hulumtim, trajtim do te bazohem ne nje regjister te burimeve bibliografike dhe literatures klasike dhe aktuale bashkohore ne vend dhe ne bote ne pergjithsi, duke

konsultuare punime, monografi kerkime materjale te projekteve dhe konferencave te ndryshme ne vend dhe bote.

Ne kete aspekt veqmas shfrytezohen te dhenat statestikore komperative mbi fenomenin e delikuences te miturve ne vendet e rajonit ose ne pergjithsi ne bote.

Hipotezat

H1- Sa jane te perhapura sjelljet devijante te femijeve dhe te miture ne aspektin vellimore Statik

H2- Sa jane te perhapura sjelljet devijante te femijeve dhe te miture ne aspektin vellimore Dinamik

Hyrje

Si çdo vend në botë, edhe Kosova po përballet me sfida të shumta. Një ndër sfidat më të rënda është prania e delikuencës së të miturve si pjesë e kriminalitetit të përgjithshëm. Në vëllimin dhe strukturën e kriminalitetit të përgjithshëm në Kosovë delikuenca e të miturve ka një peshë specifike të konsiderueshme si për nga format eshfaqjes dhe llojshmëria e veprave të kryera, ashtu edhe për nga pasojat e dëmshmenjerëzore, sociale, ekonomike, psikologjike e të tjera për shëndetin, mirëqenien dhe pasurinë e individit, të familjeve dhe të shoqërisë në përgjithësi. Megjithëkëtë, dukuria e delikuencës së të miturve në Kosovë nuk është studiuar, trajtuar e luftuar sa duhet e si duhet. Pikërisht për këtë arsye i jemi përveshur këtijstudimi me qëllim që të njihen përmasat, struktura dhe dinamika e kësaj dukurie me ante të kesaje mase të analizohet në mënyrë të gjithanshme ndikimi i faktorëve të përgjithshëm, sidomos i varfërisë, papunësisë, migrimit të popullsisë nga zonat fshatare në qytete dhe kushteve të banimit e të jetesës, si dhe i faktorëve të posaçëm (ndarja e prindërve, fëmijët jetimë, familjet e degraduara, qëndrimi negativ i prindërve ndaj të miturve delikuentë, lënia e fëmijëve pas dore, pozita ende specifike e nënës në edukimin e fëmijës etj.) në shfaqjen e delikuencës.

Funksionimi i institucioneve dhe i organizmave të tjerë përkatës që drejtpërdrejt mund të ndikojnë te delikuentët, duke filluar nga familja, shkolla, qendrat e punës sociale, policia, gjyqet, organizatat joqeveritare, humanitare e religjioze etj., që luajnë një rol të rëndësishëm frenues e kufizues apo nxitës e kontribuues në manifestimin e fenomenit të delikuencës së të miturve e veçanërisht ndikimi imasmediave, filmit, internetit etj, të vëzhgohet shkalla e ndikimit të rrjedhojave dhe traumave të Luftës, të cilat ende janë të pranishme në paraqitjen e delikuencës të të miturit, të sigurohet trajtimi adekuat i kësaj dukurie në kontekst të realitetit kosovar, në mënyrë që të sqarohen pikëpamjet e gabuara të disa ekspertëve të jashtëm se gjojarinia kosovare u bën rezistencë ndryshimeve demokratike, ose se nuk është e aftë për t'i përvetësuar vlerat e reja kulturore, të cilat ofrojnë receta që janë të pazbatueshmenë kushtet tona; Përpjekjet dhe angazhimi maksimal i të gjitha strukturave përkatëse të organizuara për mënjanimin e rrethanave që favorizojnë kriminalitetin; të ndërmerren veprime të organizuara e sistematike për parandalimin dhe reduktimin e delikuencës së të miturve, si edhe masa adekuate përmirësuese apo represive ndaj delikuentëve, në mënyrë që të pengohet rekrutimi i delikuentëve të rinj dhe recidivizmi. Delikuenca e

të miturve në këtë punim është shqyrtuar nga këndvështrime tëndryshme: sociale, ekonomike, psikologjike, pedagogjike, sociologjike, juridiko-penale etj. Nga një vështrim i tillë gjithëpërfshirës kanë dalë në pah njohuri dhe vrojtime të gatshme me interes për njohjen tërësore dhe luftimin më të efektshëm të kësaj dukurie të dëmshme shoqërore.¹

Instrumentat ndërkombëtare kryesore për të drejtat e fëmijëve

Instrumentat ndërkombëtare kryesorë për të drejtat e fëmijëve janë:

- Konventa e OKB-së Për të Drejtat e Fëmijëve;
- Rregullat e OKB-së për standartet minimale për administrimin e Drejtësisë për Fëmijë (Rregullat e Pekinit);
- Rregullat e OKB-së për Parandalimin e kriminalitetit tek të rinjtë (Rregullat e Riyadhit)
- Rezoluta 2005/20 Udhëzimet në lidhje me çështje të drejtësisë, të cilat përfshijnë fëmijët viktimë dhe dëshmitarë të krimit;
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Protokollin Nr.12 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive themelore: Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit;
- Konventa e OKB-së kundër torturës dhe dënimeve a trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese;
- Konventa Europiane për parandalimin e torturës dhe dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese;
- Konventa e OKB-së Për të Drejtat e Fëmijëve – Komenti i Përgjithshëm Nr. 10 (2007) mbi “Të drejtat e fëmijëve në drejtësinë për të mitur”;
- Konventa e OKB-së Për të Drejtat e Fëmijëve – Komenti i Përgjithshëm No.12 (2009) mbi “Të drejtën e fëmijës për t’u dëgjuar”;
- Udhëzimet e Këshillit të Europës mbi drejtësinë miqësore për fëmijët.
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike;
- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut.

Parandalimi i sjelljeve devijante të të miturit

Studimi mbi kriminalitetin tek të miturit në Kosovë është një përpjekje e parë e cila synon të realizojë një analizë të situatës aktuale lidhur me këtë fenomen. Përfshirja e fëmijëve dhe të rinjve në aktivitete kriminale është kthyer në një shqetësim për vendin tonë, veçanërisht në dhjetë vjeçarët e fundit. Studimi i statistikave nga institucionet dhe organizmat qendrore dhe lokale të specializuara dhe përgjegjëse në këtë fushë,

¹ Në Kosovë, ka një shqetësim në rritje për delikucencën e fëmijëve dhe sjellje të tjera të rrezikshme të tilla si përdorimi i alkoholit dhe përdorimi i drogës. Qëllimi i studimit është ISRD2 të krahasohet me atë që është arritur me ISRD3 dhe të bëjmë krahasimin dhe analizën me :

ISRD Ks (Gjakovë dhe Ferizaj), se a është rritur kriminaliteti në mesin e fëmijëve, a [sht] [n] renje apo ka mbetur siq e kemi analizuar me heret delikucencën e fëmijëve.

2. Do të spjegojmë ndryshimin e tendencave me kalimin e kohës dhe për të testuar nëse teoritë e caktuara kriminologjike mund të përgjithësohen në nivel ndërkombëtar. Ky studim synon rijimin një pasqyre të saktë mbi kontekstin e përgjithshëm shoqëror, mekanizmat dhe masat eventuale për trajtimin e numrit të saktë në perqindje të veprave penale të kryera nga delikuentët në R.Kosovës .

“Karakteristik themelore e delikucencës së fëmijëve në shoqërinë bashkohore, është se ajo gjendet në shtim të përhershëm dhe se manifestohet me forma të paraqitjes që janë mjaft të rrezikshme, për çka edhe delikucenca e fëmijëve është sot një ndër preokupimet më të mëdha të të gjitha shoqërive në vende”. Në të njëjtën kohë studimi ka për qëllim aftësimin e studenteve dhe zhvillimin e kapaciteteve të tyre për punë hulumtuese empirike.

tregojnë se në shumë raste shqetësimi i publikut është i drejtë. Është evidente që sjelljet Devijante, Delikumente të të miturve mbetet konstante.

Për të realizuar këtë qëllim perms punimit do t] bëjm] një prezantim të përgjithshëm të situatës aktuale mbështetur në shifra dhe fakte, ne qytetin e Gjakoves dhe Ferizajit si studime te rastit, me te cilin punim do t] mundohemi t] qartësojm] konceptet bazë për sjelljet delikumente tek të miturit ne R.Kosoves, me te dhenat tona te fituara perms studimit te Veteakuzimit dhe Viktimizimit mundohemi ti paraqesim të dhënat dhe analizat e viteve të fundit për përfshirjen e të miturve në sjellje devijante, kemi identifikuar dhe analizuar faktorët nxitës të sjelljeve delikumente tek të miturit, profilizimin e të miturve në konflikt me ligjin mbështetur në të dhëna të grumbulluara nga evidencat statestikore sipas te dhenave nga Policia, Prokuroria Gjykatat dhe prezentimit mediatik, perms anketimit (Pyetsore te starndardizuare nga ISRD3 I.H.Marshall, M.Killias), dhe intervistat me drejtor dhe arsimtare te shkollave me të mitur që vuajnë dënimet për sjelljet kriminale.²

Për të realizuar këtë hulumtim janë përdorë metoda e Krahasimit (krostabulimit ,Program SPSS),të dhënave, burimeve primare dhe sekondare te fituara gjate hulumtimit, Metoda e Analizes me te cilen kemi arrite deri te shkaqet dhe faktoret e sjelljeve devijante te miturve, Metoda Statestikore, Metoden e Rastit, Anketes,Intervistes, Studimine Veteakuzimin dhe Viktimizimin.

Kështu, për të arritë deri te të dhënat janë shfrytëzuar të gjitha burimet institucionale si, Ministria e Kultures, Ministria e Arsimit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Prokuroria e Shtetit departamenti për të mitur, Gjykata themelore Departamenti për të mitur, Policia e Shtetit deparatamenti për të mitur, si dhe intervista me përfaqësues të qeverisjes locale dhe nacionale, shkollat Filllore kl-7/8/9, prindër dhe vetë të miturit.

Të dhënat sekondare janë shfrytëzuarë literatura e përdorur në funksion të analizave, konkluzioneve dhe rekomandimeve të bëra.

Perkufizimi i drejtesise per te mitur

Me delikuecë të të miturve nënkuptojmë sjelljet antishoqëore dhe antiligjore të personave të moshës së mitur. Moshë e mitur është e caktuar me norma pozitive të shumë vendeve. Zakonisht, ajo përfshin moshën prej 14-18 vjet. Mirëpo, në literaturën kriminologjike shpeshherë përdoret edhe termi kriminaliteti i të rinjve ose sjellje kriminale e personave të rinj, me ç'rast dëshirohet të potencohet aktiviteti kriminal i të rinjve, ku përfshihen edhe të miturit edhe personat e rritur, të rinj. Pra, nocioni kriminaliteti i të rinjve përdoret për të theksuar aktivitetin kriminal të gjithë të rinjve pa marrë parasysh moshën. Në disa raste, këtu bëjnë pjesë edhe fëmijët si persona delikuentë, për arsye se ekziston një bindje se e gjithë popullata e të rinjve, pa marrë parasysh se në çfarë faze të moshës është, në pikëpamje biopsikike dhe sociokulturore, ende nuk është formuar dhe për këtë arsye, është e nevojshme një qasje dhe trajtim i veçantë. Ky kuptim, pak më i gjërë i delinkuencës së të miturve, më tepër gjen aplikim në trajtimet dhe studimet kriminologjike dhe sociologjike, e më pak në atë juridiko-penale, sepse, sipas koncepcioneve juridiko-penale, kjo çështje është diferencuar dhe rregulluar në mënyrë të saktë dhe konkrete me anë të

² Te dhenat te fituara nga analiza e fituare do të sugjerojmë masa parandaluese për të përmirësuar situatën dhe së fundmi, arrin në disa konkluzione dhe sugjerime për të gjithë të interesuarit në këtë fushë, si Ministria e Arsimit, E Kultures, dhe institucione tjera në R.kosoves.

dispozitive penale ku janë përcaktuar moshat dhe kategoritë e caktuara. Prandaj, kjo është e lidhur edhe me përgjegjësinë e tyre penale dhe aplikimin e sanksioneve të ndryshme.³

Sistemi i drejtësisë për të mitur synon mirëqenien e të miturit dhe siguron që çdo reagim ndaj kryerësve të mitur të jetë gjithmonë në proporcion me rrethanat e kryerësit dhe veprës penale.

Kryerësve të mitur u shqiptohen masat e diversitetit dhe masat edukative, sipas nevojës, Privimi nga liria shqiptohet vetëm si mjet i fundit dhe do të kufizohet në afatin më të shkurtër të mundshëm. Gjate kohës se privimit nga liria, i shqiptuar si dënim, kryesit të mitur i ofrohet edukim, ndihmë psikologjike, sipas nevojës, edhe ndihmë mjekësore, për ta lehtësuar rehabilitimin e tij.

Fëmijës që merr pjesë në procedurë penale i ofrohet mundësia që të shprehet lirisht, Çdo i mitur i privuar lirie trajtohet me humanizëm për hir të dinjitetit të personalitetit të tij njerëzor, dhe me atë rast merren parasysh nevojat personale të moshës së tij. Në veçanti, çdo i mitur i privuar lirie ndahet nga madhorët, përpos nëse konsiderohet se është në interes të miturit të mos ndahet, dhe gëzojnë të drejtën e mbajtjes së kontakteve me familjen e tij përmes korrespondencave dhe vizitave, përveç rrethanave të jashtëzakonshme të përcaktuara me ligj.

Çdo i mitur i privuar lirie ka të drejtë në ndihmë të menjëhershme ligjore dhe ndihmë tjetër adekuate, si dhe të drejtën për të kundërshtuar ligjshmërinë e privimit të tij nga liria pranë një gjykate të pavarur dhe të paanshme, si dhe në procedurë të menjëhershme. Për t'iu shmangur lëndimit për shkak të publicitetit të tepëruar ose etiketimeve, e drejta e fëmijës për privatësi respektohet në të gjitha fazat. Në parim, nuk publikohet asnjë informacion që shpie në identifikimin e kryerësit të mitur.

Shprehjet e përdorura në Kodin e drejtësisë për të mitur në R.kosves Kanë këto kuptime

- a. Fëmijë - personi i cili nuk e ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet.
- b. I mitur - personi ndërmjet moshës katërmëdhjetë (14) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjet.
- c. I mitur i ri - personi ndërmjet moshës katërmëdhjetë (14) dhe gjashtëmbëdhjetë (16) vjet.
- d. I mitur i rritur - personin ndërmjet moshës gjashtëmbëdhjetë (16) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjet.
- e. Madhor i ri - personi ndërmjet moshës tetëmbëdhjetë (18) dhe njëzetënjë (21) vjet.
- f. I ri - fëmijë apo madhor i ri.
- g. Madhor - personi i cili ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet.
- k. Edukim i specializuar - program edukativ i përpiluar sipas nevojave speciale të kryerësit të veprës penale, i cili synon të ndihmojë zhvillimin e gjithëmbarshtëm adekuat të tij dhe të zvogëlojë mundësinë e recidivizmit.
- l. Burgim për të mitur - dënim me burgim i shqiptuar ndaj kryerësit të mitur ose ndaj madhorit, që është në pajtim me Kreun IV të këtij Kodi.
- s. Objekt për kujdes të posaçëm - institucion i cili siguron trajtim të personave me paaftësi mendore, psikologjike, sociale apo fizike.
- h. Organ i kujdestarisë - organi përgjegjës që vepron në kuadër të Qendrës për Punë Sociale i cili është përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve.
- o. Gjyqtar për të mitur - gjyqtar profesional i cili është ekspert në çështjet penale ku janë të përfshirë fëmijët dhe madhorët e rinj, dhe i cili është kompetent për ushtrimin

³ R.Halili, Kriminologjia, 2016, Prishtinë.

e përgjegjëseve të parapara në këtë Kod.

u. Prokuror për të mitur - prokuror profesional i cili është ekspert në çështjet penale ku janë të përfshirë fëmijët dhe madhorët e rinj, dhe i cili është kompetent për ushtrimin e përgjegjëseve të parapara në këtë Kod.

f. Trup gjykues për të mitur - trup gjykues - kolegji i themeluar në pajtim me Kreun X të këtij Kodi, i cili ka së paku një (1) gjyqtar për të mitur dhe është kompetent për ushtrimin e përgjegjëseve të parapara në këtë Kod. z. Shërbim sprovues - institucioni i cili e bën ekzekutimin e masave dhe të dënimeve alternative.⁴

Nocioni i drejtësisë për të mitur

Delikuentët e mitur klasifikohen në disa grupe. Disa vende, në ligjet e tyre pozitive, i përcaktojnë kategoritë e moshave dhe rregullojnë një varg çështjesh rreth përgjegjësisë së tyre penale, rreth aplikimit të masave të ndryshme e sidomos masave edukative-përmirësuese. Limitimi i moshës së personave të mitur ka qëllim të caktuar, ngase varësisht nga mosha shtrohet edhe çështja e përgjegjësisë penale, shqiptimit të masave edukative-përmirësuese, shqiptimit të dënimeve të tjera dhe tretmanit edukativo-përmirësues nëpër ente edukative-përmirësuese.

Si kufi më i ulët i moshës së të miturve dhe cilësimit të tyre si kryerës të sjelljes kriminale, në disa shtete të botës bashkëkohore merret mosha 7-vjeçare (Burma, Cejloni, Egjipti, India, Iraku dhe disa shtete të tjera). Ndërsa, mosha 9-vjeçare, si moshë e përgjegjësisë penale më e ulët, merret në Izrael, Jordani, Filipine etj. Mosha 10-vjeçare konsiderohet si moshë e përgjegjësisë penale në Bolivi, Paraguaj dhe disa vende tjera të Amerikës Latine. Turqia dhe Irani, si moshë dhe kufi më të ulët të moshës e marrin moshën 11-vjeçare, Greqia, Panamaja dhe disa vende të tjera, moshën 12-vjeçare, ndërsa Franca dhe Polonia, moshën 13 vjeçare. Në pjesën më të madhe të shteteve evropiane si p.sh. Austri, Itali, Hungari, Shqipëri, ish-Jugosllavi, si limit më i ulët i përgjegjësisë penale, merret mosha 14-vjeçare. Nga ana tjetër, Zvicra, Danimarka, Suedia, si moshë më të ulët e marrin moshën 15-vjeçare. Ndërsa, Finlanda dhe Kili, si moshë më të ulët të përgjegjësisë penale së të miturve, e marrin moshën 16-vjeçare.⁵

- i. Delikuencë
- ii. Krim
- iii. Vepër penale
- iv. Person i mitur
- v. Person madhor
- vi. Fëmijë
- vii. Rrezikshmëri shoqërore
- viii. Edukimi, resocializimi i të miturve!
- ix. Trajtim të veçantë nga e drejta penale në kuptimin e gjërë:
- x. E drejta penale MATERIALE – MOSHA rrethanë lehtësuese- Masat edukuese
- xi. E drejta penale PROCEDURALE – Procedura për të mitur
- xii. E drejta MBI EKZEKUTIMIN E SANKS.PENALE – trajtimi i veçantë penitenciar

⁴ KODI Nr. 03/L-193 I DREJTËSISË PËR TË MITUR.

⁵ R.Halili, Kriminologjia, 2016, Prishtinë.

Pozita e femijeve dhe te miturve si kryers te sjelljeve delikuate

Si çdo vend në botë, edhe Kosova po përballet me sfida të shumta. Një ndër sfidat më të rënda është prania e delikuençës së të miturve si pjesë e kriminalitetit të përgjithshëm. Në vëllimin dhe strukturën e kriminalitetit të përgjithshëm në Kosovë delikuenca e të miturve ka një peshë specifike të konsiderueshme si për nga format eshfaqjes dhe llojshmëria e veprave të kryera, ashtu edhe për nga pasojat e dëmshmenjerëzore, sociale, ekonomike, psikologjike e të tjera për shëndetin, mirëqenien dhe pasurinë e individit, të familjeve dhe të shoqërisë në përgjithësi. Megjithatë, dukuria e delikuençës së të miturve në Kosovë nuk është studiuar, trajtuar e luftuar sa duhet e si duhet. Pikërisht për këtë arsye i jemi përveshur këtij studimi me qëllim që:

- të njihen përmasat, struktura dhe dinamika e kësaj dukurie;
- të analizohet në mënyrë të gjithanshme ndikimi i faktorëve të përgjithshëm, si domosdoshmëria, papunësisë, migrimit të popullsisë nga zonat fshatare në qytete dhe kushteve të banimit e të jetesës, si dhe i faktorëve të posaçëm (ndarja e prindërve, fëmijët jetimë, familjet e degraduara, qëndrimi negativ i prindërve ndaj të miturve delikuentë, lënia e fëmijëve pas dore, pozita ende specifike e nënës në edukimin e fëmijës etj.) në shfaqjen e delikuençës;
- të vlerësohet puna dhe funksionimi i institucioneve dhe i organizmave të tjerëpërkates që drejtpërdrejt mund të ndikojnë te delikuentët, duke filluar nga familja, shkolla, qendrat e punës sociale, policia, gjyqet, organizatat joqeveritare, humanitare e religjioze etj., që luajnë një rol të rëndësishëm frenues e kufizues apo nxitës e kontribuues në manifestimin e fenomenit të delikuençës së të miturve e veçanërisht ndikimi i medias, filmit, internetit etj.;
- të vëzhgohet shkalla e ndikimit të rrjedhojave dhe traumave të Luftës, të cilat ende janë të pranishme në paraqitjen e delikuençës së të miturit, të sigurohet trajtimi adekuat i kësaj dukurie në kontekst të realitetit kosovar, në mënyrë që të sqarohen pikëpamjet e gabuara të disa ekspertëve të jashtëm se gjojarinia kosovare u bën rezistencë ndryshimeve demokratike, ose se nuk është e aftë për t'i përvetësuar vlerat e reja kulturore, të cilat ofrojnë receta që janë të pazbatueshme kushtet tona; të inkurajohen përpjekjet dhe angazhimi maksimal i të gjitha strukturavepërkatese të organizuara për mënjanimin e rrethanave që favorizojnë kriminalitetin; të ndërmerren veprime të organizuara e sistematike për parandalimin dhe reduktimin e delikuençës së të miturve, si edhe masa adekuate për mirësi apo repre-sive ndaj delikuentëve, në mënyrë që të pengohet rekrutimi i delikuentëve të rinj dhe recidivizmi. Delikuenca e të miturve në këtë punim është shqyrtuar nga këndvështrime të ndryshme: sociale, ekonomike, psikologjike, pedagogjike, sociologjike, juridiko-penale etj. Nga një vështrim i tillë gjithëpërfshirës kanë dalë në pah njohuri dhe vërtetime të gatshme me interes për njohjen tërësore dhe luftimin më të efektshëm të kësaj dukurie të dëmshme shoqërore.

Çka është “dhuna” (violence)

Në gjuhën angleze fjala “violence (dhuna)” buron nga gjuhët latine: për shembull, spanjisht *violencia*, portugalisht *violência*, italisht *violenza*, frëngjisht *violence*, termet në gjuhët e tjera evropiane e kanë burimin gjuhësor mjaft të ndryshëm, si në gjermanisht *gewalt*, greqisht *βία*, gjuha islandeze *ofbeldi*, ose shqip *dhuna* (shënim i

përkthyesit). Madje edhe fjala, si ajo në gjuhën angleze “violence” është e hapur ndaj interpretimeve të ndryshme. Vetë fëmijët e definojnë dhunën në shkollë në mënyra të ndryshme varësisht nga mosha, gjuha dhe kultura e tyre⁶.

Të shohim tre definicionet e të moshuarve.

Encarta Fjalori botëror në gjuhën angleze (Encarta 1999) definicioni i dhunës është:

(1) përdorimi i forcës fizike për të lënduar ndokënd ose për të dëmtuar diçka;

(2) përdorimi jolegal i forcës së paarsyeshme ose efekti i krijuar nga kërcënimi i saj.

Definicioni i përdorur nga Olweus (Olweus 1999, f.12) është se dhuna ose sjellja e dhunshme është: sjellja agresive ku vepruesi ose autori i krimit përdor trupin e vet ose ndonjë objekt (duke përfshirë edhe armën) për të shkaktuar lëndim ose shqetësim (relativisht serioz) ndaj ndonjë personi tjetër.

Organizata Botërore e Shëndetësisë (WHO) e definojnë dhunën si: përdorimi i qëllimshëm i forcës ose fuqisë fizike ose psikologjike, kërcënuese ose aktuale, kundër vetes, ndonjë personi tjetër ose kundër një grupi ose komuniteti që ose rezulton ose ka mundësi të madhe të rezultojë me lëndim, vdekje, dëmtim psikologjik, zhvillim jo normal ose privim (WHO fi-006).

Këto dhe definicione të tjera kanë disa tipare të përbashkëta por dallojnë nga të tjerat. Normalisht, tiparet e përbashkëta janë se dhuna është:

- e dëmshme ose dëmtuese, ose të paktën kërcënon me lëndime; dhe
- ka për qëllim (dëmtim ose lëndim aksidental të shkaktuar nga ndokush që zakonisht nuk e mendon si të dhunshme).

Është e qartë se si e definojmë efektin e dhunës në atë se si i grumbullojmë të dhënat në lidhje me të në makro nivel. Një pikë e rëndësishme është të bëhet e qartë se çfarë është një përkufizim i ndokujt, por ekzistojnë çështje të tjera të rëndësishme për të marrë parasysh gjatë grumbullimit të të dhënave. Edhe pse disa statistika relevante mund të gjenden në shumicën, ndoshta në të gjitha shtetet evropiane (Smith 2003), shumica nga ato janë të tërthorta ose jo të plota – për shembull sondazhet e presionit (në vend të dhunës), statistikat zyrtare të aksidenteve të shkaktuara nga dhuna, statistikat kriminale të bazuara në definicionet “legale”, të tilla si sjellje kundër sociale, dhuna ndaj të miturve dhe vandalizmi dhe të dhëna për përjashtime në shkolla.

Ekziston një mungesë e përgjithshme e të dhënave sistematike të grumbulluara në një shkallë të madhe me kalimin e kohës. Statistikat për dhunën në shkolla janë të bazuara në një llojllojshmëri të instrumenteve, me të cilët merret me trajtimin, shqyrton se si shkolat mund të vendosen në inspektimin e dhunës në situatën e tyre. Shumica e statistikave fokusohen në dhunën nxënësi kundër nxënësit. Palët e tjera të involvuara rrallë raportohen. Kjo ndoshta reflekton perceptimet e zakonshme të problemit dhe rezistencës së mundshme në pjesën e disa shkollave ose personelit për të hapur çështje sa i përket dhunës së personelit. Është e qartë, madje pa marrë parasysh dhunës në prona dhe pa marrë parasysh dhunës institucionale, aktet e dhunës mund të shfaqen mes secilit person në kuadër të bashkësisë së shkollës. Përveç dhunës nxënës kundër nxënësit, kjo veçanërisht mund të përfshijë edhe nxënësin kundër personelit, personelin kundër nxënësit dhe personelin kundër personelit.

Pavarësisht nga përkufizimet dhe burimet e ndryshme, ne dimë shumë në lidhje me faktorët që ndikojnë në nivelin e dhunës në shkolla. Këto përfshijnë llojin e shkollës

⁶ Smith et al. 2002

dhe klimën e shkollës, karakteristikat e grupit të kolegëve, karakteristikat e nxënësit siç janë mosha, gjinia, përkatësia etnike, historia familjare, nevojat e posaçme arsimore si dhe trendet historike.

Problemet teorike dhe praktike ne trajtimin e pozites juridiko penale te femijeve dhe te miturve.

Pavarësisht nga përkufizimet dhe burimet e ndryshme, ne dimë shumë në lidhje me faktorët që ndikojnë në nivelin e dhunës në shkolla. Këto përfshijnë llojin e shkollës dhe klimën e shkollës, karakteristikat e grupit të kolegëve, karakteristikat e nxënësit siç janë mosha, gjinia, përkatësia etnike, historia familjare, nevojat e posaçme arsimore si dhe trendet historike.

Disa nisma përqendrohen më shumë në trajtimin e dhunës kur ajo të ndodhë, se sa në pamundësinë që ajo të ndodhë. Në disa shtete (Austria, Spanja, Britania e Madhe), ekzistojnë linja për shërbime telefonike për ndihmë për nxënësit si formë e kërkimit të këshillave në mënyrë anonime. Një lloj i sigurisë më të madhe mund të përfshijë nxënësit e lëndueshëm me një “byzlyk alarmues”, kështu që ata mund të kërkojnë ndihmë nëse janë të kërcënuar ose të sulmuar (Finlandë), ku ka një sistem të shpejt reagues për veprim në rast të paraqitjes së incidenteve të dhunës, të punësuarit e rojeve në shkollë (Programi për siguri të shkollave në Portugali), përforcimi i përgjithshëm i sigurisë në shkollë në lidhje me ndalimin e futjes së paautorizuar të armëve përmes video kamerave. Masat e tilla të sigurisë mund të jenë të nevojshme në disa raste, por kanë shkallë të rrezikut që të jenë kontraproduktive në tendencat për përmirësimin e klimës në shkollë dhe të bashkëjetesës. Të dhënat nga Portugalia na bëjnë me dije se në këtë shtet, aplikimi i hershëm i metodës së sigurisë, i bazuar në programin “Qasja e sigurisë në shkollë”, tani ka hapur rrugën që siguria më tepër të mbështet në parimet pedagogjike dhe në inkurajimin e vet-respektimit të nxënësve, si dhe të përgjegjësisë. Në mënyrë të ngjashme, qasjet për rivendosje përmes drejtësisë restauruese në disa të shkolla të Britanisë së Madhe japin rezultate pozitive si për viktimat ashtu edhe për aktorët e dhunës.

Administrimi i Sistemit të Drejtësisë për të Miturit dhe përputhshmëria e tij me standardet ndërkombëtare e vendos në qendër përdorimin e masave të burgimit si mjet i fundit dhe ri-integrimin si synim i sistemit të drejtësisë. Drejtësia duhet të jetë e butë me fëmijët dhe të jetë në krahë të tyre, është bërë progres në administrimin e drejtësisë për të miturit për ta bërë sistemin sa më njerëzor duke ofruar garanci ligjore dhe proceduriale, dhe duke kaluar nga një sistem ndëshkues në një sistem me një qasje të drejtësisë që edukon dhe ri-integron. Masat e ndryshme si pajtimi midis viktimës dhe shkelësit të ligjit, praktikave dëmshpërblyese, dhe dënimet alternative për të miturit që janë zbatuar së fundmi, kanë kontribuar në alternativa ndaj masës me burg për të miturit që kanë shkelur ligjin. UNICEF shpreh shqetësimin se shërbimi i provës nuk ofrohet njësoj për të miturit në të gjithë vendin dhe është pak i financuar dhe varet së tepërmi nga mbështetja e donatorëve.⁷

Emertimet e ndryshme te kryersve nga radha e femijeve dhe te miturve

⁷ http://www.unicef.org/albania/sq/children_28174.htm

Problemi i dhunës dhe delikuencës në institucionet e arsimit para-universitar mund të paraqitet edhe më shpesh duke bartur me vete pasoja potencialisht serioze për fëmijët nëse nuk identifikohen me kohë indikatorët kryesor që shpijnë deri tek përdorimi i dhunës në mes të bashkëmoshatarëve. Lirisht mund të themi se, një nga arsyet e manifestimit të dhunës në shkolla është mungesa e kulturës për raportimin e kësaj dukurie nga vet viktimat apo përjetuesit e dhunës, dëshmitarët apo personeli shkollor dhe, kur bëhet fjalë për viktimën potenciale ata, dhunën e ushtruar ndaj tyre e konsiderojnë si diçka normale me të cilën ata vetë duhet të ballafaqohen dhe të nënshtrohen.

Është me rëndësi të nënvizohet se, mos raportimi i rasteve të dhunës nga përjetuesit e dhunës apo dëshmitarët dhe personeli shkollorë, po mundëson krijimin e një perceptimi ku, tek ushtruesi i dhunës po krijohet bindja se me të vërtetë dhuna është e pranueshme dhe konsideron se dhuna ndaj bashkëmoshatarëve është alternativë e mirë për të ushtruar ndikim tek të tjerët. Do me thënë, ushtruesi i dhunës, dhunën të cilën e ushtron ndaj tjetrit e arsyeton dhe i duke krejt normale. Derisa në anën tjetër, tek viktimat potenciale e dhunës të ushtruar nga bashkëmoshatarët, krijohet një perceptim i gabuar përmes së cilit ai apo ajo e sheh të arsyeshme dhunën e përjetuar për shkak se veten e sheh si më të paaftë, të prapambetur në shumë fusha në raport me ushtruesin e dhunës. Dhe për me tepër, viktimat e arsyeton në njëfarë forme dhunën e përjetuar dhe mendon se ai apo ajo si viktimë duhet të ndryshojë dhe t'i përshtatet kushteve dhe rregullave të atij apo asaj e cila e ushtron dhunën. Përfundimisht, problemi i mos raportimit të dhunës së paraqitur në shkolla në cilëndo formë, është pasojë drejtpërdrejtë e trashëgimit të një mentaliteti nga regjimi dhe sistemi i kaluar okupues dhe aparati represiv policor.

Drejtësia penale për të mitur në legjislacionin Kosovës

Sistemi i drejtësisë për të mitur synon mirëqenien e të miturit dhe siguron që çdo reagim ndaj kryerësve të mitur të jetë gjithmonë në proporcion me rrethanat e kryerësit dhe veprës penale. Kryerësve të mitur u shqiptohen masat e diversitetit dhe masat edukative, sipas nevojës.

Privimi nga liria shqiptohet vetëm si mjet i fundit dhe do të kufizohet në afatin më të shkurtër të mundshëm. Gjatë kohës së privimit nga liria, i shqiptuar si dënim, kryesit të mitur i ofrohet edukim, ndihmë psikologjike, sipas nevojës, edhe ndihmë mjekësore, për ta lehtësuar rehabilitimin e tij.

Fëmijës që merr pjesë në procedurë penale i ofrohet mundësia që të shprehet lirisht, Çdo i mitur i privuar lirie trajtohet me humanizëm për hir të dinjitetit të personalitetit të tij njerëzor, dhe me atë rast merren parasysh nevojat personale të moshës së tij. Në veçanti, çdo i mitur i privuar lirie ndahet nga madhorët, përpos nëse konsiderohet se është në interes të miturit të mos ndahet, dhe gëzojnë të drejtën e mbajtjes së kontakteve me familjen e tij përmes korrespondencave dhe vizitave, përveç rrethanave të jashtëzakonshme të përcaktuara me ligj.

Çdo i mitur i privuar lirie ka të drejtë në ndihmë të menjëhershme ligjore dhe ndihmë tjetër adekuate, si dhe të drejtën për të kundërshtuar ligjshmërinë e privimit të tij nga liria pranë një gjykate të pavarur dhe të paanshme, si dhe në procedurë të menjëhershme, Për t'iu shmangur lëndimit për shkak të publicitetit të tepruar ose etiketimeve, e drejta e fëmijës për privatësi respektohet në të gjitha fazat. Në parim,

nuk publikohet asnjë informacion që shpie në identifikimin e kryerësit të mitur. Masat që mund të shqiptohen ndaj të miturve janë: masat e diversitetit dhe masat educative.

Dënimet që mund të shqiptohen ndaj të miturve janë: gjoba, urdhri për punë në dobi të përgjithshme dhe burgimi për të mitur.⁸

Dënimi nuk mund t'i shqiptohet të miturit i cili ka qene nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet në kohën e kryerjes së veprës penale, Kohëzgjatja e çfarëdo mase apo dënimi të shqiptuar duhet të përcaktohet me vendim të gjykatës në pajtim me këtë Kodin e drejtësisë për të mitur.

Kur gjykata cakton dënimin me burgim për të mitur deri në dy (2) vjet ose masën e dërgimit në institucionin edukativ apo edukativo-korrektues deri në dy (2) vjet, mund të shqiptojë dënimin me kusht në pajtim me Kodin Penal të Kosovës. 6. Përveç masës apo dënitimit, të miturit mund t'i shqiptohet masa apo dënim nga Kreun VIII i këtij Kodi.

Domosdoja e formimit të shërbimit të veçantë në kuadër të shërbimit të sigurimit publik, të cilin mund ta quajmë shërbim i specializuar i sigurimit publik për delikuentët e të miturve, shihet edhe në sa vijon:

- Njohja e domosdoshme e cilësive të përgjithshme, të vecanta dhe individuale të delikuentit nga kategoritë e caktuara.
- Njohja e problematikës së tërësishme sipas kategorive të caktuara në territorin apo rajonin e caktuar.
- Njohja e të gjitha desipozitave ligjore, që janë në lidhmëri të drejtpërdrejtë për zgjidhjen e rasteve të vecanta nga kategoritë e caktuara të delikuentëve.
- Trajtimi me kategorinë e fëmijëve dhe të të miturve si delikuentë duhet të jetë i vecantë, dhe këtë rrethanë e kushtëzon, në kuadër të këtij shërbimi, edhe profesionaliteti i vecantë dhe i ngushtë të punëtorit, që punon me këtë kategori delikuentësh.
- Profesionaliteti i ngushtë i punëtorit të shërbimit të sigurimit publik, që punon në këtë problematikë, duhet të realizojë në tërësi detyrat e tij, duke mos e rrezikuar personalitetin e delikuentit.⁹

Perfundimi

Ekzistojnë shumë arsye për t'u shqetësuar njeriu në lidhje me çështjen e dhunës në shkollë. Së pari, fillimisht është e dëmshme për ata persona që vuajnë nga dhuna ose për ambientet e shkollave që vuajnë nga vandalizmi dhe së dyti, ajo mund të krijojë pasiguri dhe frikë që veprojnë kundër veprimeve të shkollës. Klima e dhunës në shkollë është e kundërta e kundërta e arsimit për qytetërim që ne e kemi për qëllim në masë të gjerë.

Gjithashtu, ajo është kundër të drejtave të nxënësve dhe të rinjve për të jetuar të lirë nga frika dhe kërcënim. (Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës).

Shkollat mund të marrin hapa pozitive për të reduktuar dhunën dhe mundësinë për dhunë, dhe duhet të pregaditet një doracak që përshkruan disa nga proceset kryesore për të arritur këtë qëllim parandalues. Megjithatë, në qoftë se ne vetëm

⁸ KODI Nr. 03/L-193 I DREJTËSISË PËR TË MITUR, R. Kosoves 2010.

⁹ <http://www.shqiptari.eu/zbulimi-parandalimi-dhe-luftimi-i-delikuentes-se-te-miturve/>.

e diskutojmë çështjen e dhunës në shkolla, ia vlen të themi se ajo nuk është vetëm një problem për vetë shkollat. Ata në shkollë janë të afektuar nga mediat dhe nga qëndrimi ndaj dhunës në shoqërinë e gjerë, madje edhe nga ngjarjet ndërkombëtare. Mediat prezantojnë akte të dhunshme, dhe nganjëherë i bëjnë ato të duken tërheqëse dhe të suksesshme. Dhuna e sotshme shpesh paraqitet në shoqëri jashtë shkollave dhe ndonjëherë është miratuar. Dhuna e prindërve ndaj fëmijëve (siç janë shuplakat) janë ligjore dhe mjaft të shpeshta në shumë shtete të Evropës, por jo në të gjitha. Dhuna në kuptimin e veprimit hakmarrës të ndërmarra kundër kriminelëve (dhuna ndëshkuese) ose grupeve të perceptuara në angazhime të veprimeve terrorist, shpesh miratohen nga shumica. Legjitimiteti dhe efektiviteti i perceptuar i veprimeve të shkollës kundër dhunës gjithashtu mund të jenë të afektuar nga këto çështje të gjera. Të gjithë qytetarët mbajnë ca përgjegjësi në një vend demokratik. Është e qartë se definicioni i asaj që çka kuptojmë me dhunë është ngritur nga ky diskutim.¹⁰

Literatura

- B.Muçi, Vepratpenale ne fushen e narkotikeve, Tiranë, 2002.
 B.Petrovic, G.Mesko, Kriminologija, Pravni Fakultet US, Sarajevo, 2004.
 B.Smith, P.Preston, Hanbook of juvenile justice, theory and practice, USA , 2006.
 Banović, B. Kriminalističko – kriminoloski aspekti krivičnog dela razbojništva..., Beograd, 2002.
Begeja Skender, Kriminalistika, Tiranë, 2004 Beirne.
 C.Bonnet, Razbijeno Dijete, Incest i pedofilija, Zagreb, 2000.
 C.Hajdukovic, Prestupnicko ponasanje mladih, Beograd, 1975.
 D.Termiz, Kritika teorije, Sarajevo, 2013.
 D.Termiz, Metodologija drustvenih nauka, Universitet u Sarajevo, 2004.
 D.Termiz, Specificnosti metodologije istrazivanja u bezbednosnoj djelatnosti, Sarajevo, 2014.
 D.Termiz. Osnovni Metodologije Socijalne Psihologije, Sarajevo, 2013.
 D.Tripan, Detektivska Delatnost, Beograd, 2014.
 Dr. Elezi, Ismet, " E drejta penale – pjesa e posaçme ", Tiranë, 2002.
 Dr. Elezi, Ismet, Hysi, V, " Politika penale " Tiranë, 2010.
 Dr. Latifi, Vesel, Kriminalistika...Prishtinë, 2011.
 Dr. Latifi, Vesel, Politika kriminale, 2011, Prishtinë.
 Dr.Bačić, Franjo i dr.Šime, Pavlović, Kazneno pravo (posebni dio), Zagreb, 2001.
 Dr.Dvoršek, Anton, Značaj Kriminalne strategije za prevenciju kriminaliteta, Beograd 2002.
 Dr.Halili, Ragip, Kriminologija, Prishtinë, 2016.
 Dr.Jovašević, Dragan, Teži oblici razbojništva i razbojničke kradje, Časopis Bezbednost, 2/2005, Beograd.
 Dr.Kambovski, Vllado, E Drejta Penale, Pjesa e përgjithshme, Shkup, 2004.
 Dr.Salihi, Ismet, E drejta penale – pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2008.
 Dr.Salihi, Ismet, E drejta penale ndërkombëtare penale, Prishtinë, 2011.
 Dr.Zejneli, Ismail, " E drejta Penale – pjesa e posaçme ", Tetovë, 2007.
 E.McLaughlin, J.Muncie, Criminological Perspectives, Sage, 2013.
 E.Muratbegovic, Preventivne teorije, FKN, Sarajevo, 2008.
 E.Sahiti E Drejta e Procedures penale, 2014, Prishtinë.
 E.Sahiti, Argumentimi ne procedur penale, 2006, Universiteti I Prishtines, Prishtinë.
 E.Sahiti, I.Zejneli E Drejta e Procedures Penale e R.Maqedonise, 2007, Shkup.
 G.Ponti, Compendio di Criminologia, Milano, 1997.
 H.Dieter Schëind, Kriminologie, Munchen, 2007.
 I.Salihi, H.Zhitija, F.Hasani, Komentari I Kodit penal ne R.Kosoves, 2014, GIZ, Prishtinë.

¹⁰ Perspektiva evropiane Peter K. Smith

- I.Salihi, Vrasjet ne KSA te Kosoves, Rilindja, 1985.
- I.Zejneli Trafikimi me njerz aspekti juridik, 2007, Tetovë.
- I.Zejneli, Delikuenca e te miturve ne R.Maqedonise, 2010, Universiteti EJL/SEE, Tetove.
- Ilia, F, " Kanuni i Skanderbegut", Milot, 2003.
- J. Junger-Tas, I. Haen Marshall, D. Enzmann, M. Killias, M. Steketee & B Gruszczynska (Eds.),Juvenile Delinquency in Europe and Beyond: Results of the Second International Self-Report Delinquency Study, Neë York: Springer (2010) .
- J. Junger-Tas, Ineke Haen Marshall, Dirk Enzmann, Martin Killias, Majone Steketee & Beata Gruszczynska, The Many Faces of Youth Crime: Contrasting Theoretical Perspectives on Juvenile Delinquency across Countries and Cultures, Neë York: Springer (2012).
- J.Antonio Rodriguez, N Perez-Santiago, Ch.Birkbeck, Surveys as cultural artefacts: Applying the International Self-Report Delinquency study to Latin American adolosents, 2015.
- J.Ferrell, Cultural criminology, Sage,1999.
- J.M.Antonian, A.A.Tkaçenko, Krimet Seksuale,Tiranë. 2006.
- L.Mimrovic, M.Daniscic, R.Tanja, S.Joic,,N.Grbic, Maloletnicka delinknbencija u R.Serbskoj, Banja luka, 2008.
- L.Prifti, Psikologjia e krimi (ose penale), Tirane, 2003.
- Latifi, V, Elezi, I, Hysi, V, " Politika e luftimit të kriminalitetit" Prishtinë, 2012.
- Ling Ren, Jihong Zhao, Ni He, Ineke Haen Marshall, Hongëei Zhang, Ruohui Zhao & Cheng Jin, Testing for measurement invariance of attachment across Chinese and American adolescent samples. International Journal of Offender Therapy and Comparative Criminology First published on January 2013.
- Mandro – Balili, A, " Pashallëqet feudale shqipëtare në këndëvështrimin e shtetit dhe të së drejtës ", Tiranë, 2008.
- N.Korailic, Istrazivanje krivicni djela, FKN Un.Sarajevo, BiH, Sarajevo2012.
- Pred delinkventno ponasanje ucenika, Osnovnih I srednjih skola kanton Sarajevo, 2005, Sarajevo, BiH.
- R.Gassin, Criminologie, 6 edition, 2007.
- R.Halili, Kriminologjia , 2016, Prishtinë.
- R.Halili, Penologjia, 2014, Prishtinë.
- R.Halili, Viktimologjia, 2014, Prishtinë.
- R.Llukiç, Metodologjia e se drejtes, Universiteti i Prishtines, Prishtinë, 2012.
- R.Maslesa, Organizirani kriminalitet-politicko sigurnosni, Policiska akademija, Beograd, 2005.
- S.Bejatovic, J. lazeric,Ministarstvo nauke R.Serbije, Krivicnopravna pitanja maloletnicke delikvencije, 2008.
- S.Milosavljevic, D.Termiz, Naucni osnovi savremene Analitike,Sarajevo, 2008.
- Shegani, A, " Aspekte fenomenologjike, juridiko-penale e kriminologjike të terrorizmit ndërkombëtar ", Tiranë, 2010.
- T.Markovic, Maloletnicka delinkvencija i njezino suzbianje, beograd, 1973.
- V.Kambovski E Drejta Penale(Shqip), 2010, Shkup.
- V.Latifi, Kriminaliteti i te rinjeve ne Kosovë, Prishtinë, 1981.
- V.Obradovic, „Delinkventno ponasanje“, Sarajevo, 2008.
- V.Obradovic, Delikventno ponasanje, empiriska studija,2008, Sarajevo,BiH.
- V.Obradovic, Rizicno I kaznjivo ponasanje, Empirijske studije, 2015, Sarajevo. BiH.
- Z.Gruda, Mbrojtja nderkombetare e te drejtave te njeriut, 2000, Prishtinë.
- Z.Sylejmanov, Makedonska Kriminologjia, 2000, Shkup.
- Zarko B.Jasovic, Kriminologjia Maloletnicke Delinkvencije, Naucna Knjiga,1991, Beograd.

Përprojekjet për stabilitet dhe politika opozitare e Shkodrës në vitet 1921 – 1923

Dr. proc Marsel Nilaj
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Abstrakt

Viti 1921 nisi i mbarë për Shqipërinë e viteve 1920. Për herë të parë pas disa përprojekjesh në letër, u arrit të hapej Parlamenti i parë në vend, nën emrin Këshilli Kombëtar. Prefektura e Shkodrës do të ishte prefektura më e populluar në Shqipëri, e cila do të nxirrte numrin më të madh të deputetëve, që do të dilnin nga prefekturat e Shqipërisë. Deputetët e dalë nga ato zgjedhje, pavarësisht peripecive, me karakter fetar, do të ishin personalitetet më përfaqësuese dhe më të denja për Shkodrën.

Por jeta tre vieçare parlamentare pati edhe peripecitë e veta, sidomos ngjarjet ku do të dominonte aspekti i dhunshëm, më shumë se ai i politikës parlamentare, do të linte impakt edhe në jetën parlamentare. Ngjarje të tilla si Kryengritja e Mirditës, e cila i përkiste Prefekturës së Shkodrës, do të krijonte një lloj ngërçi në vënd, gjë që i detyroi edhe deputetët e Shkodrës të dalin nga politika asnjëse. Kjo dalje nga një bllok i vetëm i bën të bashkëpunojë ato me deputetë të partive parlamentare, duke krijuar "Bashkimin e Shenjtë". Një koalicion i cili, në parim ishte shumë pozitiv, dhe një veprim i shpeshtë politik, në qytetërimin perendimor, por i vështirë për t'u hedhë në praktikën e realitetit shqiptar.

Ky koalicion në vënd që të ulte gjakrat, i nxehu ato më shumë, dhe deputetët shkodranë, ishin ato që u veçuan edhe më shumë në një krah të vetëm. Kjo arriti deri në atë pikë, sa që në zgjedhjet e 1923, grupi i deputetëve katolik shkodranë do të dalë, në një grup të vetëm nën emrin "Ora e Maleve". Rëndësia e këtij grupimi ishte, se arriti të krijonte një fushatë të vërtetë zgjedhore, dhe një organizim, i cili dallonte nga partitë e tjera në vënd. Një grupim, që erdhi nga shtypi, si grupim intelektual dhe u fut në politikë. Megjithatë suksesin e fitoren në Prefekturën e Shkodrës, kjo fitore çoi në diferencimin tashmë jo të një grupimi deputetësh, por të gati krejt Prefekturës së Shkodrës nga politika qëndrore që bëhej në kryeqytet.

Fjalë kyçe: Shkodra, Këshill Kombëtar, Bashkimi i Shenjtë, Mirdita, Luigj Gurakuqi.

Hyrje

Viti 1921 kishte nisur me ligjin për zgjedhjet e prillit 1921, dhe kishte vazhduar me këto zgjedhje, të cilët kishin nxjerr për herë të parë një Këshill Kombëtar të zgjedhur nga vota e shqiptarëve në dy shkallë. Brenda Shqipërisë nuk kishte pasur parti politike të plota. Në atë kohë kishin nisur të krijoheshin grupime politike që pretendonin, se ishin parti, megjithatë akoma ishin në hapat e parë. Në vënd ekzistonin dy grupime të tilla politike që ishin në Parlament; Partia Popullore e krijuar më 24 prill 1921 (Dervishi, 2005, 131), dhe pak ditë më vonë u krijua edhe një parti tjetër, Partia Përparimtare. Grupimet nuk ishin koherente brenda vetes, sidomos partia e parë. Kur u krijuan këto parti, deputetët e Shkodrës, për shkak se akoma nuk kishin rënë në konsensus për raportin e numrit të deputetëve mbi baza të përkatësisë fetare, akoma nuk ishin të përfshirë në asnjërën prej partive. Megjithatë në kohën kur hynë në parlament ishin afruar drejt Partisë Popullore.

Në këtë vit të parë të parlamentit, shohim se jo vetëm problemet e brëndshme janë të shumta, por edhe probleme madhore për vendin jashtë tij, nisin të kenë ndikim në ecurin dhe stabilitetin e vendit. Kërkesat e here pas here nga Mirdita për autonomi, dhe shfrytëzimi i kësaj situatë nga Jugosllavia, e kishin acaruar situatën në vend. Deputetët shkodranë kishin dhënë alarmin për një situatë të tillë duke i veshur edhe qeverisë fajet e saja të cilat që nga marsi i 1921 nuk kishte marrur masat e duhura (A.Q.SH., 1921, 175). Kryeministër i kësaj kohe ishte Iliaz Vrioni, në qeverinë Vrioni 1 (15 nëntor 1920 – 1 korrik 1921) dhe Vrioni 2 (11 korrik – 16 tetor 1921), ku shohim se deputetët e Shkodrës, kryesisht ato katolik nuk ishin të kënaqur me veprimtarinë e tij në Mirditë. Arrihet deri aty sa At Gjergj Fuishta shprehet në Hylli i Dritës se qeveria me sjelljen e tij e kishte lënë pas dore Mirditën, dhe indirekt vetë ajo, e shtynte në veprime të tilla.

Deputetët shkodranë, si pjesë e “Bashkimit të Shenjtë” gjatë vitit 1921

Kërcënimi jugosllav në Mirditë, u pa se i vuri në rrezik kufijtë e brishtë të Shqipërisë, dhe në një rast të tillë, deputet të veçantë nga të dy partitë menduan, që do të ishte më mirë të ishte një bashkim interesash kombëtare, përballë këtij rreziku. Ky lloj bashkimi u quajt “Bashkimi i Shenjtë” (Frashëri, 2008, 259), me një emër tepër pompoz, por që rruga e tij nuk do të ishte e gjatë. Brenda këtij grupimi, që në ideimin e tij, shohim edhe rolin e deputetëve të Shkodrës. Në krye të këtij grupimi qëndronte Hasan bej Prishtina, Mustafa Merlika – Kruja dhe Luigj Gurakuqi (Vlora, 2001, 182). Megjithatë, pjesë e kësaj organizate ishte edhe At Gjergj Fishta. Nëse për Luigj Gurakuqin dëshmitë vijnë nga bashkëkohësit, At Gjergj Fishta e deklaroi vetë në një letër, të cilën i dërgon provincialit të tij, At Pal Dodaj. Letra, që mban datën 12 tetor 1921, deklaroi se, “në mbrëmjen rreth orës 11, kishin formuar Bashkimin e Shenjtë (Dema, 1941, 124), duke parë se vendit i nevojitej një bashkim më i forte, me qëllim për të ruajtur kufijtë e 1913, deputet nga Partia Popullore, Partia Progresiste dhe deputetët e pavarur ishin bashkuar në këtë qëllim” (A.Q.SH., 1921, 1). Lajmërimi jepet po nga At Gjergj Fishta në Hyllin e Dritës të po atij muaji e ku bashkë me nënshkrues organizatorë si Ferid Vokopola, Bahri Omari, Qazim Koculi, është edhe emri i at Gjergj Fishtës.

Megjithatë deputetët Luigj Gurakuqi dhe At Gjergj Fishta nuk ishin të vetmit që ishin të përfshirë. Në protokollin e krijimit të datës 10 tetor 1921 brenda grupit të 40 deputetëve janë edhe deputetë të tjerë shkodranë si nënshkrues, të tillë si: Riza Dani, Ndre Mjeda, Patuk Saraçi, Kolë Thaçi, Maliq Bushati dhe Halid Rroji.

Suksesi i Ahmet Zogut, i cili drejtonte forcat ushtarake në Mirditë, e dobësitë që po shfaqte Qeveria Vrioni 2, e bënë që Iliaz Vrioni të paraqiste dorëheqjen me 16 tetor 1921, pas një kërcënimi, të cilit i ishte bërë atij nga katër vetë, por që gjatë deklaratës, ai nuk i përmend me emër (B.K.K., 1921, 483). Por shprehet, se pranon vetëm në mënyrë zyrtare të gjykohet sipas ligjeve në fuqi, e siç e shprehte rregullorja, duke e vendos qeverinë e tij përpara Parlamentit për votëbesim. Kjo qeveri votohet për t’u rrëzuar. Nga 55 deputetë të pranishëm në sallë, 39 prej tyre votojnë për t’a rrëzuar qeverinë. Të bie në sy, se në atë seancë të shkurtër, nga deputetët shkodranë, nuk ishin të pranishëm vetëm Hil Mosi dhe Xhemal Bushati, kurse pjesa tjetër e deputetëve të Prefekturës që ishin të pranishëm nuk mori fjalën, duke heshtur në këtë ngjarje. Një veprim ky, që të lë të kuptosh, se në heshtje e pranonin dorëheqjen e kësaj qeverie,

duke qenë se ishin pjesë nënshkruese e Bashkimit të Shenjtë. Rezultati i dytë i këtij bashkimi ishte krijimi i qeverisë së re nën emrin e Pandeli Evangjelit, deputetit të Korçës. Ky kishte qenë një mik i ngushtë i Dom Ndre Mjedës, që herët në kohën kur ky i fundit kishte qenë seminarist në Krakov. Sipas shënime për këtë ngjarje në ditarin e vet, At Pal Dodaj shprehet se ditë përpara se të bëhej kryeministër, kishte pasur një takim mes këtyre të dyve (B.K.K., 1921, 486).

Votëbesimi i qeverisë së re u bë në mbledhjen pasardhëse vetëm tre ditë më vonë me date 19 tetor 1921, ku shihej qartë se në këtë mbledhje ishte krijuar një ndasi e re. Në parlament bënë pjesë vetëm deputetët që ishin pjesëtarë të Bashkimit të Shenjtë, kurse një pjesë e deputetëve tjerë kundër kësaj nuk kishin marrë pjesë. Për sa i përket deputetëve të Shkodrës, nuk merrte pjesë Riza Dani dhe Halid Rroji, të cilët mungonin, si dhe Hil Mosi, i cili ishte i nisur me mision dhe Xhemal Bushati, i cili kishte marrë leje (B.K.K., 1921, 487). Këto dy të fundit nuk ishin pjesëmarrës në fakt në Bashkimin e Shenjtë. Qeveria ishte më shumë një kompromis ndërmjet dy partive; Përparimtare dhe Popullore, megjithatë nuk kishte personalitetet më të zotë në ato dikastere, ajo thjeshte u nda përgjysëm, kurse kryesimin e mori ana e krahut popullor (Merlika, 2001, 297).

Program i paraqitur në parlament nga Pandeli Evangjeli është ndër më të shkurtët që kishte paraqitur një qeveri në parlament gjatë gjithë legjislaturës së parë, dhe shihet se më tepër ka një karakter formal. Ai shprehet se ka si qëllim njohjen e shtetit shqiptar në arenën ndërkombëtare, dhe se në politikën e brendshme, parimi i qeverisjes do të ishte "*Qeverim i pëlqyer prej të Qeverisurve*". Gjithashtu qëllimi i kësaj qeverie do të ishte edhe rritja e arsimit në shoqërinë shqiptare duke shtuar numrin e shkollave, si edhe atyre pedagogjike për rritjen e numrit të mësuesve. Kjo qeveri do të përpiqej për krijimin e një shkolle të lartë për nxjerrjen e nëpunësve të ardhshëm të aftë. Në aspektin ekonomik, do të rritej taksa doganore, dhe qeveria duhet të ishte në kursim, megjithatë nuk e analizonte mirë fushën ekonomike të shpërndarë në sektorë të veçantë për të thënë se cila do të ishte mënyra e balancimit të buxhetit.

Ajo që të bie në sy, është mungesa e analizës së kësaj qeverie e Luigj Gurakuqit, i cili gjatë gjithë kohës analizonte programet e qeverive gjatë të dy legjislaturave. Por nuk ishte i vetmi që nuk replikoi për programin, sepse për këtë qeveri nuk pati asnjë kundërshti dhe asnjë analizë. Përkundrazi Gurakuqi deklaroi, se në vërtetë e dëgjuam programin, por realisht kjo nuk ishte fort e nevojshme, sepse vetë Pandeli Evangjeli së bashku me ministrant e përzgjedhur janë një program më vete (B.K.K., 1921, 489). Këto ministra sipas Gurakuqit, plotësonin dy cilësina; zotësinë dhe atdhetarinë, çka i bënte ato që votëbesimin t'ia jepnin me gjithë dëshirë. Fjalimi i tij në këtë moment ishte një superlativë përgëzimi më shumë se asgjë, e kjo na jep vërtetë fakte për të kuptuar rolin që kishte pasur ky deputet në Bashkimin e Shenjtë. Ndërkohë që deputetët e tjerë të Shkodrës nuk dhanë asnjë lloj sygjerimi tjetër. Qeveria u votëbesua.

Në votëbesimin e qeverisë, si pjesë e qeverisë nga deputetët shkodranë ishte vetëm Hilë Mosi në rolin e Ministrit të Arsimit, i cili vetëm pak kohë më vonë u zëvendësua nga Rexhep Mitrovica. Kurse po pak më vonë Kolë Thaçi, pjesë e Bashkimit të Shenjtë, zuri vendin e Ahmet Daklit në Ministrinë e Financave (Dervishi, 2005, 147), pas kundërshtisë që i bëri fort, kryeministri Evangjeli, regjentit të Këshillit të Naltë, Aqif pashës, i cili donte të vendoste Shuk Gurakuqin, një tjetër shkodran.

Megjithatë kjo aleancë nuk e pati jetën fort të gjatë, ajo u rrëzua me 6 dhjetor 1921.

Grupimi ishte një bashkim më shumë utopik i njerëzve me qëllime dhe interesa shpeshherë të ndryshme. Të nisur nga një situatë, e cila tashmë kishte perfunduar, siç ishte rreziku i dalë nga sulmi jugosllav në Mirditë në pranverë – verën e 1921. Si rrjedhim, pranimi nga ana e deputetëve të Shkodrës, gjatë ftesës për bashkim, nga të dy partitë kishte ardhur për shkak të kësaj ngjarje, kurse partitë politike i kishin ftuar këto deputetë, duke i parë ato si të gatshëm, për mbrojtjen që ato i bënin kryengritjes së Mirditës. Prej një reagimi të tillë, ato e kishin kuptuar fare mire, se këto deputet ishin të gatshëm për bashkëpunime të tilla, mjafton që të zgjidhej situatë politike dhe impakti ushtarako – politik që kishte krijuar.

Qeveritë që dolën më pas ishin shumë jetë shkurta, dhe vetëm brenda dhjetorit, kriza e atij muaji prodhoi 4 qeveri. Tashmë grupi ishte shpërbërë, ama afërsia mes anëtarëve të veçantë vazhdonte. Ndër ideatorët kryesor u fol që kishin qenë Hasan Prishtina si edhe Luigj Gurakuqi, të cilët edhe pse Bashkimi i Shenjtë tashmë kishte perfunduar ato e vazhdonin këtë lidhje nën këtë ndjesi, nën këtë bashkim. Në qeverin 5 ditore të Hasan Prishtinës, (7 – 12 dhjetor 1921) në korpusin qeveritar, një ndër ministrant do të ishte edhe Luigj Gurakuqi, si ministër i Punëve të Brendshme. Megjithatë Luigj Gurakuqi nuk ishte në Shqipëri për të marrë pjesë në qeverisje. Megjithatë rreth 1 vjet e gjysëm më vonë në një replikë me Terenc Toçin drejtesin e gazetës “Shtypi”, shprehet se nuk e mohon se e ka mik Hasan Prishtinën (Gurakuqi, 1923, 3-4). E gjithashtu, se ai nuk mund të thoshte sot si do të vepronte nëse do të ishte në Shqipëri, ama të linte të kuptohej se do të ishte i pranishëm brenda këtij formacioni. Gjithashtu njëri ndër anëtarët e Regjencës, Imzot Bumçi një njeri i dalë nga Prefektura e Shkodrës, kishte dhënë dorëheqjen në këtë kohë. Ai ishte simpatizant i “Bashkimit të Shenjtë” (Vlora, 2001, 184), dhe mbante lidhje të ngushta me grupin e deputetëve të Shkodrës. Një ndër njerëz, të cilët kishte qenë pjesë e Bashkimit të Shenjtë, por që relativisht kishte mbetur jashtë ministrive, gjatë gjithë kohës që ajo kishte vepruar ishte Ahmet Zogu. Në fillim ai i përkiste grupit të Popullorëve, megjithatë lënia jashtë e qeverive, e sidomos vendosja në vend të tij, si ministër i brendshëm Luigj Gurakuqin, në qeverinë e Hasan Prishtinës, bëri që gradualisht të prishej marrëdhënia e brishtë ndërmjet këtyre dy personaliteteve. Për më tepër, Gurakuqi tashmë kishte zënë postin ministror të cilin Ahmet Zogu e kishte pretenduar çdo herë dhe e kishte ushtruar.

Këto veprime, të cilat në kohë ishin afat shkurtëra dhe pa ndonjë rezultat shumë frytdhënës, patën një impakt të madh në kohët e mëtejme. Tashmë grupimi i deputetëve shkodranë, i cili kishte qenë në një krah e në disa ide i njëjtë me pjesën tjetër që i afroheshin Ahmet Zogut, me këtë veprim patën ndarjen finale mes tyre. Luigj Gurakuqi, At Gjergj Fishta, Dom Ndre Mjeda apo edhe deputet të tjerë sidomos të spektrit katolik nuk patën më çasje me përkrahësit e Ahmet Zogut, apo edhe me vetë atë. Kjo tentativë drejt polarizimit, çoi në rritjen e tensionit si brenda Kuvendit Kombëtar, ashtu edhe në politikën e përgjithshme. Situata në vend edhe tek popullsia nisi të polarizohet, pjesa katolike e Shqipërisë e pozicionuar kryesisht në krahun e grupimeve të deputetëve katolik të Shkodrës, mbante anën e deputetëve, të cilët u dolën kundra Ahmet Zogut. Kjo zonë ishte zona nga të cilët kishin dalur dhe kishin mbështetje këto deputet.

Tashmë kishte nisur koha e tensioneve të mëdha për politikën shqiptare të kohës. Ku interesat vetjakë si dhe inatet personale, jepnin një ndikim shumë të madh edhe në fatet e brendshme të Shqipërisë.

Grupi “Ora e Maleve”, nga grupim intelektual në grupim politik

Kjo lloj ndasie do t'i ketë frytet e saja, edhe pse të hidhura në të shumtën e rasteve, në vitet pasues, sidomos në vitin 1923. Periudha zgjedhore nisi të nxjerr në pah më me vrull, atë të cilën koha parlamentare, e kishte nxjerrur në pah me mjaft finesë dhe stil intelektual. Ajo çfarë ishte kritikuar nëpër replikat e seancave tashmë në kohën e fushatës merr një vrull më të madh. Vrull ky i shprehur fuqishëm në zonën e Shkodrës si nga krahu i deputetëve katolik, apo i grupimit katolik, ashtu edhe nga ato që të parët i quanin grupi zogist apo musajukan.

Në vitin 1923, kishim pothuajse dy vjet organizim politik mbi baza parlamentare në Shqipëri. Një organizim i nisur me qëllim të mirë, megjithatë i pa formuar ashtu sikurse duhej, apo ashtu sikurse teorikisht funksiononte. Grupimet parlamentare brenda parlamentit, me tepër funksiononin si grupime politike, sesa në kuadrin e partive. Dy partitë e krijuara që në 1921, të vetquajtura të tilla, ishin Partia Popullore e ajo Përparimtare (Duka, 2007, 131), të cilat veprimtarinë e tyre politike e ushtronin brenda Këshillit Kombëtar, ishin më tepër të ngjashme me grupimet politike. Në grupimin e parë përfshiheshin kryesisht deputetët e shtresave të larta bejlerë ndërkohë në grupimin e dytë atë popullor, që nga emri ishin të përfshirë ato deputetë të cilët ishin më tepër më afër shtresave të popullit e interesave të tyre. Por edhe brenda tyre kishte një bashkim më tepër opozitar se një grup interesi të përcaktuar saktë. Ngjarjet e grushtit shtetit 1921, dhe trazirat e Marsit 1922 në Tiranë, bënë që të prishej grupi i popullorëve, për shkak të qëndrimeve të kundërta lidhur me këto ngjarje. Tashmë kemi një ridimensionim të grupimeve ku në një krah ishte Bashkimi i Shenjtë, e në krahun tjetër Klika. E që më vonë njihej si grupimi qeveritar, e opozitar. Shkodra, që në zgjedhjet e para, kishte nxjerrur deputetë në një formë krejt më të veçantë sesa prefekturat e tjera. Deputetët dilnin mbi baza fetare, ku u vendos dalja e deputetëve në një raport të tillë, dy katolik në një deputet musliman, e kjo pas shumë peripecish. Një pjesë e deputetëve shkodran sidomos ato që mbështeteshin nga kleri e shtresa e katolikëve të Shqipërisë, e cila pjesa më e madhe e tyre jetonte brenda kësaj prefektуре, për një periudhë gati dy vjeçare të shtetit shqiptar, e kishte ndërjetë vetën të zhgënjyer nga ajo që priste nga politika e kohës (Rocca, 1994, 84). Kjo pjesë e deputetëve në këtë kohë ishte e pozicionuar në krahun opozitar, veprimtaria e tyre mjaft e dendur në politikë, si në atë parlamentare ashtu edhe në atë të shtypit të kohës ishte mjaft e dendur. Kjo gjë shihej edhe në gazetatat e revistat e kohës, si fjala vjen në Hyllin e Dritës, organ i i Franceskanëve të Shkodrës. Megjithatë kulmin politik katolikët në organizimin politik në shtyp, e arritën me një gazetë shumë të njohur nga viti 1923 deri në fund të vitit 1924 “Ora e Maleve”.

Ora e Maleve, nuk ishte thejshtë një gazetë opozitare, ai u krijua si një grupim opozitar, i cili mblodhi rreth vetes një pjesë të madhe të elitës katolike të kryesuar me klerin që nga vitit 1922. Sikurse e shpreha edhe më lart, që në 1922 grupimi i popullores u shpërbë, ose e humbi atë bashkimin e fillimit të deputetëve, e ndër deputetët e parë pas ngjarjeve që ndodhën ishin edhe një pjesë e deputetëve katolik si Luigj Gurakuqi, At Gjergj Fishta, Dom Ndre Mjeda e të tjerë. Këto deputet mbronin fuqimisht interesat katolike të kohës, si dhe kishin një lidhje të fortë me udhëheqësit fetar në qytetin e Shkodrës. Grupimi në fillim u krijua si grupim intelektual nën idenë dhe udhëheqjen e Dom Lazër Mjedës, arqipeshkvit të Shkodrës që nga 1922, i

cili ishte edhe vëllai i deputetit shkodran Dom Ndre Mjeda. Ky person kishte hedhur tezën e ndarjes së Shqipërisë në tre kantone kohë më parë, të cilën edhe në këtë kohë e mbronte si të nevojshme këtë tezë, kjo sipas tij për t'i dhënë më shumë çlirim situatës në të cilën ndodhej vendi (Peters, 2010, 58). Në përbërje të këtij grupimi intelektual ishin ato deputet shkodran që ishin në krahun opozitar sikurse At Gjergj Fishta, Luigj Gurakuqi, Dom Ndre Mjeda si dhe Shuk Gurakuqi, apo edhe intelektual fetarë aktiv në shtypin e kohës si Dom Lazer Shantoja apo edhe At Benardin Palaj, ish deputeti i Shkodrës dhe ish ministri i Financave Ndoc Çoba edhe plot figura të tjera të njohura në Shkodër.

Qëllimi i krijimit të grupimit nuk kishte qëllim ndarës, ai madje shprehet si një qëllim bashkimi i të gjithë shqiptarëve, po mbi të gjitha i bashkimit të katolikëve, ashtu sikurse shprehet edhe Luigj Gurakuqi në një letër që i drejtohet Dom Lazer Mjedës nga Tirana, me 30 tetor 1922. Nevojitet një organizim hierarkik dhe një organizim të dioqezave apo të arkidioqezave nën një person juridik të njohur nga shteti shqiptar kundrejt ligjeve. Pra shihej se kjo krijesë duhet të ishte kundrejt të gjithë ligjeve në fuqi. Brenda këtij grupimi u përfshinë shumë grupime të mëparshme edhe kulturore të kohës, e dy ndër më kryesoret ishin edhe shoqëria "Rozafat" dhe ajo "Bogdani", e të dyja këto e ndjenin nevojën, se duhej të ishte një fletore e kohës. Veprimi më i mirë u duk bashkimi i tyre me grupimin e "Orës së Maleve" dhe nxjerrja e një fletoreje të përbashkët. Tashmë grupi ishte i mbledhur dhe i njohur si pro katolik dhe anti qeveritar, me qëllim mbrojtjen e interesave të Shqipërisë, megjithatë ato ishin si një lobim mbi baza fetare, mbrojtës të katoliçizmit.

Numri i parë i kësaj gazete doli me 15 prill 1923 e do të zgjas deri me 25 prill 1924, gazeta kryesisht shpërndahej në dyert e kishave të Shkodrës, por edhe shpërndahej me abonime, si edhe në territore jashtë prefekturës së Shkodrës. Kurse dy kryeredaktorët ishin i pari Shuk Gurakuqi, deputet gjatë gjithë kësaj kohe, dhe më pas Luigj Mjeda (Pretota, 2008, 443). Që në numrin e parë të saj, në një prezantim të vetes, por që nuk mund ta quash një program të saktë të saj për të ardhmen ato shprehen se do të jenë mbrojtës të interesave të prefekturës së Shkodrës, por pa iu larguar atyre mbarë shqiptare (Drejtori, 1923, 1). Në një farë mënyre paraqitet haptazi në mbrojtje të interesave të qytetit të Shkodrës, kjo gazetë, ky grupim që në krijimet e saj ashtu sikurse edhe një pjesë e deputetëve të lartpërmendur që merrnin pjesë në këtë grupim, edhe në parlament jo rrallë herë kishin bërë lobim për Shkodrën. Gazeta paraqitet si një gazetë gjysëm rajonale e gjysëm kombëtare, edhe pse në të ardhmen do jetë e përfshirë thellë edhe në probleme mbarë kombëtare që ndodhin jo vetëm brenda kësaj prefekturë.

Padyshim që një ndër njerëzit më aktiv të kësaj kohe në këtë gazetë dhe brenda këtij grupi ishte Luigj Gurakuqi. Ky deputet njihej si një ndër deputetët kryesor të grupit opozitar dhe i nëngrupimit katolik. Gjithashtu Luigj Gurakuqi ishte ai që mbante peshën kryesore në këtë gazetë, ku një pjesë e artikujve më të rëndësishëm të kësaj gazete janë të shkruar prej tij, kryesisht gjatë vitit të parë të jetës së saj. Ai bashkëpunoi thellë me këtë gazetë në shkrime dhe redaktime ideologjike dhe gjuhësore, e së bashku me të edhe Pader Anton Harapi (Harapi, 1944, 68).

Gjatë gjithë kohës kjo gazetë shkroi artikuj kryesisht kundra qeverisë e jo rrallë herë në mbështetje të opozitës, megjithatë veprimtarinë e tij kryesore opozitare, e nisi rreth fund shtatorit 1923, në atë kohë kur ishte mbyllur legjislatura e parë parlamentare, dhe kish nisur ai boshllëk i cili dalëngadalë po përdorej për fushatën elektorale të

ardhshme. Një pjesë e artikujve të kohës janë therës dhe kritikues ndaj qeverisë që ishte aktualisht, e veçanarisht kryeministrit (A. Zogu). Kjo gazetë ishte ajo që e godiste më tepër Ahmet Zogun, dhe është e qartë arsyeja pse. Luigj Gurakuqi ishte një ndër deputetët më kritikues të Ahmet Zogut brenda Këshillit Kombëtar, e kjo gazetë ishte gazeta kryesore, që publikonte shkrimet e tij. Edhe pse ai nuk e kishte pranuar të ishte kryeredaktor i saj, ai ishte një ndër njerëzit që e drejtonte këtë gazetë. Megjithatë nuk ishte i vetmi kritikues ndaj qeverisë brenda gazetës.

Në artikuj të ndryshëm nisin me thirrjen se shqiptarët nuk duhet t'u besonin gjithkujt kur jepnin votën, e që me anë të kësaj shprehje akuza indirekte se në lidhje me premtimet kishte pasur edhe mashtrime në kohën e veprimtarisë politike pas zgjedhjeve të para. Jo rrallë herë u kujtohet panorama se si ishte periudha dy vjeçare e legjislaturës së parë. E duke shprehur, se koncepti i nacionalizmit kishte rënë më poshtë se ai i interesit personal (W, 1923, 4), duke akuzuar deputetët që jo rrallë herë kishin humbur kontaktet me elektoratin, i cili i kishte zgjedhur. Artikuj që shpeshherë u drejttoheshin edhe deputetëve të Shkodrës, të cilët ishin pak të lidhur me Shkodrën apo me elektoratin shkodran, sidomos ato të cilët ishin në krahun e qeverisë.

Në një artikull të tetorit 1923, në një kohë kur tashmë nuk kishte më Kuvend Kombëtar, deklarojnë haptaz tashmë se kjo gazetë, ky grupim është një grupim në mbrojtje të interesave të katolikë, dhe jo domosdoshmërisht opozitar, ama në mbështetje të veprimeve të tyre kur ato janë në të njëjtin krah me interesat e tyre. Një shprehje e qartë kjo për herë të parë se grupimi katolik ishte një grupim më vete me interesat e tyre dhe që bashkëpunonte me veprimtari të veçanta me opozitën. Ato janë të mendimit, që në fillim ishte dashur krijimi i Kuvendit Kushtetues pra një sistem që të ishte më afër krijimit të një sistemi të plotë kushtetues në Shqipëri, por interesat qeveritare nuk e kishin lënë këtë (W, 1923, 1). Madje ato ishin për një rritje të mëtejshme të sistemit zgjedhor për një hapje të tij në votim direkt ose një rritje të zgjedhësve të dytë, një pikë kjo që i bashkonte me opozitën.

Ato çdoherë i kujtonin qeverisë se pjesa më e madhe e fajeve që gjëndja e Shqipërisë ishte e tillë ishte për shkak të qeverisjes së tillë. Deputeti i Shkodrës Hil Mosi shkruante shpesh në këtë gazetë, ku shprehje se, edhe nëse opozita ka faje që nga komisionet e ligjeve që drejtonte kishte sjellë për miratim ligje jo kompetente, faji ishte i qeverisë, e cila kishte pranuar t'i zbatonte. Gjithashtu akuzohet direkt qeveria, e cila ishte në këtë kohë, pra ajo e Ahmet Zogut e cila edhe pse fajëson ligjet, që kishte gjetur, nuk bëri ligje të reja, për të përmirësuar gabimet që kishin bërë komisionet ligjore (Redaksija, 1923, 1).

Megjithatë sjelljen totalisht vlerësuese pro opozitës e shohim në nëntorin e 1923, në atë kohë kur në vend kishte nisur plotësisht fushata elektorale. Në këtë artikull, shohim ndoshta kulmin e shkrimit opozitar të kësaj gazete, një artikull shumë i goditur po në shumë raste edhe i fryrë ndoshta në shprehje e në vlerësime ndaj opozitës. Krahasimet që i bën opozitës, janë tepër superlative duke e krahasuar atë me të bukurën e dheut, e që qëllimi i vetëm i saj ishte ç'armatosja e popullsisë. Ndër ato që kritikohen apo lakohen më shumë ishte Ahmet Zogu dhe deputeti tjetër shkodran Ministër i Financave për një kohë tepër të gjatë Kolë Thaqi. Ky i fundit akuzohet se kishte rritur krizën dhe zinë e bukës në pjesën veriore të vendit dhe njëkohësisht se kishte blerë drithë në një sasi tepër të pakët, për qëllime të tjera e jo për qëllime për të ulur urinë e këtyre zonave. Jemi në një kohë, kur veriu i vendit e një pjesë e Prefekturës së Shkodrës vuante shumë nga kriza e urisë. Një muaj më

vonë do jetë drithi përsëri, i cili bëhet shkak të akuzohet qeveria e cila abuzon me të duke e shpërndarë në zonat elektorale të Mirditës për të fituar vota në krahun e proqeveritares (Redaksija, 1923, 3). Çka do të thotë se në një farë mënyre e bën përgjegjës edhe ministrin shkodran i cili e njihte këtë zonë.

Në Shkodër në këtë kohë ekzistonte edhe një gazetë tjetër mjaft prestigjioze për kohën nën emrin "Republika" e drejtuar nga Mirash Ivanaj, vëllai i deputetit tjetër të Shkodrës, Nikolla Ivanaj gjatë legjislaturës së pare, i cili jo rradhë herë replikonte me artikuj të ndryshëm në fillim me gazetën e më pas me deputetët e dalë nga Ora e Maleve. Në një artikull të saj, ai e lidh gazetën plotësisht si një vazhduese të gazetës pro austro hungareze të asaj kohe Posta e Shqipnis. E kjo gjë nuk shihet si fyerje, as si një mohim nga ana e grupimit, të cilët shprehen se edhe nëse ishin të tillë, e kishin për nder, por mos të harronin shqiptarët se vetë Nikolla Ivanaj kishte qenë bashkëpunëtor, jo rrallë herë me të. Në fakt, ato nuk e shprehin në mënyrë të plotë, ama shihet qartë se, në këtë kohë ishte një gazete, që kishte ruajtur stilin e po asaj gazete, ku në fakt një pjesë e atyre, që më pak se një dekadë më parë kishin qenë aktiv edhe në atë gazetë.

Për gjatë tre muajve ato ishin shprehur mjaft për organizimin e zgjedhjeve, kishin komentuar, madje edhe ligjin zgjedhor apo kishin paraqitur edhe programe të grupeve të tjera politike të cilët merrnin pjesë. Program i tyre u paraqit tepër vonë, në krahasim me atë që bënin grupet e tjera. Ky program në gazetë u shfaq vetëm një javë përpara zgjedhjeve. Ai ishte një program i vogël prej 10 pikash. Në fakt në krahasim me partitë e tjera, ai ishte një program i vogël racional, çka bën të dyshimtë ngritjen e tyre në një shkallë më të lartë se grupi politik në atë të një partie. Dihej që drejtues nderi ishte Dom Lazer Mjeda, ai që e kishte themeluar grupin që në 1922, por që nuk ishte drejtues i kësaj partie. Gjithashtu edhe Luigj Gurakuqi ishte njeriu më aktiv i këtij grupimi edhe në rangun e deputetit të ardhshëm, nën siglën e Orës së Maleve, por edhe ky i fundit nuk ishte në cilësinë e kryetarit. Një grupim politik pa një kryetar de jure, dhe me dy kryetar de facto, Dom Lazer Mjeden si kryetar fetar, dhe drejtues laik Luigj Gurakuqi.

Në programin e tyre ato ishin për një regjim monarkik, çka rrjedhimisht do të thoshte se deri në zgjedhjen përfundimtare të një mbreti ato njihnin Regjencën. Gjatë gjithë kohës ky grupim, por edhe deputetët katolik të legjislaturës së pare, e kishin njohur formën më të mire, mbajtjen e një regjence dhe prisnin kalimin drejt një drejtimi nën një monark të ardhshëm. Arsyeja kryesore ishte, se i qëndronin besnik atij vendimi që konferenca e Ambasadorëve kishte dhënë për Shqipërinë, si formë e organizimi shtetëror, principatë autonome sovraane dhe e trashëgueshme (Xhafa, 2009, 98), që do të thoshte njohje e një sistemi monarkik. Dhe arsyeja e dytë ishte se në regjencë duke qenë katër vetë një për çdo besim, do të thoshte se brenda saj ruhej influenca e grupimit katolik.

Një ndër pikat kryesore e të domosdoshme ishte diskutimi i kryeqytetit i cili ato këmbëngulnin që të ishte Shkodra duke qenë se zgjedhjet ishin për Asamble Kushtetuese, ishte shpresa se do të flitej edhe për kryeqytetin dhe në bazë të kësaj mendohej se ishte moment më i duhur. Program i kësaj partie, sikurse vërehej ishte i krijuar edhe mbi idetë e hedhura, si dhe mbi bazat e atyre diskutime të cilët ato kishin prekur gjatë bisedimeve në Kuvendin Kushtetues. Program jo vetëm ishte i shkurtër, po realisht në shumë gjëra kërkonte të ruante status quo-n aktuale. Kërkohej mbajtja e shkollave private, të cilët ishin sulmuar shumë gjatë gjithë kohës,

kërkohej martesë fetare të njëjës, madje edhe në administratë kërkohej të ruhej dhe të përshtatej nevojave të vendit ku ndodhej, çka do të thoshte që në zona të ndryshme, të ruhej raporti shpeshherë edhe fetar siç ishte rasti i Shkodrës. Anë tepër pozitive ishte kërkesa për kontroll të financave publike, investimeve të ndryshme që bëheshin në Shqipëri, apo edhe kërkesa me çdo kusht të pavarësisë së sistemit gjyqësor, me një fjalë ruajtje e mos cënimit të pushtetit të tretë.

Grupi ishte i bashkuar edhe me grupimin musliman të Sulçe beg Bushatit (Dervishi, 2005, 193). Edhe pse ishin pra një grup pro katolik, kishin të bashkuara interesat së bashku me këtë grupim i cili edhe ky ishte kundër grupit të Musa Jukës, i cili ishte i krahut pro qeveritar dhe mbështetës i Ahmet Zogut që në zgjedhjet e vitit 1921. Pas bashkimit të këtij grupimi, i cili kishte bashkuar forcat me Orë e Maleve, arriti të kishte mbështetje edhe në krahun musliman të qytetit duke nxjerrë më vonë deputetë musliman brenda krahut opozitar në Prefekturën e Shkodrës.

Fushata zgjedhore edhe pse nuk ishte shprehur fort mbi probleme fetare, të cilët tashmë diheshin raportet fetare në Prefekturën e Shkodrës, kishte pasur një fushatë me një konkurrencë të ashpër, në një krah ishte grupi i Orës së Maleve dhe në krahun tjetër ishte grupi proqeveritar i Musa Jukës. Propaganda e bërë nga krahu i Orës së Maleve ishte e organizuar më mirë, e dukej se po jepte më rezultat një grup, i cili kishte rreth një vjet e gjysëm që ishte krijuar, me një pjesë të deputetëve të legjislativës së mëparshme të pëfshirë brënda, e bënte që kjo fushatë të ishte në favorin e tyre. Por jo rrallëherë e kishin pasur edhe të vështirë. Grupi pro qeveritar ishte i organizuar zyrtarisht shpeshherë, në shumë raste kishte pasur veprime flagrante, ku zyrtarë të shtetit në rangje të larta deri edhe nën prefekte ishin zënë duke bërë hapur fushatë elektorale, siç ishte rasti i Z. Këlliçi, nënprefekt i Lezhës. Një rast shumë acarues edhe pse nuk pati incidente ishte më shumë në zonat jashtë Shkodrës, aty ku ndoshta organizimi dhe syri i qendrës nuk ishte i fortë në pamje të parë.

Megjithatë një pjesë e këtyre shkeljeve u demaskuan që heret, kryesisht në zgjedhësit e dytë. Shkelje të shumta kishte në zonën e Koplikut, të cilët kishte pas mbyllje të votimit të para kohës, kërcënime të shumta atyre zgjedhësve të dytë, të cilët njiheshin se ishin pro Orës së Malëve. Gjithashtu duke lëvizur qendrat e votimit nga Nënshkodra, e duke i kaluar për këto të fundit në Koplík, e për të gjithë votuesit proqeveritar, të cilëve ishin paguar makina për t'i dërguar deri atje.

Një rast tjetër ishte nënprefektura e Lezhës, në të cilën përfekti kishte nisur thasët me drithë në zonën e Mirditës, për t'i sjellë rreth vetës votuesit. E gjithashtu kishte përdorur edhe shantazhin ndaj At Klement Miraj që i përkiste grupimit Ora e Maleve, duke dashur ta largonin me çdo kusht nga zona e votimit.

Por veprimet ishin sporadike, për sa i përkiste incidenteve zgjedhore. Pas zgjedhjeve të mbajtura me 27 dhjetor 1923, grupimi i Orës së Maleve fitoi bindshëm në të gjithë zonat e votimit. Ky ishte një sukses i plotë i këtij grupimi. Në pesë zona që u morën vesh rezultatet e votimeve, të nesërmen e datës së zgjedhjeve, rezultati ishte 4 me 1, në favor të grupimit të Orës së Maleve. E vetmja zonë e cila kishte një fitore të lehtë sipër në këtë prefekturë ishte Koplík, ndërkohë që nga zona e Mirditës akoma nuk kishin ardhur rezultatet, por shihej se cili do që të ishte rezultati atje, nuk përmbysje asgjë në rezultatin e përgjithshëm (Redaksija, 1923, 1). Përsa i përket Koplikut, grupimi i Orës së Maleve, gjatë gjithë kohës ishin ankuar për parregullsi edhe për ndërhyrje të nëpunësve të shtetit në këtë zonë zgjedhore.

Organizimi politik nën emrin Ora e Maleve, ishte hera e parë që grupimi katolik

organizohej kaq mirë në zgjedhje, ndryshe nga legjislatura e parë ku kishte pasur konflikte edhe mes grupimeve katolike. Në këtë kohë, shohim se kemi një grupim më solid, të cilëve kjo punë i dha një sukses të plotë. Duhet thënë se edhe puna e Dom Lazer Mjedës, ishte tepër e plotë në një organizëm të tillë të klerit dhe laikëve katolik si një grupim i tillë. Dom Lazer Mjeda, edhe pse nuk arriti të krijonte një kanton katolik, arriti të bënte të parin grupim politik në parlamentin shqiptar. Një grupim, i cili kishte në përbërje të tij njerëz mjaft aktiv në parlamentin e ardhshëm jetëshkurtër gjatë vitit 1924.

Dom Mjeda, gjatë periudhës së zgjedhjeve, i kishte shkruar një leter baritore të gjithë votuesve katolik duke dashur të ulte gjakrat dhe të ruante qetësinë në vend për zgjedhjet që do të vinin, roli i tij ishte tepër paqësor dhe në korrektësi të mirë me ligjin zgjedhor në fuqi. Organizimi i mirë në njërin krah ishte sekret i suksesit, por nuk duhet harruar se ishte edhe një kohë e cila prefekturën e Shkodrës, më shumë e kishte larguar nga qeveria e Zogut.

Viti 1924 po e gjente Shkodrën dhe zonat e brëndshme të saj, në një krah politik tërësisht opozitar. Përplasjet, përballjet apo edhe incidentet politike të ndodhura brenda këtyre dy viteve çuan në këtë rezultat. Cila do të ishte ecuria e ngjarjeve brenda këtij viti politik që sapo kishte nisur, dihej që Shkodra do të mbante qëndrim opozitar.

Konkluzione

Situata në të cilën gjëndevoj vëndi, gjatë tre viteve të legjisklaturës së paë patrlamentare, kishte lënë edhe impakt jo të vogël në prefekturën e Shkodrës. Madje duke qenë se prefektura e Shkodrës ishte prefektura më e madhe në vënd, ajo ishte prekur nga probleme politike dhe ekonomike. Situata më domethënëse, ku problemet ekonomike ishin transformuar në probleme politike ishte më së miri, të shprehura në krynegritjen e Mirditës. Deputetët shkodranë duke qenë se ishin të një niveli të lartë intelektual e shihnin se dhuna nuk do të /onte në zgjidhje të situatës politike. Si rrjedhojë, ato ishin iniciatorët, dhe frymëzuesit e bashkimit të Shenjtë. Ky bashkim i cili në pamje të jashtme kishte si qëllim vendosjen e një ekuilibri brenda forcave politike. Stil politik ky i përdor shumë edhe në Evropë, por i pasuksesshëm në vëndin tonë. Kjo të linte të kuptohej se politika jonë ishte larg asaj evropiane. Tek ne mungonte vullneti politik që një strukturë politike evropiane të hidhej në praktikë. Pavarësisht se idetë e deputetëve shkodranë ishin mbase të përparura, edhe qëllimi i tyre, ishte për të ulur gjakrat në një kohë të rrezikshme për vëndin, sidomos gjatë ndërhyrjes jugosllave në Mirditë.

Rreth dy vite rresht Shkodra kishte ndjerë pak dorën e qeverisë, si në aspektin ekonomik, ashtu edhe në atë të punëve botore apo të problemeve kufitare. Siç ishte rasti i përmytjeve në Shkodër nga Drini, apo rasti i kufinjve verior duke u ndjerë të kërcënuar herë pas here. Problem i zisë së bukës në shumë prej zonave veriore apo të zonës së Mirditës që herë pas herë kërkoheshin fonde të veçanta apo vinin ndihma nga jashtë për t'i mbajtur me bukë. Ajo që ishte shumë më e rëndësishme brenda qytetit të Shkodrës, ishte zhgënjimi nga qeveria, e shkodranëve, për ta spostuar kryeqytetin në Shkodër. Edhe nëse gjatë legjislaturës parlamentare kjo nuk ishte kopetencë as e qeverisë as e Kuvendit Kombëtar, Tashmë me krijimin e Kuvendit Kushtetues, ishin ngjallur shpresat e mëdha se kjo do të ndodhte. Dhe i vetmi grupim që e kishte në

program të saj kërkesën për kalimin e kryeqytetit në Shkodër ishte grupimi i “Orës së maleve”.

Bibliografia

- A. Q. SH., F. Ministria e Punëve të Brëndshme, V. 1921.
- A. Q. SH., F. Pal Dodaj.
- Bisedimet e Këshillit Kombëtar në v. 1921. (1922). Tiranë.
- Bisedimet e Këshillit Kombëtar në v. 1923. (1924). Tiranë.
- Dervishi, K. (2006). Historia e Shtetit Shqiptar 1912 – 2005. Tiranë.
- Frashëri, K. (2008). Histori e qytetërimit shqiptar. Tiranë.
- Dema, B. (1941). At Gjergj Fishta: 1871-1940 numër përkujtimuer. Tiranë.
- Merlika, M. (2001). Antologji Historike. Elbasan.
- Vlora, E. b. (2001). Kujtime 1885 – 1925. Tiranë.
- Duka, V. (2007). Historia e Shqipërisë 1912 – 2000. Tiranë.
- Rocca, R. M. d. (1994). Kombësia dhe feja në Shqipëri 1920 – 1944. Tiranë.
- Peters, M. E. E. (2010). Përballjet e Historisë së Kishës Katolike në Shqipëri 1919 – 1996. Tiranë.
- Pretota, G. (2008). Populli, gjuha dhe letërsia shqiptare. Tiranë.
- Xhafa, B. (2009). Historia e Shqipërisë Periudha e Pavarësisë 1912 – 1939, Pjesa I 1912 – 1924. Shkodër.
- Gurakuqi, L. (1923, 8 Korrik). Qeverrija e opozita. Ora e Maleve.
- Drejtorija. (1923, 15 prill). Dy fjalë kënduesve. Ora e Maleve.
- W. (1923, 29 Shtatuer). E para legjislaturë parlamentare asht kah soset. Ora e Maleve.
- W. (1923, 13 Tetuer). Sugurimi i lirisë së votimit. Ora e Maleve.
- Redaksija. (1923, 22 Tetuer). Parlamenti e Qeverija. Ora e Maleve.
- Redaksija. (1923, 24 Dhetuer). Ndërhyrje e shpërdorime në çashtje të Zgjedhjevet. Ora e Maleve.
- Redaksija. (1923, 28 Dhetuer). E drejta e popullit duel në shesh. Ora e Maleve.
- Nache. (1921, Tetuer). Lajme rrokull Shqypnies. Hylli i Dritës, 6, 282 – 284.
- Harapi. A. (1944, Marc). Si e njoh unë Gurakuqin. Hylli i Dritës. 3. 66 – 70.

Teknologjizimi i arsimit, sfidë apo progres?

Nuredin Nazarko

Shkolla e mesme Mollaj, Korçë

Abstrakt

Të arsimohesh sot konsiderohet një nga gjërat mëse normale, madje edhe më të rëndësishmet. Rëndësia e arsimit të qenies njerëzore është kthyer në një bindje aksiomatike, aq sa nuk na intereson më nëse dikush i ka kapacitetet dhe potencialet për të përthithur dhe shprehur njohuritë. Të bindur katërçipërisht se pa kaluar nga hallkat e zinxhirit arsimor nuk ka shans të jesh një qenie njerëzore të gjithë po rendin të arsimohen, duke ëndërruar më pas një fund të suksesshëm përgjatë përkohësisë. Njeriut i pëlqen të ëndërrojë, të imagjinojë dhe suskese imagjinare, sepse kështu ndoshta lehtëson barrën dhe peshën e tensionit që buron nga vështirësitë e mëdha në rrugën e të arsimuarit. Evoluimi i shumë ideve, dhe praktikave në shoqërinë njerëzore nuk mund të mos prekte edhe arsimimin. Revolucioni tekniko – informatik ka gjeneruar shumë ëndërrime tek shumë syresh, ëndërrime të cilat janë duke i dhënë formë realitetit të të arsimuarit. Ndërtimi i realiteteve mbi baza ëndërrimesh e përfytyrimesh të nxitura nga instrumente artificiale, nuk mund të zbresë në skenë asgjë më shumë përtej mundësive. Të ndodhur mes kësaj gjendje, është detyrë e jona si qenie në botë që të përpiqemi sado flashkët, për të qartësuar idetë dhe përfytyrimet tona, për të larguar vallon e bukur të teknologjizimit, zbukuruar me lulet e progresit. Është mëse natyrore që ne të përpiqemi t'i çojmë gjërat drejt përmirësimit, drejt lehtësimit. Nuk duhet që për hir të këtij përmirësimi apo lehtësimi, t'i largohemi qëllimit të parëhershëm. Nuk duhet ta konsiderojmë veten të vetëmjaftueshëm, dhe të panevojshëm për askënd, meqënëse tashmë zotërojmë shkencën, teknologjinë. Këndellja nga këto ëndrra është sfida jonë.

Fjalë kyçe: Teknologjizim, Arsimim, Qenie në mundësi, Progres, Sfidë.

Hyrje

Mendojmë se nuk është e tepërt nëse arsimin e përcaktojmë si zemra e një shoqërie, për nga rëndësia që ka për të ndikuar në formësimin dhe zhvillimin e shoqërisë. Ashtu sikundërse zemra pompon gjakun drejt organeve për t'i mbajtur në jetë, ashtu edhe arsimit dërgon drejt segmenteve të shoqërisë njerëzore e nevojshëm për t'i shërbyer asaj në profile të ndryshme, me qëllim që të marrë atë çfarë është e nevojshme për të qëndruar në jetë.

Krahasimi i arsimit me zemrën dhe vlerësimin e tij me vlerën, peshën dhe rëndësinë që ka zemra për njeriun, jo thjesht në përmasën e saj fizike, nuk është aksidental dhe i atypëratyshëm. Në qoftë se shoqëria është e nevojshme për njerëz të arsimuar e kualifikuar, detyrimisht është arsimit ai që i jep atë për të cilën ka nevojë, si p.sh. mësues, pedagogë, juristë, mjekë, inshinierë, arkitektë, etj. Gjithçka që i duhet dhe nevojitet shoqërisë kalon nga arsimit dhe pikërisht për këtë shkak arsimit duhet t'i kushtohet një rëndësi e posaçme dhe krejtësisht e veçantë. Nuk duhet thjesht të teoretizojmë rreth rëndësisë së tij.

Kur themi që duhet t'i kushtohet një rëndësi e posaçme dhe krejtësisht e veçantë, nuk e kemi fjalën thjesht dhe vetëm për të mundësuar furnizimin e shoqërisë me profesionistët e nevojshëm. Me rëndësi e veçantë dhe e posaçme, nënkuptojmë

jo thjesht aftësimin profesional të individit, por mbi gjithçka edukimin e qenies njerëzore që dëshiron të arsimohet. Edukimi dhe profesionalizmi i qenies njerëzore që dëshiron të arsimohet, duhet të jetë kryefjala e çdo reforme që ndërmerret ndaj hallkave të sistemit arsimor, me qëllim që arsimit t'i shërbejë formësimit të qenies njerëzore sot, që nesër të kemi në shoqëri jo thjesht profesionistë, por edhe qenie njerëzore më së pari.

Përse duhet të na shërbejë arsimiti?

Arsimi duhet t'i shërbejë edukimit dhe profesionalizmit të qenies njerëzore. Shpesh kuptimin e edukimit apo profesionalizmit e konsiderojmë gati të parëndësishëm, pasi që kuptimësinë e tyre e quajmë të përfunduar qyshse kemi arritur në konkluzionin se tek edukimi ne shohim njeriun e urtë, të butë, të komunikueshëm, qytetarin e mirë, ndërsa tek profesionalizmi shohim aftësinë për të kryer dhe përfunduar një punë sa më saktësisht.

Jemi të mendimit se qenia njerëzore asnjëherë nuk duhet të përfundojë në kufijtë e shterueses për çështje të cilat janë pjesë të përkohësisë së tij, aq më tepër kur konceptet që përpiqet t'i shterojë më një shpjegim përfundimtar tipik shkencor, janë të rëndësishme jetike për qenien njerëzore. Këtë fat nuk duhet të kenë edhe dy konceptet mbi të cilat përpiqet të ndërtohet sistemi arsimor, edukimi dhe profesionalizmi.

Të kuptuarit dhe të interpretuarit e asaj çfarë ke kuptuar është çështje e rëndësishme e qenies njerëzore. Mundësitë për ta arritur këtë ekzistojnë, për aq sa ekziston edhe qenia njerëzore. Qenia njerëzore në përkohësi është një projekt, i hapur ndaj mundësive për realizimin e vetvetes. Kësisoj njeriu nuk mund t'i shterojë mundësitë që shtrihen para tij, për realizimin e vetvetes në përkohësi. Një prej këtyre mundësive që shtrihet para qenies njerëzore është edhe mënyra sesi i kuptojmë dhe interpretojmë konceptet themelore që afektojnë përfytyrimet dhe qëndrimet tona si qenie në mundësi, madje edhe si e shohim dhe kuptojmë edhe vetë kuptimin e interpretimit.

Sikundërse është e kuptueshme projekti i Dasein është Qenie në mundësi. Kjo *Qenie – drejt – mundësive*, që realizohet, është vetëvetja, një mundësi për Qenien, dhe është kështu, si rrjedhim i mënyrës sesi këto mundësi, ta pazbuluara, shfaqin përplasjet e tyre tek Dasein. Projekti i të kuptuarit, ka mundësinë e tij – që të zhvillojë vetveten. Këtë zhvillim të të kuptuarit ne e quajmë “interpretim”. Brenda interpretimit të kuptuarit afrohet në mënyrë të kuptueshme, e cila është kuptuar prej interpretimit. Brenda interpretimit të kuptuarit nuk bëhet diçka tjetër. Bëhet vetvetja. Një interpretim i tillë është nxjerrë thelbësisht si pjesë e kuptimit; i dyti nuk mund të rrjedhë prej të parit. Interpretimi nuk është as mbledhje e informacionit mbi atë çfarë është kuptuar, më saktë është zbulim i mundësive tashmë të projektuara si pjesë e kuptimit. (Heidegger, 1962, 188 – 189).

Qenia njerëzore, duke qënë Qenie në mundësi dhe në zhvillim të përhershëm, si rrjedhojë e mundësive ende të pazbuluara përbrenda saj, ka përpara vetes të gjithë hapësirën e mundshme për të kuptuar dhe interpretuar drejt, në rastin tonë edukimin dhe profesionalizmin.

Çfarë kuptojmë ne me edukim dhe profesionalizëm?

Synimi i edukimit të vërtetë s'është që të ndryshojë njeriun drejtpërdrejt (sepse shikuar hollë e hollë, kjo nuk është as e mundshme), por që me shembull, këshillë, pamje o me çfarëdo tjetër, të vë në lëvizje një rrjedhë të brendshme të përjetimeve, të

detyrojë një vendim fare të brendshëm në dobi të së mirës. Pa këtë s'ka ndryshim të vërtetë të njeriut, arrihet vetëm ndryshimi i sjelljeve, që mund të jetë i shtirur ose fare i përkohshëm. Sjellja që nuk angazhon gjakimin tonë më të thellë, që ka ngelur në sipërfaqe, s'është edukim, por dresurë. Edukimi përfshin pjesmarrjen tonë vetjake, përpjekjen tonë vetjake. Prandaj rezultati i edukimit është gjithmonë i ndryshëm dhe i paparashikueshëm. (Izetbegoviç, 2009, 125).

Edukimi i kuptuar dhe interpretuar drejt, ka si fokus njeriun me të gjitha mundësitë e tij, të zbuluara apo të pazbuluara ende, prandaj dhe synon ta tronditë, ta vendosë në lëvizje përbrendësinë e njeriut drejt së mirës. Gabimisht besohet se këtë gjë mund ta realizojë vetëm arsimit. Minimizohet deri në zhdukje roli i familjes. Është e rëndësishme të theksohet se arsimit mund të hapë horizonte të reja ku qenia njerëzore dëshiron të arrijë, ku qenia njerëzore mund të arrijë të shfaqë mundësitë ende të pazbuluara brenda saj, por mbjellja e farës së edukimit të njëmendtë mbetet detyrë thelbësore e familjes. Pa rolin përcaktues të familjes në edukim, sukcesi i arsimit në këtë pjesë mund edhe të vihet në dyshim. Ne nuk mund ta përcaktojmë të suksesshme një shoqëri ku vetëm arsimit përfytyrohet dhe perceptohet si edukues i brezinive të reja. Përkrahësit e këtij përfytyrimi mund edhe të kërkojnë statistika të prekshme për përqindjen e qenieve njerëzore që janë edukuar nga sistemi arsimor, duke e konsideruar edukimin një eksperiment në fund të të cilit duhet të kemi një substancë konkrete në provëz. Por a mund të jetë edukimi i njëmendtë substancë konkrete në provëz?

Edukimi është i pakapshëm dhe subtil, fare i tërthortë, ndikim në shpirtin e njeriut me dashuri, me shembull, me përdëllim, madje edhe me dënime, që vënë në lëvizje një aktivitet të brendshëm dhe e ndryshojnë njeriun. Dresura, shtazore në esencë, është sistem i masave dhe i veprimeve që shtaza njerëzore të detyrohet në sjellje të caktuar, në të a.q. sjellje të drejtë. Edukimi i përket njeriut, dresura shtazës. (Izetbegoviç, 2009, 125).

Përsa i përket profesionalizmit duhet të themi se nuk është e mjaftueshme që puna që ka marrë përsipër qenia njerëzore për ta kryer, të kryhet saktë. Përtej saktësisë, ajo çfarë është më e rëndësishme sidomos kur fokusi i veprimtarisë është qenia njerëzore në formim, profesionalizmi më shumë sesa saktësi, është përgjegjshmëri. Përgjegjshmëria nga ana e vet është vetë ekzistenca njerëzore, sepse të ekzistosh do të thotë të jesh përgjegjës mbi mënyrën sesi e jetëson jetën tënde si qenie në mundësi, apo si qenie në botë. Kryerja me përgjegjshmëri e një profesioni të caktuar është rrjedhim i drejtpërdrejtë i të kuptuarit dhe interpretuarit të ekzistencës njerëzore. Prandaj kur shtruar pyetjen se përse duhet të na shërbejë arsimit, kishim si synim të nxirrnim në pah pikërisht rolin që mund të luajë arsimit për ta grishur qenien njerëzore drejt horizonteve dhe mundësive që ende nuk i ka zbuluar brenda vetvetes, pa devijuar kuptimin e njëmendtë të gjërave dhe në rastin tonë të edukimit dhe profesionalizmit.

Teknologjizimi i arsimit – një tendencë tunduese

Nevoja e shoqërisë për të patur profesionistë në gjirin e saj, gjithmonë e ka grishur njeriun për të sjellë modele arsimimi në mënyrë që t'i përgjigjen kërkesave të shoqërisë. Bazuar tek nevojat e shoqërisë dhe tek dëshirat konsumeriste të saj, reformimi i vazhdueshëm i arsimit synon që të ketë gjithmonë një përputhshmëri midis këtyre nevojave dhe kurrikulave që do të mësohen e studiohen. Për të patur një efikasitet

sa më produktive dhe duke iu përshtatur ritmeve bashkëkohore të zhvillimeve teknologjike, edhe arsimit nuk mund të shpëtonte nga tendenca teknologjizuese. Lehtësirat që ka krijuar teknologjia janë mëse të prekshme edhe në fushën e arsimit. Sot mund të kemi një qasje shumë më të shpejtë dhe me rezultate ndaj njohurive, e – book, bibliotekave online, etj. Natyrisht që kjo lehtësi për akses tek mundësitë e sigurimit të shpejtë të diçkaje që na nevojitet, si p.sh. përdorimi i një fjalori online, shkarkimi falas i llojeve të ndryshme të librave, mund të konsiderohet me të drejtë një mundësi e madhe për këdo që dëshiron të lexojë.

Zhvillimi i teknologjisë dhe fuqizimi i saj duke ndërhyrë pothuaj në çdo sferë të jetës në ditët e sotme, dha efektet e veta edhe tek ndryshimi mbi mënyrat e transmetimit të njohurive. Transmetimi i njohurive tashmë ka si kryefjalë përdorimin e teknologjisë së informacionit. Klasat teknologjike në shumë vende janë një realitet i prekshëm dhe mëse normal. Kjo tendencë pritet të gjejë zbatim edhe në vendet më pak të zhvilluara dhe që e kanë të vështirë ta anshkalojnë këtë realitet të ri të krijuar nga ndërhyrja e teknologjisë deri dhe në detaje të jetës së njeriut. Pritshmëritë janë të mëdha. Besimi se me teknologjizimin e arsimit do të hapet një epokë e re dhe tepër produktive, duket të jetë tepër ndezullitës. Në sajë të kësaj ndezullie, jemi gati të investojmë qoftë edhe shuma të konsiderueshme për krijimin e klasave teknologjike, me shpresën se duke ndërfutur teknologjinë tek njohuritë, këto të fundit do të na ngjallin më shumë interes në sajë të zbulimeve teknologjike që do të shoqërojnë shpjegimet apo komentet mbi njohuritë. *De facto*, kjo lloj mënyre e transmetimit të njohurive duket të jetë tepër tunduese. Në qoftë se arrin të realizosh orë mësimore ku integrohet dhe teknologjia e informacionit, do të konsiderohesh i suksesshëm dhe ndjekës i ritmeve bashkëkohore të zhvillimit.

Sfidë apo progres

Duke iu referuar dy parashtrimeve të mësipërme, mbërrijmë tek pyetja së cilës nuk mund t'i shmangemi dhe as ta lëmë në harresë, përderisa çështja që shtrohet është e një rëndësie të veçantë.

Teknologjizimi i arsimit është një sfidë apo progres?

Mund të themi pa asnjë mëdyshje se kur përmendet fjala progres, apo kur diskutohet për progres natyrisht që nëpër mend nuk mund të na kalojë asgjë negative rreth progresit, madje gjithmonë progresi është konsideruar lëvizje në drejtimin pozitiv, përparim dhe zhvillim. Ky perceptim ndaj progresit nuk është i rastësishëm. Zhvillimi materialistik, veçanërisht pas Revolucionit II Industrial e thelloi rrënjosjen me karakter pozitiv të progresit në vetëdijen e njeriut, aq sa sot termi progres është kthyer në emëruesin e të gjitha zhvillimeve që çojnë drejt rritjes së fuqisë materiale, apo rritjes së mundësive për sundim ndaj natyrës.

Lëvizjen nëpër këto rrugina ne e quajmë Progres. Kjo ishte motoja e madhe e shekullit të kaluar. Njerëzit e panë historinë para tyre si një rrugë në të cilën marshoi me trimëri dhe gjithmonë përpara “njerëzimi” - në kuptimin e këtij termi të racave të bardha, ose më saktësisht banorët e qyteteve të tyre të mëdha, apo edhe më saktë, “të arsimuarit” midis tyre.

Po për ku? Për sa kohë? Dhe çfarë ka më pas?

Ishte paksa qesharak ky marshim drejt pafundësisë, drejt një objekti të cilin njerëzit nuk e kishin menduar seriozisht apo kuptuar qartësisht me veten e tyre, ose realisht,

nuk kishin guxuar ta parashikonin, sepse një objektiv është një fund. Askush nuk bën gjë pa menduar për çastin kur ai do ta ketë fituar atë që dëshironte. Askush nuk fillon një luftë, një udhëtim, apo madje dhe një shëtitje të thjeshtë pa menduar për drejtimin dhe fundin e saj. Çdo qenie njerëzore vërtet krijuese e di dhe i druhet boshësisë që pason pas kryerjes së një pune.” (Spengler, 2010, 22).

Shqetësimi që ne duhet të kemi para se ky proces të marrë trajtën e plotë është pikërisht boshësia. A do të jetë arsimit më i zhvilluar, më progresiv, sikundërse na pëlqen ta dëgjojmë të thuhet, në përfundim të teknologjizimit? A do të arrijë teknologjizimi i arsimit të shmangë pikërisht boshësinë, të cilën nuk duam ta mendojmë si fundin e pashmangshëm të një ndezullie të ushqyer nga fuqia e afektimit teknologjik?

Njeriu ishte dhe është tepër i cekët dhe frikacak për të duruar faktin e vdekshmërisë të çdo gjëje që jeton. Ai e mbështjell atë me një optimizëm të progresit të bojatisur me ngjyrë rozë, stivon mbi të lulet e literaturës, zvarritet pas strehës së idealeve për të mos parë asgjë. (Spengler, 2010, 23).

Duke iu referuar teknologjizimit të arsimit thjesht dhe vetëm si progresi paevitueshëm, apo si arsimit i së ardhmes, që çuditërisht besohet se do të jetë ende më e mirë nën fuqinë ndërhyrëse në rritje të teknologjisë në jetën e qenies njerëzore, i shmangemi përballjes me një të vërtetë të madhe, përkufizimin e veprimtarisë sonë nga fuqia e makinës dhe nënshtrimin para saj.

Makina punon dhe e detyron forcërisht njeriun të bashkëpunojë. E tërë Kultura arrin një nivel aktiviteti të tillë që toka fërgëllon nën të. (Spengler, 1928, volume two, 503). Padroni i botës po bëhet skllav i makinës, e cila po e detyron atë – po na detyron ne të gjithëve, jemi apo nuk jemi të vetëdijshëm për këtë – të ndjekë kursin e saj. (Spengler, 2010, 87).

Letëm (300-400 forca) mendonin të lëviznin në jug e të sulmonin në lindje Elbasanit³. Në Dragostunjë paria e Librazhdit mundi të arrijë marrëveshje për të ulur armët pasi vëllavrasja ishte në dëm të Shqiptare dhe se akoma “çështja kombëtare ishte në rrezik. Njëkohësisht paria vendosi se e tërë treva e Librazhdit të bashkohej në një njësi administrative, si pjesë përbërëse e prefekturës së Elbasanit”⁴. Për të ruajtur rendin dhe qetësinë duke rregulluar punët e përditshme, qeveria provizore e Elbasanit mendonte të organizonte postin e xhandarmërisë: 15 vetë në Çermenikë me qendër në Floq, 15 vetë të mobilizuar në Zgost e Mokër. Në qoftëse Quksi bëhej prefekturë mendohej të kishte një kompani milicësh. Në 4 maj të vitit 1913 Aqif Pasha njoftonte parinë e Gramshit dhe të rrethinave të tjera, se Elbasani u çlirua nga ushtria Serbe e cila filloi udhëtimin drejt Strugës, prandaj njofton ai derisa të bëhet organizimi i qeverisë qendrore krijoni qeverisje lokale për të ruajtur rendin dhe rregulluar punët e përditshme. Në muajin maj 1913 tendencat esadiste që mbollën përçarjen forcohen. Në 13 maj të vitit 1913 Ahmet Dakli i drejton një letër qeverisë së Vlorës ku sqaron pozicionin e Aqif Pashës. Elbasani dhe sidomos shkëlqesia e tij Aqif Pasha këtë iniciativë konsideronte si një paralajmërim që do të shkaktonte shkatërrimin e Shqipërisë. Aqif Pasha jo vetëm që kishte vendosur të mos aderonte në emër të Elbasanit, por ka thënë se ne jemi me qeverinë e Vlorës. Shumica e oficerëve shqiptarë e kishin inat Esat Pashën, e akuzonin si turkofil, partizan të Turqisë”⁵. Më 30 maj 1913 plot gjashtë muaj përpëlitse, përpjekje për ekzistencën e luftë, për mbrojtjen e tokave shqiptare, Konferenca e Ambasadorve të fuqive të mëdha në Londër shprehet për çështjen shqiptare. Në artikullin 2 thuhet ‘ madhëria e tij perandori i otomanëve ju lëshon madhërisë së tyre sovranëve aleatë të gjitha territoret e perandorisë së tij ne kontinentin Evropian me përjashtim të Shqipërisë”⁶.

Një vendim i tillë kishte rëndësi fundamentale pasi saktëson ekzistencën e shqiptarëve e të Shqipërisë jashtë sundimit turk dhe nuk lejon realizimin e synimeve të shteteve fqinje. Çështja Shqiptare mbetet në dorë të fuqive tlamtumirës, kryetari i qeverisë se përkohshme të Vlorës Ismail Qemali drejtuar prefekturës së Elbasanit me anë të të cilit njofton se: qeveria ju dorëzua komisionit të kontrollit të fuqive të mëdha.

Më 22 janar shkruan Ju them pra lamtumirë dhe atdheun dhe kombin e dashur e lënë dorë të perëndisë”⁷. Më 5 shkurt 1914 në telegramin e tij Aqif Pasha shkruan: “gjesti atdhetar i shkëlqesisë suaj i shton një fletë lavdie shërbimeve të larta atdhetare të bëra nga ju” Dorëheqja e qeverisë së përkohshme të Vlorës ndodh në një kohë shumë të vështirë për popullin e Librazhdit si për tërë popullin shqiptar. Lufta dhe përpjekjet e popullit të Librazhdit për progres ekonomik ishte e gërshtuar me luftën për drejtësi sociale e shoqërore dhe luftën për mbrojtjen e tërësisë tokësore të shtetit shqiptar në kushtet e reja historike.

³ Qeveria e Vlorës dhe veprimtaria e Saj, bot 11. Fq 307

⁴ Po aty. f. 308

⁵ Qeveria e Vlorës dhe veprimtaria e saj .bot 11. Viti 1962.f. 134

⁶ Po aty.Bot 11.f.140

⁷ Po aty. Bot 11. F.223

Konkluzione

1- Periudhën kohore,që i referohet gjysmës së dytë të vitit 1911 deri në janar 1914 e cila ka në brendësi dy tablo historike si: fundin e sundimit osman në Shqipëri e Librazhdit duke mbyllur historinë 500 vjeçare të sundimit turk dhe fillimin e jetës së pavarur të shtetit Shqiptar, e kam konceptuar si një periudhë historike më vete. Në këtë kontekst, rezistencën e popullit të Librazhdit gjatë gjithë kësaj periudhe e kemi studiuar në vijimësi e në mënyrë të vazhdueshme. Lëvizja kombëtare shqiptare në 28 Nëntor të vitit 1912 arriti objektivin final, Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë.

2- Treva e Librazhdit, në këto kushte historike shumë të vështira të përfshirë nga prapambetja e thellë ekonomike, kulturore e arsimore historikisht është shquar për tendencë progresiste kombëtare duke përdorur të gjitha format e luftës, duke mbështetur patriotët e mëdhenj shqiptar,të cilët kanë dhënë një kontribut të çmuar në mbështetjen e Pavarësisë Kombëtare.

3- Në realitetin historik të cilit i jemi referuar, paria e trevës së Librazhdit e mbështetur nga vegjëlja, shume herët ka shfaqur tendenca vetëqeverisëse, duke mos e njohur pushtetin dhe administratën turke. Ajo nuk ka lënë që momenti historik të shkojë atëherë kur koha e ka kërkuar, ka përdorur gjuhën e pushkës për tu çliruar njëherë e përgjithmonë sundimin turk. Janë me dhjetëra patriotë nga Bërzeshta e Çermenika të cilët kanë dhënë një rrezatim më shumë se rajonal,emrat e të cilëve përbëjnë një objekt studimi më vete. Ata kanë dhënë një kontribut të shquar në vitet 1912 dhe kanë mbështetur fuqimisht me të gjitha format e mënyrat Aqif pashë Elbasanin dhe Ismail Qemalin në realizimin e Pavarësisë së Shqipërisë. Pas vitit 1912 si për ironi të fatit populli i Librazhdit nuk i ka lëshuar armët. Ata i kanë bërë një rezistencë të fortë sulmit serb në trevën e Librazhdit, duke u bërë një barrierë mbrojtëse drejt pushtimit të mëtejshëm të Shqipërisë.

4- Paria e Librazhdit duke mbështetur vazhdimisht qeverinë e Vlorës ka kërkuar që të forcohet qeverisja lokale, të vendoset rendi dhe qetësia dhe të dyja pjesët në veri dhe në jug të Shkumbinit të përfshihen në një njësi administrative në përbërje të prefekturës së Elbasanit.

Beqir (Beg) Balla (1873-1954)

Beg Balla lindi në fshatin Orenjë më 1 gusht të vitit 1873. Në moshën 11- vjeçar u detyrua të emigrojë jashtë atdheut, në Selanik të Greqisë ku qëndroi tek dajat e tij nga fisi Xhurai i Floqit, të cilët e vendosën në shkollë. Ai mundi të marrë një arsim të mesëm (gjimnaz)mjaft të mirë për kohën. Në vitin 1879 kthehet në Shqipëri së bashku me disa abetare që i mori me vetë dhe ju përkushtua veprimtarisë për mësimin e gjuhës shqipe bashkëkrahinarëve të tij të Çermenikës. Beg Balla mori pjesë në aktin e madh të Shpalljes së Pavarësisë Kombëtare në Vlorë më 28 nëntor 1912, si përfaqësues i krahinës së Çermenikës etj. Beg Balla vdiq më 25.02.1954.

Shaban Blloshmi (1882-1929)lindi në vitin 1882 në katundin Bërzeshtë. Ai u bashkua me bërzeshtarët e aktivizuar për çështjen kombëtare në Stamboll, si Ibrahim Bërzeshta, Halit Bërzeshta etj. I kthyer në Shqipëri para vitit 1905, ai u hodh menjëherë në lëvizjen e armatosur kundër pushtuesve, duke vepruar sidomos me çetat e Elbasanit, Korçës, duke i ndihmuar e strehuar ato, por duke luftuar edhe vetë. Shaban Blloshmi mori pjesë aktive me armë në dorë për të mbrojtur pavarësinë e Atdheut etj. Shaban Blloshmi u vra në Bërzeshtë më 5 nëntor 1929.

Prof.dr.Ibrahim Lutfi Pasha (1823-1904)

Familja e Ibrahim Pashës duhet të ketë emigruar në vitet e fundit të gjysmës së XIX në Stamboll. Ai rridhte nga një familje e varfër fshatare. Babai i tij punonte bashkë me tre djemtë si kopshtar për të siguruar jetën e familjes, kurse Ibrahim dhe një vëlla tjetër u dërguan në shkollë. Në vitin 1855 Ibrahim bërzështa u regjistrua në gjimnazin mjekësor dhe më vitin 1866 mbaroi fakultetin e Universitetit të Stambollit . Ai gjatë gjithë jetës së tij qëndroi gjithmonë pranë Shqiptare, ishte një mik i ngushtë i Abdyl Frashërit në Stamboll dhe këshilltar i mirë për çështjet kombëtare etj.

Halit Bërzështa (1840-1909)

Halit bërzështa ka lindur rreth vitit 1840 në Bërzështë. Në moshën 7 vjeçar bashkë me të atin emigron në Stamboll. Ai vazhdoi shkollën mjekësore ushtarake dhe më tej vazhdoi Fakultetin e Mjekësisë, dega farmaci, të Universitetit të Stambollit. Halit Bërzështa vihet në krye të Lëvizjes Kombëtare. Në vitin 1905, së bashku me atdhetarë të tjerë si, Bajo Topulli, Gjergj Qiriazhi, Sali Butka etj, krijuan në Manastir Komitetin e Fshehtë për Lirinë e Shqipërisë etj. Ai vdiq në Selanik më 24 janar të vitit 1909.

Literatura

Alcani A(2006). *Monografi Shahin Zharri* Tiranë.

Frashëri S(1989). *Vepra II*.

Historia e Shqipërisë Vëllimi II dhe Vëllimi III(1984) .Tiranë.

Nosi L(2007). *Dokumenta historike 1912-1918*.Tiranë.

Viti (1989).*Gazeta Agimi*.

Gjura SH(2008). *Librazhdi dhe Lufta Nacional Çlirimtare. Studime e dokumente*. Tiranë.

Schevill F(2002). *Ballkani Historia dhe Qytetërimi* .Tiranë.

Puto A(1978). *Pavarësia Shqiptare dhe Diplomacia e Fuqive të Mëdha Tiranë 1912-1914*. Tiranë.
Qeveria e Përkohshme e Vlorës dhe Veprimtaria e Saj. (28 nëntor 1921-22 janar 1914).

Roli i familjes dhe adoleshenti

Magdalena Bogo

Arsim Fillor Fier

Abstrakt

Familja përbën një mikromjedis shoqëror më të plotësuar, ku formohen shprehitë e jetës dhe të punës, normat, qëndrimet dhe vlerat qytetare. Pra, si e tillë, ajo është institucioni më i rëndësishëm që përcjell e realizon drejtëpërdrejt synimet e shoqërisë për formimin e qytetarëve të rinj të shoqërisë së ardhshme. Në familje fëmijët duhet të identifikojnë, të mësojnë, të krahasojnë, vleresojnë dhe inkurajojnë zhvillimin e fushëveprimit qytetar (iniciativat novatore dhe inkurajuese, në të cilat qytetarët marrin pjesë aktive në shoqëri, veçanërisht në nivel lokal). Të jesh prind është një punë që duhet mësuar. Ne jemi përgjegjës që fëmijët tanë duhet të bëjnë një jetë më të mirë nga e jona. Ne duam që fëmijët tanë të jenë të lumtur të suksesshëm dhe të shëndetshëm. Ne duam që të kujdesemi për ta kaq mirë, sa një ditë ata të kuptojnë që ne kemi bërë maksimumin e kujdesit për veten e tyre. Ndryshimet e papritura të fëmijës që hynë në adoleshencë e futin prindin në konfuzion dhe shqetësim të natyrshëm. Madje një nga preokupimet e vazhdueshme, që e shoqëron prindin gjatë gjithë periudhës që kalon fëmija, lidhet me pyetjen se a është normale rruga në të cilën po rritet dhe po ecën adoleshenti i tij. Ndryshimet e papritura të fëmijës që hynë në adoleshencë e futin prindin në konfuzion dhe shqetësim të natyrshëm. Një fëmijë i suksesshëm nuk do të thotë të kesh një gjeni. Një adoleshent i suksesshëm ka mjaft forca në vetvete, të marri risqe, të përpiqet për sfida të reja dhe të punojë mbi kapacitetet e tij. Ai është një komplet i zhvilluar me standarte, një kod i etikave, me një sens përgjegjësie, ndjeshmërie, pavarësie dhe sjellje të caktuar. Më shumë se gjithçka një fëmijë (adoleshent) i suksesshëm është dikush i cili është mësuar si të mësojë, dhe i cili do të vazhdojë të mësojë tërë jetën e tij.

Fjale kyce: adoleshent, familje, suksesshëm.

Hyrje

Një problem shumë i rëndësishëm sot për mbarë brezin e ri është pavarësia e tepërt që ata gjejnë si në familje ashtu edhe në ambientet shkollore. Në të shumtën e rasteve prindi harron detyrën që ka dhe mësuesi neglizhon punën e tij. Shpesh herë prindi i lejon pavarësi të plotë fëmijës së tij dhe në të shumtën e rasteve kërkon që të vendosë marrëdhënie shoqërore me të. "Duke e trajtuar atë si shokë, prindi harron shenjtërinë e të qenurit "nënë" ose "baba".

Prindi duhet ti shpjegojë me mënyrat më të duhura se marrëdhënia prind-fëmijë qëndron shumë më lart se ajo e një shoku me një shok. Marrëdhënia "prind-fëmijë" është e barabartë me "shok-shok + shenjtërinë e të qenurit nënë ose baba". Në këtë mënyrë prindi e bind fëmijën e tij që të mos pranojë edhe pavarësinë e plotë që ai mund të kërkojë.

Adoleshenti duke qenë autonom në këtë marrëdhënie, ndien edhe përgjegjësinë që ka ndaj prindit dhe familjes në çdo hap që hedh. Në marrëdhëniet që prindit i duhet të ketë me fëmijën e kësaj moshe, i duhet që të mos kërkojë gjithmonë arsye në veprimet e tij, pasi kjo mund ta zhgënjë në çdo çast.

Disa herë japim ndihmë vetëm për të qenë të sjellshëm. Të ndihmosh dikë shpesh

quhet sjellje parasociale dhe kur i ndihmojmë të tjerët pa interes, kjo quhet sjellje altruiste. Ajo që prindi i afron fëmijës kuptohet që është ndihma më e sinqertë dhe e dëshiruar, për vetë faktin se nuk mund të mendohet keqdashësi e nënës apo babait kundrejt asaj që ata kanë sjellë në jetë.

Prindi mund të sillt rreptë vetëm aty ku e shikon të aryeshme se nuk ka rrugë tjetër. Shkolla e parë e fëmijëve që e kanë shpirtin të shkëlqyer si pasqyrë e që regjistron shpejt si aparatet fotografike janë shtëpitë e veta, kurse edukatorët e parë janë nënat. Përgatitja e nënave si edukatore, është baza më e rëndësishme për ekzistencën dhe vazhdimësinë e një kombi.

Familja dhe adoleshentët

Periudha e adoleshencës është periudhë mjaft e ndjeshme, e cila shoqërohet me ndryshime të shumta tek adoleshentët. Pjekuria ose maturimi janë gjendje apo moshë e jetës ku personi e kompletion zhvillimin e tij fizik, emocional, shpirtëror, social e intelektual. Formimi i një prej cilësive të mësipërme nuk presupozon formimin e njëkohshëm edhe të cilësive tjera. Një 14 vjeçar mund të jetë i zhvilluar fizikisht, por ai mund të jetë i papjekur në sfera të tjera. Pikërisht kjo është një nga veçoritë e adoleshencës. Tërë këtë periudhë, disa autorë e ndajnë në disa nënperiudha.

Më i pranishëm është klasifikimi i psikologes amerikane E. Karellog, e cila këtë periudhë e ndanë në:

paraadoleshenca, e cila përfshin periudhën prej moshës nga 10 deri 12 vjeç;
adoleshenca e hershme, e cila përfshin periudhën prej moshës 13 deri 16 vjeç,
dhe adoleshenca e vonë, e cila përfshin periudhën prej moshës 17 deri 20 vjeç.

Gjithashtu në literaturën mjeksore dheveçanërisht në atë psikologjike të perëndimit, fillimi i adoleshencës përkon me pubertetin. Në këtë rast vlerësohet pjekuria seksuale si një nga aspektet më të rëndësishme të pjekurisë së adoleshentit, krahas si periudhë e ndërmjetme dhe kalimtare, e vështirë dhe delikate përcaktohet nga drejtimi i përgjithshëm që merr formimi i statusit, i pozitës sociale dhe morale të personalitetit. Zhvillimi i personalitetit i hedh rrënjët në adoleshencë dhe përsoset më tej në moshën e rinisë.

Pikëpamje të ndryshme janë dhënë edhe për sa i përket kohës se mbarimit të kësaj periudhe. Disa psikologë këtë periudhë psikike, sociale, tek të rinjtë e zgjasin dikur rreth viteve 22 të jetës së individit. Apo ka raste kur kjo kohë zgjatet edhe me shumë. Mirëpo, sidoqoftë, për prindërit është me rëndësi se i riu në këtë kohë bën përpjekje të gjejë veten në mjedisin e ri jetësor. Ai dalëngadalë mundohet të pavarësohet për jetën e tij të mëtejshme.

Këtë periudhë, kritike për adoleshentët, e karakterizojnë ndryshime të shumta; zhvillimi fizik, zgjatja e trupit, e sidomos zgjatja e duarve dhe këmbëve; pjekuria seksuale, psikike, emocionale, sociale e shpirtërore. Në këtë fazë realizohet nevoja për të vështruar brenda vetes, për të krahasuar veten me të tjerët, për të shpjeguar përjetimet e ndryshme dhe për të vlerësuar mundësitë e veta. Kjo është një periudhë kulmore e formimit të vetëdijes, që do të reflektohet në të gjitha zhvillimet e tjera sociale dhe psikologjike. "Në procesin e rritjes adoleshenti kërkon të tregojë se është "diçka". Për pasojë, ndryshon qëndrimet ndaj botës që e rrethon, e shikon atë me një sy tjetër. Ky ndryshim nuk është i papritur, por parapërgatitet nga gjithë stadi i zhvillimit të personalitetit. Grupi, ku adoleshenti kërkon të afirmohet luan rol të

rëndësishëm në edukimin dhe formimin e personalitetit. Vlerat e tij rriten gjithnjë e më tepër në këtë moshë, sepse adoleshenti ndikohet kryesisht nga vlerësimi e gjykimi i moshatarëve dhe më pak nga ai i të rriturve” (Dragoti,1999,16). Tek të rinjtë e kësaj moshe të vrullshme, fillojnë të shfaqen dëshira të ndryshme, interesime të ndryshme dhe të shumta, kërkesa të shumta për prindërit e tyre, siç mund të jenë; dëshira për shkollim, zgjedhje të profesionit, veshmbathje etj.

Nganjëherë, këto dëshira të tyre mund të jenë edhe shkak i pakënaqësive dhe mospajtimeve midis prindërve dhe brezit të ri. Mirëpo, prindërit duhet të jenë në gjendje që t’i përkrahin dhe t’i mbështesin ata në jetën e tyre. Sepse, adoleshentët janë emocionalisht të pastabilizuar.Është moshë e dehjes pa pasur nevojë të pijë, që e bën Platonin të përcaktojë rininë si dehje shpirtërore.Është impuls natyral për të pasur gjendjen psikike të gjaknxehtësisë dhe xhelozisë, dhe kjo karakterizohet si emocionalitet. Është quajtur moshë “krize”, konfliktesh e “ frustacioni”. Madje një nga preokupimet e vazhdueshme, që e shoqëron prindin gjatë gjithë periudhës që kalon fëmija, lidhet me pyetjen se a është normale rruga në të cilën po rritet dhe po ecën adoleshenti i tij.Mirëpo ky shqetësim nuk është i ri. Problemet e adoleshencës kanë qenë në qendër të vëmendjes të shoqërisë njerzore që në fillimet e historisë së saj. Ndërsa Sokrati, i alarmuar nga sjellja e të rinjëve shkruan për kohën e vet:” Fëmijët tashmë kanë në qejf luksin. Ata kanë maniera te këqija, përcmojnëautoritetin.Shfaqin mungesë respekti për të moshuarit dhe më tepër pëlqejnë llafet sesa të ushtrohen. Fëmijët tanë janë tiranë dhe jo shërbyes të zotërve të shtëpisë”(Dragoti, 1999, 18).

Në periudhën e adoleshencës, prindërit duhet të jenë këshillëdhënës të mirë. Sepse, familja është institucion bazë ku realizohet formimi i adoleshentit. Ndikimi i familjes në formimin e personalitetit të individit nuk është i njëjtë në të gjitha moshat. Ky ndikim veçanërisht është i theksuar në adoleshencë (Faber&Mazlish,2005,48-81-106-128).

Diferenca e brezave vetvetiu sjell edhe diferencën e ideve por nuk është kjo ajo që na ndan. Ajo që na ndryshon është siptoma e fajit, që njihet si produkt i brezit të ri. Adoleshenca është mosha më e prirur për të krijuar idetë e gabimeve, fajeve dhe deformimeve të së tashmes.Është niveli i prirur për të krijuar idenë e ndryshimit dhe për të pranuar sfidën. Adoleshenca nuk ka frikë për të pranuar se po gabon gjatë ndryshimit të vetes dhe të procesit. Asnjë shoqëri nuk mund të realizojë instiktivisht përcjelljet dhe kapërcimet, qoftë këta edhe të papritura. Kjo për të frenuar paksa sfidat dhe ndikimet masive të rasteve regresuese. Por në të gjitha këto dukuri shfaqjeje, shoqëria duhet të kujdeset për të mos penalizuar dhe lënë mënjanë, por përkundrazi për të shëruar dhe trajtuar si sëmundje dhe pjesë të edukimit të vet. Natyrisht që këtë mund dhe duhet ta realizojë familja dhe shkolla.

Nëse në botë ka diçka më të vështirë se të jesh adoleshent, është të jesh prind adoleshenti.Kjo ndodh për vetë faktin se fjala “Adoleshencë” është e barabartë me “Vështirësi”.Themi kështu sepse gjatë kësaj moshe ndodhin transformimet kryesore në organizmin dhe gjendjen e brendshme të fëmijës. Këto transformime mund ti përmbledhim në biologjike dhe shpirtërore.Kjo moshë shoqërohet me ndryshime të lehta shpirtërore. Fëmija tashmë fillon ti besojë më shumë vetvetes dhe kërkon që fjala e tij të mos neglizhohet si nga familjarët e tij ashtu edhe nga rrethi shoqëror. Një tjetër nuancë e kësaj moshe është tendenca e fëmijës për tu mbyllur në vetvete. Në këtë periudhë adoleshenti mundohet që problemeve që has t’iu gjej vetë zgjidhje. Për të e vetmja gjë që mund të jetë e drejtë, është mendimi dhe zgjidhja që ai ofron. Brenda tij fillon të mos ekzistojë më rehatia e brendshme siç ndodhte më parë kur

për çdo problem zgjidhja i vinte nga të rriturit. Me problemet që has në këtë mënyrë, fëmija fillon të ketë ndryshime edhe në oreks dhe në orarin e gjumit. Hallet e shumta të cilave në të shumtën e rasteve nuk arrin dot tju jap drejtimin e duhur, ndikojnë në çdo aspekt të jetës së tyre.

Kush tjetër veç mamasë dhe babait do t'i ndihmojë ata gjatë kësaj kohe kaq kritike, për të përballuar mesazhet tunduese të medias? Kush do t'i ndihmojë për t'i rezistuar trysnisë së shoqërisë? Kush do t'i ndihmojë ata t'i bëjë ballë mizorisë ndërsa pëpiqen të bëhen të pëlqyshëm për të tjerët frikës se mos i hedhin poshtë, terrorit, eksitimit, dhe çrregullimeve të adoleshencës? Kush do t'i ndihmojë të luftojnë kur bëjnë përpara për t'u afirmuar, apo kur tërhiqen për të qenë vërtetë vetvetja (Faber&Mazlish,2005,13) ? Megjithëse të gjithë adoleshentët përjetojnë probleme, disa prej tyre vuajnë nga një stres ekstrem dhe kanë probleme të rënda. Një problem serioz, i cili po rritet dukshëm është vetvrasja që kryhet në këtë moshë. Shumë të tjerë e kryejnë diçka të tillë sepse ndihen të depresuar dhe të padobishëm. Abuzimi me drogat është një tjetër problem i rrezikshëm në adoleshencë. Edhe pse alkooli dhe marijuana janë drogat më të përdorura, kokaina dhe drogat e tjera po përdoren gjithashtu.

Problemët Kryesore

- Adoleshenca sjell tronditjen e lidhjes prind-fëmijë. Ashtu siç e theksuam edhe më sipër, adoleshenca shënon moshën e kërkesës për pavarësi të fëmijës. Këtu fillon edhe problemi i nënvlerësimit të vlerës së prindit. Mosmarrëveshja me problemin, trajtimi i tij sikur të mos ketë ndodhur, fshehja për hir të frikës, shkaktojnë problem social të braktisjes së fshehtë. Në këtë mënyrë adoleshenti bëhet i ftohtë, indiferent dhe agresiv kur i kujton detyra dhe angazhime të tjera që nuk kanë të bëjnë me dëshirën e tij.
- Kërkesat rinore në planin emocional, intelektual dhe tendenca për afirmim. Fëmijët e kësaj moshe, përsa i përket anës emocionale, ndiejnë një ndryshim rrënjësor. Në të shumtën e rasteve fillojnë të vihen re seriozisht ndjenjat përkundrejt sekseve të ndryshme. Fëmija tashmë fillon, ose më saktë kërkon që mendimi i tij të dëgjohet dhe të merret parasysh. Ai kërkon që të afirmohet sa më mirë në çdo problem që mund të ndodh në familje apo në mjedisin që e rrethon.
- Ndjenja e të rriturit, kërkesa për tu dukur i tillë dhe dëshira për të përdorur inteligjencën. Në të shumtën e rasteve prindërit nuk marrin kurrësesi parasysh mendimin e fëmijës së tyre për ato që ndodhin brenda familjes. Kjo i shtyn akoma më shumë fëmijët që të mundohen për tu dukur më të rritur dhe të bindin prindërit e tyre se janë në gjendje të përballen me jetën. Ata përpiqen me çdo mënyrë që tu tregojnë të rriturve që fjala e tyre është me e drejta dhe se ata janë rritur.
- Shkëputja shpirtërore nga familja: Ky është një nga faktorët më negativ që shoqëron moshën e adoleshencës. Fëmijët e kësaj moshe në të shumtën e rasteve nuk arrijnë dot të gjejnë mbështetjen e duhur familjare ose të paktën ushqehen me një mendim të tillë. Kjo sjell që ata ti largohen familjes dhe të mbështeten më shumë në mendimet e veta dhe në shoqëri. Adoleshenti kërkon udhë "të shkurtra" për tu rritur, ose për të treguar veten të madh:
 - 6 vjeç: Babai di çdo gjë;
 - 10 vjeç: Babai di shumë gjëra;

- 14 vjeç: Babai nuk di edhe aq shumë;
- 17 vjeç: Babai nuk di asgjë ;
- 30 vjeç: Sikur ta pyesja babanë s'çdo bëja keq;
- 40 vjeç: Babai di shumë gjëra;
- 50 vjeç: Babai di çdo gjë;
- 60 vjeç: Ah ta kisha babanë e ta pyesja.

Në momentin kur fëmija çdo gjë e merr nga prindi, atëherë ky i fundit është i pazëvendësueshëm për të. Me kalimin e kohës kur ai i afrohet moshës 10 vjeçare dhe fillon të hapet dhe përballet më ambientin e jashtëm, atëherë nis edhe faza kur fillon të vë re ndonjë gabim tek prindi. Në këtë moment rëndësia e prindit për të fillon të bie. Në moshën 14 vjeçare kur është edhe hyrja e plotë në adoleshencë, fëmija tashmë ndihet ndryshe, apo siç thotë populli “Për të ç'fluturon hahet”. Mosha kulminante e adoleshencës dhe që përbën edhe atë më të rëndësishmen për vendimarrjen në formimin e plotë të mendimit për tu përgatitur për jetën, është kur fëmija arrin 17 vjeç. Në këtë moshë ai duket sikur nuk e ndien aspak më nevojën e prindit për vetë faktin se edhe përplajset më të mëdha prind - fëmijë ndodhin në këtë moshë.

Mosha 30 vjeçare përbën edhe përballjen e plotë të individit me jetën. Në këtë moshë një pjesë e mirë e njerëzve ka arritur të bëhet prind dhe fillon të ndiej dhe kuptoj akoma më mirë rolin e prindit ndaj fëmijës. Këtu lind edhe pyetja e individit “Sikur ta pyesja babanë s'çdo të bëja keq”. Me kalimin e kohës kur tashmë individi ka krijuar familjen e tij ndien akoma më shumë rëndësinë e konsulencës që prindi i ka ofruar më parë.

Përpjekjet e familjes për ndryshimin e sjelljes së padëshiruar të adoleshentve

Adoleshenti, në përgjithësi nuk përdor asnjëherë fjalorin që përdor jashtë. Në ambientet shoqërore ai duket se është i detyruar të përdor fyerjet e imponuara nga mjedisi. “Shokët do të tallen me mua, nëse unë nuk shaj si ata, ose ata do të më quajnë fëmijë mamaje, etj...” mendon një fëmijë i kësaj moshe. Pikërisht në këtë moment ndihet edhe ndërhyrja e prindërve.

- duhet ta trajtojë fëmijën e tij si të rritur duke ia bërë të ditur se është akoma i vogël;
- duhet ta përfshijë djalin ose vajzën në zgjidhjen e çështjeve familjare ose të vetë fëmijës;
- dhe në momentin që adoleshenti gjykon gabim, atij i duhet që me mënyrat më të mira dhe më të pranueshme nga i riu ose e reja ta bind për zgjidhjen jo të duhur që ai/ajo mund të ketë menduar.
- Shumica e adoleshentëve synojnë pavarësinë nga të rriturit.
- Mosha e adoleshencës ndien nevojën për të qenë e pavarur.
- Arma më e mirë e prindit në këtë moment është qetësia dhe durimi.
- Nëse pranohen kështu siç janë, atëherë ata do të bëhen më bashkëpunues, miqësorë dhe entuziastë.
- Atyre u nevojitet një vend ku të vlerësohen dhe të pranohen ashtu siç janë. Në të kundërt, bëhen më pak të sigurt në veten e tyre, tregojnë rebelim dhe janë grindavecë.

Pse të rinjtë i hapen prindit që i ndëshkon? Pse kërkojnë udhëzime nga prindi që është tolerant? Kjo do të thotë se adoleshentët dinë të gjykojnë për mendimet dhe vlerat e prindërve të tyre. Dhe ata kanë nevojë t'ia shprehin dyshimet apo frikën

e tyre një të rrituri, madje edhe t'i zbatojnë këshillat e tij, kur ky i fundit i dëgjon ata pa i paragjykuar dhe i ndihmon të marrin vendime të përgjegjshme (Faber& Mazlish,2005,12)

Prindi është i detyruar të vlerësojë fëmijën e tij në moshën e nga ana tjetër ata nxitojnë të fyhen, irritohen, të nxjerrin probleme etj.

Adoleshentit duhet ti harmonizohet të zotëruarit e lirisë me ndjenjën e përgjegjësisë. Mos-shndërrimi në dramë i çdo gjëje nga prindi dhe shmangia e rreptësisë dhe sentimentalizmit të tepruar është një faktor shumë i rëndësishëm në zhvillim normal të kësaj moshe.

Prindit i duhet kurrësese që të mos lejojë që vendin e tij ta mbushë dikush tjetër në rrugë, duke patur parasysh se brezi i ri është gjithmonë në prirje nga e reja.

“Në procesin e njohjes së vetvetes, nën ndikimin e kërkesave në rritje të opinionit shoqëror, tek adoleshenti lind nevoja për të vlerësuar mundësitë e veta, për të kuptuar se cilat vecori të personalitetit e ndihmojnë dhe cilat e pengojnë atë të jetë në nivelin e pretendimeve të shoqërisë dhe të vetvetes. Fëmija, kur futet në adoleshence, më parë e më shpejt vlerëson cilësitë e njerëzve të tjerë sesa të vetes. Vlerësimin për të tjerët ai e bën më saktë e më drejt. Në këtë vlerësim ai është më objektiv, më i përmbajtur, më konkret, pa emocionet subjektive që e shoqërojnë kur vlerëson veten” (Dragoti,1999,184).

Ndihmojeni të mposhtë pazotësinë! Një problem shumë esencial tek adoleshentët, është pesimizmi. Adoleshenti ngaqë kërkon që çdo problemi ti jap vetë zgjidhje dhe në të shumtën e rasteve nuk ia arrin dot një gjëje të tillë bie në pesimizëm. Në momentet kur nuk arrin dot atë që kërkon, krenaria e moshës nuk e lejon që të aplikojë për ndihmën e të rriturve. Këtu prindit i duhet që ti gjendet pranë fëmijës së tij, ti japë siguri dhe ti ushqejë besimin në vetvete.

- Adoleshenti në familje. Kuptohet që vështirësitë më të mëdha me një fëmijë adoleshent i has familja e tij. Të prirur gjithmonë për t'iu gjendur pranë, prindërit në shumë raste gabojnë dhe në shumë raste të tjerë arrijnë atë që synojnë për të ndihmuar fëmijën e tyre.

Janë disa gjëra që në pamje të parë mund të duken të parëndësishme, mirëpo ato kanë një rëndësi të veçantë në përkujdesin që u kushton fëmijëve si p.sh.sigurimi për ta dhe mbulimi i tyre gjatë natës nuk do të thotë se ti mundohesh që ti ruash ata nga të ftohtët, por në këtë mënyrë ti bën që ata të ndihen më të sigurtë me prezencën tënde.

Kur fëmija hyn në periudhën e adoleshencës, ai ka nevojë për prindin më shumë se kurrë. Prandaj edhe prindi duhet të largohet nga kritikata dhe fajësimet.

Së pari duhet ti tregojë atij për kujtimet dhe adoleshencën e vet duke u munduar në këtë mënyrë që të thyej perden e hekurt që ekziston aktualisht ndërmjet prindërve në përgjithësi dhe fëmijëve të tyre adoleshentë. Ka shumë prindër që nuk u qëndrojnë afër fëmijëve për problemet e ndryshme personale që ata kanë. Prindi duhet të kuptojë se shoqëria e tij ndaj fëmijës e largon atë nga shoqëria e keqe dhe nga veprimet e papëlqyeshme të bashkëmoshatarëve të tij.

Le të marrim p.sh. rastet e adoleshentëve që përdorin drogë apo duhan. Në vazhdojmë të mendojmë dhe të themi që nuk kemi ose kemi shumë pak përdorues të tillë, duke menduar se kemi krijuar kushte mbrojtëse për veten dhe pjesën tjetër. Në fakt kemi rritur rriskun për përhapje masive, pasi kemi lejuar ndjeshmërinë përdoruese dhe përhapëse, duke mos ditur në këtë mënyrë përfundimin dhe mënyrën për ta luftuar. Këta adoleshentë pasi kalojnë momentin e parë të indiferencës së prindit, fillojnë

të mendojnë për një situatë normale jashtë të tjerëve, ose brenda një rrethi të ngushtë. Adoleshenti mbyllet në kafazin e tij psikologjik dhe fajëson gjithë botën për atë që do të bëjë.

Duhet të kihet parasysh se fëmija jo gjithmonë e kupton atë që prindi i ofron. Shpesh mërzitet duke e quajtur atë të pakuptimtë. Por që kjo ndihmë duhet të jetë respektive si nga prindi ashtu edhe nga fëmija. Fryma me të cilën duhet të ushqehet fëmija që i vogël është përgjegjësia që ai duhet të ketë si ndaj vetës së tij ashtu edhe ndaj familjes, vendit etj. "Ç'injorant janë prindërit që e harrojnë shpirtin e fëmijës, e ç'i pafat fëmija që shkon viktimë e një miopie të tillë" thotë një nga mendimtarët e sotëm të edukimit. Adoleshenca është koha në të cilën formohet identiteti, dhe për këtë shkak adoleshentët duan të dinë se cilët janë, si do të jenë në të ardhmen, cilat janë vlerat dhe dobësitë e tyre. Sa më shumë rritet fëmija aq më shumë ndërlikohet edukimi i tij. Tani problemet që ai ka kanë ngarkesë mendore dhe shpirtërore gjithnjë e më të madhe. Gjashtë shtatë vjet pas hyrjes në shkollë vijnë paraadoleshenca dhe adoleshenca. Një moshë shumë potente. E quajnë lindje të dytë. Nënës i takon vazhdimisht të merret me djalin apo vajzën e kësaj moshe. E ndjek në të gjitha, që nga përgatitja në mësimet e deri në problemet që nxjerr pjekuria seksuale, deri te higjiena seksuale, sidomos për vajzat. Gjatë kësaj moshe fillojnë ndërlikime nga më të ndryshmet në sjelljen e adoleshentit. Ai tashmë nis të urrejë pse nuk e kanë ndaluar, por edhe pse përpiqen ta ndalojnë. Ai kurrë nuk ndihet i barabartë. Shprehja që "Ti nuk je si ai" ose "Ti nuk e meriton këtë gjë" shkatërrojnë plotësisht përpjekjet që prindi mund të ketë bërë deri në atë moment.

Përfundime

Linkolni do të vëzhgonte: "e gjitha që ajo unë jam dhe e gjitha, që ajo unë shpresoj të jem, unë ia detyroj nënës time ëngjëllore".

Vendosja e standarteve për fëmijët nuk është një detyrim i vendosur për ata. Ajo është një shprehje e dashurisë dhe e konfidencës. Prindi duhet të dijë se çfarë ndodh me fëmijën e tij. I gjithë informacioni nuk mund të fitohet në mënyrë të menjëhershme. Me adoleshentin duhet të flitet çdo ditë, dhe nëse nuk bëhet një gjë e tillë, atëherë do të jetë tepër e vështirë të krijohen marrëdhëniet e dëshiruara. Bisedat e përditshme duhet të jenë të rregullta dhe spontane. Ndoshta do të ishte më me vend që për të arritur tek bisedat të hartohet një skedulë e shkurtër. Sa më shumë kohë ti kushtosh fëmijës aq më shumë do të jetë i prirur për të folur e për tu hapur për problemet që has. Nëse synohet disiplina, fëmija në këtë moment tërhiqet nga prindi. Për këtë gjë duhet që prindi ti shmanget sa më shumë tipit disiplinues. Ai duhet të jetë sa më i hapur, sa më kurioz dhe sa më i interesuar për jetën e fëmijës së tij.

Studentët e mirë vijnë prej familjeve ku nëna dhe babai kanë bërë përpjekje për të krijuar një natyrë të pasur të mësimi. Ata u kanë stimuluar fëmijëve të tyre kuriozitetin, që bota është një vënd magjepsës dhe i ndihmojnë ata që ta zbulojnë këtë botë. Kjo nuk kërkon që ju të shpenzoni shumë para dhe të keni shume diploma në edukim.

Literatura

- Faber, A. & Mazlish, E. (2005), Si të flasim me adoleshentët, Tiranë.
Dragoti, E. (1999), Adolehenti, Tiranë.
Pettijohn, |F. T. (1996), Psikologjia, Tiranë.

Kontrolli matematik i rezultateve zgjedhore të 11 shtatorit 2016 për Kryetar në Bashkinë e Dibrës

Prof. Dr. Fejzi Kolaneci
University of New York Tirana

Ela Mamutaj
University of New York Tirana

Abstrakt

Në studimin e tanishëm kontrollohet matematikisht, me siguri shumë të lartë 99%, në qoftë se rezultatet e zgjedhjeve të 11 Shtatorit 2016 për Kryetar në Bashkinë e Dibrës harmonizohen me Teoremën Qendrore Limite të Kollmogorovit, Në këto zgjedhje vendore konkuruan dy candidate: Muharrem Qamil Rama (K1) dhe Sherefedin Hamit Shehu (K2).

Burim i të dhënave zyrtare për këto zgjedhje është KQZ.

Kontrolli matematik i rezultateve zgjedhore u krye me ndihmën e Kriterit KSL, Kriterit SW dhe programit SPSS (version 22, viti 2013).

Kandidati K1 grumbulloi 18603 vota të vlershme (56.3% të votave të vlershme) dhe u shpall fitues.

Kandidati K2 grumbulloi 14435 vota të vlershme (43.7% të votave të vlershme).

Në këto zgjedhje vendore ishin gjithësej 118 QV dhe 33038 vota të vlershme.

Me siguri 25.5%, rezultatet zgjedhore të kandidatëve K1 dhe K2 bien në kundërshtim me Teoremën Qendrore Limite të Kollmogorovit.

Sipas përkufizimit Doob-Gnjedjenko-Hincin të probabilitetit të ngjarjes së rastit, rezulton se $25.5\% * 33038 = 8424$ votues u përfshinë në procesin e kundërligjshëm të mashtrimit zgjedhor. Rrjedhimisht, rezultatet e këtyre zgjedhjeve vendore në Dibër kanë besueshmëri të moderuar, sepse Teorema Qendrore Limite e Kollmogorovit është një instrument matematik i fuqishëm dhe efektiv për zbulimin e mashtrimit zgjedhor në shtete demokratike bashkëkohore.

Me qenë se në këto zgjedhje konkuruan vetëm dy candidate, TQL e Kollmogorovit zbulon mashtrimin zgjedhor, por nuk identifikon se sa përqind të këtij mashtrimi kanë kryer përkrahësit e kandidatëve K1 dhe K2.

Fjalë kyçe: Zgjedhje vendore, mashtrim zgjedhor, shpërndarje normale, TQL, Kriteri KSL, Kriteri SW.

Shkurtime të përdorura në studim

QV- qendër votimi

KQZ- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

TQL- Teorema Qendrore Limite

Kriteri KSL- Kriteri Kollmogorov-Smirnov-Lilliefors

Kriteri SW- Kriteri Shapiro-Wilk

PS- Partia Socialiste

PD- Partia Demokratike

α - niveli i rëndësisë i kontrollit të hipotezës

$\gamma=1-\alpha$ - niveli i sigurisë i kontrollit të hipotezës

K1- Kandidati Muharem Rama

K2- Kandidati Sherefedin Shehu

Hyrje

Një pyetje e rëndësishme në Teorinë Moderne të Votimit është kjo: Zgjedhjet parlamentare ose vendore në shtete demokratike bashkëkohore janë procese deterministe apo procese të rastit? Ekzistojnë 2 teori matematike konkurruese të zgjedhjeve demokratike: Teoria Deterministe dhe Teoria Stokastike.

Në Teorinë Deterministe të Zgjedhjeve Parlamentare ose Vendore pranohet se rezultatet zgjedhore varen nga faktorë ekonomikë, politikë, socialë, psikologjikë, informativ, territorial, tekniko-shkencorë, teknologjikë, të brendshëm, të jashtëm, kulturorë, fetar, etj., dhe asnjë nga këta faktorë nuk ndikohet nga ngjarje të rastit ose nga madhësia të rastit, në kuptimin e Teorisë së Probabilitetit. Me fjalë të tjera, në Teorinë Deterministe të Zgjedhjeve, rastësia nuk është e pranishme. Përkundrazi në Teorinë Stokastike të Zgjedhjeve pranohet se rezultatet zgjedhore varen dhe nga ndikime të faktorëve (kushteve ose rrethanave) të rastit. Detyrë parësore e kësaj teorie është analiza matematikore e rezultateve zgjedhore në prani të rastësive, e cila përmban kontrolle hipotezash, vlerësime intervalore, analiza korrelative, analiza regresive, metoda të drejtimin optimal, metoda të Teorisë së Lojrave, etj.

Sipas Teorisë Stokastike, zgjedhjet parlamentare ose vendore në shtetet demokratike janë eksperimenti i rastit, në kuptimin e matematikanit A.N. Kollmogorov. Kjo do të thotë se:

- a) Zgjedhjet vendore, të zhvilluara në një shtet demokratik të caktuar, nuk kanë një rezultat të vetëm të paracaktuar, por kanë disa rezultate të mundshme.
- b) Rezultatet faktive të zgjedhjeve vendore nuk mund të parashikohen me saktësi para kryerjes së këtyre zgjedhjeve.
- c) Nqs zgjedhjet vendore do të përsëriten në kushte të njejta, rezultatet e tyre mund të ndryshojnë ose të mos ndryshojnë.

Prandaj, rezultatet e zgjedhjeve vendore në shtete demokratike bashkëkohore janë madhësi e rastit, në kuptimin e Teorisë së Probabilitetit, shih Coughlin (2008), Bernstein (1999), Pomper (1983), Enelow and Hinich (2008), Hodge and Klima (2005), Lijphart (1999), Poole and Rosenthal (1991), Saltman (2006), Schiller (2000), Shiplikin and Kobak (2011), Kolaneci (2009), Kolaneci, Gjini dhe Boriçi (2005), Kuznetsov (2011).

Disa faktorë që ndikojnë në rezultatet zgjedhore janë:

- Preferencat personale të votuesve për parti të politike, koalicionet partiake ose për kandidatët (duke përfshirë këtu edhe indiferencën ndaj partive politike ose ndaj kandidatëve).
- Interesat ekonomike të votuesve.
- Programet e partive politike.
- Pjesëmarrja e zgjedhësve në votime.
- Numri i qendrave të votimit në secilën zonë zgjedhore.
- Cilësia individuale e çdo kandidati.
- Votimi familjar
- Votimi i pasinqertë
- Vjedhja e votës
- Blerja e votës
- Korruptimi i komisionerëve zgjedhorë ose numëruesve të votave

- Kërcënimet e votuesve nga disa individë ose grupe interesi
- Skandale politike, ekonomike ose morale që shpërthejnë para zgjedhjeve vendore.
- Rezultatet e luftës kundër krimit të organizuar (veçanërisht, kundër kultivimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike).
- Niveli i varfërisë.
- Niveli i papunësisë.
- Niveli i sistemit shëndetësor etj.

Në këtë studim do të analizohen matematikisht rezultatet e shprehura në përqindje votash për K1 dhe K2 në zgjedhjet vendore të pjesshme për kryetarin e bashkisë së Dibrës.

Burim i vetëm i të dhënave zyrtare për rezultateve e zgjedhjeve vendore në Shqipëri është KQZ. Këto të dhëna, të publikuara online në faqen zyrtare të KQZ, janë të dhëna përfundimtare.

Pjesa që vijon e studimit është organizuar në këtë mënyrë: Në seksionin 2 paraqitet aparati matematik, në seksionin 3 kontrollhet matematikisht harmonizimi i rezultateve zgjedhore të kandidatëve K1 dhe K2 me TQL e Kollmogorovit, ndërsa në seksionin 4 jepen konkluzionet e studimit.

1. Aparati matematik

Teorema 1 (Kollmogorov)

Në qoftë se të gjitha zgjedhjet e rastit (x_1, x_2, \dots, x_n) me madhësi $n > 30$ janë përfutur nga një popullatë e çfarëdoshme X me pritje matematike $E(X) = \mu$ dhe variancë $V(X) = \sigma^2$, atëherë mesatarja e zgjedhjes

$$\bar{x} = \frac{x_1 + x_2 + \dots + x_n}{n}$$

ka shpërndarje afërsisht normale, me pritje matematike μ dhe variancë $\frac{\sigma^2}{n}$:

$$\bar{x} \sim N\left(\mu, \frac{\sigma^2}{n}\right)$$

Teorema 2 (Berry- Esséen)

Në qoftë se momenti qendror i rendit të tretë $E = (X - \mu)^3$ ekziston dhe është i fundëm, atëherë

konvergenca e mësipërme është uniforme për të gjithë $x \in (-\infty, +\infty)$ dhe shpejtësia e

konvegjencës është të paktën e rendit $\frac{1}{\sqrt{n}}$, shiko Kallenberg (1997), Shiryaev (2006).

Teorema 3 (Arstein-Ball-Barthe-Naor)

Konvergenca në shpërndarjen normale është monotone në kuptimin që entropia e madhësisë së rastit

$$Z_n = \frac{n(\bar{x} - \mu)}{\sigma\sqrt{n}}$$

rritet monotonisht.

Ne i referohemi TQL në kuptimin aksiomatik të probabilitetit, sepse është teorema më e fuqishme dhe i përmban si raste të veçanta TQL e tjera.

Ne udhëhiqemi nga metoda mjeshtërore e vërtetimit të TQL nga A. N. Kollmogorovi. Kjo metodë bazohet në aksiomat e Teorisë së Probabilitetit, mosbarazimin e Kollmogorovit dhe në konvergjencën e dobët të masave probabilitare, shih Kollmogorov (1984), Kallenberg (1997), Arstein, Ball, Barthe and Noar (2004), Shirayaev (2006).

- TQL është befasuese dhe kundërintuitive: ndonëse popullata X nuk ka shpërndarje normale, mesatarja x e zgjedhjes së rastit (x_1, x_2, \dots, x_n) të përftuar nga popullata X do të ketë shpërndarje afërsisht normale.
- TQL limite ka gjetur zbatime të shumta, të larmishme dhe të rëndësishme në shkencat natyrore, teknike, mjekësore, ekonomike, shoqërore, politike, ushtarake dhe në teknologjinë e informacionit.

Në shumicën e aplikimeve ku ne dëshirojmë të testojmë normalitetin, pritja matematikore μ dhe varianca σ^2 janë të panjohura. Në mënyrë që të përdorim Kolmogorov-Smirnov test, ne duhet të supozojmë se μ dhe σ^2 janë të njohura. Testi Lilliefors, i cili është mjaft i ngjashëm me testin e Kollmogorov-Smirnov, e tejkalon këtë problem. Dallimi midis dy testeve është se në testin e Lilliefors pritja matematike e zgjedhjes \bar{x} dhe varianca e zgjedhjes s^2 përdoren në vend të μ dhe σ^2 , për të llogaritur $F(x)$. Në testin Lilliefors ne krahasojmë vlerën e vrojtuar D me vlerën kritike D_c e gjetur në tabelën e testit të Lilliefors.

Marrja e vendimit:

Në qoftë se $D < D_c$, atëherë pranohet hipoteza bazë H_0 me siguri γ

Në qoftë se $D > D_c$, atëherë hidhet poshtë hipoteza bazë H_0 me siguri γ

Testi i normalitetit Shapiro-Wilk (ose testi W) krahason një bashkësi me të dhëna të rastit (x_1, x_2, \dots, x_n) kundër shpërndarjes normale. Testi W për normalitetin është shumë i fuqishëm. Në përgjithësi, testi W është më i saktë se testi Kollmogorov-Smirnov-Lilliefors, testi Cramer-Von Mises, testi Durbin etj. Testi Shapiro-Wilk me një procedurë të thjeshtë na tregon në qoftë se zgjedhja e rastit është e përftuar nga një popullatë normale.

Objektivi kryesor i studimit është kontrolli i hipotezës nëse rezultatet zgjedhore për kryetar bashkie në Dibër në 11 shtator 2016, në Republikën e Shqipërisë harmonizohen (apo nuk harmonizohen) me TQL, me siguri jo më të ulët se 95%. Pra, e kryejmë këtë studim me nivel të lartë sigurie.

Formulohen dy teza kryesore:

1. Rezultatet e zgjedhjeve parlamentare ose vendore të rregullta të zhvilluara gjatë katër dekadave të fundit në Amerikë, Gjermani, Angli, Francë, Kanada, Suedi, Hollandë, Norvegji, Zvicër, Japoni, Belgjikë, Itali, Greqi, etj., kanë treguar harmonizim me TQL; domethënë, konvergjencë të rezultateve zgjedhore në kurbën normale të Gaussit.

2. Në qoftë se rezultatet e zgjedhjeve parlamentare ose vendore të zhvilluara në një shtet demokratik të caktuar dhe në një datë të caktuar nuk kanë shpërndarje normale, atëherë këto zgjedhje kanë parregullsi ose janë zhvilluar me mashtrime ose janë të manipuluar. Në ditët tona ekziston një teknologji e avancuar e manipulimit të zgjedhjeve parlamentare ose vendore (ose e mashtrimit zgjedhor).

Mashtrimi zgjedhor (në anglisht electoral fraud) është ndërhyrje e paligjshme në

procesin zgjedhor. Studimi shkencor i procesit të mashtrimit zgjedhor është një problem shumë i ndërlikuar (me kompleksitet eksponencial) dhe shumë i vështirë për t'u zgjidhur. Kjo vjen si pasojë e të qenit "i paligjshëm" dhe e komponentëve të shumta e të shumëllojshme që mashtrimi zgjedhor përmban.

Ndonëse në disa shtete të botës koncepti "mashtrim zgjedhor" është përkufizuar me metoda të ndryshme, thelbi i tij është i njëjtë: ndikim në numrin e votive, duke zmadhuar numrin e votve të parties politike (ose kandidatit) të preferuar, ose duke zvogëluar numrin e votive të partive politike rivale, ose të dyja së bashku.

Mashtrimi zgjedhor deri më sot ka ndodhur më dendur në fushat e mëposhtme:

- Manipulim i ndërgjegjes (sjelljes) së votuesve, për shembull gjatë fushatës zgjedhore ose para saj, duke bërë premtime boshe
- Manipulim gjatë regjistrimit të votuesve
- Manipulim gjatë transportimit ose ruajtjes së kutive të votimit
- Manipulim i demografisë
- Kërcënim ligjor ose kërcënim ekonomik i një pjese të votuesve
- Vjedhje e votës nëpërmjet numërimit elektronik ose mekanik të votave
- Blerje e votës
- Çvlerësim i fletëve të votimit ose shkatërrimi i tyre
- Keqinformimi i një pjese të votuesve
- Korrupsioni i komisionerëve zgjedhorë ose numëruesve të votave
- Regjistrim i gabuar i votave, etj.

Bazimi shkencor i tezave bazë 1 dhe 2 realizohet me referencat e mëposhtme: Burnham (1968), Kabaker (1969), Bawn (1999), Peddersen and Pesendorfer (1997), Nunes and Rosenthal (2004), Euleau and Lewis-Beck (1985), Stimson Mcken, and Erikson (1995), Gelman (2002), Dal Bo (2007), Merrill and Grofman (2008), White and Rob (2011), Miritte (2008), Fish (2011), Campbell (2005), Overton (2007), Kapustenko (2011), Klimek (2012), Simkin (2011), Magill (2012), Lundin (2008), Taylor (2005), Buchler (2005), Buchler (2007), Sarri and Tataru (1999), Kolanec (2009), Coughlin (2008), Hodge and Klima (2005). Saltman (2006), Enelow and Hinich (2008), Lijphart (1999).

TQL e Kollmogorovit është një instrument matematik efektiv dhe i dobishëm për të zbuluar manipulimet e mundshme, të bëra në zgjedhjet parlamentare ose vendore në shtete demokratike bashkëkohore. Këto manipulime shkatërrojnë mekanizmin e rastësisë në sjelljen e votuesve dhe e divergjojnë ligjin e shpërndarjes së probabiliteteve të votave të grumbulluara nga partite politike nga kurba normale. TQL nuk harmonizohet me rezultatet zgjedhore në qoftë se kënaqet të paktën një njërin nga tri kushtet e mëposhtme:

1. Rezultatet zgjedhore nuk janë madhësi e rastit në kuptimin e Teorisë Moderne të Probabilitetit
 2. Rezultatet zgjedhore nuk përfaqësojnë me vërtetësi preferencat individuale të një pjese të votuesve për partite politike apo për kandidatët e tyre.
 3. Sjellja e votuesve në këto zgjedhje vendore nuk kënaq kushtin e pavarësisë, domethënë preferencat individuale të një pjese të votuesve varen nga interesat e disa votuesve të tjerë (të cilët janë politikanë, pushtetarë ose biznesmenë të fuqishëm).
- Me zmadhimin e numrit të QV të investiguara, bëhet më e theksuar konvergjenca e rezultateve të zgjedhjeve të regullta në shpërndarjen normale ose divergjenca e rezultateve të zgjedhjeve të parregullta nga shpërndarja normale.

- Në shtetet demokratike bashkëkohore, zgjedhjet vendore me rezultate zgjedhore të manipuluar janë shoqëruar me zmadhimin e korrupsionit politik dhe nivelit të spekulimit.

3. Kontrolli matematik i harmonizimit të rezultateve zgjedhore në Bashkinë e Dibrës me Teoremën Qendrore Limite

Shqyrtohen rezultatet zgjedhore për Kryetarin në Bashkinë e Dibrës, në datën 11 shtator 2016. Këto rezultate zgjedhore paraqiten në tabelën 1 (e cila përmban numrin e votave të vlershme për secilin kandidat) dhe në tabelën 2 (e cila përmban përqindjen e votave të vlershme për secilin kandidat). Votat e vlershme janë paraqitur për çdo QV. Janë gjithësej 118 QV. Ne do të analizojmë vetëm tabelën 2, sepse QV të ndryshme kanë numra të ndryshëm votuesish. Burimi i të dhënave zyrtare të rezultateve zgjedhore është KQZ.

Bazime teorike të studimit tonë janë: TQL e Kollmogorovit, Kriterit KSL, Kriteri SW dhe SPSS version 22 (2013).

Kandidatë për Kryetar Bashkie janë:

Muharem Qamil Rama (K1) dhe

Sherefedin Hamit Shehu (K2)

Formulohen hipoteza bazë H_0 dhe hipoteza alternative H_1 si më poshtë vijon.

H_0 : Rezultatet zgjedhore të kandidatit të shqyrtuar, të shprehura në përqindje votash të vlershme, kanë shpërndarje normale.

H_1 : Rezultatet zgjedhore të kandidatit të shqyrtuar, të shprehura në përqindje votash të vlershme, nuk kanë shpërndarje normale.

Rezultatet zgjedhore të kandidatit Muharrem Qamil Rama (kandidati K1)

Në zgjedhjet vendore për Kryetar në Bashkinë e Dibrës ishin gjithësej 33038 vota të vlershme. Kandidati K1 (Muharrem Q. Rama) grumbulloi gjithësej 18603 vota të vlershme; domethënë, 56.3 % të votave të vlershme.

Vlerësimi intervalor i pritjes matematike μ të përqindjes të votave të kandidatit K1, me siguri shumë të lartë $\gamma=99\%$, është:

$$P(53.76\% < \mu < 58.06\%) = \gamma = 99\%$$

$$\text{Mediana} = 56.51\%$$

$$\text{Deviacioni standard} = 8.91\%$$

$$\text{Koeficienti i variacionit} = 15.82\%$$

$$\text{Skewness} = 0.285 = 28.5\%$$

$$\text{Kurtosis} = 0.116 = 11.6\%$$

Kriteri KSL rezulton të jetë i pazbatueshëm për të dhënat e rezultateve zgjedhore të kandidatit K1, ndërsa Kriteri SW rezulton të jetë i zbatueshëm. Kriteri KSL është i pazbatueshëm për këto rezultate zgjedhore sepse mashtimi zgjedhor ka shkallë të lartë kompleksiteti në kuptimin Kollmogorov (Kolmogorov's complexity).

Vlera e vrojtuar e Kriterit SW është e barabartë me 0.992, ndërsa niveli i rëndësisë është $\alpha = 0.745 = 74.5\%$

Rregulli i marrjes së vendimit

Me siguri $\gamma = 1 - \alpha = 1 - 74.5\% = 25.5\%$ rezultatet zgjedhore të kandidatit K1 bien në kundërshtim me TQL e Kollmogorovit. Prandaj, besueshmëria e rezultateve zgjedhore të Kandidatit K1 (në kuptimin e zbatimit të TQL) është 74.5%.

Kjo besueshmëri nuk është e lartë, por konsiderohet e moderuar (sipas klasifikimit

statistikor), sepse me siguri 25.5% rezultatet zgjedhore të kandidatit K1 janë të manipuluar.

Rezultatet zgjedhore të kandidatit Sherefedin Hamit Shehu (kandidati K2)

Kandidati K2 (Sherefedin H. Shehu) grumbulloi gjithësej 14435 vota të vlershme; domethënë, 43.7% të votave të vlershme.

Vlerësimi intervalor i pritjes matematike μ të përqindjes së votave të kandidatit K2, me siguri shumë të lartë $\gamma=99.9\%$ është:

$P(41.94\% < \mu < 44.09\%) = \gamma = 99\%$

Mediana=43.49%

Deviacioni standard=8.91%

Koeficienti i varacionit=20.39%

Skewness=0.285=28.5%

Kurtosis=0.116=11.6%

Kriteri KSL është i pazbatueshëm, ndërsa Kriteri SW është i zbatueshëm për të dhënat e rezultateve zgjedhore të kandidatit K2.

Vlera e vrojtuar e Kriterit SW është e barabartë me 0.992

Rregulli i marrjes së vendimit:

Me siguri 25.5% rezultatet zgjedhore të kandidatit K2 bien në kundërshtim me TQL e Kollmogorovit. Pra, me siguri 25.5% këto rezultatet zgjedhore janë të manipuluar. Sipas përkufizimit statistikor Doob-Gnjedjenko-Hinçin të probabilitetit të ngjarjes së rastit, rrjedh se procesi i mashtrimit zgjedhor ka përfshirë 25.5% të votuesve. Prandaj këto rezultate zgjedhore kanë besueshmeri të moderuar (74.5%).

Ka vetëm dy kandidatë K1 dhe K2 për Kryetar në Bashkinë e Dibrës. Në këto kushte, TQL e Kollmogorovit vërteton (argumenton) matematikisht sa mashtrime (hile) kanë kryer bashkëpunorët e kandidatit K1 ose kandidatit K2, po nuk specifikon sa përqind të mashtrimeve ka kryer secili nga dy kandidatët.

- Marshall, B., & Drummond, M. (2006). *How teachers engage with Assessment for Learning: lessons from the classroom*. Kelvin Grove, Queensland, Australia: Research Papers in Education, 21(2), 133 - 149.
- MASHT. (2012). *Korniza Kurrikulare e Kosovës*. Prishtinë: Masht.
- Maxwell, J. (2004). Reemergent scientism, postmodernism, and dialogue across differences. *Qualitative Inquiry* 10(1). *Educational Researcher*, Vol. 33(No. 2), 3–11.
- Priestley, M. (2005). *Making the most of the Curriculum Review: some reflections on supporting and sustaining change in schools*, . (2. 3. 37(1), Ed.) Scottish: Scottish Educational Review.
- Rossi, O. L., & Freeman, H. (2003). *Evaluation A Systematic Approach*. (7. ed., Ed.) Thousand Oaks: Sage.
- Sainsbury, E., & Walker, R. (2007). *Same words, different meanings: Learning to talk the scientific language of pharmacy* (In Angela Brew & Judyth Sachs (Eds.), *Transforming a university: the scholarship of teaching and learning in practice*, (pp. 13-25 ed.). NSW, Australia:: Sydney University Press.
- Schwab, J. (1969). *Education and Career, Scholarly Work, The Practical, Legacy - Curriculum*. Chicago: Universitu and Educational.
- Scriven, M. (1967). The methodology of evaluation. (R. M. R.W. Tyler, Ed.) *Big Dog & Little Dog's Performance Juxtaposition*, 39-83.
- Sime, D., & Priestley, M. (2005). Introducing Formative Assessment: the case study of a Scottish school. *Stirling, University of Stirling*.
- Taras, H. (2005, July 5). Physical Activity and Student Performance at School Authors Howard Taras. (D. 10.1111/j.1746-1561.2005.00026.x, Trans.) *Wiley Online Library, Volume 75*, 214–218.
- Tunstall, P., & Gipps, C. (1996, Sep 5). Teacher Feedback to Young Children in Formative Assessment: A Typology. *British Educational Research Journal*, Vol. 22(No. 4), 389-404.
- Woolfolk, A. (2011). *Psikolgi Edukimi*. Tirane.
- Worthen, B. R., & Sanders, J. &. (2004). *Educational evaluation: Alternative approaches and practical guidelines* (3rd ed.). Boston: Allyn & Bacon.

Contracting competence through the economy growth and organizational culture in Republic of Kosovo

PhD (C.) Kastriot Blakaj

Dukagjini European College/ Peja, Kosovo

Prof Dr Alba Dumi

Dean of Graduated School, Ismail Qemali, Vlora University, Albania

Abstract

The Paper employed exploratory and qualitative research method. Data was sourced through the review of extant literature on the area of study. The study discovered base on the literature reviewed that organization culture has a relationship with employee career progression because career development initiatives are employee driven and also supported by the culture of an organization. The paper recommends that since management is familiar with the organization changing performance, therefore management should adequately support career development in order for employees to give their best so that the organization can realize its objectives. The paper also revealed that organization culture that does not promote entrepreneurial and risk taking initiatives poorly motivate employees, discourage and consequently affect the career progression of employees.

The paper concludes that organizational culture is positively related to employee career progression in public enterprises. It is recommended that management should develop cultural practices that will adequately support employee career development in public organizations. In terms of globalized economy, the integration trade cooperation process between state institutions, international organizations, and business entities are being followed by a dynamism regarding creation, modification, and termination of relations through the contracts which are now more standardized. Good business practices offered a good experience in terms of solving disputes on business transactions, local or international, security, efficiency and speed of trialing are enforced only if this issue is foreseen and contracted with special courts of arbitration. The role of arbitration on international trade, before all it is not only the solution of disputes. The arbitration has its mission before itself to build a fair trading practice and legal – business principle – bona fides.

Keywords: Organizational culture, Career progression, employee motivation, career development.

JEL qualification: K0, K2, K02.

Introduction

Organizational culture affects the performance and productivity of organizations in a tremendous way. According to Ejiogu (2004), a major factor militating against productivity in the Nigerian public sector is the public servants attitude to work and of course the general indiscipline and indolence of the larger society. Ejiogu (2004) also points out that we must not attribute the low productivity in the public sector to only the attitude of workers. Other factors contributing to low productivity, according to the author, include inequitable salary structure, poor working and living conditions, among others. Although the courts of arbitration should fulfill the

requirements of natural justice and decide in compliance with the law they should and can approve flexible and quick procedures. Despite the fact that arbitration may be more expensive trial process than the one carried out at a regular court, it is convenient to the traders and in principle they agree to stay with this procedure to win time and simplicity of the procedure. Except that, the expenses of arbitration usually should be affordable by the parties, and according to the rule they should be tax-free. The traders often prefer the intimacy of the arbitration process for publicity that gets during the trial procedure.

Dispute resolution through arbitration is known from antiquity. The roots may be found in old clan societies, where the leader of a tribe appointed its representatives who would then solve disagreements among different members of society. As the most known and the oldest agreement of arbitration that is considered to be is the agreement between Sumerian towns of Lagosh and Ume, in the fourth millennium B.C. for settling the borders (International Review, 2011).

In the beginning during the history, arbitration often was serving the first states, according to which private persons contracted their engagement for resolution of disputes in order to avoid strict formalities, ritual court procedures of that time, but also for resolution of disputes to which no appropriate claims were determined. The advantages of arbitration were seen from that time, which was applied not for domestic disputes but also between citizens of different states. "The arbitration courts emerged in the antique Greece. For the first time private judges were engaged to solve disputes between entangled citizens, although they were procedures of reconciliation and negotiation" (Thaçi, 2012, 24).

The findings from this research contribute to a wider appreciation of the implicit barriers to women's career development and retention and help organizations engage with the promotion of diversity initiatives that encourage gender career advancement and provide a better understanding of how organizations and their members can make progress.

The resolution of disputes out of state courts was also known in ancient Rome, when citizens could contract arbitration, but they also had a possibility to give up from the judgment of the arbitration, then they could continue the procedure with the same application at the regular court. However the parties did not have that right if they had an earlier agreement bound in written form.

Like every science, every action, every instrument has its own method of practical use, so does the arbitration law have its own methods of functioning." Arbitration methods are determined based on actions and means that it uses on the subject of the dispute during its work" (Thaçi 2012, 30). There are general methods that are used in some social sciences. Law on arbitration as a branch of law applies some methods like other sciences of justice do, however taking into account its specifications and the subject that this science deals with its application and diversity of these methods is specific (Thaçi 2012, 30).

The methods used by the law on arbitrations are as follows:

- Expertise method
- Analyses method
- Synthesis method
- Deduction method
- Abstraction method

- Classification method
- Comparison method

These methods are applicative methods from the arbitration law through which economic disputes are resolved and all these are international practices of functioning of the arbitration law.

It is well known that the complicated character and structure of international business relations require maximum care and special treatment when resolving certain disputes in this area¹This is because a belief prevails that the dispute shall be solved justly, quickly, professionally, and by personalities that are qualified and have proper moral and professional qualities."The parties before the arbiter of this court usually belong to business world and business activity".²

From these reasons the parties' interests are sometimes higher to keep their business connections and authority status rather than win the initiated dispute.

The role of arbitration in international trade is not based only on resolution of certain disputes. Before all, the mission of this institution is to build a practice based on *fair play* and *bona fide* principles within international trade activities in general. Therefore in the area of circulation and international trade operations arbitration stands, in principle, are taken into consideration too. According to the rule despite the arbitration stands are considered the effects that come from the risks in case of dispute resolution before these courts.

II. Results of the survey

"Regardless of principles and beliefs of certain countries for impartiality of the regular national courts, still the practice has not rarely shown that there are cases when these courts were bias favoring the local party. Such situation favored and actualized arbitration as a serious and impartial forum on resolution of disputes".³The selection of arbiter criteria influenced on determination of interested parties for arbitration, usually they are experts of international trade turnover and have enough knowledge about business techniques and operations. As we can select the arbiter and arbitration panel, the parties can freely declare which material or procedural laws want to proceed.

Except that the parties have the right according to the consensus principle to select the place of arbitration which means to select the country where the arbiter shall issue a award which has significant importance in its execution phase.

The special importance of arbitration is in the procedure speed. Within the process – arbitration trial, according to the rule the adjudication is of a single instance and less formal than the one that is issued by a regular court. The arbitration award is merited and the parties cannot appeal the award. The only legal remedy which can be applied against this award is the application to annul the award of the arbitration which will be decided by the competent domestic court according to the place where the procedure was conducted.

However, the annulment of the arbitration award can be applied only on allegations that the procedural conditions were not respected and in no way the material and factual conditions were not respected. The procedure before arbitration is not public

¹ Prof.Dr. Armand Krasniqi – International business law p-90

² Prof.Dr Armand Krasniqi – International business law p-91

³ Prof.Dr Armand Krasniqi – International business law p-99

because of the interests and business secrets that the parties have. All these conditions affected arbitration to gain primary role in dispute resolution of international trade turnover and business life.

III. Methodology of the paper research

According to Kotler and Heskett (1992), in a person, the personality is made up of the values, beliefs, underlying assumptions, interests, experiences, upbringing, and habits that create a person's behavior. Something as simple as the objects chosen to grace a desk says a lot about how employees view and participate in the culture of an organization. Lewis (1990) suggested that the content of a company's bulletin board, the company newsletter, the interaction of employees in meetings, and the way in which people collaborate, speak volumes about the culture of an organization.

The reasons for passing special national laws for arbitration are multiple. In the first place are those arising from intensive operations that are characteristic for international business. Arbitration has become the most common method for resolving disputes and even those states that are "inconsistency" with its concepts and choices every day are undergoing a much tougher regime and international trade requirements to change attitude in this field. In this context, the Arbitration Model Law on International Trade has proven to be the most important base for the modernization of the rules of international trade arbitration. Obviously this implies the need for national laws in this field to harmonize with it.

Provided that the arbitration award, no matter where land where it was issued will be recognized as binding, and that a written request to the competent court to make the narrow circle exactly specifying the reasons for refusal of recognition or enforcement, these documents provide effective results the price as the primary objective of any arbitration.

In current flourishing practice of arbitration proceedings, there are two main types of arbitration:

Ad hoc arbitration (A-temporary) and

➤ institutional arbitration (permanent selected courts). *Ad hoc arbitration* - is a chosen court which is established under the contract of the parties with the task and aim to judge only of a particular dispute, in order to cease to exist after the trial of the case.⁴

3.3.2 *Institutional Arbitration* - is a permanent organization, established with the task to carry out its function of the selected court, even when the parties involved in the dispute are advised to do that. These arbitrations are non-state services, ready to assist entities in need.

Agreement for arbitration

The dispute can be settled through arbitration unless there is an agreement between the parties (Article 5.1). "The focus of particular importance to arbitration is that the parties intentionally agreed to the use of arbitration and waive their right to judicial review in the courts of the country. Determining whether the parties have agreed to arbitration is the condition loosely covered in Article 6 of the Kosovo

⁴ *Programme system of execution of agreements and awards in Kosovo – USAID 2010 p-6*

Law on Arbitration which is discussed below”.⁵ It also notes that the agreement for arbitration is validity (Article 512).⁶

IV. Analyze and research

Basically, organizational culture is the workplace environment created or enacted from the interaction of the employees in the workplace (Wilkins, 2010). Organizational culture is defined by all of the life experiences, strengths, weaknesses, education, upbringing, and so forth of the employees as they are played out in the organization (Ogbor, 2003). While executive leaders or founders play a large role in defining the culture of the organization by their actions and style of leadership, all employees contribute to the maintenance of the culture of the organization once it has been created (Mitroff and Kilmann, 2001). Because organizational culture involves shared expectations, values, and attitudes, it exerts influence on individuals, groups, and organizational processes. According to Kennedy (2003), in many ways, the culture of organization affects the behaviors of its employees significantly. There are two categories of cancellation: when the basis for the annulment of the award is evidenced by the party invoking the cancellation, and when this is done by the court on its own initiative. Provisions for legal remedies are in compliance with the UNCITRAL Model for the Law on arbitration. Grounds to be proved by the party:

- one party had no capacity to act
- arbitration agreement is not valid
- violate one of due process—the claimant was not given proper notice of the appointment of an arbitrator or of the arbitral proceedings.

Basic grounds that the court may consider:

- arbitration is prohibited by law
- Execution of the award is contrary to public policy. *The losing party pays all expenses.*

KCC reports that since 2000 in total eight procedures were organized. Disputes were among Kosova companies and foreign companies. It seems that these informal procedures have been initiated by the embassies (commercial services) upon request of foreign companies.

Further KCC has reported that international companies have sought the assistance of KCC in resolving disputes with their local partners, but local companies refused to participate and take a stand that they can resolve disputes directly with their business partner. This issue is addressed in the education and public relations part.

V. Conclusions and recommendations

And, according to Bolman and Deal (2009), organizational culture is both a product and a process: “As a product, it embodies wisdom learned as it solved its problems of external adaptation and integration, that has worked well enough to be considered valid and therefore to be taught to new members as the correct way to perceive, think, and feel in relation to those problems.” As a process, it is renewed and re-created as newcomers learn the old ways and eventually become teachers themselves.” At its most basic, organizational culture is described as the personality of an organization,

⁵ *Programme system of execution of agreements and awards in Kosovo – USAID 2010 f-16*

⁶ *USAID in Kosovo 2010 f-10*

or simply as “how things are done around here.”

As described above, the institution may create the application for arbitration, support the arbitration process and enable quality control while maintaining high standards for arbitrators and reviewing arbitration awards. Since KCC and AmCham-are the only institutions which are currently prepared to move forward in the development of ADR, SEAD will initially focus its assistance to these institutions. Kosovo also continues to need to have consultations with regard to international arbitration and mediation, especially in the following areas:Update rules (rules of arbitration proceedings) to comply with current law on arbitration and international standards Krasniqi A - International Business Law - Pristine 2010. In all cases, the standards are generally based on documented experience, training, education and reputation. An arbitral tribunal usually does not begin to analyze in detail the agreement for arbitration to see that it meets all the prerequisites of validity, unless one of the parties challenges the jurisdiction of the Tribunal on the basis of an invalid clause for arbitration”.

References

- Dumi, A MCSER 2013, Roma Italy” AJIS Journal p. p 123.
- EMSG - Economic Stability and Growth management for program execution system of agreements and decisions in Kosovo - USAID - Pristine 2010.
- “Guides stones-jurisprudence of the European Court of Human Rights” Tirana 2000.Vol 1 p. p 198.
- “Guides stones-jurisprudence of the European Court of Human Rights” Tirana 2000.Vol 1fq 198.
- “Law court and the Convention of the Rights of Man “European University Centre of Warsaw vol 2 , 2001 pp 19-21.
- “For a European public order; Selected decisions are the European court of human Rights Tirana2000,Vol I ,pp 7.
- “For a European public order” . Selected decisions are the European court of human rights”. Tirana 2000,Vol I, pp 289.
- USAID - Document - International Contract and Dispute Resolution - Pristine -2008.
- Kotter, J.P. and Heskett, J.L. (1992). Culture and performance. New York: Free Press.
- Kunda, G. (1992). Engineering culture. Philadelphia, PA: Temple University Press.
- Lewis, G. (1990). Corporate strategy in action: The strategy process in British road services. London: Routledge.
- Martin, J. (2002). Organizational culture: Mapping the terrain. Thousand Oaks, CA: Sage.
- Miller, V.L. (2004). An examination of contemporary marketing prospects used by organizations
- Mitroff, I.I. and Kilmann, R.H. (1995). “Stories that managers tell: A new toolfor organizational problem solving”. Management Review, 64 (7),PP. 18-28.
- Mitroff, I.I. and Kilmann, R.H. (2001). On Organizational Stories: Approach to the design and analysis of organizations through myths and stories. In R.H. Kilmann, L.R. Pondy, and L. Steven (Eds.), The Management of Organization Design. New York: Elsevier.

Shqipja përballë procesit të globalizimit

Celjeta Nikolla

Abstrakt

Në këtë punim jemi përpjekur të tregojmë rrezikun që i kanoset në ditët e sotme gjuhës shqipe prej vërshimit të anglicizmave. Intesifikimi i marrëdhënieve në të gjitha fushat e jetës të vendit tonë më vendet e tjera dhe përpjekjet për t'u integruar në organizmat dhe nismat globale, kanë bërë që edhe Shqipëria, dhe gjuha shqipe të jenë më të hapura ndaj të huajës, veçanërisht ndaj gjuhëve të huaja. Pasi përshkruajmë rrugët dhe shkaqet e ardhjes në gjuhën tonë, të fjalëve të huaja, punimi vazhdon me dallimin midis "anglicizmave" dhe "huazimeve" nga gjuha angleze. Po kështu kemi përshkruar dhe analizuar disa nga tiparet që fitojnë këto njësi leksikore në trupin e shqipes.

Punimi vijon edhe me luftën, por jo purizmin e tepëruar ndaj anglicizmave, kriteret që na bëjnë të luftojmë me vendosmëri ndaj tyre si dhe vënien në dukje të atyre që kanë për detyrë ta ruajnë të pastër shqipen e të kujdesen për të, duke qenë se gjuha shqipe është i vetmi mjet unik përbashkimi i shqiparëve kudo në botë.

Fjalë kyçe: huazime, globalizëm, anglicizma, fushë leksikore, tipare gjuhësore.

Ne jetojmë në një botë ku marrëdhëniet janë të ngushta dhe intensive me popuj dhe kultura të tjera. Bota në të cilën jetojmë, këto dekadat e fundit, po na paraqitet ndryshe në kuptimin se po shfaqet një "sistem i ri" botëror. Kjo duket në të gjitha marrëdhëniet si: politike, ekonomike, kulturore etj dhe ka bërë që raportet e ndërvarësisë në mes të shoqërive të vinë gjithmonë e në rritje, kështu që ngjarjet në një pjesë të botës, ku më shumë e ku më pak, të ndikojnë në njerëzit dhe në shoqëritë e tjera. Të gjitha këto marrëdhënie të reja e të ngushta që po shfaqen dita-ditës janë të bazuara mbi komunikimin, prandaj për mendimin tonë, globalizmi në radhë të parë është komunikim. Ky realizohet me anë të mediave, botimeve, televizionit, internetit, pra, me anë të gjuhës së folur e të shkruar.

Rezultati që ka sjellë ky lloj komunikimi është i dukshëm. Kështu s'mund të gjenden më sot në botë komunitete njerëzore që për shekuj e shekuj kanë qenë të izoluar, me karakteristika të dallueshme e të pastra nga ana gjuhësore e kulturore, por gjejmë gjithnjë e më tepër shoqëri të prirura drejt botës, ku gjuhët e kulturat ndërveprojnë midis tyre. Në këtë kontekst, natyrshëm lind pyetja: ç'do të ndodhë me gjuhën tonë, të cilën e mbrojtën dhe na e lanë trashëgim të parët tanë?

Shqipja edhe para shumë shekujsh është gjendur nën tryshninë e gjuhëve të huaja me prestigj kulturor si: greqishtja, latinishtja, apo turqishtja. Por asnjëherë si në këto vite ajo s'është ndodhur nën presionin e njëkohshëm të disa gjuhëve. Fjalët e huaja po vërshojnë nga të gjitha drejtimet e mundshme e në shumicën e rasteve në kushtet e dygjuhësisë. Problemet ekonomike përpara të cilave u ndodhëm si vend nuk na lanë kohë t'i vinim re në kohën e duhur. Megjithatë, këto vitet e fundit, shqetësimi është shfaqur në shkrime të ndryshme, jo vetëm nga gjuhëtarët që e kanë për detyrë të kujdesen për gjuhën, por edhe nga njerëz të letrave, megjithëse janë këta të fundit që në shumicën e rasteve sollën fjalë e ndërtime të huaja të panevojshme.

Një trajtim i thellë gjuhësor i fjalëve të huaja sot në gjuhësinë shqiptare është më

së i nevojshëm për shumë arsye, sidomos për arsyen se në shqipen sot hyjnë me të madhe elemente të huaja të gjuheve me ndikim, sidomos nga anglishtja. Shtrohet pyetja: si të sillemi me fjalët e huaja, çfarë qëndrimi të mbajmë ndaj anglicizmave të rinj? Në studimet tona gjuhësore që trajtojnë fjalët e huaja duhet të jemi më realistë dhe ta kuptojmë drejt se pa fjalë të huaja nuk mund të jetojë as shqipja.

Ndikimi i anglishtes në botë dhe tek ne është vështirë të pengohet. Kultura masive, muzika, filmi, televizioni, interneti janë kanalet më të shpejta për pranimin e elementeve të huaja, sidomos nga anglishtja, po edhe nga frëngjishtja, italishtja etj. Duhet ta kuptojmë se kundër ndikimit të anglishtes nuk mund të luftojmë me masa administrative.

Sot jemi përballë dukurive kontradiktore në Europë. Nga njëra anë po flitet për Europën e Bashkuar, për heqje kufijsh, për politika të përbashkëta ekonomike, për luftë kundër urisë globale e terorizmit, për integrim Euroantantik apo në NATO, nga ana tjetër kemi një respektim të gjuhës së gjithsecilit shtet, madje edhe të pakicave. Në këtë shfaqje të kundërtash të gjithë kërkojnë një zgjidhje. Po t'i referohemi së kaluarës përpjekjet për një komunikim midis popujve me gjuhë të ndryshme kanë qenë të hershme. Shembuj për këtë janë notat e muzikës, matematika, kompjuteri, deri tek esperantoja.

Ndikimi i anglishtes nuk është ndikim i gjuhës si mjet dhune ose si mjet kolonizimi të mirëfilltë. Anglishtja sot është gjuhë e komunikimit ndërkombëtar, është gjuhë botërore dhe lufta kundër saj nuk është e thjeshtë. Por gjuhëtarët vërejnë me të drejtë se "Nëse për gjuhët e tjera rreziku nga globalizmi është më i vogël, në momentet e tanishme, sepse ato kanë qenë shoqëri të hapura ndaj tij më shpejt se ne e si rrjedhim gjuha e tyre është ndeshur më shpejt me keto probleme, për ne shqiptarët rreziku i shprishjes së gjuhës është aktual."¹

Gjuha angleze është sot gjuhë zyrtare në Britani, në SHBA, në Kanada (krahas frëngjishtes), në Australi, në Zelandën e Re dhe në Afrikën e Jugut. Ajo është gjuha që zë një vend të rëndësishëm në jetën e Pakistani dhe të Indisë. Jo rrallë ajo përdoret si gjuhë e tregtisë, e shkencës dhe e publicistikës në Azi, Afrikë e pjesërisht në Amerikën e Jugut. Miliona njerëz e flasin atë si gjuhë të dytë.

Siç dihet anglishtja po ushtron presion mbi shumë gjuhë europiane e sigurisht edhe mbi gjuhën tonë. Kjo përhapje e anglicizmave është rezultat i ndikimit politik, kulturor, ekonomik e teknologjik i ShBA-së, sidomos pas Luftës II Botërore, ndikim që u shtua edhe më shumë pas viteve '90. Me këtë rast duhet të theksohet se gjuha angleze nuk përhap vetëm ndikim negativ, por nga ana tjetër, ajo ka sjellë edhe pasurim, ashtu siç kanë sjellë pasurim edhe greqishtja, latinishtja, sllavishtja e turqishtja në historinë e shqipes, leksiku i të cilave vazhdon të jetë aktiv edhe sot e gjithë ditën.

Do t'i quajmë anglicizma (Shehu, 2015, 199) për t'i dalluar nga huazimet prej anglishtes, sepse janë të panevojshme dhe e dëmtojnë gjuhën shqipe. Ato ndihen si mishi i huaj në gjuhën tonë dhe nuk sjellin pasurim, por vetëm dublete të panevojshme.

Rrugët nëpërmjet të cilave hyjnë janë më së shumti: nga përkthimet politike, ekonomike, informatike, gazetave, lajmet televizive, konferencat, filmat e bisedat e takimet e ndryshme.

Lufta dhe qëndrimi ndaj tyre duhet të na kujtojë atë që bënë Rilindësit tanë me huazimet nga turqishtja në shek.XIX. Anglicizmat mund të themi se vërshojnë.

¹ Xh. Lloshi, "Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot", Studia Albanica, 2/2005

Brenda pak minutave që dikush mund të ndjekë një emision televiziv gjuha infektohet me shumë anglicizma që janë të panevojshme, si: Këshilli i Ministrave do të *asistojë*, qeveria *manaxhon* krizën e përmbytjeve, ka një *handikap* ligjor, kanë *trajnuar* ekspertë shqiptarë me *fulltime*, *leadershipet* e të dy vendeve, *startuan ndeshjet*, kjo që thotë është *nonsense*, *impakti* i vizitës së tij, ajo është tani *first lady* i vendit, është *involuuar* në një konflikt *etj.*

Tashmë jemi para faktit se huazimet angleze dhe anglicizmat “janë ulur këmbëkryq” në mediat tona, përkthime, fushën e modës dhe të politikës. Ky fakt u bë i dukshëm pas viteve nëntëdhjetë në Shqipëri, kur mijëra emigrantë çanë rrugët e botës, më së shumti në Greqi e në Itali, por s’munguan edhe në vendet e tjera, veçanërisht anglishtfolëse.

Po çfarë karakteristikash shfaqin këto fjalë të huaja në gjuhën tonë? A dallohen lehtë ato? A përshtaten me rregullat e shqipes dhe tipologjinë e saj?

Anglicizmat që përdoren rëndom në gjuhën tonë nuk shprehin nocione (Shehu, 2015), dukuri të reja. Ata janë më pak shprehëse, nuk sjellin ndikim cilësor në leksikon tonë. Kjo vjen se ato janë më pak shprehëse se fjala përgjegjëse në gjuhën shqipe, kanë kuptim më të pjesshëm se ato. Ato zakonisht janë më të veçuara dhe më të ngushta nga kuptimi, p.sh nuk mund të përdoret kudo fjala *interferim* kurse *ndërhyrje*, po: “U krye një *ndërhyrje* nga mjekët në gjurin e pacientit”, por jo “U krye një *interferim* nga mjekët në gjurin e pacientit”

Anglicizmat janë të kufizuara në përdorim edhe sepse ato nga vendi ku përdoren, i përkasin rëndom ligjërit libror, psh *implementim* i reformës; i dha *impakt* të ri *etj.*

Një veçori tjetër e anglicizmave është se ato nuk e zgjerojnë kuptimin leksikor zanafillës të tyre, psh: *kek*, *klikoj*, *bojkotoj*, *poster*, *monitoroj*, *piknik*, *smog*, *klub*, *bos*, *xhentëlmen*, *xhungël*, *menaxhoj*, *leadership*, *bord*, *draft*, *bandë* (muzikore), *grant* *etj.* Pra, mbeten të ngurta pa zgjerim kuptimi dhe si të tilla përdoren si njësi të gatshme, pra si “parafabrikate”. Përdoruesit e tyre nuk lodhen për të gjetur fjalën shqipe të barasvlerëshme me to, por mendojnë e flasin si gjuha e huaj që kanë mësuar nëpër kurse, nga këngët e filmat e preferuar.

Shqipja, nga ana tjetër, ka vetinë t’i përvetësojë dhe t’i përshtatë fjalët e huaja, madje t’i modifikojë edhe fonetikisht. Këtë e vërente dhe A. Kostallari kur thoshte se anglicizmat “nuk përdoren në trajtën e anglishtes, por në përgjithësi janë asimiluar nga struktura fonetike e gramatikore e shqipes” (Kostallari, 1982, 28-30). Kështu ne i lakojmë si në gjuhën shqipe anglicizmat: *bodigard-i*, *kontabilitet-i*, *luk-u*, *part-time-i*, *mban risk-un*, *shok-u* cerebral, *fans-a*, *apdejt-im* *etj.*

Kjo përshatje ka anën e mirë, por edhe të rrezikshme për gjuhën tonë. E para ka të bëjë me faktin se ato nuk ndihen të huaja dhe futen dalëngadalë në brumin e shqipes. Nga ana tjetër ato rrisin artificialisht leksikon e shqipes pa qenë e nevojshme, sepse ekziston fjala përgjegjëse në shqipe. Kështu ç’nevojë ka për *luk* kur shqipja ka fjalët *pamje*, *shou* për *shfaqje*, *bodigard* për *rojë*, *par-time* për kohë e *pjeseshme* ose jo e plotë apo *full* për *plot*, *feër* (*fair*) për *e ndershme*, *korne* për *këndore kast* i aktorëve për *trupa* e aktorëve, *lider* për *udhëheqës*, *market* për *treg*, *fajër* (*fire*) për *zjarr* *etj.*

Sigurisht, ne nuk jemi kundër fjalëve të huazuara nga anglishtja, të cilat kanë hyrë si terma të një fushe të caktuar. Kjo ka ndodhur jo vetëm në gjuhën tonë, por edhe në gjuhët e tjera, madje e njëjta fjalë përdoret në shqipe, por edhe italisht, gjermanisht *etj.* Kështu ne s’mund të luftojmë e të nxjerrim nga gjuha jonë njësi të tilla leksikore si: *fiskal*, *kompjuter*, *printer*, *skaut*, *futboll*, *basketboll*, *rimbursoj*, *biznes*, *buxhet*, *licensoj*, *trust*,

bord, bojkot, të cilat janë të rëndësishme për fushën ekonomisë, sportit e teknikës. Nuk mund të ndryshojmë as fjalë që kanë kuptim për historinë dhe kulturën e Amerikës apo të Anglisë, si: *puritanizëm, çartist, laburist, tuist, xhaz, rokenroll, kauboj, hipi, western* etj.

Kontrolli ndaj vërshimit të anglicizmave të panevojshme, së pari duhet të vijë nga politikat shtetërore. Një rol të rëndësishëm duhet të luajë shkolla dhe familja. Po një rëndësi të dorës së parë kanë mediat, gazetarët, drejtuesit e emisioneve, folësit në podiumin e kuvendit.

Konteksti socio-gjuhësor shqiptar ka ndryshuar shumë. Ai është dukshëm tjetër se ç'ka qenë madje edhe vetëm para dhjetë vjetëve dhe ndryshimet janë të kushtëzuara nga shumë faktorë. Edhe ndjeshmëria për problemet gjuhësore është tjetër. Për gjuhën dhe problemet gjuhësore nuk interesohen sot vetëm gjuhëtarët. Rrethi i të interesuarve është jo vetëm shumë i gjerë, po edhe i një përbërjeje mjaft heterogjene. Kjo të kujton thënien e filozofit Hajdegeri, i cili thoshte: "*Gjuha është një çështje aq e madhe sa s'mund të lihet vetëm në dorë të gjuhëtarëve*". Por për ne shqiptarët, ruajtja e gjuhë sonë është edhe një çështje kombëtare, sepse ajo është i vetmi mjet bashkimi që na afron të gjithë shqiptarëve edhe pse me troje të ndara. Veçanërisht e rëndësishme është ruajtja e strukturës së gjuhës sonë nga modelet kalkuese prej gjuhëve të huaja të cilat prekin thelbin e gjuhës.

Në rrethanat e sotme janë me vend fjalët e Shefkije Islamajt "*purizmi si refleks i vetëmbrojtjes gjuhësore, është nevojë e domosdoshme e ditës*" (Islamaj, 2002) Kjo nevojë e domosdoshme duhet të shkundë të gjithë ata që përdorin gjuhën si mjet pune.

Literatura

Islamaj, Sh. *Kultura e gjuhës dhe përdorimi estetik i saj*, Tiranë, 2002.

Kostallari, A. *Mbi disa drejtime të përsosjessë sistemit e të strukturës së gjuhës sonë*, "Studime filologjike", 1982, /2.

Lloshi, Xh. "Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot", *Studia Albanica*, 2/2005.

Shehu, H. "*Për anglicizmat në mjetet e sotme të informimit masiv*", në "Studime për leksikun dhe leksikologjinë", Tiranë, 2015.

Ndikimi i medias si mjet komunikimi, ne edukimin dhe formimin e te rinjve

Alma Kalija

Abstrakt

Mund të shprehemi dhe të japim mendimin se ndodh që ekrani i vogël apo edhe programet e tjera mediatike na rrëmbejnë gjithë vëmendjen dhe kohën, na kushtezojnë si për mirë dhe për keq. Shpesh na ngjall kërshëri e na informon dhe herë na con në mërzë e na largon dëshirën për të vepruar, kjo për shkak të pasojave, ndonjëherë të kobshme, të pushtetit që televizioni ushtron mbi teleshikuesit dhe në formimin e moshave të reja.

Njeriu është pjesmarrës i bashkësisë, në të cilën ndërton personalitetin, identitetin e vet, gjithmonë i ndikuar nga komunikimet. Në këtë punim shkencor paraqes prirjet themelore të shoqërisë shqiptare lidhur mbi fushën e mediave, dinamikat që ato shfaqin si dhe ngjarjet dhe realitetet themelore që plotësojnë jetën. Mediat luajnë një rol dominues në jetën e të rinjve, sepse ato kanë një sërë funksionesh, si p.sh funksioni informues, ku sa më të informuar të jenë qytetarët për aspektet ekonomike, sociale, politike, kulturore të vendit, aq më mirë ata do ta njohin situatën në të cilën jetojnë dhe aspektet ku do të jenë pjesmarrës. Funkzioni orientues, media ndihmon në formimin e gjykitimit personal të qytetarëve mbi punën e qeverisë dhe institucioneve të tjera demokratike. Funkzioni kritik dhe kontrollues, pa kontrollin e vazhdueshëm të gazetave dhe radio-televizionit mund të ndodhte që procesi politik demokratik të vihej në rrezik, të vuante nga korrupsioni apo burokracia e vetvetes. Funkzioni shoqëror, social, media ofron modele orientimi në të menduarin dhe sjelljen, imazhet dhe tipologjinë për fëmijët dhe të rinjtë.

Fjalet kyce: Ndikim, Media, Edukim, Komunikim, Adolehentë.

Hyrje

Masmedia dhe komunikimi masiv. Gazetaria me rolin e saj si ndërmjetësuese e informacioneve në interes të publikut mund të thuhet se lëviz brenda një hapësire të procesit të komunikimit. Ky proces gati revolucionar fillon me zbulimin e shtypshkronjës së Gutenbergut në shekullin XV. Natyrisht, komunikimi kishte funksionuar edhe më përpara, pasi libra shkruheshin, shtypeshin dhe qarkullonin, por shpërndarja masive e librave përmes shtypshkronjës solli masivizimin e informacionit. Komunikimi masiv, në formën që ne njohim sot, daton në shekullin XIX, në kohën e ngritjes së sistemeve demokratike, pas revolucionit industrial dhe prodhimit masiv të librave, gazetave, revistave, fotografive, muzikës etj., që njihet ndryshe si: kultura masive. Si pasojë e nevojave të mëtejshme të njerëzve lindën televizioni, radio, filmi dhe zhvillimi i mëtejshëm teknologjik solli internetin. Pra, kemi një komunikim masiv që kalon përmes mediash masive. Termi "**komunikim masiv**" do të thotë këtu se u drejtohet një numri të madh njerëzish (publikut) që paraqitet si anonim dhe heterogjen. Prandaj për procesin e komunikimit masiv, ekzistenca e masmediave është një kusht i domosdoshëm.

Cfarë mund të kuptojmë me termin "komunikim masiv":

Sipas studiuesit gjerman Gerhard Maletzke "komunikimi masiv" është ajo formë e komunikimit, ku thënie të bëhen publike, përmes mjeteve teknike të përhapjes (mediat), indirekt (distanca hapësinore, kohore mes partnerëve në komunikim) dhe në mënyrë të njëanshme

(pa ndërrim rolesh mes atyre që komunikojnë dhe atyre që e marrin mesazhin) për një publik të shpërndarë dhe anonim. Aspekte të ndryshme të procesit të komunikimit masiv i shohim te formula e njohur e studiuesit amerikan Harold Lasswell më 1948: “Kush thotë çfarë, në cilin kanal, kujt dhe, me ç’ndikim?”. Këtu hasim pesë dimensionë bazë: Komunikuesin; përmbajtjen mediatike; mediumin; marrësin dhe pasojat. Komunikuesi është ai që nis dhe drejton procesin e komunikimit. Me këtë nënkuptohen ata persona që marrin pjesë në prodhimin dhe publikimin e përmbajtjes mediatike. Kjo përmbajtje është forma e produktit që përhap masmedia. Mediumi është bartësi i vërtetë i mesazhit; këtu futen të gjitha mjetet (edhe teknike) që mundësojnë shkëmbimin e informacioneve mes atyre që komunikojnë. Marrësi paraqet atë që “merr” thëniet publike dhe përmbajtjet e transmetuara në media. Kjo sjell me vete pasojat e medias: ndikimi i lajmit që është komunikuar etj.

Funksionet e medias në Shqipërinë paskomuniste”

Në fillimet e janarit më 1991, shoqëria shqiptare e përqëndroi vëmendjen e saj tek një ngjarje, e cila pritej me padurim dhe shpresë. Pritej të dilte numri i parë i gazetës së parë opozitare, asaj të partisë Demokratike, që ishte formuar pak më parë. Gazeta që u quajt *Rilindja Demokratike*, doli për herë të parë në treg më 5 janar 1991. Ajo u shfaq në një mjedis shoqëror të etur për të thënë dhe për të dëgjuar dicka të re, të ndaluar deri atëherë. Ajo që bunte më shumë në sy ishte etja për te blerë e gjetur gjithsesi një gazetë të opozitës dhe për ta lexuar me një frymë. Etja e fillimit për shtypin nuk mbeti e njëjtë gjatë gjithë periudhës së mëvonshme. Pasi kaloi kjo dallgë e parë e pasionit, ajo nisi të zbehej dhe të kthehej në rutinë. Njerëzit e morën kënaqësinë e madhe për të folur në mënyrë të shpenguar, por më pas u lodhën. Me gjithë luhatjet e kuptueshme të interesit për mediat funksioni i tyre mbeti i pacënueshem.

1. Në radhë të parë roli i shtypit dhe i mediave në përgjithësi në Shqipërinë paskomuniste mbeti ai i plotësimit të dëshirës për të folur dhe për të dëgjuar lajme në mënyrë intensive, pas një heshtjeje të gjatë mediatike në kushtet e ankthit përballë së ardhmes, të vënë tashmë në kontakt të drejtpërdrejtë me individin.
2. Funksioni i dytë i mediave në Shqipërinë e periudhës menjëherë pas rënies së komunizmit është ai i rregullatorit në sjelljen politike të qytetarit shqiptar, i vendosjes së marrëdhënieve reciproke midis tij dhe forcave politike të vendit. Në njëfarë mënyre mediat u bënë faktor shumë i rëndësishëm për ndërtimin e raporteve politike të shoqërisë dhe, në një farë kuptimi, të vetë shtetit. Mjeti më i mirë i luftës politike bëhet në atë kohë propaganda me anë të medias dhe kryesisht me anë të gazetave, që kryesisht janë në dorë të partive politike.
3. Funksion i tretë i medias në Shqipërinë paskomuniste të periudhës së parë të tranzicionit ka qënë ai i hapjes kulturore dhe shpirtërore për nga perëndimi dhe vlerat e tij kulturore dhe politike. Në të vërtetë, në këtë drejtim, rolin parësor e ka luajtur televizioni, edhe pse stacionet televizive private shqiptare ende nuk kishin lindur.

Si rezultat i të (Fuga, 2006, 24) gjithë rrethanave në vend, mund të thuhet se hapja kulturore nëpërmjet mediave në Shqipëri u bë më shumë nëpërmjet televizionit sesa me anë të elementeve të tjera mediatike; nepermjet figurës si gjuhë komunikimi, sesa fjalë; bëhej më shumë nëpërmjet përshkrimit disi të lirë e të pavarur të mesazhit

mediatik të figurshëm, sesa nëpërmjet një mesazhi të shpjeguar gjerësisht; merte më shumë një psmje artistike të botës së jashtme; përbënte një shprehje emocionale të saj sesa kishte pamjen e një shpjegimi logjik. Për rrjedhojë të kësaj gjendjeje, njohej më mirë bota artistike, vlerat komuniste të Perëndimit të atyre viteve, yjet e tij, dhe më pak realiteti i shumëllojshëm, me përparësitë e jashtëzakonshme, por dhe me sfidat e mëdha me të cilat ndeshej shoqëria perëndimore e atyre viteve. Nuk do të ishte e mundur ndryshe. Duke jetuar në një mjedis shoqëror të izoluar nga pikpamja ekonomike dhe kulturore, te prapambetur në krahasim me Perëndimin e zhvilluar teknologjikisht, me një akses të vetëm mediatik në të atë televiziv, shqiptari i mbetur në Shqipëri, jo emigrant i mëvonshëm, nuk mund të mos kishte një përfytyrim parajsor mbi Perëndimin. Kjo traditë vazhdoi edhe në periudhën e parë të shoqërisë paskomuniste.

4. Lidhur vecanërisht me televizionin, është përvijuar edhe një funksion i katërt i mediave në Shqipërinë paskomuniste, që ka të bëjë me rolin e tyre argëtues. Ndikimi shoqëror i mediave si mjet argëtimi nga njëra anë zvogëlohej në krahasim me më parë, ndërsa nga ana tjetër rritej, nëse do të matej me rolin e institucioneve të tjera të argëtimit.
5. Në Shqipërinë paskomuniste mediat kanë luajtur, si funksion të tyre të pestë, një rol të rëndësishëm edhe për krijimin e hapësirës mediatike, kulturore e shpirtërore gjithëkombëtare.
6. Një vend të vecantë në mediat shqiptare (Fuga, 2006, 33-35) të periudhës paskomuniste së tranzicionit ka zënë edhe paraqitja e gjendjes së hapësirës informative të shqiptarët përtej kufirit shtetëror, kryesisht përpara ndërhyrjes ushtarake perëndimore në Jugosllavi.
7. Në këtë kuptim, mediat kanë shërbyer, së shtati, si një formë e drejtpërdrejtë reagimi, si një formë provokacioni, si një formë presioni politik nga ana e punonjësve të mediave për të përmbushur aspiratat e tyre ose për të mbrojtur interesat.

Të rinjtë dhe masmedia

Mediat luajnë një rol dominues në jetën e të rinjve. Prania e gjithanshme e mediave dhe mediatizimi i shoqërisë ndikojnë para së gjithash në formimin e identitetit të tyre. Duke qenë të vetëdijshëm për këtë rol të medias, të rinjtë nevojiten të kenë disa aftësi të caktuara ose atë që quhet kompetenca mediatike. Këtu futet njohja dhe mënyra e përdorimit teknik i mjeteve dhe gjuhës mediatike si dhe aftësia për të bërë dallime mes medimeve të ndryshme.

Lajmi dhe përzgjedhja e tij

Me rritjen e llojeve të medimeve është rritur edhe sasia e informacioneve që qarkullojnë për përdoruesit, të cilët vendosen para dilemës si t'i kuptojnë dhe perceptojnë ato. Shumë të dhëna mund të gjenden sot në internet, gjë që është sa komode, aq edhe problematike. Si të zgjedhim informacionin që duhet nga një botë e mbushur me njoftime dhe lajme të vazhdueshme? (Musai, Godole, Abdurrahmani, 2011). Kjo sfi dë e përzgjedhjes është sidomos për të rinjtë, por edhe për vetë median. Në ditë ndodhin përditë me mijëra ngjarje, të cilat media nuk mundet t'i mbulojë.

Kështu që ajo bën një përzgjedhje të ndodhive më të rëndësishme dhe ia paraqet ato publikut. Kjo bëhet në bazë të disa faktorëve:

Aktualiteti: Lajmet janë informacione të përgatitura mediatike për ngjarje aktuale. Ato shpalosin diçka të re, të rëndësishme apo të pazakontë. Edhe këtu ndiqet parimi “kur qeni kafshon njeriun nuk përbën lajm”. Por sipas logjikës së medias vetëm “kur njeriu kafshon qenin” kemi të bëjmë me një lajm.

Interesi publik: A përmend persona dhe fi gura të njohura? Zakonisht kur flitet për politikanë apo artistë çdo gjë e tyre përbën lajm. Për shembull kur një lider partie fi llon të mbajë një dietë, kjo pasqyrohet në media, por jo kur njerëzit e zakonshëm e bëjnë këtë.

Afërsia: sa më afër publikut (nga ana gjeografi ke por edhe nga tema) të jetë ngjarja, aq më shumë përbën lajm.

Zbavitja: Temat sensacionale të ashtuquajtura *sex & crime* shiten shumë dhe i interesojnë gazetës. Kronika e zezë vazhdon të mbetet në Shqipëri shumë e lexuar, duke u bazuar më shumë te emocionet, se sa te racionaliteti i lexuesve.

Kuptueshmëria: sa më i papritur të jetë një lajm, aq më shumë vlerë ka ai për lexuesit dhe gazetën. Lajmi duhet të jetë sa më teknik, sa më objektiv, pa paragjykime dhe të informojë në mënyrë korrekte për të gjitha detajet e ngjarjes.

Televizioni dhe Publiku, (Snobizmi intelektual dhe komunikimi masiv)

Përse vallë një mesazh politik, që synon të arrijë shkallën më të lartë të bindjes dhe ndikimit të njerëzit, nuk përcillet më nëpërmjet grumbullimeve tradicionale në sheshe, sic ndodhte në lashtësi, por përcillet nëpërmjet televizionit? (Zecchi, 2006, 11- 15) Dhe përgjigjja është sepse televizioni është më efikas. Por përse vallë? Kjo çështje ka vend për diskutim. Dhe përgjigjja është se fluksi i pamjeve televizive përcakton organizimin tonë racional, sistemin tonë të gjykimit, pra është modeli i jetës shoqërisht mbizotërues me të cilin pajtohemi. Ky racionalitet është product i një materializmi të ri viziv: “Ne jemi ajo cka shohim”.

Kush e ndjek televizionin? Ai që nuk ka ndonjë gjë për të bërë. Nuk shohim televizor kur vendosim të bëjmë dicka; madje, në mënyrë krejt paradoksale, as që vendosim të shohim televizor. Por nëse e shohim nga një kah tjetër themi se në thelb televizioni mbush një boshllëk. S’dimë c’të bëjmë dhe vetiu na shkon dora tek telekomanda; televizioni është shndërruar në një sfond të zakonshëm të jetës familjare, që na shoqëron kur këmbëjmë dy fjalë dhe rrëfejmë ngjarjet e ditës; jemi vetëm skemi asnjë angazhim tjetër dhe televizioni është një mënyrë për të vlarë mërzinë e për të flakur tej trishtimin.

Shkurt, një boshllëk që e mbush televizioni; në të vërtetë është një detyrë sa delicate, aq edhe e vështirë. Pikërisht ky fakt duhet të na shtyjë të mendojmë seriozisht se çfarë roli dhe kuptimi ka sot televizioni, si i zgjedhim programet për të mbushur zbrazëtinë ose më saktë: si e përdorim telekomandën që të zgjedhë për ne, ndësa shëtisim nga një stacion në tjetrin duke pritur dicka që mund të na tërheqë vëmendjen. Ndryshe nga dje kur vendosje të shihje dicka; sot boshllëku që mbush televizioni është dëshmi e pushtetit të pamatë televiziv dhe e aftësisë së tij për të krijuar një marrëdhënie të drejtpërdrejtë dhe të fortë me publikun. Televizioni arrin të bëhet zot i kohës sonë, jo sepse është i bukur, tundues, inteligjent, por sepse boshllëku i qënies sonë është i gatshëm ta presë krahë hapur.

Televizioni nuk është një enë e madhe që mbledh gjithcka, sepse në anën tjetër të ekranit ka nga ata që janë të gatshëm të pranojnë gjithcka me padurim, bezdi dhe neveri, por edhe me kërshtëri, interes e zbatimje. Kohët e vundit në ibrat e botuar i është kushtuar vëmendje e madhe televizionit, nga të cilët mund të nxirren këto përfundime: televizioni shtrembëron përfytyrimin e të rinjve, varfëron kërshtërinë e të rriturve, mpin inteligjencën, krijon pasivitete dhe shkatërron marrëdhëniet ndërpersonale në familje, zhvlerëson shkollën, ushtron një kontroll politik tinëzar, ndryshon pa e kuptuar mënyrën e të mnduarit, manipulon informacionin duke propozuar një model kulturor të njësuar, tjetërson shpirtin, u jep një grusht të rëndë ndjenjave duke kaluar sa hap e mbyll sytë nga një pamje mizore e të dhunshme në pamje rozë ose vulgare, pasqyron përgjithësisht një pjesë të realitetit duke lënë pas dore situatat më konkrete ose politikisht të diskutueshme. Televizioni është edhe një vrasës mizor i gjuhës dhe traditave krahinore, i merr frymën librit, kulturës së vërtetë të kërkimit dhe hierarkive kulturore. Natyrisht këto mëkate të rënda nuk janë krejt të rreme, as krejt të vërteta.

Interneti

Interneti është mbase mediumi më interaktiv sot. Ai ka hyrë gjerësisht në jetën e njerëzve dhe lehtëson mjaft të përditshmen e gjithsecilit. Një nga vlerat më positive të internetit është mundësia interaktive direkte që i ofrohet çdo përdoruesi për të shprehur mendimin e tij në lidhje me tema të caktuara, pra mundësia për të qenë një *komunikues*. Përdorimi i internetit sjell me vete edhe disa rreziqe, ndër të cilat mund të përmendim p.sh. mos reflektimin e përdoruesit mbi informacionet e marra, mos verifikimin e mjaftueshëm të të dhënave dhe varësinë teknologjike

Informacioni dhe Media

Informacioni televiziv mbërrin më shpejt se ai i shtypit të shkruar (Zecchi, 2006, 77), mund të hyjë në shtëpi në çdo orë të ditës dhe të na bëjë me dije në kohë reale për dicka të rëndësishme që është duke ndodhur. Në shumë raste, falë lidhjeve televizive, ke mundësi të shohësh, jo thjesht ta marrësh vesh nëpërmjet fjalëve të shkruara, atë që po ndodh edhe në skajin më të largët të planetit. Mënyra sesi televizioni e kryen këtë funksion, shpesh bëhet objekt kritikash të hidhura dhe therëse, si ajo që qarkullon në redaksitë e të përditshmeve: thuhet që nëse gazetarët televizivë do të ishin në lartësinë që kërkon detyra e tyre, shtypi i shkruar do të dilte krejt jashtë loje përsa i përket informacionit. Natyrisht që nuk është kështu, por kjo pyetje ngacmuese gjithsesi dëshmon se ç'forcë dhe pushtet zotërojnë lajmet e transmetuara nga televizioni në krahasim me ato të gazetave. Informacioni dhe e vërteta asnjëherë nuk përkojnë me njëra-tjetrën. E vërteta është e pafundme; informacioni është zgjedhje, interpretim, cka nënkupton se duhet të mbash një anë të caktuar. Informacioni nuk është e vërteta, por ç'do të ishte vallë e vërteta pa informacion? Sot, pikërisht nëpërmjet televizionit, jemi shumë më të informuar se në të shkuarën, por cilësia e këtyre informacioneve paditet me argument të përafërta me ato që përgjithësisht përdoren kundër televizionit. E vërteta është se televizioni i tregon shumicës së njerëzve vende, për të cilët ata s'kishin as njohuri të më elementare. Këtë fakt nuk e hedhin poshtë as ata që e konsiderojnë të përciptë

informacionin televiziv, as ata që hamendësojnë komplete të errëta të politikanëve për ta përdorur televizionin në dobi të interesave të tyre. Atëherë nuk kemi pse ta vëmë në kandar cilësinë e informacionit të televizionit për një ngjarje të caktuar, me cilësinë e një sprove që trajton të njëjtën çështje, të shkruar nga një akademik. Çështja thelbësore është të vlerësojmë nëse informacioni televiziv ngjall kureshtjen dhe ngre pikëpyetje. Detyra e tij kryesore është të sensibilizojë njerëzit dhe t'i nxitë ata të shfrytëzojnë gazetat apo librat për tu thelluar në çështjen në fjalë.

Shkolla dhe televizioni

Njëherë e një kohë përmbajtja e lëndëve mësimore ishte e shenjtë (Zecchi, 2006, 86), pra nuk vihej në diskutim. Nxënësit mund të kishin pakënaqësi dhe të vinin në diskutim mënyrën sesi mësuesit e pedagogët e jepnin lëndën, por jo vetë brendinë e lëndëve mësimore apo përse ishte në program një lëndë apo një tjetër. Lëndët, temat, përmbajtjet ishin të detyruara për nxënësit- dhe vetë mësuesit- dhe dobia e domosdoshmërisë e tyre as që vihej në diskutim. Kjo ishte dëshmi e fuqisë që kishte tradita në përcimin e trashëgimisë kulturore të qytetërimit tonë. Thjesht të guxojë të vejë në diskutim këtë të vërtetë, quhej herezi, shkelje e palejueshme e rregullave të sjelljes, të vendosura nga logjika akademike dhe autoriteti i saj në perceptimin e lëndëve dhe temave të programeve shkollore. Mërzia që shfaqin studentët, lëndët dhe programet që shpesh përmbanin ujë të tepërt dhe pasojat që sillte mungesa e interesit, jo vetëm që nuk merreshin për bazë nga autoritetet përgjegjëse të organizimit shkollor dhe universitar, por shiheshin si teka dhe injorancë e studentëve. Kundërshtimet e mëdha që zunë fill në vitin 1968 dhe që prekjin në radhë të parë sistemin shkollor, i dhanë goditjen përfundimtare legjitimitetit të padiskutueshëm tradicional të didaktikës dhe autoriteteve që e mbështesnin. Hovi individualist i të rinjve të '68-s u dha studentëve të drejtën për të vendosur lidhur me parimet e formimit dhe edukimit. Rrjedhja e kësaj është rrënim i sistemit autoritar ku bazohej shkolla dhe universiteti.

Kthim mbrapa nuk ka dhe është e kotë nostalgjia për të shkuarën, që në ditët tona do të ishte krejt pa vend. Sot duhet futurë në udhë të mbarë shkolla, që luhatet nën peshën e modernizimit. Nuk është fjala thjesht për reformimin e programeve të studimit, përditësimin e disiplinave apo rishikimin e metodave didaktikave: të gjitha këto janë me vend; por gjithsesi nuk preket thelbi i problemit; kjo mund të shërbejë thjesht në dukje për të gjallëruar kulturën shkollore, por në thelb e mohon atë, duke e vënë në varësi të kulturës mediatike, duke i dhënë pamjes një përparësi që leximi dhe shkrimi nuk e përmbushin dot. Vlera dhe autoriteti i kulturës shkollore u ishin imponuar studentëve. Për më tepër, vlera dhe autoriteti i shkollës respektohehin nga të rinjtë farë ndërmjetësimit të prindërve, ngaqë shkolla dhe familja bashkoheshin si një trup i vetëm rreth idesë së shtrëngimit, detyrimit, kufizimit të lirisë. Sot shkolla s'ka rrugë tjetër- dhe nëse kjo do të ndodhte do të ishte për të parën herë- vecse të bazohet tek aktualiteti i kuptimit kulturor dhe shoqëror, duke flakur tej dy arsyetimet e skajshme, që të dyja fort të dëmshme, pra legjitimitetin e saj nëpërmjet autoritetit, ose nëpërmjet thjeshtëzimit të të nxënit, sipas idesë se studimi është zbatimje. Kultura shkollore nuk mund të zëvendësohet me institucione të tjera; formimi dhe dijet që merren në shkollë nëpërmjet leximit të atyre teksteve që nuk do t'u kthehemi më në moshë të rritur, apo nëpërmjet teksteve shkencore që më vonë do të zënë pluhur në

rafte ose do të flaken tej, janë të qënësishme dhe mund të jenë një ndihmë e vlefshme pikërisht për shkak të sfidës që ka lëshuar televizioni. Humbja e pushtetit të kulturës shkollore dhe e funksionit të transmetimit të një trashëgimie mijëvjeçare qytetërimi, nuk varet nga televizioni, por nga vetë sistemi shkollor. Këtë realitet e njohin fort mirë mësuesit që, edhe pa ndihmën e sistemit shkollor, arrijnë, falë aftësive të tyre profesionale, t'i japin kuptim dhe t'i kthejnë autoritetin shkollës.

Televizioni mund të jetë një *ndihmë* dhe *sfidë*. Ndhimë, sepse fare mirë mund të jetë një aleat i shkëlqyer e kulturës së shkruar. Shumë emisione përbëjnë një ndihmesë të vyer për mësimdhënien cilësore. A nuk duhet të jetë ky një nga funksionet e të ashtuquajturit "shërbim publik televizioni"? Por edhe sfidë, në kuptimin që kultura shkollore duhet të bëhet konkurruese me pamjen, pra të jetë më kuptimplotë, më e thellë, më joshëse se ajo televizive.

Asnjë qytetërim nuk është i pavdekshëm, e përse duhet të jetë i tillë qytetërimi i librit? Gjithsesi kush beson në modelin e një culture që mishërohet në edukimin nëpërmjet leximit dhe shkrimit, duke e parë si një formë të qënësishme të lirisë dhe emancipimit të njeriut, e hedh poshtë nihilizmin e atyre që e quajnë mjetin televiziv thjesht në një spektakël të rëndomtë e aspak serioz dhe ngulin këmbë se ky është maksimumi që mund të japë mjeti televiziv duke përcmuar jo dhe aq televizionin, nga i cili fusin në xhepa goxha para drejtpërsëdrejtin apo tërthorazi, por njerëzit që e shohin.

Nga ana tjetër, nëse është e vërtetë që formimi shkollor është i pazëvendësueshëm, që vepra themelore të kulturës sonë nuk preken më me dorë pasi dalim nga bankat e shkollës, është po aq e vërtetë që veprat teatrore të Pirandelos apo të Shekspirit mund të shihen në television nga miliona njerëz dhe falë kësaj, këta shkrimtarë janë më shumë të njohur sot se në të shkuarën. Televizioni është mjet i përkryer informimi, culture dhe zbavitjeje, me të cilin "qytetërimi i librit dhe i shkollës" duhet të vihet në garë.

Vetëm se kjo garë ka *rregullat* e veta. Dhe përderisa ekzistojnë rregullat, është e rëndësishme të zhvillohet një kritikë e brendshme në botën e televizionit, me qëllim që tu vihet fre zërave që bërtasin për thjeshtëzim dhe banalizim të spektakularizimit televiziv dhe trullos mendjet e njerëzve, apo nihilizmit që e quant ë pamundur ekzistencën e dallimeve në cilësinë dhe llojin e mesazhit, sepse e konsideron televizionin si një gur mulliri që bluan e njëson gjithcka që kalon nëpërmjet mekanizmit të tij komunikativ.

Publiku dhe format e ndikimit te publikut

Që nga fillimet e shtypit dhe më vonë edhe të zhvillimit të medias elektronike, përmbajtjet e prodhuara mediale janë përdorur, jo vetëm për të informuar, arsimuar dhe argëtuar opinionin, por edhe për ta manipuluar, varësisht prej asaj se kush ka qenë mbrapa medias, kush e ka financuar.

Mediat sigurisht që kanë ndikuar në procesin e lidhjes së njerëzve dhe kjo ka ardhur nga shkak i urbanizimit dhe industrializimit të madh në fillim të shek XX. Njerëzit nuk mund të jetonin të izoluar apo në ambiente lidhjeje të ngushta familjare. Nën ndikimin e mediave të komunikimit masiv masa mori përmasën e fenomenit, të cilin sociologu frëng Gustav Le Bon, shekullin XX e kishte quajtur, i ndikuar po nga ky fenomen, si shekull i masës. Masa derisa u paraqiten mediat massive, vlerësohej si

një "qënie" që vepron mbi parimin ideomotorik, pa farë vullneti. Kjo masë madje petiohej si një kope që kërkontë bariun e vet, sepse pa të ajo ishte dhe do të mbetej e humbur. Në këtë gjendje, pra një personalitet i fuqishëm mund që vullnetin e vet t'ia impononte kësaj mase. Kjo u lehtësua shumë me futjen në përdorim të mediave masive.

Në aspektin sociologjik shtypi krijoi fenomenin e ri shoqëror-publikun (Zecchi, 2006, 88). Përvec ndikimit nga jashtë, përmes mediave, publiku konsiderohet si një factor shumë i rëndësishëm ndërveprues dhe këtu duhen parë elementët e një faktoragjensi, i cili në disa raste të vecanta krizash më shumë, merr një rol shumë të madh. Në mediat publike vecmas, duke qënë vetë një nga financuesit e medias, publiku dëshiron që të ketë dhe të mbajë një ndikim të vërejtshëm në përmbajtjet mediale. Jo kot pretendohet se ky lloj i mediave, pra publike, funksionojnë në parimin e sërbyesve publikë që, në fakt, financohen nga publiku dhe pretendohet se kontrollohen po nga publiku. Jo rrallë shtrohet pyetje nëse ndikon dhe në çfarë mase është e manifestuar pesha e publikut në kontekst të medias.

Karl Jaspers nisur nga kjo gjendje konfuze potencon: "Eshte e diskutueshme nëse në liri realizohen të vërtetat. Ajo që është e sigurt, është se nën censurë ajo e vërteta, pra do të jetë e shtrembëruar". Vetëm në publikun ku funksionon individi, mund të ketë krijim të lirë të opinionit public dhe ai vetë mund të vendosë për zgjedhjen e tij. Demokracia dhe liria e mendimit janë dy çështje të të njëjtës medalje. Cilat modele të lirisë i nevojiten individit për të realizuar opinionin autonom. Pavarësisht nga natyra e të qenit të tyre, mediat dhe prodhimet e tyre, vërtet janë të kushtëzuara nga hapësira e lirisë, të cilën kryesisht e diktojnë proceset politike dhe zhvillimi social-ekonomik i një shoqërie. Një përkufizim i lirisë d.m.th. të mos ekzistojë dhuna. Në aspektin politik liria definohet si "pavarësi e popullit nga vullneti i pakontrolluar i individit, ose pavarësia e shteteve nga ndikimi, presioni dhe kërcënimi i shteteve të tjera".

Perfundime

Një definicion i mundshëm përmbledhës do të ishte: " Mediat janë të gjitha mjetet e informimit (gazetat, revistat, publikimet, agjencionet, radiot, televizionet, internet etj)". Studiuesit e shkencave të gazetarisë, në mesin e mediave sot numërojnë: gazetetat, revistat, publikimet e specializuara, radiot, televizionet dhe internet ose median virtual, e cila është bërë pjesë e shoqërisë bashkëkohore, mungesa e të cilës është e paimagjinueshme për të komunikuar. Kur thuhet media, atëherë kuptimi i kësaj fjale është shumë larg prejardhjes latine: " Media është mjedisi, vendi, ndërmjetësi, në të cilin bëhet ndikimi shpirtëror dhe hipnoza".

Mediat u pasqyrojnë të rinjve faktet sikur edhe vlerat e përgjithshme, duke i mësuar ata se cilët elemente prodhojnë fuqi, sukses, dominon në shoqëri dhe ata u ofrojnë të rinjve shembuj të sjelljes. Kjo bëhet, sepse të rinjve u mungojnë sjelljet e standartizuara, ata i përdorin këto informata që të zhvillojnë mendimet e tyre. Sociologët, ndër të cilët edhe Doris Graber, mendojnë se mediat massive duhet të jenë të besueshme dhe me një rëndësi të vecantë për vazhdimin e socializimit dhe të risocializimit. Ndryshe nga Graber, më herët, Mekuejl theksonte konceptin teorik se mediat massive janë një tërësi e komunikimeve massive. Në këtë koncept të komunikimeve massive ai fut "tërësinë e aktivitetet e ndryshme që kërkojnë përmbajtje mediale etj". Një

tjetër studiues i gazetarisë, Lorimer thekson se në këtë nënkuptohet se mediat kanë detyrë primare, por të paformalizuar që ta shënojnë realitetin dhe njëkohësisht ta kontrollojnë atë. Por, këtu shprehet më shumë realiteti, sepse ai në të vërtetë “ është ashtu sic e paraqesim ne”.

Mediat luajnë një rol të madh etik. Duke botuar shkrime kundër korrupsionit, ato denoncojnë bartësit e dukurive sociopatologjike dhe negative në shoqëri. Roli i tyre dënues etik në shumë raste, krijon atmosferë aktive të preventivës, po njëkohësisht hap rrugë edhe për dënime reale, pas argumentimit dhe procedurave ligjore, dënime që i jep institucioni i gjyqit.

Mediat krijojnë vlera dhe nxisin krijimin e kërkesave të reja te publiku, ndonëse publiku nuk ka mjete që ato kërkesa t’i realizojë. Në këtë kuptim mediat shndërrohen në një prodhues të frustrimeve kolektive. Kjo mund të shkaktojë edhe *deprivacitetin relativ*, mbasi publiku nuk mund të mbërrijë atë që është e paarritshme nga ai në realitet.

Referenca

Artan Fuga. (1990- 2000), Spekter, (2006), Media, shoqëria dhe politika. Tirane.

Stefano Zecchi. (2006), Njeriu është cka ai sheh: televizioni dhe populli. Tiranë.

Ibrahim Berisha. (2006), Media, Agjenset e komunikimeve. Pen Qendra e Kosoves, (Peje:,, Dukagjini’). Prishtine.

Bardhyl Musai, Jonila Godole, Tidita Abdurrahmani. (2011), Edukimi Mediatik. Botues: Instituti Shqiptar i Medias, Tirane.

Roli i viktimave të krimeve gjatë procesit penal

Drnt. Jeta Shkurti Toçila

*Prokuroria e Përgjithshme Shqiptare
Zyra e Ndhmës ndaj Viktimave të Krimit*

Abstrakt

Në shumë shoqëri viktimave me të drejtë është quajtur si “person i harruar” në administrimin e drejtësisë. Vëmendje e konsiderueshme i është dhënë procesit të pandehurit, i cili mbi të gjitha ka mbi krye kërcënimin e dënimit dhe për këtë arsye i duhet dhënë cdo mundësi për sigurimin e pafajësisë përmes prezantimit të çështjeve gjatë mbrojtjes. Kjo shkallë vëmendje nuk është dhënë ndaj viktimës. Shteti supozohet të përfaqësojë interesat e viktimës dhe deri më sot nuk është realizuar ende asgjë për përfshirjen direkte të viktimës në proces. Nisma e Prokurorit të Përgjithshëm Adriatik Llalla në krijimin e Zyrës së Ndhmës ndaj Viktimave në shkurt 2016, është hapi i parë që duhet pasohet me ndryshime në kuadrin ligjor. Në legjislacionin tonë termi “viktimë” përmendet në disa nene të Kodit Penal, por aty nënkuptohet personi që ka humbur jetën si pasojë e një veprë penale. Lipsët që të futet më gjerë koncepti i viktimës si person fizik që ka pësuar dëm, duke përfshirë dëmtime mendore apo fizike, vuajtje emocionale, humbje ekonomike të shkaktuara drejtpërdrejtë nga një krim dhe anëtarët e familjes së një personi që kanë pësuar dëm për shkak të humbjes së jetës së tij si pasojë e një krimi. Që herët në vitet '40 Benjamin Mendelsohn dhe Hans von Hentig, të njohur si baballarët e viktimologjisë, kanë tërhequr vëmendjen ndaj problemeve me të cilat përballen viktimat, si në shoqëri ashtu edhe në ndërveprimet e tyre me sistemin e drejtësisë penale. Shumë shtete janë përpjekur prej kohësh ti përgjigjen sfidave dhe të forcojnë pozicionin e viktimës, po aq sa edhe të sigurojnë akses në shërbimet e duhura. Vendi ynë ka miratuar një pjesë të mirë të Konventave që lidhen me drejtësinë e viktimave të dhunës në familje, abuzimeve seksuale, trafikimit apo terrorizmit, por ende nuk ka ndërmarrë nisma për hartimin e ligjit të posaçëm apo të përmirësimit të ligjeve ekzistuese ku të përmenden mbrojtja e të drejtave të viktimave. Ky punim përpiket të adresojë rolin e viktimave në procesin e drejtësisë penale. Qëllimi është të sugjerojë ndryshime në legjislacion duke shtuar rolin e viktimave në procesin penal dhe të drejtat e tyre. Në punim diskutohen dhe jepen rekomandime për ndryshimet që mund të bëhen në mënyrë që të kënaqen edhe pritshmëritë e viktimave të krimit nga përfshirja e tyre në proces.

Fjalët kyçe: viktimë, të drejta, dëm, ndihma ndaj viktimave.

Hyrje

Në sistemin tradicional të drejtësisë, viktimat e krimeve kanë gjetur zakonisht mbështetje nga familja, fisi apo komuniteti. Rrjeti informal social ka zbutur ndikimin e viktimizimit dhe ka ndihmuar viktimën në rikuperim. i njëjti rrjet social ka ndihmuar në zgjidhjen e konflikteve dhe sigurimin se cdo vendim i marrë është zbatuar. Në këtë kontekst, merret e mirëqënë që viktimave, viktimizuesi dhe i gjithë grupi social do të ndajnë barrën që lidhet me konfliktin. Në shumë vende të botës, roli i viktimave të krimeve ka qenë një burim debati. Megjithatë shumë iniciativa janë marrë në drejtim të legjislacionit në shumë vende, duke inkurajuar pjesëmarrjen në procesin e drejtësisë penale edhe të organizatave me fokus në këshillimin e viktimave, rehabilitimit, përfshirjes së komunitetit, shumë viktimave janë ndjerë të lëna jashtë

vëmëndjes. (OVC, 1998, OVC, 2002, Rodrigues, 2005). Mungesa e entuziazmit për përfshirjen e viktimave në proces mund të jetë rezultat i mungesës së komunikimit së organizatave me viktimat për rolin dhe të drejtat e tyre. Ata që e kundërshtojnë përfshirjen e viktimave në procesin e drejtësisë argumentojnë se prania gjatë seancës gjyqësore ose ndikimi i viktimës në vendimin gjyqësor, con në vendime më të ashpra ndaj autorëve (Davis & Smith, 1994, Erez & Tontodonato, 1992, OVC 2002). Ndërsa mbështetësit e përfshirjes së viktimave argumentojnë se studimet kanë treguar që viktimat përgjithësisht kanë ndjenja pakënaqësie ndaj procesit penal, janë të palumtur me rezultatet e çështjes dhe se sistemi drejtësisë preokupohet më tepër për autorin sesa për viktimën. (OVC, 1998, OVC, 2002, Gegan & Rodriguez, 1992). Këto debate na cojnë drejt çështjes se cili duhet të jetë roli i viktimës në procesin penal. Ky punim do të diskutojë mbi rolin e viktimave të krimit gjatë procesit penal në vendin tonë me theks në balancimin e interesave të shtetit dhe viktimës, gjithmonë duke iu referuar praktikës ndërkombëtare.

Të drejtat e viktimave në rrafshin ndërkombëtar

Me rritjen e kompleksitetit të shoqërisë dhe evoluimin e sistemit të drejtësisë, disa vende gradualisht kanë pohuar rolin dominant në procesin e drejtësisë pasi shumë viktima janë përballur nga trajtime të padenja nga punonjësit e policisë, prokurorët apo oficerët gjyqësorë, duke shkaktuar një "lëndim të dytë". Kjo vlen veçanërisht për disa kategori veçanërisht vulnerabël të viktimave, siç janë femrat e dhunuara ose shfrytëzuara, minoritetet dhe viktimat e krimeve seksuale të mitur ose jo. Edhe nëse shkelësi është arrestuar dhe sjellë në gjyq, përvoja e viktimave në shumë juridiksione është se ata kanë qenë të marxhinalizuar dhe nuk kanë patur mundësi për të shprehur pikëpamjet dhe shqetësimet e tyre në procesin e drejtësisë penale, ose në gjykata të drejtave të njeriut apo të gjykatave ndërkombëtare. Shumë sisteme nuk lejojnë që viktima të paraqesë kërkesën e saj në lidhje me pjesëmarrjen në procedurën penale. Edhe nëse autori i krimit është i dënuar, sanksionet (shpesh një gjobë, ose me dënim alternativ) kanë pak rëndësi për viktimën, përveç ofrimit të kënaqësisë për dënimin e autorit.

Gjithashtu, faktorë të tjerë, si ndryshimet në shoqëritë që kanë rritur ndikimin e viktimizimit, kanë cuar në një rivlerësim fundamental të pozicionit të viktimës. Incidencat e krimit dhe abuzimet janë shtuar në gjithë botën. Në të njëjtën kohë modelet tradicionale të solidaritetit social dhe varësisë janë ndërprerë. Ndryshimet në mënyrat e prodhimit dhe prirjet drejt urbanizimit të cilat janë shoqëruar nga imigrimi i brendshëm dhe i jashtëm dhe dëmtimi i infrastrukturës shoqërore kanë zvogëluar rolin e familjes së gjerë dhe forcën e kontrollit social. Anomia, papunësia, dobësimi i skemave të mbështetjes shoqërore, kanë minuar aftësinë e individit për të marrë veten nga viktimizimi. Shumë shtete janë përpjekur prej kohësh ti përgjigjen sfidave dhe të forcojnë pozicionin e viktimës, po aq sa edhe të sigurojnë akses në shërbimet e duhura. Në nivel ndërkombëtar, interesimi për viktimat është trajtuar në kongreset ndërkombëtare të mbajtura gjatë 1800-s, ku, janë bërë thirrje për kthim të dëmshpërblimit në drejtësinë penale, një çështje e cila është trajtuar në shumë vitet e fundit nga organizata të tilla si Shoqata Ndërkombëtare e Ligjit Penal, Shoqata Ndërkombëtare e Mbrojtjes Sociale dhe Shoqata Ndërkombëtare e Kriminologjisë. Takimi i parë i madh ndërkombëtar që u fokusua në mënyrë të veçantë mbi viktimat

ishte Simpoziumi Ndërkombëtar mbi Viktimologjinë, mbajtur në Izrael në vitin 1973, i cili në 1979 çoi në krijimin e Shoqatës Botërore të Viktimologjisë. Në nivel ndërqeveritar, puna e Këshillit të Evropës në 1983 ka çuar në miratimin e Konventës Evropiane për Kompensimin e Viktimave të Krimeve të Dhunshme (që hyri në fuqi në vitin 1988), 1985 rekomandimi në pozitën e viktimës në kuadër të drejtës dhe procedurës penale, dhe 1987 rekomandimi mbi ndihmën për viktimat dhe parandalimin e viktimizimit. Në një nivel praktik, Kombet e Bashkuara kanë kërkuar të sigurojnë ndihmë humanitare për viktimat e fatkeqësive natyrore dhe atyre të shkaktuara nga njeriu. Operacionet e saj paqeruajtëse kanë kërkuar të ndihmojnë edhe viktimat e dhunës etnike dhe të një konflikti civil. Përpijekjet e Kombeve të Bashkuara në parandalimin e diskriminimit të minoriteteve, si dhe dhuna ndaj refugjatëve dhe objektivave të tjera të ndjeshme, sidomos emigrantëve, grave dhe fëmijëve janë shembuj të tjerë. Megjithatë, më shumë punë duhet bërë, për të adresuar plotësisht kërkesat e veçanta të viktimave të krimit në vendet në zhvillim dhe në vendet me ekonomi në tranzicion, si dhe kategoritë e veçanta të viktimave, siç janë viktimat e genocidit, terrorizmit, krimit të organizuar dhe lloje të tjera e viktimizimit masiv. Puna e individëve, organizatave, qeverive dhe organeve ndërkombëtare për të rivendosur viktimat e krimit në vendin e tyre të ligjshëm në sistemet ligjore dhe për të rritur sasinë dhe cilësinë e ndihmës në dispozicion të viktimave nuk ka qenë e lehtë. Sistemet ligjore kanë evoluar gradualisht gjatë shekujve dhe propozimet për reforma për të përfituar viktimat kanë ngritur shqetësimet që ata mund të heqin nga të drejtat legjitime të të tjerëve si të dyshuarit dhe të pandehurit. Për më tepër, është provuar shpesh se është e vështirë për të sensibilizuar përfaqësuesit kryesorë të sistemit të drejtësisë penale, hartuesit e politikave, ligjvënësit dhe anëtarët e komunitetit për faktin se ndryshimi është i nevojshëm. Mund të ketë në fakt, fusha ku interesat dhe shqetësimet e viktimave të jenë në kundërshtim me ato të të tjerëve. Krijimi i shërbimeve për viktimat kërkon burime të cilat për pasojë nuk mund të jenë në dispozicion për qëllime të tjera. Të drejtat e ndryshme procedurale, të tilla si e drejta për konfidencialitetin dhe mbrojtjen, duhet të jenë të balancuara kundrejt të drejtave të të pandehurit, si e drejta për t'u përballur me akuzën dhe për të përgatitur mbrojtjen e tij ose të saj. Megjithatë në shumicën e rasteve, nuk ka konflikt të tillë. Edhe pse shërbimet kërkojnë burime, duhet kuptuar se çdo anëtar i një komuniteti mund të bëhet një viktimë dhe se shumica e krimeve kontribuon në viktimizimin e anëtarëve të tjerë të komunitetit dhe përkeqësimin e komunitetit dhe harmonisë shoqërore.

Pse është thelbësore të ndihmohen viktimat?

Qëllimi kryesor i ligjit penal është të mbrojë rendin kushtetues, dinjitetin e njeriut, pronën dhe bashkëjetesën e njerëzve nga veprat penale. Ligji procedural duhet të garantojë një balancë mes të drejtave të të akuzuarit dhe të drejtave të viktimës. Të gjithë ndihmësit e viktimave dhe hartuesit e politikave duhet të kuptojnë ndikimin e viktimizimit në mënyrë që të kuptojnë nevojën për asistim. Ndihmësit e viktimave dhe të tjerët që punojnë me ta ose në dobi të tyre duhet të kuptojnë nivelet e reagimeve të viktimave që janë universale dhe të kuptojnë se këto reagime mund të shprehën në një mënyrë të tillë që të reflektojnë një kulturë të caktuar.

Ndikimet fizike dhe financiare të viktimizimit

Në kohën e ndodhjes së krimit ose pas zbulimit të tij, viktimat mund të përjetojnë reagime fizike ndaj ngjarjes. Kjo mund të përfshijë rritje të adrenalinës në organizëm, rritje e rrahje të zemrës, frymëmarrje të përshpejtuar, dridhje, lot, ngrirje, mpirje, ngadalësim lëvizjesh, tharje e gojës, përgjigje “lufto ose fluturo”. Është e natyrshme për njerëzit të humbin kontrollin e lëvizjeve të tyre. Disa nga këto reagime fizike mund të mos ndodhin deri sa kalon reziku. Ato mund të ndodhin në një fazë të mëvonshme kur kthehet kujtesa rreth krimit. Pas krimit, viktimat mund të vuajnë një sërë efektesh fizike si insomnia, humbje e oreksit, dhimbje koke, tensione muskulore, marrje mendsh, rënia e libidos. Disa nga këto reagime mund të persistojnë për ca kohë pasi krimi ka ndodhur. Dëmtimet fizike që rezultojnë nga viktimizimi mund të mos jenë të dukshme menjëherë. Kjo mund të jetë veçanërisht e vërtetë në rastet e dhunës në familje ku dëmi ndodh në pjesë të trupit të cilat normalisht janë të mbuluara me veshje. Dëmtimet e fytyrës ndodhin më shpesh gjatë formave të tjera të sulmeve. Viktimat mund të vuajnë një sërë dëmsh fizike, përfshirë djegiet, thyerje hundësh, thyerje kockash, thyerje dhëmbësh. Dëmtime të tjera mund të shoqërohen edhe me përdorimin e thikave ose armëve të zjarrit. Dëmtimet fizike mund të jenë një efekt i përhershëm i krimit dhe ka fakte se kjo ka efekte negative në rikuperimin afatgjatë psikologjik, përderisa shenjat fizike shërbejnë si një kujtesë konstante e krimit. Faktorët kulturorë, gjinia, profesioni mund të ndikojnë tek reagimet e individit ndaj paaftësisë së përhershme sic edhe reagimet e të tjerëve.

Për impaktin ekonomik të krimit ka më pak të dhëna. Viktimat mund të bëjnë shpenzimet e mëposhtme: Riparimin ose zëvendësimin e pronës së dëmtuar, instalimin e masave të sigurisë, aksesit në shërbimet shëndetësore, marrja pjesë në proceset gjyqësore, ndjekja e këshillimit psikologjik, marrja e raporteve mjekësore, shpenzime funerale.

Në terma afatgjatë, krimi mund të ndikojë në punësimin e viktimës. Viktima mund ta ketë të vështirë të kthehet në punë dhe performanca në punë mund të afektohet, duke sjellë ulje në detyrë, ulje në pagë apo edhe shkarkim nga detyra. Kjo mund të ndodhë kur krimi është kryer në ambientet e punës, prandaj do të jetë e vështirë për viktimën të shmangë njerëzit ose situatat që cojnë drejt viktimizimit. Marrëdhëniet martesore apo lidhjet sentimentale të viktimës mund të afektohen si pasojë e një krimi dhe kjo mund të ndikojë edhe në gjendjen financiare të familjes. Studimet tregojnë se valët e tronditjes nga viktimizimi prekin jo vetëm viktimën por edhe familjen, të afërmit e miqtë e ngushtë. Kjo mbetet e vërtetë për pasojat emocionale po aq sa edhe financiare dhe efektet mund të zgjasin për shumë vjet ose përgjithmonë. Në rastet e genocideve, abuzimeve me fëmijët, ekspozimit ndaj dhunës dhe abuzimit me pushtetin, efektet mund të transmetohen nga një brez në tjetrin. Efektet e viktimizimit godasin veçanërisht të varfërit, të pafuqishmit, të paaftët dhe të izoluarit nga shoqëria. Hulumentimet tregojnë se ata që janë tashmë të prekur nga viktimizimi janë veçanërisht të ndjeshëm ndaj viktimizimit të mëvonshëm nga të njëjtat forma të krimit apo të tjera. Këto viktime të përsëritura në shumë vende qëndrojnë në komunitetet me nivele të larta të krimit dhe janë gjithashtu një dukuri e zakonshme gjatë kohës së luftës. Refugjatët janë një pre e mirë për tu abuzuar dhe ata shpesh janë subjekte të viktimizimit sekondar. Ky është rasti për shembull i dhunës ndaj punëtorëve të cilët mund të bëhen viktime të një abuzimi fizik, mendor

dhe seksual nga punëdhënësi, ose policia. Ata janë bërë target i krimeve të urrejtjes dhe praktikave të shfrytëzimit. Viktimizimi sekondar i referohet viktimizimit që ndodh jo si rezultat direkt i aktit kriminal por përmes përgjigjeve apo veprimeve të institucioneve apo individëve ndaj viktimës. Viktimizimi sekondar i institucionalizuar është më i dukshëm në sistemin e drejtësisë penale. Disa herë ajo mund të përbëjë një mohim të plotë të të drejtave të njeriut për viktimat e grupeve të veçanta kulturore, klase ose një gjinie të caktuar, me anë të refuzimit për të njohur përvojën e tyre si viktimitë e një krimi. Kjo mund të duket nga sjelljet ndërhyrëse ose e papërshtatshme nga ana e policisë ose personelit tjetër të drejtësisë penale. Më shumë viktimizim sekondar mund të shkaktohet gjatë gjithë procesit të hetimit dhe gjykimit, kur mund të ndodhë që çështja të pushohet ose autori të lirohet.

Dëmi psikologjik dhe kostoja sociale

Krimi zakonisht përjetohet më seriozisht sesa një aksident. Është vështirë të kuptosh e pranosh se humbja dhe lëndimi janë shkaktuar nga akti i cilit limit të një tjetër qenieje njerëzore. Në të njëjtën kohë është evidente nga studimet dhe përvojat se është e pamundur të parashikosh se si një individ do të përgjigjet ndaj një krimi. Një mënyrë për konceptimin e reagimeve të përbashkëta të krimit është si një proces me katër faza. Reagimi fillestar mund të përfshijë shok, frikë, zemërim, pafuqi, mosbesim dhe faj. Reagime të tilla janë të dokumentuara mirë menjëherë pas krimit. Disa prej këtyre reagimeve mund të përsëriten në një fazë të mëvonshme, si dhe, për shembull, kur marrin pjesë në një gjyq ose duke shkuar në spital për trajtim mjekësor. Zemërimi është një reagim që disa viktimat dhe ndihmësit e tyre e kanë të vështirë ta përballojnë. Ai mund të drejtohet në viktimat të tjera, tek ndihmësit, kalimtarët, organizatat dhe te vetja. Në disa kultura mund të konsiderohet e gabuar shprehja e zemërimit edhe kur ndjenja është e fortë. Por nuk mund të ketë presion mbi viktimat për të kontrolluar emocionet e tyre. Këto reagime fillestare mund të pasohen nga një periudhë çrregullimesh, të cilat mund të shfaqen me simptoma psikologjike të tilla si mendimet shqetësuese në lidhje me ngjarjen, ëndrra të këqija, depresioni, faji, frika dhe humbjen e besimit. Jeta duket se ngadalësohet dhe të humbasë kuptimin. Besimet e mëparshme duket se nuk të japin komfortin e duhur. Përgjigjet sjellore mund të përfshijnë rritjen e përdorimit të alkoolit dhe përdorimit të substancave, fragmentarizimin e marrëdhënieve sociale, shmangien e njerëzve dhe situatave të shoqëruara me krimin dhe tërheqjen sociale. Për shumë njerëz, vjen një periudhë e rikonstruksionit dhe pranimit, e cila con në normalizimin ose përshtatjen. Fazat e hershme në kushtet e krimit karakterizohen nga të menduarit retrospektivë, ku viktimat presin gjatë që gjërat të kthehen si më parë. Kjo fazë kyce në rehabilitimin e viktimave i drejton viktimat në pranimin e realitetit asht sic është. Ristrukturimi kognitiv mund të jetë i nevojshëm, në mënyrë që viktimat të riinterpretojnë eksperiencat e tyre për të përmirësuar efektet e krimit dhe mundësisht të gjejnë një shpjegim për atë që ka ndodhur ose të vlerësojnë ngjarjen ndërsa shkojnë drejt rritjes personale. Lidhjet mes fazave të ndryshme nuk janë të prera me thikë sic sugjerohen këtu dhe divizionet kanë qëllim të jenë si një ndihmë për të kuptuar procesin më tepër sesa përshkrimet kategorike. Njëkohësisht viktimat mund të mos progresojnë lehtësisht përmes fazave por mund të luhaten me kohën ndërmjet tyre. Masa në të cilën individët (viktimat, dëshmitarët, anëtarët e familjes, të komunitetit) afektohen

nga krimi do të variojë nga një ekstrem në tjetrin, njerëzit mund tu kushtojnë vëmendje krimeve të rënda pa efekte të dukshme, ndërkohë që nga ana tjetër, ata ngecen në një fazë dhe asnjëherë nuk dalin prej saj.

Të drejtat e viktimave në vendin tonë

Edhe në vendin tonë shkalla e vëmendjes ndaj viktimave ka qenë e ulët pothuaj inekzistente. Shteti supozohet të përfaqësojë interesat e viktimës dhe deri në fillim të vitit 2016 nuk ishte perceptuar asnjë nevojë për përfshirjen direkte të viktimës në proces. Në legjislacionin termi “viktimë” përmendet në nenet 48, 52/a, 79,/a/b, 82 dhe 303 të Kodit Penal. Kodi i Procedurës Penale përdor termin “i dëmtuar nga vepra penale”. Viktimat nuk janë, si rregull, subjekt procedural, (përfshirje bën rasti i të dëmtuarit akuzues), pasi interesat e viktimës duhet t’i përfaqësojë prokurori.

Por pritet që me ndryshimet e reja ligjore të futet më gjerë koncepti i viktimës si person fizik që ka pësuar dëm, duke përfshirë dëmtime mendore apo fizike, vuajtje emocionale, humbje ekonomike të shkaktuara drejtpërdrejtë nga një krim dhe anëtarët e familjes së një personi që kanë pësuar dëm për shkak të humbjes së jetës së tij si pasojë e një krimi. Ndërkohë, bazuar në Kushtetutë si dhe në Aktet Ndërkombëtare të miratuara nga shteti shqiptar, si Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollin e saj, Deklarata e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së mbi Parimet Bazë të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Abuzimit me Pushtetin, Direktiva 2012/29/EU të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje Stamboll 11.05.2011, në muajin janar të vitit 2016, në Prokurorinë e Përgjithshme është krijuar Zyra e Ndihmës ndaj Viktimave. Qëllimi është rritja e përgjegjësisë institucionale në mbrojtjen e të drejtave të individit dhe respektimin e dinjitetit, privatësisë, sigurisë personale të personave të dëmtuar nga vepra penale me njohjen me të drejtat e tyre në procesin penal. Objekt i punës së Zyrës së Ndihmës ndaj Viktimave, deri në momentin e mungesës së një neni të vecantë në Kodin e Procedurës Penale është këshillimi dhe informimi i viktimave të krimit me fokus të vecantë viktimat në moshë të mitur apo me aftësi të kufizuara, viktimat e dhunës në familje, viktimat e shfrytëzimit seksual, trafikimit dhe terrorizmit. Këshillimi dhe Informimi përfshijnë dhënien e mbështetjes fillestare përmes orientimit me shërbimet mjekësore, psiko-sociale, etj, që ofrohen nga strukturat shtetërore apo dhe organizatat si dhe informimin me të drejtat e tyre bazë. Aktualisht, viktimës (të dëmtuarit) i njihen këto të drejta: Të bëjë kallëzim penal (neni 58 i KPP-së), të kërkojë marrjen e provave nga prokurori dhe të ankohet në gjykatë, në rast refuzimi (neni 58 i KPP-së), të njoftohet për pushimin e çështjes nga prokurori dhe të bëjë ankim kundër këtij vendimi (neni 329 i KPP-së), të kërkojë kthimin e sendit dhe shpërblimin e dëmit me padi civile (neni 58 i KPP-së dhe nenet 608 e vijues të Kodit Civil), të njoftohet për seancën gjyqësore (neni 333 i KPP-së), të shpërblehet për shpenzimet e kryera nëse thirret si dëshmitar.

Viktimës (të dëmtuarit) nuk i njihen këto të drejta: E drejta për mbrojtje nga kërcënimet/ sulmet e të pandehurit (përveç zhvillimit të seancës me dyer të mbyllura dhe disa mundësi procedurale që u jepen vetëm gjykatave për krimet e rënda). E drejta për t’u njoftuar në kohë për çdo zhvillim të rëndësishëm të çështjes, veçanërisht për arrestimin ose lirimin e të akuzuarit. E drejta për t’u dëgjuar nga gjykata, edhe

nëse asnjëra nga palët nuk ka kërkuar thirrjen si dëshmitar. E drejta për të përfituar ndihmë ligjore falas. E drejta për t'u përjashtuar nga taksat gjyqësore për paraqitjen e padisë civile dhe kërkesës për ekzekutimin e vendimit civil.

Si ndihmohet një viktimë në vendin tonë?

Menjëherë sapo rregjistrohet një procedim penal me objekt vepra penale që implikojnë një viktimë të mundshme, Prokurori i çështjes ose Oficeri i Policisë Gjyqësore, pasi ka identifikuar viktimën e krimit njofton Zyrën për Ndhimën ndaj Viktimave, përmes telefonit, për të patur shpejtësi komunikimi, dhe më pas përmes shkresës zyrtare. Gjithashtu prokurori bashkëngjijt në njoftim edhe një informacion të përmbledhur rreth ngjarjes. Koordinatori për Ndhimën ndaj Viktimave kontakton sa më shpejt të jetë e mundur viktimën në zyrën e tij, ose në ambientet e prokurorisë apo një ambienti tjetër në përputhje me situatën e viktimës. Fillimisht bëhet prezantimi mes palëve dhe një përshkrim i përgjithshëm i rolit të ndihmësit të viktimave në proces. Në këtë takim, viktimja njihet me të drejtat e tij/saj dhe pyetet nëse dëshiron të marrë shërbimin e ofruar nga ZNV. Mund të ndodhë që një person i identifikuar si viktimë nga prokurori i çështjes, të mund të mos e pranojë statusin e viktimës. Prandaj, në këtë pikë, viktimja jep deklaratë me shkrim pranimi ose refuzimi shërbimi. Pas deklaratës së pranimit viktimja plotëson formularin e kërkesave për marrje informacioni nga ZNV. Jo të gjitha viktimat e një krimi duan të kenë dijeni mbi gjithçka që ndodh për një proces penal. Ka syresh që u intereson vetëm masa e dënimit, ka të tjerë që duan informacion për çdo seancë gjyqësore që zhvillohet. Prandaj viktimave u kërkohet që në fillim të shprehin interesat e tyre mbi llojet e njoftimeve. Më pas viktimja intervistohet me synimin e mbledhjes së informacionit rreth ngjarjes dhe pasojat e shkaktuara te viktimja. Ndhimësi i viktimave bën një vlerësim paraprak, me qëllim përcaktimin e nevojave të viktimës, sigurisht duke vënë në fokus edhe kërkesat apo nevojat që artikuloohen prej viktimës. Në bazë të nevojave të përcaktuara, Ndhimësi i viktimave kontakton me koordinatoren e shërbimeve sociale në Bashki, duke i paraqitur rastin bashkë me rekomandimet e zyrës. Gjithashtu i bëhet e ditur viktimës informacioni i nevojshëm për përfitimin e ndihmës së caktuar që do ti ofrohet nga strukturat shtetërore në bashkëpunim edhe me organizatat jofitimprurëse. Pas referimit të viktimës tek koordinatori në bashki, Viktimës i caktohet takimi i rradhës me ndihmësin e viktimave, sipas grafikut të dakordësuar. Në takimin e dytë, zhvillohet intervista e dytë, e cila synon mbledhjen e të dhënave lidhur me ecurinë e rastit që ndiqet nga strukturat e bashkisë. Gjatë gjithë periudhës së trajtimit të viktimës me shërbime të ndryshme, Viktimja duhet të informohet edhe rreth ecurisë së hetimeve dhe procesit gjyqësor, në përputhje me kërkesat që ai ka deklaruar në takimin e parë. Nevojat e viktimës për trajtim mund të variojnë në kohë sipas rasteve. Mendohet minimalisht një afat nga 48 orë deri në 3-mujaj periudha e asistimit të viktimës nga Zyra e Ndhimës ndaj Viktimave. Në fund të kësaj periudhe, institucioni/organizata ku është referuar viktimja dërgon raportin përfundimtar me shkrim. Dhe më pas, ZNV harton relacionin e tij përfundimtar të rastit duke i dërguar edhe një kopje prokurorit të çështjes.

Çfarë ndodh kur viktimja nuk merr mbështetjen e pritur nga shërbimet sociale?

Në rast se viktimja raporton se nga strukturat ku është referuar për të marrë ndihmë nuk i është ofruar mbështetje e mjaftueshme, ndihmësi i viktimave kontakton me

koordinatorin e bashkisë për të gjetur zgjidhje alternative. Viktimave të krimit mund t'u ofrohet dhënie e ndihmës në sigurimin e të drejtave dhe shërbimeve edhe nga organizata që operojnë në fushën përkatëse, kur strukturat shtetërore nuk kanë kapacitete të mjaftueshme për tu ardhur në ndihmë. Ato referohen nga ndihmësi i viktimave në këto qendra, të cilat nga ana e tyre duhet të informojnë vazhdimisht ZNV për ecurinë e gjendjes së viktimës, përmes raporteve me shkrim. *Kur viktima siguron prova shtesë apo informacione ajo mund të kërkojë takim jashtë rradhe me ndihmësin e viktimave dhe ia vë në dispozicion. Ndihmësi i viktimave ka detyrimin të kontaktojë prokurorin e çështjes në funksion të mbështetjes së viktimës në proces. Në rast se viktima merret në cilësinë e dëshmitarit, ndihmësi i viktimës, mund ta shoqërojë në seancën gjyqësore, për ti dhënë mbështetje.*

Pra deri në këtë pikë ka arritur në vendin tonë çështja e të drejtave të viktimave. Përveç urdhrin të Prokurorit të përgjithshëm, ende nuk ka një ligj ose nen në Kodin e Procedurës Penale të përcaktojë nocionin dhe pozicionin e viktimës sipas konceptit të dhënë në direktivën 29/2012 të Këshillit të Europës.

Përfundime

Roli i viktimës së krimit në procesin penal duhet parë si një akt ekuilibruar. Nën një perspektivë të re, roli i viktimave në procesin penal mund të jetë për të balancuar çështjet dhe interesat që kanë lidhje me të drejtat e viktimave. Viktima duhet të jetë më tepër se një dëshmitar, por jo duke patur kontroll total mbi çështjen. (Stickels, 2008).

Roli që viktima luan duhet të jetë më i fortë sesa ka qënë më parë, me theks tek vendimi i gjykatës. Viktima dhe gjykata duhet të komunikojnë rregullisht duke dhënë shpjegime specifike se pse një shkelës ligji, autori i veprës penale duhet të dënohet ndryshe nga c'pret viktima.

Kjo bën që viktima të ndihet mirë dhe të marrë si një lloj shpërblimi kur dëgjohet ndërkohë që vendoset balanca mes viktimës dhe shtetit. (Wemmers & Cyr, 2006).

Nevojat e viktimave duhen mbushur dhe për këtë lipsen ndryshime në shtetin e drejtësisë penale. 30 vitet e fundit në SHBA lëvizjet për të drejtat e viktimave kanë ndikuar në rritjen e ndryshimeve duke vënë theksin në balancat mes interesave të shtetit dhe interesave të viktimave.

Por edhe pse janë bërë këto ndryshime, viktimat janë ndër të neglizhuara dhe të pakënaqura në arritjen e objektivave të tyre për tu dëgjuar në një proces penal. Krijimi i një fondi për rimbursimin e viktimave do të ishte një rekomandim i vlefshëm në kohën kur rritja e numrit të viktimave të dhunës në familje për shembull në vendin tonë është fakt. Krijimi i Qendrës Kombëtare për Dhunën në familje është një hap pozitiv, por i pamjaftueshëm. Në këtë qendër momentalisht janë vetëm 40 shtretër ndërkohë që numri i viktimave të dhunës në familje është më tepër se 4-fishi i shtretërve në ditë. Në mënyrë që të drejtat e viktimave të krimeve të përmbushen duhet që të paktën në cdo prokurori të ketë mbrojtës së viktimave të cilët duhet të koordinohen me punonjësit përkatës të komisarivateve të policisë dhe së bashku të koordinojnë me shërbimet që mund ti ofrohen nga organizatat viktimave. Edhe pse në disa ligje të kohëve të fundit mbi shërbimet sociale të varura nga pushteti vendor parashikohen ofrime shërbimesh për kategoritë në nevojë si psh viktimat e dhunës dhe trafikimit, këto shërbime nuk janë të mundshme pasi mungojnë profesionistët e duhur dhe investimet në këtë fushë. Por si cdo prurje e re në sistemin e drejtësisë,

edhe cështja e të drejtave të viktimave do kërkojë kohën e vet për tu implementuar. Shpresojmë që me mbështetjen dhe vullnetin e ligjvënësve dhe palëve të ekspertëve të arrihet standardi i kërkuar nga Bashkimi Evropian edhe për të drejtat e viktimave.

Referencat

- Blackwell, B. & M. Vaughn (2003). "Police civil liability for inappropriate response to domestic assault victims," *Journal of Criminal Justice* 31(2):129-146.
- Davis, R. & B. Smith (1994). "The effects of victim impact statements on sentencing decisions: A test in an urban setting," *Justice Quarterly* 11(3):453-469.
- Deklarata e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së mbi Parimet Bazë të Drejtësisë për Viktimat e Krimin dhe Abuzimit me Pushtetin.
- Direktiva 2012/29/EU të Parlamentit dhe Këshillit Evropian.
- Elias, R. (1993). "Taking the victim's movement for a ride," Sage Publications:52-65.
- Erez, E., & Tontodonato, P. (1992). Victim participation in sentencing and satisfaction with justice. *Justice Quarterly*, 9:393-418.
- Cassell, Paul G., and Steven Joffe (2013). "The Crime Victim's Expanding Role in a System of Public Prosecution". *Northwestern University Law Review*.
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollin.
- Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje. Stamboll 11.05.2011.
- Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.
- Kilpatrick, D., D. Beatty, & S. Hoëley (1998). *The rights of crime victims—Does legal protection make a difference?* Washington, DC: National Institute of Justice.
- Langton, L. (2011). *Use of victim service agencies by victims of serious violent crime*. Bureau of Justice Statistics.
- Ligji nr 10 039 dt 22.11.2008 "Për ndihmë juridike".
- Ligj nr 8503 dt 30.06.1999 "Për të drejtën e informimit".
- Ligj Nr.10 347, datë 4.11.2010 "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës".
- Ligj Nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare".
- Ligj Nr.10 425, datë 2.6.2011 Për ratifikimin e konventës së këshillit të europës "Për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve".
- Ligj Nr.9833, datë 22.11.2007 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin opsional të konventës së OKB-së " Për të drejtat e fëmijëve", për përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura".
- Ligj Nr.9834, datë 22.11.2007, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin opsional të konventës së OKB-së "Për të drejtat e fëmijëve", për shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë me fëmijë".
- Ligji 8737 datë 12.02.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe parimet e rregullat e njohura nga e drejta ndërkombëtare.
- Morgan, K. & B. Smith (2005) "Victims, punishment, and parole: The effect of victim participation on parole hearings." *Criminology & Public Policy* 4(2):333-360.
- Rojek, D., J. Coverdill, & S. Fors (2003). "The effect of victim impact panels on DUI rearrest rates: A five-year follow-up," *Criminology* 41(4):1319-1340.
- Sims, B., B. Yost, & C. Abbott (2005) "Use and nonuse of victim services programs: Implications from a statewide survey of crime victims." *Criminology & Public Policy* 4(1):361-384.
- Vendim Nr.204, datë 21.3.2012 Për miratimin e "Dokumentit Bazë, si pjesë përbërëse e raporteve të shteteve palë në konventat e OKB-së për të drejtat e njeriut".

Efiçienca e energjise, burimet e ripërteritshme (aplikimi i tyre) dhe strategjit e energjise ne Kosove

PhD (C.) Valdet Gashi

MIS Management of Information System
Universiteti European i Tiranes

Abstrakt

Menaxhimi i efiçiences se energjise elektrike, shfrytëzimi i burimeve të energjive të rinovueshme (shkurt: BER) së bashku me përmirësimin e përdorimit me efiçencë të energjisë nga përdoruesit fundore (EE) mund të kontribuojë në reduktimin e konsumit primar të energjisë, zvogëlimin e emetimeve të gazeve me efektin serrë dhe si rrjedhim në parandalimin e ndryshimeve klimatike të rrezikshme. Potenciali i pashfrytëzuar i burimeve të biomasës, energjisë diellore, hidrike, të erës dhe gjeotermike është ende i lartë. Megjithatë gjate viteve të fundit, për shkak të stimujve publikë të konsiderueshëm, në formën e tarifave të rregulluara të shitjes së energjisë elektrike (*feed in tariffs*), në shumë vende evropiane zhvillimi i sektorit ka shënuar rritje të vazhdueshme. BE miratoi strategjinë e saj për të luftuar ndryshimet klimatike deri në miratimin e një plani për një rritje të qendrueshme të Evropës në vitin 2020, në të cilin janë vendosur objektiva ambicioze përsa i përket energjisë (e ashtuquajtura objektiva 20-20-20). Lëvizja drejt një ekonomie që emeton më pak karbon kërkon një sektor publik që të jetë në gjendje të identifikojë dhe mbështesë mundësitë ekonomike. Në veçanti sektori publik lokal mund të luajë një rol strategjik si menaxheri i territorit dhe zbatuesi i fundit i politikave publike. Prandaj në fushën e energjisë së qëndrueshme, është e nevojshme që të përforcohen kapacitetet e sektorit publik lokal nëpërmjet delegimit të funksioneve tek punonjësit e tij. Kjo është objektiva kryesore e punimit - forcimi i aftësive dhe kompetencave në fushën e planifikimit dhe menaxhimit të BER-it.

Fjalë kyçe: Privatizim, ekonomi joformale, performancë, pas-privatizim.

Hyrje

Energjia është madhësi fizike që paraqet aftësinë punuese të ndonjë lënde (trupi). Energjia (sikurse materia) nuk mund të krijohet e as të zhduket, por vetëm të transformohet pre një forme në tjetrën.¹ Energjia mund të paraqitet si e akumuluar ose në formë rrjedhëse, kurse format e ndryshme që paraqiten në natyrë, mund të klasifikohen në gjashtë grupe dhe atë në: mekanike, elektrike, kimike, të nxehtësisë, elektromagnetike dhe nukleare.

²Në mbështetje të nenit 65 të Republikës së Kosovës është miratuar ligji për Energjinë, i cili përfshin komplet 35 nene dhe 9 kapituj.

Sektori i energjetikës, e posaçërisht ai i prodhimit të energjisë elektrike, vazhdon të jetë njëri ndër sektorët që paraqesin problem serioz për Kosovën. Konsumatorët,

¹ Burimet e energjisë, Xhevat Berisha Prishtinë 2007 (faqe 12)

² Ligji Nr. 03/L-184. 7 tetor 2010

si amvisëritë ashtu dhe bizneset, përballen me furnizim jocilësor dhe jostabil të energjisë elektrike, e cila është shndërruar në barrierë për zhvillimin ekonomik të vendit.

Qëllimi i punimit është që të bëhet një vlerësim i gjendjes aktuale energjetike, duke marrur parasysh energjinë dhe burimet e saj me konsumin e energjisë në përgjithësi. Aplikimi i efijencies, menaxhimi i energjisë, dhe ndryshimet që pasojnë pas aplikimit të masave nga efijencia e energjisë elektrike janë masat që do të ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve energjetike. Element tjetër i qëllimit të punimit është trajtimi i aplikimit të efijencës së energjis elektrike, dhe se me përdorimin e burimeve të ripërtëritshme dukshëm do të zvogëlohen shpenzimet e energjis elektrike dhe emetimet e pluhurit do të zvogëlohen për më shumë se 90%, ato të SO_x dhe NO_x për rreth 70% dhe nuk do të ketë rritje të emetimit të dyoksidit të karbonit për njësi të energjisë elektrike të prodhuar.

Rezultatet e pritura

Një hap konkret dhe fillestar që do të nxiste investimet individuale në EE do të ishin masat fiskale që do të sillte qeveria lidhur me taksimin e importit të materialeve dhe të shërbimeve që janë të lidhura drejtpërdrejt me efijencën e energjisë. Lirimi prej taksave për produktet e gatshme ose gjysmëproduktet që shërbejnë për implementimin e projekteve të EE do t'i bënte tërheqës projektet e EE. Kjo do të sillte edhe dobi tjera ekonomike në krijimin e vendeve të punës në firmat kontraktuese implementuese të projekteve.

Metodat e përdorura për hulumtim

Grumbullimi i të dhënave për vlerësimin e këtij projekti është bërë përmes dy metodave:

- hulumtimi i të dhënave sekondare,
- intervistave.

Sa i përket të dhënave sekondare është mbledhur material i mjaftueshëm dhe shumë produktiv nga Institucionet e Qeverisë, organizatave joqeveritare, KEK-ut, Bankës. Botërore etj.

Rezultatet e Studimeve që këtu paraqiten, janë bazuar në hulumtimin me anketim të konsumit të sektorit të shërbimeve (institucioneve publike) dhe amvisërisë sipas këtyre kategorive:

- për ngrohjen e hapësirave,
- për ngrohjen e ujit sanitar,
- për gatim, dhe
- për përdorim jo termik.

Strategjia e energjisë

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, ³si përgjegjëse për energji ka për qëllim themelor sigurimin e furnizimit të qëndrueshëm dhe të sigurt me energji për të gjithë konsumatorët, duke marrë në konsideratë ruajtjen e mjedisit, shfrytëzimin me

³ www.rks-gov.net

efiçencë të energjisë, diverzifikimin e burimeve të energjisë dhe nxitjen e përdorimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë.

Siguria e furnizimit me energji në Republikën e Kosovës nuk është e kënaqshme. Furnizimi me energji elektrike nuk i plotëson kërkesat e konsumatorëve, sidomos në periudhën e dimrit, kur kërkesat për energji rriten, si pasojë e nevojës për ngrohjen e hapësirave të banimit dhe atyre të punës. Kapacitetet prodhuese të energjisë elektrike janë të vjetruara dhe me besueshmëri të ulët të sigurisë së prodhimit. Ndërprerjet e planifikuara të energjisë, si pasojë e pamundësisë së furnizimit, janë dukuri të kthyer në “normalitet” të jetës në Kosovë. Gjithashtu, ndërprerjet e paplanifikuara, si pasojë e defekteve të shumta për shkak të vjetërisë së sistemeve, janë të shumta.

Nuk kemi kapacitete të reja prodhuese të ndërtuara që nga viti 1984. Kërkesat mjedisore nga BE-ja për TC-të e mëdha janë gjithnjë në rritje. Investimet për rivitalizimin e tyre llogariten të jenë shumë të mëdha, në krahasim me mundësitë financiare të sektorit publik.

Një pjesë e madhe e energjisë (rreth 20%) nuk faturohet. Humbjet teknike në shpërndarje janë afër 18% dhe për pasojë ndërmarrja KEK nuk ka mundësi të zhvillojë biznes rentabil dhe të garantojë siguri të furnizimit. Ndërmarrja në kushte të tilla nuk mund të importojë energji me forca vetanake, por i duhet subvencionimi nga shteti.

Depërtimi i teknologjive të burimeve të ripërtëritshme të energjisë bëhet me shumë vështirësi në Kosovë.

⁴Opsionet e Kosovës për furnizim me energji varen nga disponueshmëria e kufizuar e burimeve të ripërtëritshme, termocentralet e vjetra, në të cilat qytetarët nuk mund të mbështeten shumë; furnizimi i mangët në Ballkan që kufizon aftësinë e Kosovës për import të rrymës elektrike, ku përfshihet edhe mosekzistimi i burimeve natyrore të gazit apo të gazsjellësit për importin e tij.

Qeveria e Kosovës⁵ është e intersuar të sigurojë furnizim të duhur dhe të besueshëm me energji elektrike për qytetarët e saj dhe të rrisë ekonomizimin apo efiçencën e energjisë në nivel të vendit. Kosova gjithashtu është e detyruar të mbyll termocentralin 40 vjet të vjetër, të quajtur Kosova A, i cili është një nga burimet më të këqija të ndotjes në Evropë.

Kombinimi i furnizimit me energji që është duke u marrë parasysh nga Qeveria e Kosovës do të përfshinte 300 MW të hidroenergjisë, 60 MW nga hidrocentralet e vogla dhe 395 MW të energjisë së gjeneruar nga era, biomasa dhe biogazi, si dhe termocentrali i propozuar me thëngjill prej 600-MW që do t’ia mundësonte Kosovës mbylljen e termocentralit Kosova A dhe eliminimin e mungesave në furnizim që gjymtojnë ekonominë e Kosovës.

⁶Studimi i opsioneve i Bankës Botërore ka krahasuar kostot e parapara ekonomike dhe mjedisore për termocentralin me linjit prej 600 MW, për impiantin me gaz natyror prej 575 MW dhe për impiantin me karburant prej 575 MW. Ky studim ka konstatuar se termocentrali me linjit është opsioni më i lirë, duke llogaritur edhe kostot mjedisore.

Përlllogaritjet e bëra nga ⁷Ministria e Zhvillimit Ekonomik tregojnë se pas fillimit të punës të termocentralit të ri, mbylles së Kosovës A dhe rehabilitimit të Kosovës B,

⁴ www.rks-gov.net

⁵ Strategjia e energjisë e Republikës së Kosovës për periudhën 2009-2018, Prishtinë, shtator 200

⁶ 2011 The World Bank Group

⁷ Strategjia e energjisë e Republikës së Kosovës për periudhën 2009-2018

emetimet e pluhurit do të zvogëlohen për më shumë se 90%, ato të SO_x dhe NO_x dhe nuk do të ketë rritje të emetimit të dyoksidit të karbonit për njësi të energjisë elektrike të prodhuar.

Tre ekspertët e dalluar të energjetikës që përbëjnë panelin e pavarur janë: Dr. János Beér, Dr. Wladyslaw Mielczarski, dhe Dr. Derek Taylor. Në shqyrtimin e tyre të projektit, ata vunë në pah ekonominë e brishtë të pasluftës në Kosovë, kapacitetin e saj të kufizuar për zhvillim ekonomik dhe po ashtu u pajtuan se furnizimi i sigurt dhe me çmim të përballueshëm i energjisë elektrike është thelbësor për zhvillimin dhe stabilitetin e Kosovës.

Paneli i ekspertëve njëzëri u pajtua se projekti i plotësonte gjashtë kriteret e mëposhtme, me kusht që t'i bëhen modifikimet e caktuara dhe të jepen rekomandimet për qeverinë:

1. Do të ketë ndikim të dukshëm zhvillimor të projektit, duke përfshirë përmirësimin e përgjithshëm të sigurisë së furnizimit me energji dhe zvogëlimin e mungesës së energjisë. Termocentrali i ri së bashku me Kosovën B të modernizuar, duhet të rezultojë me rritje në besueshmërinë e sistemit dhe në më pak ndërprerje të rrymës.

2. Ndhimesa po ofrohet në identifikimin dhe përgatitjen e projekteve me emetime të ulëta të dyoksidit të karbonit. Kjo punë përfshinë vlerësimin e burimeve të energjisë së ripërtërishme, studimin e parafizibilitetit për hidrocentralet e vogla, përditësimin e studimit ekzistues të fizibilitetit për hidrocentralin në Zhur, ndihmesën për studime në fushën e zënies dhe ruajtjes së dyoksidit të karbonit, si dhe kredinë e propozuar për përmirësime në eficiencën e energjisë dhe për energjinë e ripërtërishme.

3. Burimet e energjisë janë duke u optimizuar dhe janë duke u bërë përpjekje të konsiderueshme për përmirësimin e eficiencës së energjisë. Ka nevojë për përpjekje të shtuara për zvogëlimin e kërkesës për energji dhe të humbjeve teknike e komerciale gjatë furnizimit me energji, si dhe për avancimin e parimit të kursimit të energjisë.

4. Pas shqyrtimit të plotë të alternativave të realizueshme është arritur pajtimi se projekti do të paraqes opsionin më së paku të kushtueshëm për Kosovë, duke përfshirë edhe koston mjedisore. Paneli i ekspertëve po ashtu u pajtua se energjia e ripërtërishme duhet të luajë në rol të rëndësishëm në kombinimin e ardhshëm të burimeve energjetike, ku do të përfshihet ndertimi i hidrocentralit të Zhurit, hidrocentraleve të tjera të vogla dhe i kapaciteteve të energjisë së erës, si dhe i energjisë së qëndrueshme nga biomasa dhe biogazi.

Paneli theksoi se rritja e dukshme e shfrytëzimit të energjisë së ripërtërishme dhe, më pas, edhe e gazit natyror, do të kërkonte një qasje regjionale ndaj tregjeve të energjisë dhe më shumë interkoneksione me vendet fqinje se sa që eksitojnë sot.

5. Projekti do të ideohej duke përdorur teknologjinë më të mirë dhe të duhur në dispozicion për arritjen e eficiencës së lartë. Paneli fuqimisht inkurajon qeverinë e Kosovës që të nxisë ofertuesit për termocentral të japin eficiencën më të lartë të mundshme e jo vetëm që të plotësojnë nivelin e eficiencës minimale.

6. Në analizën e projektit janë duke u përfshirë edhe aspektet mjedisore. Paneli nënvizoi rëndësinë e përcaktimi të nivelit bazë të emetimit, posaçërisht për dyoksidin e karbonit dhe për gazrat e tjera me efekt serrë, me qëllim të identifikimit dhe saktësimin të përfitimeve të pritura. Kjo do të kërkon kapacitete më të mëdha të monitorimit. Paneli po ashtu ka rekomanduar që përmes studimeve të vazhdohet vlerësimi i ndikimit të ndryshimeve të mundshme të çmimit të dyoksidit të karbonit në ekonominë e termocentraleve me linjit në Kosovë.

Paneli gjithashtu inkurajon fuqimisht përfshirjen e shoqërisë civile në procese të ndryshme sa herë që kjo të jetë e mundur përmes proceseve të hapura, transparente dhe plotësisht të zhvilluara.

Ofrimi i kredive dhe garancive nga Banka Botërore ofrohet me kusht të vlerësimit të kënaqshëm nga Grupi i Bankës Botërore të përputhshmërisë me të gjitha kushtet në fuqi të grupit të Bankës Botërore, duke përfshirë ato që ndërlidhen me aspektet sociale e mjedisore; të shqyrtimit dhe pranimit të pronësisë, menaxhimit, strukturës financiare dhe dokumentacionit për transaksion nga Grupi i Bankës Botërore, si dhe të miratimit të menaxhmentit dhe drejtorëve ekzekutivë të çdo institucioni të Grupit të Bankës Botërore vetëm në diskrecion të tyre.

Në vitin 2011, Grupi i Bankës Botërore⁸ gjithsej ka dhënë \$8.2 miliardë në financimin e projekteve për zhvillimin e energjisë në mbarë botën. Përmes këtij financimi, u ndihmon shteteve në zgjerimin e kapaciteteve energjetike, posaçërisht në rastet kur mungesat e energjisë bllokojnë rritjen dhe zhvillimin, siç është rasti i Kosovës.

Kurdo që është e mundur, Grupi i Bankës Botërore përkrahë zhvillimet energjetike të qëndrueshme dhe me emetime të ulëta të karbon dyoksidit. Portofoli i tij i energjisë së ripërtërishme është rritur nga \$3.1 miliardë mes viteve fiskale 2008-2009 në \$4.9 miliardë në vitet 2010-2011. Gjatë kësaj periudhe të njëjtë, përpjesëtimi i energjisë së ripërtërishme është rritur nga 20% në 23%.

Banka Botërore po ashtu financon një numër relativisht të vogël të projekteve të bazuara në thëngjill. Kjo përkrahje jepet vetëm atëherë kur përmes analizës së rreptë arrihet në përfundim se opsionet për energji më të pastër nuk janë në dispozicion apo nuk janë të realizueshme. Në analizë përdoren kriteret e cekura në Kriteret udhëzuese operationale të Bankës Botërore për shqyrtim të projekteve me thëngjill, në kuadër të kornizës strategjike për zhvillim dhe ndryshime klimatike (KSZhNK).

Mundësitë dhe rreziqet (Swot Analiza)

Mobilizimi i aktiviteteve tradicionale do të jetë qenësor për ekonominë e Kosovës në një afat të shkurtër dhe të mesëm. Bujqësia në një afat të shkurtë kohor, Minierat dhe Energjia në një afat të mesëm (pesë deri në dhjetë vite). Sidoqoftë, këtu përfshihen edhe sfida, dhe nepermes SWOT-it do të bëjmë analizën e këtyre katër faktorëve në përgjithësi.

S	W
<p>Investimet per ringjalljen e sektorit te energjisë – tërheqja e investitorëve të vendit dhe ndërkombëtar.</p> <p>Me aplikimin e masave eficiënte do të ulen shpenzimet e konsumit të energjisë në të gjithë sektorët.</p>	<p>Mungesa njohurive për aplikimin e masave të eficiences -vetëdijes së faktorit njeri në Kosovë dhe mjete jo të mjaftueshme nga Institucionet e Qeverisë për investime ne burime të ripërteritshme te energjive alternative.</p>

⁸ 2011 The World Bank Group

O	T
<p>Shfrytëzimi i burimeve alternative te energjive te ripërtëritshme.</p> <p>Stoku i ndërtesave në shërbime publike dhe private, në amvisëri përfshin kontributin më të madh të kursimit të energjisë (40%+30%=70%) andaj plani i veprimit 2013-2015 parashef edhe fokusin në sektorin e ndërtesave të Kosovës</p>	<p>Aktualisht 97 % e energjisë përfitohet nga TC e Kosovës A dhe B dmth 3 % janë nga HC, prandaj ndotja e ambientit konsiderohet si një nga faktorët negativ për vendin tonë, duke mos harruar në ç'rregullimet e ngrohjes globale dhe ndërtimin edhe të një TC të ri me lëndë djegëse të linjtit.</p>

Investime të mëdha nevojiten për të ringjallur sektorin e energjisë dhe të minierave dhe, në këtë aspekt investimet direkte nga jashtë janë të një rëndësie qenësore. Kushtet e nevojshme për të tërhequr investitorët e huaj duhet të mbahen në mend.

Një stimulim i shpejtë do të vijë nga procesi i ringjallur i privatizimit. Privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore do të ndihmojë në shpëtimin e bërthamave industriale që kanë një potencial të vërtetë ekonomik. Proces i privatizimit gjithashtu ka për qëllim tërheqjen e investimeve direkte nga jashtë, jo vetëm për shkak të teknologjisë superiore dhe shkathësive menaxhuese që vijnë me të, por si shenjë e një ambienti të mirë të punës për investitorët e tjerë të interesuar.

Sfidat e Kosovës në sektorin e energjisë janë të mëdha sepse për prodhimin e energjisë elektrike, vendi mbështetet në termocentralet me djegie të linjtit. Me dekada, prodhimi i energjisë është përqëndruar në shfrytëzimin e qymyrit, dhe prodhimin e energjisë elektrike pa i kushtuar shumë vëmendje qështjeve mjedisore. Zhvillimi bazës së të dhënave për konsumin e energjisë për institucionet publike, sektorit të amvisëris, industris, shërbimeve, të transportit do të mundësonte identifikimin e konsumit të energjisë dhe krijimit të procesit të monitorimit te rezultateve.

Privatizimi në Kosovë, ka hapur shumë dilema, andaj është një proces i kompleks dhe shumëdimensional. Ndërmarrjet e privatizura në Kosovë në periudhën pas privatizimit të tyre, hasin në vështirësi në operimin e tyre. Në këtë punim bëhet përpjekje të shtrohen çështje të cilat japin përgjigje lidhur me problemet e menaxhmentit, sfidat dhe përfitimet në ndërmarrjet pas privatizimit.

Në trajtimin e temës do të përdoret metoda cilësore dhe sasiore, e plotësuar me metodën e krahasimit dhe abstraksionit. Analiza empirike do të mbështetet në të dhënat e dorës së parë, të plotësuar nga burime të dorës së dytë. Si burime parësore do të përdoren shkresat zyrtare dhe raportet e AKP-së, një pjesë e kontratave të shitjes dhe të dhënat që mbledhen nga pyetësori. Bazë e burimeve dytësore është përdorimi i literaturës, studimeve hulumtuese, raporteve për të arriturat në fushën e privatizimit dhe pasprivatizimit, si dhe materiale tjera të publikuara.

Kampioni (mostra): Nga lista e përgjithsme e ndërmarrjeve të privatizuara deri në fund të vitit 2013, me metodën e rastit do të caktohet numri i ndërmarrjeve që do të anketohen. Si teknikë e mbledhjes së të dhënave përdoret anketa me pronarët ose menaxherët. Instrumenti kryesor për mbledhjen e të dhënave të dorës së parë është pyetësori gjysmë i strukturuar i cili lejon përdorimin e variablave brenda

⁹ B.M. Weedy Electric Power Systems, John Wiley@Sons, New York, 1972,

përgjigjeve...Variablat...

Gjetjet janë rezultat i anketës së kryer në ndërmarrjet e privatizuara të përcaktuara me metodën e rastit (...-spin off special,-spin off i rregullt,-likuidim), në këta sektorë: industri, ndërtimtari, tregti, bujqësi, shërbime dhe transport. Problemet më të mëdha me të cilat ballafaqohen ndërmarrjet pas privatizimit e që e pengojnë rentabilitetin e tyre janë: konkurrenca e pandershme, ligjet dhe moszbatimi i tyre si dhe taksat e larta (?). Modeli joadekuat i privatizimit gjithashtu ndikon në menaxhmentin e ri e rrjedhimisht edhe në performancën e tyre.

Disa ndërmarrje pas privatizimit janë rentabile dhe kanë pasur një menaxhim efektiv pas privatizimit. Megjithëse ka pasur disa përmirësime të lehta për bizneset, ndërmarrjet e reja pas privatizimit ende përballen vështirësi që ndikon direkt në performancën e tyre. Metodatat e aplikuara të privatizimit nga AKP dhe AKM, duke marrë për bazë çmimin më të lartë konsiderohet vetëm një sukses relativ. Që procesi i privatizimit të ketë ndikim pozitiv në ekonominë e vendit, politikatat e shtetit duhet të jenë në funksion të rivitalizimit të bizneseve. Kurse modeli joadekuat i privatizimit ka bërë që më parë të prëfitorë individët apo grupet kurse ekonomia e Kosovës ka përfituar pak dhe varfëria është rritur.

Në vitet dhe dekadat e ardhshme konsumi i energjisë do të ketë rritje të konsiderueshme. Në strategjinë e energjisë së Kosovës është parashikuar një rritje vjetore sipas 2 skenarëve të zhvillimit ekonomik: 3% skenari i ulët, respektivisht 5% skenari i lartë.¹⁰Dokumenti i strategjisë së energjisë 2009-2018 dhe ligjet relevante të sektorit sigurojnë kornizën për implementimin e efijencës së energjisë në Republikën e Kosovës. Me zbatimin e politikave dhe masave adekuate, efektet e masave të efijencës dhe masave tjera si izolimet termike të ndërtesave dhe të përmirësimeve të aparaturave shtëpiake pritet një mesatare e realizimit të kursimeve prej 10-15% (USAID 2008) dhe më shumë. Me gjithë ngritjen e EE-së në aparatet shtëpiake konsumi i energjisë në vendet e EJT do të ngritet me 2% në vit deri në vitin 2027. Po qe se nuk do të zbatoheshin masat e EE-së në dekadat e ardhshme konsumi do të kishte rritje dramatike.¹¹Përmirësimi i EE-së nuk bëhet pa investime dhe pa kosto. Investimet në këtë fushë megjithatë japin vlera ekonomike jo vetëm në zvogëlimin e faturave të energjisë dhe zvogëlimin e importeve të energjisë, por edhe në rritjen e punësimit dhe ngritjen e aftësisë konkurruese të produkteve. Si palë kontraktuese e ¹²Traktatit për Komunitetin e Energjisë (TKE) dhe anëtare e Task forcës së TKE për EE-se, Kosova ka hartuar planin nacional për Efijencën e Energjisë. Ky plan përcakton caqet nacionale për kursimin e energjisë duke zbatuar masat e EE-së për periudhën 2009-2011 në vlerë prej 3% të 1021.08 ktoe. Kjo sasi e energjisë (31ktoe) e paraparë të kursehet për këtë periudhë kaq të shkurtër paraqet një cak shumë robust, i cili shume vështirë mund të realizohet.

Efijencia = vlerën e konsumuar/vlerën e prodhuar (%),

Konsumi i energjisë

Përafërsisht 98% e energjisë prodhuar në Kosovë bëhet nga dy termocentralet me thëngjill të linjtit (TC), „Kosova A & B. Këto termocentrale janë në pronësi dhe operohen nga Korporata Energjetike e Kosoves (KEK): ndërmarrja energjetike e

¹⁰ www.rks-gov.net/mzhe

¹¹ Direktiva 2006/32/EC

¹² www.ks-gov.net/mzhe

integruar vertikalisht e Kosovës është përgjegjëse për mihjet e thëngjillit, gjenerim, shpërndarje dhe furnizim.

TC Kosova A përbëhet nga pesë njësi (A1-A5), me një kapacitet total të instaluar prej 800 MW, edhe pse njësitë A1 dhe A2¹³ nuk janë më operacionale dhe konsiderohen si të papërshtatshme për komisionim të mëtejshëm.

TC Kosova B përbëhet nga dy njësi më të mëdha (B1 dhe B2) me një kapacitet të instaluar prej 678 MW.

Disponueshmëria e TC Kosova A dhe B është e ulët për shkak të dështimeve të shpeshta të

sistemit, shkyçjet dhe riparimet. Kjo ka qenë veçanërisht e rëndë për sektorin e prodhimit dhe të ndërtimit, ku në vitin 2009, firmat kanë raportuar një mesatare prej 43 ndërprerjesh në muaj. Këto ndërprerje kanë rezultuar në humbje të cilat janë ekuivalente me 17% të shitjeve

vjetore të firmave, krahasuar me më pak se 4% për ekonomitë e ngjashme në tranzicion.

Disponueshmëria e ulët e TC A & B ndodhë edhe pjesërisht për shkak të dëmeve të shkaktuara gjatë luftës. Dëmet në rotorët me presion të ulët të njërive B1 dhe B2, për shembull, kanë reduktuar kapacitetet maksimale në dispozicion për 240 MW respektivisht 280 MW.

- Totali i bruto i prodhimit vjetor nga TC Kosova A & B (2010) = 5041 GWh

- Totali i neto i prodhimit vjetor nga TC Kosova A dhe B (2010) = 5010 GWh

Hydrocentralet (HC) llogariten për pjesën e mbetur prej ~ 2.2% të neto prodhimit të energjisë elektrike në Kosovë në vitin 2010. ¹⁴HC Ujmani /Gazivoda (HC Ujmani) menaxhohet nga ndërmarrja publike Ibër-Lipenci. Ky hidrocentral, i cili furnizon direkt rrjetin e transmissioinit, kishte një prodhim¹⁵ neto prej 114 GWh në vitin 2010 (korrespondon me faktorin e kapacitetit prej 41~%). Hydrocentralet e vogla të mbetura (të gjitha në pronësi të investitorëve privat) lidhen në vende të ndryshme në rrjetin e shpërndarjes së Kosovës. Në total, këto HC të vogla kishin një prodhim neto prej 42 GWh (faktorin e kapacitetit ~ 48%). KOSTT sh.a (KOSTT) menaxhon dhe operon sistemin e transmissioinit të energjisë elektrike të Kosovës dhe është përgjegjës për transmissioinin e pjesës më të madhe të energjisë elektrike në rrjetet e tensionit të lartë elektrik. KOSTT është themeluar në vitin 2006 si rezultat i ristrukturimit të sektorit të energjisë në bazë të Traktatit të Komunitetit të Energjisë për Evropën Juglindore. Përveç transmissioinit në Kosovë, sistemi i KOSTT-it ndërlidhet me vendet fqinje si me Malin e Zi (400 kV), Maqedoninë (400 kV), Shqipërinë (220 kV) dhe Serbinë (400 kV, 220 kV dhe 110 kV) duke lejuar transitin, importet dhe eksportet e energjisë elektrike. ¹⁶Kapaciteti maksimal i këmbimit të energjisë ndërmjet Kosovës dhe fqinjëve të saj (llogaritur si shuma e kapacitetit të transmissioinit të natyrshëm të secilës linjë) është 1740 MW¹⁷. Republika e Kosovës në pikëpamje energjetike karakterizohet me një rritje të lartë të konsumit energjetik dhe import të tërësishëm të produkteve të naftës. Në anën tjetër, kapacitetet e vjetruara gjeneruese elektrike

¹³ Plani i Përshtatshmërisë së Gjenerimit, 2011-2020

http://www.kostt.com/website/images/stories/dokumente/tjera/Generation_Adequacy_Plan_2011-2020

¹⁴ Deklarata e Sigurisë së Furnizimit për Kosovën (Energji elektrike, Gaz dhe Naftë) -korrik 2011 http://eroks.org/Publications/2011/Statement_of_Security_of_Supply_for_Kosovo_Electricity_Gas&Oil.pdf

¹⁵ Plani i përshtatshmërisë së prodhimit 2011-2020

http://www.kostt.com/website/images/stories/dokumente/tjera/Generation_Adequacy_Plan_2011-2020

¹⁶ <http://rael.berkeley.edu>

¹⁷ Plani i Përshtatshmërisë së Gjenerimit, 2011-2020

me të cilat disponon vendi, me gjithë ngritjen kontinuale të performancës dhe rritjen e gjenerimit viteve të fundit dhe në vitin 2010, nuk mjaftonin të mbulojnë nevojat e rritura të konsumit. Importi i energjisë elektrike sikurse edhe viteve tjera ishte i domosdoshëm për të mbuluar konsumin. Sektori me konsumin më të madh edhe gjate vitit 2010 ishte sektori i amvisërisë.

¹⁸Në vitet dhe dekadat që vijnë parashikohet rritje e konsumit në çdo sektor të energjisë për më shumë se 3% në vit deri në vitin 2027. Rritja më e madhe parashikohet në sektorin e shërbimeve i pasuar nga sektori i industrisë dhe sektori i amvisërisë ku kjo rritje parashikohet të jetë 60%.

Rritja e pashmangshme e konsumit duhet të ngadalësohet me përpjekje të sforcuara në anën e menaxhimit të kërkesës së konsumit dhe zbatimit të masave të efijencës së energjisë, të cilat do të manifestoheshin me kursimin e energjisë në çdo sektor.

Planifikimi i politikave efikase për kursimin e energjisë kërkon të dhëna të sakta energjetike të bazuara në udhëzimet e EUROSTAT-it. Asnjë plan efektiv nuk mund të zbatohet dhe monitorohet pa të dhëna të sakta dhe të besueshme.

Nën sektori i ndërtesave dhe objekteve publike (shkollave, spitaleve, administrates publike) qysh tani mund të prinë në futjen e masave të EE-së dhe menaxhimit e kërkesës në ndërtesat publike dhe të shërbej si model i zbatimit të masave të EE-së. Shembujt e projekteve të realizuara së voni në Kosovë dëshmojnë se kjo qasje jo vetëm që jep rezultate të mira në kursimin e energjisë por ka edhe efekte edukative dhe promovuese të efijencës së energjisë. Sektori amvisërisë ka numrin më të madh të konsumatorëve nga të gjithë sektorët tjerë. Kur kësaj i shtohet edhe rritja e madhe e konsumit që këtë sektor e karakterizon, atëherë shihet se sa e rëndësishme është qasja e analizave të bazuara mirë të këtij sektori.

Republika e Kosovës si edhe vendet tjera të Evropës juglindore (EJL) karakterizohen me konsum relativisht të lartë të energjisë (Intensitet të lartë energjetik) për njësi të (GDP) dhe varshmëri të madhe nga importi i produkteve të naftës. Mbulimi i konsumit në ngritje të vazhdueshme, në afat të mesëm, mund të realizohet, me ndërtimin e burimeve të reja gjeneruese termike në bazë të linjtit, shfrytëzimi maksimal i potencialit të kufizuar hidrik dhe përpjekjet për shfrytëzimin e burimeve tjera të rinovueshme.

Përveç veprimeve në anën e gjenerimit siguria e furnizimit mund të ndihmohet edhe në anën e konsumit me masat e menaxhimit të kërkesës, duke stimuluar konsumin racional dhe duke zbatuar masat e Efijencës së Energjisë EE-së në të gjithë sektorët e konsumit.

Konkluzione

Kursim i energjisë në proces të prodhimit dhe transformimit të energjisë, duke përfshi edhe rrjetin shpërndarës të energjisë, reduktimin e humbjeve të bartjes dhe shpërndarjes, përmirsimin e efijencës së energjisë së termocentraleve, rritjen e komponentës së energjisë të prodhuar nga bashkegjenerimi me efijenc të lartë.

Para marrjes së vendimeve strategjike të zhvillimit ekonomik të bëhet vlersimi i potencialeve nacionale në sigurin e furnizimit për një zhvillim të qëndrueshëm.

Efijencia e energjisë elektrike është mjet i rëndësishëm për arritjen e zvoglimit të lirimit të gazërave me efekt serrë, kështu që konsumatorët do të zvoglonin faturat

¹⁸ USAID/IRG, Future Energy scenario in SEE and the Potential for Energy efficiency (2008)

e tyre të energjisë dhe do të zvogëlohej kërkesa në përgjithësi, së paku në kuptimin relativ.

Është e qartë se rritja e pjesës së energjisë nga burimet e ripërtëritshme është e rëndësishme për Kosovën në aspektin e diversifikimit të burimeve energjetike dhe varësia gati e plotë nga kapacitetet gjeneruese me djegie të linjtit.

Efiçienca e energjisë ndërlihet dhe interferohet me më shumë fusha të politikave, të njohurive dhe kompetencave dhe përgjegjësive të shpërndara. Këto, në formë të pengesave paraqiten në elementet kryesore të kornizës institucionale. Prandaj në mes tjerash duhet:

- Kompletimi i kornizës institucionale dhe sforcimi i zbatimit të legjislacionit,
- Përmirësimi i grumbullimit të të dhënave dhe shënimeve dhe të zbatohen metodat statistikore sipas EUROSTAT-it,
- Të zbatohen masat e menaxhimit të kërkesës në anën e konsumit për energji,
- Plani veprimit për EE-së duhet të jetë në harmoni me direktivën e shërbimeve energjetike dhe të koordinohet me ministrinë,
- Monitorimi i masave të EE-së në nivel dhe me përgjegjësi të gjithëmbarshme.

Bibliografia

Burimet e energjisë, Xhevat Berisha Prishtinë 2007 (faqe 12).

Ligji Nr. 03/ L-184. 7 tetor 2010.

Strategjia e energjisë e Republikës së Kosovës për periudhën 2009-2018, Prishtinë

The World Bank Group 2011

Plani i Përshtatshmërisë së Gjenerimit, 2011-2020

Deklarata e Sigurisë së Furnizimit për Kosovën (Energji elektrike, Gaz dhe Naftë) -korrik 2011

USAID/IRG, Future Energy scenario in SEE and the Potential for Energy efficiency (2008)

http://www.kostt.com/website/images/stories/dokumente/tjera/Generation_Adequacy_Plan_2011-2020 http://eroks.org/Publications/2011/Statement_of_Security_of_Supply_for_Kosovo_Electricity_Gas&Oil.pdf

http://www.kostt.com/website/images/stories/dokumente/tjera/Generation_Adequacy_Plan_2011-2020

<http://rael.berkeley.edu>

www.rks-gov.net

Sistemi gjyqësor në Bashkimin Evropian

Enertila Bekteshi

Instituti i Studimeve Evropiane/UT

Psikologe/QSUT/Tiranë

Abstrakt

Ky punim përfshin një pjesë shumë të rëndësishme, sic është Jurisprudenca në BE. Jurisprudenca e GJED është një jurisprudencë tepër e pasur e cila u ka dhënë jetë traktateve në bazë të të cilave funksionojnë institucionet e Bashkimit Evropian. Në këtë kuptim GJED ka vepruar si një institucion autonom. Fillimisht ka patur një reagim shumë negativ nga ana e politikanëve për ndërhyrjen e GJED në gjykatat kombëtare dhe në gjyqtarët profesioniste. Megjithatë supermacia e ligjit të Komunitetit Evropian duhet të pranohet nga të gjithë. Gjykata ka bërë një politikë shumë aktive integruese në këtë drejtim roli i së cilës nuk vihet në dyshim, por ka një ndarje në mënyrën sesi interpretohet ky rol. GJED ka qënë aktive në zbatimin e legjislacionit të BE nga vendet anëtare, në mënyrë të vecantë në politikën sociale. Shpesh GJED është parë se “leader” në politikën e zbatimit kur institucionet e tjera kanë qënë joefektive. Gjykata e Shkallës së Parë (GjSHP) u krijua nga Akti Unik Evropian, i cili e parashikoi në 3 nene. Por edhe pse quhet gjykata e shkallës së parë, vendimet e saj janë përfundimare dhe shumë çështje të gjykuara nga kjo gjykatë është e vështirë të kenë mundësinë për t’u pranuar për rishqyrtim nga Gjykata e Drejtësisë. Gjykata e Llogarive u krijua në vitin 1975 nga traktati që amendoi nenin financiar të KEE. Traktati krijoi një institucion të ri për Komunitetin të quajtur Gjykata e Llogarive. Traktati i njeh Gjykatës së Llogarive detyrën kryesore të kontrollit të llogarive, ligjshmerinë e tyre dhe zbatimin e buxhetit të BE në një mënyrë të dyfishtë: 1 për të përmirësuar menaxhimin financiar, 1 raportimin qytetarëve të Evropës për përdorimin e fondeve publike nga autoritetet përgjegjëse për menaxhimin e tyre.

Sistemi Gjyqësor

1. Gjykata Evropiane e Drejtësisë (GJED)
2. Gjykata e shkallës së parë (GjShP)
3. Gjykata e Llogarive (GJLL)

Sistemi Gjyqësor

Gjykata Evropiane e Drejtësisë (GJED) është “arbitri” final në interpretimin e traktateve dhe në aplikimin e legjislacionit të Komunitetit Evropian nga shtetet anëtare. GJED jep vendime në bazë të kompetencave të dhëna nga traktatet ose nga legjislacioni dytësor. Padyshim mund të themi që roli i kësaj gjykate në procesin e integritit evropian është shumë i rëndësishëm.¹ Ka një konsensus të shteteve anëtare të BE për nevojën e GJED në rolin e një interpretuesi autoritativ për të dy traktatet e medha që janë në fuqi dhe për legjislacionin dytësor (direktiva, rregullore), i zbatuar nga shtetet anëtare. Njëkohësisht kritikohet

¹ Jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë, geshjet e saj kryesore janë të detyrueshme për t’u njohur dhe përbejne pjesë të legjislacionit të *acquis communautaire* që duhet të pershtatet në kuadrin e përafritimit të legjislacionit nga shtetet që kerkojne të aderojne në BE. Në këte rast edhe për vendin tone.

po nga vetë qeveritë anëtare për rregullat e përgjithshme në favor të zgjidhjes integruese, sepse shteteve u duket sikur humbasin pak nga sovraniteti i tyre sa herë që zbarojnë vendimet e kësaj GJED. Para Traktatit të Mاستrihtit zbatimi i detyrueshëm i vendimeve varej nga vullneti i mirë i shteteve anëtare për të bashkëpunuar.² Në periudhën pas ratifikimit të Mاستrihtit, (Mاستriht) GJED ishte subjekt i rritjes së kritikizmit nga shtetet anëtare për jurisprudencën radikale. Qeveritë britanike dhe gjermane e kishin vënë në shënjestër të kritikave. Por ndërsa në vitin 1990 mund ishim para disa pyetje rreth ndikimit të Gjykatës dhe rëndësisë së saj për procesin e integrimit evropian, aktualisht roli i saj është vendimtar dhe i plotë. Praktikisht GJED ka një autoritet të padiskutueshëm mbi shtetet anëtare, të cilët e ndjejnë autoritetin e kësaj gjykate, vërtetuar edhe me faktin se vendimet e marra nuk konstestohen nga palet. Në fillimet nuk kishte sanksione për zbatimin e një vendimi të dhënë nga GJED, por me tepër një presion moral, n.q.s. vendet anëtare do të dështonin të përmbushnin detyrimet e tyre. Traktati i Bashkimit Evropian (TBE) amendoi nenin 171 të KEE (ish neni 228) i cili lejon Komisionin të kthehet GJED n.q.s. vëren që shteti nuk zbaton rregullat komunitare, si edhe të kërkojë vendosjen e një sanksioni financiar për shtetin që shkel këto rregulla. Gjykata fitoi tashme të drejtën për të vendosur sanksione financiare ndaj shteteve. Megjithatë aftësia e Gjykatës për të vendosur me detyrim sanksione mbetet rreptesisht e kuizuar dhe e varur nga pranimi baze i vendimeve të tij nga shtetet anëtare dhe gjykatat e tyre (të larta) kombëtare. TBE thekson gjithashtu që GJED shprehet në rrugë paragjykimore mbi vlefshmërinë dhe interpretimin e vendimeve-kuadër dhe të vendimeve mbi interpretimin e konventave. Në këtë kuptim GJED është kompetente për të kontrolluar ligjshmërinë e vendimeve-kuadër dhe të vendimeve, kur është bërë ankim nga një shtet anëtar ose nga Komisioni, për mungesë kompetence, për shkelje të normave thelbësore procedurale, për shkelje të traktatit ose të cdo norme juridike të nxjerrë për zbatim të tij, ose për keqpërdorim të kompetencave. Është kompetentë për të vendosur në lidhje me cdo mosmarrëveshje ndërmjet shteteve anëtare, përsa i përket interpretimit dhe zbatimit të akteve të miratuara. GJED është një nga institucionet kryesore të KEE dhe Euroatomit. Duket qartë se Vendimet paraprakë janë një mjet prej nga Gjykata mund të marrë vendime mbi vlefshmërinë dhe interpretimin e vendimeve-kuadër dhe vendimeve në këtë fushë.³ Sipas kushteve të caktuara në të ardhmen GJED do të jetë gjithashtu e aftë të marrë vendime për ligjin e azilit dhe migracionit⁴ Në doktrinën juridike ka mendime të ndryshme; nese Gjykata e Drejtësisë në ndryshim nga evolucioni i institucioneve të tjera do të konsiderohej si një institucion i përbashket i tre komuniteteve, apo si një institucion që përmbledh funksionet lidhur me disa ente. Shumëllojshmëria e kompetencave ka bërë të mundur që Gjykata e Drejtësisë të shikohet në cilësinë e saj jo vetëm si institucion i Komunitetit, por t'i jepen edhe disa cilësime të tjera. Së pari, GJED vepron si institucion në kuadrin komunitar. Së dyti, sipas disa autorëve gjykata vepron dhe si gjykatë ndërkombëtare kur gjykon mosmarrëveshjet midis shteteve apo midis shteteve dhe Komuniteteve.

Së treti, gjykon si gjykatë e brendshme e shteteve anëtare kur interpreton me

² TKE neni 228, ish - neni 171.

³ TBE neni 35, ish-neni K.7. Përmbledhje traktatesh.

⁴ TKE neni 234, ish-neni 177. Përmbledhje traktatesh.

cilesi paragjykimore traktatin dhe aktet komunitare në instance të gjykatësve kombëtar. Për shkak të kompetencave të veta për mbikëqyrje dhe natyrës detyruese të vendimeve të veta, sig e thamë me siper GJED është shndërruar në një aktor të rëndësishëm të integritit evropian. Ndër kompetencat rendisim; a. Vendos në dështimin e përmbushjes së detyrimeve; b. Vendos për paulefshëmërinë; c. Vendos për dështimin në kryerjen e veprimeve, d. Vendos për dëmet, e. Vendos për ankimet; f. Kompetencat paragjykimore.

Mënyra sesi vihet në funksionim Gjykata e Drejtësisë ndryshon në nenet e trakteve, p.sh. KEQQ kishte paraqitur procedura te vecanta.⁵ Vendimet e GJED merren me shumicen e votave të anëtarëve të cilët janë të paanshëm në dhënien e vendimeve dhe ndjekin bindjet vetjake që kanë për ligjin dhe drejtësinë. Me Traktatin e Matrihtit u rrit edhe roli Gjykatës së Llogarive që së bashku me BQE mund të paraqesin veprime të revokueshme kundër Këshillit ose kunder Komisionit 'e qellim të mbrojtjes së privilegjeve të tyre. Kjo ndodh p.sh; kur legjislacioni është miratuar thjesht në bazë të konsultimit, kur në fakt miratimi i legjislacionit kërkonte përdorimin e bashkëpunimit ose procedurave të bashkëvendim-marrjes. Gjykata ka juridiksionin për të rishikuar ligjerisht aktet e miratuara nga PE dhe Këshilli së bashku.⁶ Kjo i drejtohet procedurës së bashkëvendim-marrjes, sipas së cilës Këshilli dhe PE marrin pjesë në procesin e vendim-marrjes.⁷ Cdo shtet anëtar ose institucion i Komunitetit mund të paraqese ankesën e tij kundër PE, Këshillit dhe Komisionit që kanë dështuar të kryejnë rolin që kërkohet nga traktati. Veprimi mund t'i paraqitet GJED, sapo institucioni të cilit i është kërkuar të veprojë nuk arrin brenda afatit kohor të përcaktuar të përmbush detyrimet. Veprime të tilla gjithashtu mund të flllojnë nga qytetarë të zakonshëm apo persona ligjorë, nese një institucion i Komunitetit nuk ka arritur t'i drejtojë personit një akt të ndryshëm nga ai i opinionit ose rekomandimit. PE e ka shfrytëzuar shumë herë këtë dispozitë të vecantë në veprimet kundër Komisionit, me qëllim propozimin e një legjislacioni të caktuar. Ka mosmarrëveshje për afatin kohor pas mbarimit të të cilit Komisioni mund të akuzohet se nuk ka arritur që të veprojë. Në përgjithësi një institucion nuk ka arritur të veprojë, nese pala që kërkon të veprohet e ka përseritur kërkesën e saj dhe nuk ka marrë përgjigje. Ky instrument ndihmon në garantimin e uniformitetit të legjislacionit komunitar. Gjykatat kombëtare kanë të drejtë t'i drejtohen për një çështje të GJED, nëse çështja lidhet me interpretimin e ligjit për traktatin ose ligjshmërinë e akteve të institucioneve evropiane, për të cilat vendimi që duhet të arrihet nga gjykata kombëtare është përfundimtar.⁸ Gjykatat kombëtare duhet t'i drejtojnë Gjykatës Evropiane një çështje "kur cdo çështje e tillë e ngritur në një rast që pret vendimin nga gjykata kombëtare kundër vendimeve të së cilës nuk ka rishikim gjyqësor sipas ligjit kombëtar".⁹ Kompetencat vendim-marrëse të GJED janë zgjeruar në mënyrë të konsiderueshme, si rezultat i Traktatit të

⁵ KEQQ) traktati i lidhur për një afat 50 vjeçar, ka mbaruar afatin e tij ne 2002 dhe nuk funksion me. Tashme funksionet që përmbushte ky traktat janë trupezuar në funksionet që përmbush traktatit i Bashkimit Evropian.

⁶ TKE, neni230.

⁷ TKE neni 251, ish- neni 189b.

⁸ TKE, neni 234.2.

⁹ TKE, neni 234.

Amsterdami dhe jurisprudences të krijuar nga vetë GJED. Kjo e ka rritur rolin e Gjykatës në sistemin institucional dhe politik të Bashkimit Evropian. Së pari, vepron si “një gjykatë kushtetuese”, duke rishikuar shkeljet ndaj traktateve dhe zbatimin e traktateve. Së dyti, vepron si “një gjykatë administrative” në veprime që paraqiten nga individë apo persona juridike, të cilët paraqesin ankesën për legjislacionin dytësor (vendim, direktive etj.) e Komunitetit Evropian që cenon interesat private të tyre. Së treti, vepron si “një gjykatë arbitrazhi” në debatet mes shteteve anëtare. Së katërti, vepron si “një gjykatë këshilluese”, e cila mund t’i dërgojë peticione institucioneve të Bashkimit Evropian për të ofruar rishikim gjyqësor për marrëveshjet e traktatit me shtetet jo-anëtare dhe organizmat ndërkombëtare. Nga viti 1993, GJED ka qënë e aftë të vendosë gjoha ndaj shteteve anëtare që nuk i binden vullnetit të Gjykatës_Gjykata e Drejtësisë nuk ka kompetenca për shtyllën e dytë dhe ka kompetenca të reduktuara në shtyllën e tretë. Traktati i Amsterdami i jep GJED një juridiksion të kufizuar në DPB, sic rregullohet nga TKE.

Keëhtu GJED mund të rishikojë legjitimitetin e vendimeve që merren në shtyllën e III, gjithshu mund të nxisë diskutime ndërmjet shteteve anëtare për aplikimin e akteve të shtyllës së tretë (Laura Cram, Desmond Dian and Neil Nugent, f.260.) Traktati i Amsterdami gjithashtu i dha GJED kompetenca mbikqyrese për veprimtaritë e Këshillit Evropian Traktati i Nices reformoi sistemin gjyqësor që rrethon GJED, pa kundërvënje politike¹⁰ dhe protokollin për statutin e Gjykates si Shtojca V e Deklarates).¹¹ Ndryshimet shikohen se e bëjnë sistemin ligjor me frytdhënës. Për më tepër, pas Traktatit të Nices, protokollin thelbesor në statutin e GJED mund të ndryshohet nga Këshilli nëpërmjet vendimit unanim dhe pa pasur nevojë për ratifikimet kombëtare. Kështu u pa e nevojshme; 1) të bëhet një ndarje më e qartë e kompetencave ndërmjet GJED dhe Gjykatës së Shkallës së Parë, 2) të ridimensionoheshin strukturat duke vepruar tashme me kolegje të specializuara për probleme të vecanta, 3) si instance e fundit u caktua të ishte Dhoma e Madhe me 11 gjyqtarë, përfshirë presidentin e Gjykatës dhe presidentet e pesë kolegjeve me nga 5 gjyqtarë dhe jo si aktualisht sesioni plenar që mblidhet me të gjithë gjyqtarët. Në Traktatin Kushtetues kompetencat e GJED zgjerohen, veganerisht në zonën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë dhe në disa aspekte të politikës së jashtme. Ka gjithashtu dispozita për akses individual në GJED.¹²

Konkluzion

Jurisprudenca e GJED është një jurisprudencë tepër e pasur e cila u ka dhënë jetë traktateve në bazë të të cilave funksionojnë institucionet e Bashkimit Evropian. Në këtë kuptim GJED ka vepruar si një institucion autonom. Fillimisht ka patur një reagim shumë negativ nga ana e politikanëve për ndërhyrjen e GJED në gjykatat kombëtare dhe në gjyqtarët profesionistë. Megjithatë supermacia e ligjit të Komunitetit Evropian duhet të pranohet nga të gjithë. Gjykata ka bërë një politikë shumë aktive integruese në këtë drejtim roli i së cilës nuk vihet në dyshim, por ka një ndarje në mënyrën sesi interpretohet ky rol.

¹⁰ TKE, nenet 46, ish-neni N.

¹¹ TKE, nenet 220-225.1, 229, 245; ish-nenet 164-168a, 172, 188.

¹² Materiale studimi për Bashkimin Evropian.

GJED ka qënë aktive në zbatimin e legjislacionit të BE nga vendet anëtare, në mënyrë të vecantë në politikën sociale. Shpesh GJED është parë se “leader” në politikën e zbatimit kur institucionet e tjera kanë qënë joefektive.¹³ Gjykata e Shkallës së Parë (GjSHP) u krijua nga Akti Unik Evropian, i cili e parashikoi në 3 nene. Krijimi u bë me një vendim të jashtëzakonshëm të Këshillit, në thelb i autorizuar për këtë qëllim, sepse Këshilli i delegohej pushteti të bëjë modifikime të traktatit d.m.th të normave primare. Gjykata nisi të funksionojë në 31 tetor 1989 dhe nëni 225 i këtij akti parashikonte që Gjykata e shkallës së parë i “ngjitet” GJED. GjSHP ka në kompetencë të saj të gjitha çështjet me karakter me pak të rëndësishëm. Por edhe pse quhet gjykata e shkallës së parë, vendimet e saj janë përfundimare dhe shumë çështje të gjykuara nga kjo gjykatë është e vështirë të kenë mundësinë për t’u pranuar për rishqyrtim nga Gjykata e Drejtësisë. Në fakt mund të bëhet ankim para Gjykatës së Drejtësisë vetëm për “çështje të së drejtës” (Eleanor e.Zeff, Ellen Pirro, 1986,f.5). Megjithatë i vetmi institucion i Komunitetit është Gjykata e Drejtësisë, por edhe me një degë të saj që është GjSHP. Kompetencat e GjSHP. GjSHP shqyrton konfliktet në kuadër të kompetencave të veta si më poshtë; 1) rnosmarrëveshjet e funksionareve të Komunitetit për probleme të ndryshme administrative, 2) konfliktet KEQC, 3) konfliktet KEE ku futet përgjithësisht shkelja e rregullave të konkurrencës nga ndërmarrjet private, 4) gjykime që lidhen me çështje të përqëndrimit mes ndërmarrjeve dhe degëve të tyre, kompetencë e parashikuar në vendimin themelues të GjSHP dhe është bërë aktuale me nxjerrjen e rregullores.

Traktati i Mastrihtit zgjeroi kompetencat e Gjykatës së Shkallës së Parë (por jo për çështje paragykimore). Por duhet të kuptojmë që Gjykatat kanë kompetenca të ndara në lidhje me eështjet (bazen ligjore) që duhet të trajtojnë. Traktati i Nices e rishikon pozicionin e kësaj gjykate¹⁴dhe i beson tashme edhe detyren e përmbushjes “në kuadrin e kompetencave përkatëse, respektimin e të drejtës në mënyrën e interpretimit dhe në mënyrën e aplikimit të traktatit aktual”. Madje i jep gjykatës kompetencë paragykimore për çështjet, referuar nenit 225/3 (TBE ish- neni 234) si më poshtë: (Luigi Daniele,. p. 62).

“Gjykata është kompetente të njoh çështje paragykimore sipas nenit 234, në çështje të vendosura specifikisht nga shtetet. Megjithatë Statuti i Gjykatës akoma nuk parashikon asnjë çështje në të cilën të zbatohet kjo kompetencë edhe pse me zbatimin e saj në praktikë do të krijoheshin shumë probleme.

Gjykata e Llogarive u krijua në vitin 1975 nga traktati që amendoi nenin financiar të KEE. Traktati krijoi një institucion të ri për Komunitetin të quajtur Gjykata e Llogarive. Traktati i njeh Gjykatës së Llogarive detyren kryesore të kontrollit të llogarive, ligjshmërinë e tyre dhe zbatimin e buxhetit të BE në një mënyrë të dyfishtë: | për të përmiresuar menaxhimin financiar, I raportimin qytetareve të Evropës për përdorimin e fondeve publike nga autoritetet përgjegjëse për menaxhimin e tyre.

Anëtares e Gjykatës së Llogarive emerohen nga Këshilli Evropian për një periudhë 6 vjecare. I ushtrojnë funksionet e tyre në pavaresi të plotë, në interes të gjithë Komunitetit. Në ushtrimin e funksioneve të tyre nuk pranojnë ndërhyrje

¹³ Kushtetuta do t-i jape mundësi çdo personi (ligjor apo natyral) të nise procedime kundër rregulloreve të cilat e prekin direkt personin dhe nuk përfshijnë masa zbatuese.

¹⁴ Neni 220 i traktatit të Nices. Treaty of Nice..

nga asnjë qeveri dhe nga asnjë organizem. Anëtarët e Gjykatës së Llogarive gjatë kohës së ushtrimit të funksioneve të tyre nuk mund të ushtrojnë asnjë aktivitetet tjetër profesional si dhe duhet të pranojnë detyrimet në pajtim me funksionin e tyre. Kur një nga anëtarët jep doreheqjen ai zëvendësohet për pjesën tjetër të mandatit. Në këto raste anëtarët rininë në detyrë deri në zëvendësimin e tyre. Paga e Anëtarëve të Gjykatës së Llogarive vendoset nga Këshilli me shumicë të cilësuar. Imuniteti dhe privilegjet e aplikuarra për gjykatësit e Gjykatës së Llogarive aplikohen dhe për anëtarët e Gjykatës së Llogarive. Anëtarët e Gjykatës zgjedhin vetë një president nga anëtarët e tyre për një periudhë 3 vjecare. Mandati i presidentit është i rinovueshëm. Në Traktatin e Nicës për herë të parë thuhet shprehimisht se në Gjykatën e Llogarive do të ketë nga një shtetas të tijin cdo shtet anëtar i BE (Zaganjori Xhezair,f.21). Anëtarët do të emërohen me shumicë të cilësuar nga Këshilli Evropian për një periudhë 6 vjecare. Gjykata do të ketë të drejtë të krijojë kolegje të vecanta, në përputhje me specifikën që kanë çështje të caktuara që paraqiten për gjykim. Gjithashtu vendosen rregulla për një bashkëpunim sa më të mirë ndërmjet kësaj Gjykate dhe institucioneve financiare të shteteve anëtare të BE. Për këtë qëllim është rekomanduar që presidenti i GJLL të mund të krijojë një komitet të vecante që do të krijonte kontakte të qëndrueshme me institucionet financiare të shteteve anëtare (Zaganjori Xhezair,f.21). Traktati kushtetues për GJLL nuk parashikon ndryshime të rëndësishme.

Funksionet e Gjykatës së Llogarive

& Gjykata ekzaminon llogarite e të gjitha të adhurave dhe shpenzimeve të KE për të vendosur kur të ardhurat do të mbledhen edhe shpenzimet do të dalin në mënyre ligjore dhe konform rregullave¹⁵. \$• Siguron që Parlamenti Evropian dhe Këshilli të publikojnë raportet vjetore të shpenzimeve. Vete Gjykata e Llogarive mban një relacion vjetor.

Kjo i transmetohet institucioneve të tjera të komunitetit dhe publikohet në gazetën zyrtare e shoqëruar nga përgjigjet e institucioneve dhe obsevacionet e Gjykatës së Llogarive. \$• Përgatit raporte speciale në aspektet e llogarive dhe me iniciativen e vete ose me kërkesën e institucionit nxjerr opinione. & Prezanton në cdo kohë kur e shikon të nevojshme obsevacionet mbi probleme të veganta që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e caktuara si dhe jep mendime kur i kërkohet nga institucionet e tjera për legjislacionin e propozuar. <& Asiston Parlamentin Evropian dhe Këshillin në ushtrimin e funksioneve të tyre të kontrollit dhe në realizimin e buxhetit. Shënime GJED vendos:

- për dëme; (TKC, neri 235, ish-neni 178).
- <* për mosnarrveshje pune mes Komunitetit dhe nëpunësve të tij; (TKE neni 236, ish-neni 179) dhe Rregullorja për Personelin, neni 91.
- * për mosmarrveshjet midis BQE dhe bankave ëndrore kombëtare; (TKE neni 237,ish-neni 180).
- * për marrjen e vendimeve në zbatim të klauzolave të arbitrazhit; (TKE neni 238, ish-neni 181).

¹⁵ Dispozitat që rregullojnë funksionet, nenet 246 dhe 248 të TKE.

- > Luan rolin e arbitrit mes shteteve anëtare që kanë mosmarrveshje që lidhen zbatimin e legjislacionit të Komunitetit; (TKE 239, ish-neni 182).
 - + Ofron rishikim gjyqësor të rregulloreve; (TKE neni 241, ish-neni 184).
 - * Parashkruan masa të përkohshme që i nevojiten; (TKE, neni 243, ish-neni 186).
 - * Pezullon detyrimin e zbatimit të vendimeve të Komisionit ose Këshillit; (TKE neni 256.4, ish-neni 192).
 - Përcjell opinione dhe rekomandime mbi ceshtjet të ndryshme si marreveshjet ndërkombëtare dhe marreveshjet e asociimit; (TKE neni 300, ish-neni 228).
 - * Pranon apeline kundër vendimeve të Gjykatës së Shkallës së Parë; Vendimi i Këshillit, neni 3 (24 tetor 1988) lidhur me nenin 49 të Statuteve të Gjykatës së Drejtësisë Evropiane. (materiale studimi për BE, për vendet në procesin e Stabilizim -Asocimit).
- Disa nga vendimet kryesore të GJED: a. Van Gend dhe Loos kundër Administratës së të Ardhurave Vendore të Hollandes: zbatimi i drejtpërdrejtë i ligjit të Komunitetit (JCE, 5 shkurt 1962, Vendimi 26/62), b. Costa kundër ENEL: përparësia e ligjit të Komunitetit (ECJ, 15 korrik 1964, Vendimi 6/64), c. Frankovich kundër Republikës së Italisë: zbatimi i drejtpërdrejtë i direktivave dhe përgjegjesisë shtetërore për moszbatimin e një direktive (EJC, 19 nëntor 1991, Vendimi C-6 and 9/90), d. Factortame, e. Van Duyn kundër Home Office.

Bibliografia

- Eleanor E.Zeff, Elle Pirro, The europa states, 1986.
 Xhezair Zaganjori, Për reformën institucionale të Bashkimit Europian.
 Laura Cram, Desmond Dian, Developments in the European Union.
 Luigi Daniele. Il diritto dell' Unione Europea.
 TKE, neni 235, ish-neni 178
 TKE neni 236, ish-neni 179)
 TKE neni 237,ish-neni 180
 TKE neni 238, ish-neni 181
 TKE 239, ish-neni 182
 TKE neni 241, ish-neni 184
 TKE, neni 243, ish-neni 186
 TKE neni 256.4, ish-neni 192
 TKE neni 300, ish-neni 228
 TKE nenet 246 dhe 248 .
 TKE, nenet 220-225.1, 229, 245; ish-nenet 164-168a, 172, 188.
 TKE neni 251, ish- neni 189b.
 TKE neni 2342
 TKE neni 234
 TKE neni 230
 TBE neni 35, ish-neni K.7. Përmbledhje traktatesh.
 TKE neni 234, ish-neni 177. Përmbledhje traktatesh.
 TKE neni 228, ish - neni 171.

Fundamentalism, extremism and religious terrorism

Dr. Mirela Shameti

Abstract

Often in our daily life we hear the word fundamentalism. Generally Muslim individual faith identifies them as fundamental. Quiet naturally comes the question what does it means fundamentalism? According to the Oxford dictionary 'fundamentalism' means strong foundations content and knowledge of any religion, especially Islam (Kulla, 2012).

Një tjetër karakteristikë e kësaj kohe është edhe përdorimi i basit “bordun”(pedal) si hyrje, një tjetër karakteristikë popullore e kësaj kohe, e cila asocon në pedalin e mbajtur nga gajdat, një instrument popullor i përdorur nga popujt e ndryshëm europian.

Shembulli numër 2,

⁴ Franjo Kuhač *Josip Haydn i hrvatske narodne popievke*, Zagreb, 1880, f.17

Hajdn Simfonia 103. Koha e katërt tema ⁵

a) Simfonija 103, Tema Finala



b) Hrvatska narodna pjesma „Divojčica potok gazi“




Gjithashtu, edhe kjo temë ka formë simetrike, ku pjesa e dytë është një lloj pasoje (përgjigje ndaj frazës së parë). Kjo temë është marrë nga kënga kroate e quajtur “Divojçica potok gazi”.

Shpesh këngët popullore janë identike me meloditë e Hajdnit, por ngadonjëherë versioni i Hajdnit (për dallim nga ai popullor), është më pak simetrik dhe më i përshtatshëm për tu zhvilluar, pasi siç e dijmë, periudhat simetrike janë më pak të përshtatshme për zhvillim. Pra, sipas muzikologut Hadow, dy versionet fillojnë ngjashëm në fillim dhe janë të ndryshëm në fund.

Shembulli numër 3

Beethoven Simfonia numër 6, koha 5



Kjo temë ka prejardhje nga një temë popullore kroate. Gjithashtu, nëse shohim temën do të vërejmë periudhën e përbërë nga dy fraza, ku fraza e parë mbaron në gjysëm kadencë dhe e dyta në kadencë jo perfekte autentike.

Menueti dhe Trio në simfoninë klasike

Nëse flasim për kohën e parë të simfonisë, e cila ka formën e allegro sonatës, do të shohim se qëllim në vetevete në këtë kohë kemi ballafaqimin e dy temave në tonalitete dhe karaktere të ndryshme në ekspozicion dhe fragmentimin dhe zhvillimin e tyre të mëtutjeshëm në përpunim.

Një ballafaqim ndryshe ndodh në kohën e tretë të simfonive, forma e të cilës është menuet dhe trio.

1). Skema e formës menuet dhe trio:

⁵ F. Kuhač *Josip Haydn i hrvatske narodne popevke*, Zagreb, 1880, f.21

Menuet			Trio			Menuet		
A			B			A		
a	b	a	c	D	c	A	B	a

Përveç kontrastit në tonalitet midis menuetit dhe trios, ku zakonisht trioja është në tonalitetin dominant të menuetit (ose në tonalitetin parallel), ekziston edhe kontrasti midis karaktereve.

Karakteri i menuetit është një valle me metër $\frac{3}{4}$, e cila është luajtur nëpër sallonet e aristokratëve, kurse karakteri i trios zakonisht është karakter fshataresk.

Shembulli numër 4

Hajdn simfonia 88 koha 3

Forma e Trios në këtë kohë është IC:IDC1:II. E gjithë trioja përcillet nga tinguj të mbajtur pedali, të cilat I përngjasojnë pedalit të gajdës. Një tjetër karakteristikë në këtë trio gjithashtu është edhe harmonia, e cila në disa vende lëviz me kuinta paralele, lëvizje e cila ka qënë e ndaluar në stilin e harmonisë klasike, por me sa duket këto rregulla strikte të lëvizjes harmonike nuk janë respektuar nga muzikantët popullor. Me vendosjen e zërave në këtë mënyrë, Hajden edhe më thellë thekson karakterin popullor të trios.

Pjesë e karakterit të trio-s shpesh është edhe karakteri komik i saj. Kjo vjen pasi që trioja shpesh imiton orkestrat fshatare, të cilat kanë luajtur muzikë popullore nëpër tavernat e fshatit dhe si të tillë këto muzikantë shpesh nuk kanë qënë profesionalisht mirë të përgatitur. Gjithashtu, ato shpesh nuk kanë qënë të koordinuar mirë ritmikisht ndërmjet veti dhe kjo pasqyrohet te trioja në pjesën D, kur melodia hyn në kontratempo me përcjelljen orkestrale.

I gjithë ky kaos melodiko ritmik gjen zgjidhje (koordinohet) tek fundi I I pjesës C1, ku më në fund kemi koordinim ritmik midis melodisë dhe përcjelljes, pra, e gjithë orkestra bëhet bashkë në fund (në kadencë).

Shembulli numër 5

Beethoven simfonia 4 koha 3

Gjithashtu, edhe te kjo pjesë e trios te simfonia numër katër, Beethoven tregon karakterin komik të "orkestrës fshatare", ku violinat "mundohen që të gjejnë intonacionin" e saktë gjatë luajtjes së melodisë (përgjigjes), raportin pyetje përgjigje që krijohet me instrumentat frymore të drurit.

Shembulli numër 6

Beethoven simfonia 6 koha 3

Një shembull tjetër komik, ndoshta më flagrant në historinë e muzikës simfonike ndodh në trion e simfonisë numër 6 (pastorale). Kjo është simfonia, e cila I është dedikuar natyrës dhe jetës në fshat. Forma: Skerco-A-A-B-A1-B-A1, Trio 1 -C-D-C1, Skerco2, Trio2, Coda (Skerco3)A.

Beethoven, derisa e kompozonte këtë vepër ishte klient i rregullt në tavernën e fshatit që quhej "Tre Korbat", në të cilën luante një orkestër frymore dhe në trion e veprës Beethoven mundohet të imitojë "orkestrin", I cili nuk arrin të koordinohet siç duhet, ku fagoti ka vetëm tre nota shoqërim në bas. Në ato tre nota fagoti nuk arrin të koordinohet me pjesën tjetër të orkestrës (oboa dhe klarineti), të cilët sipas melodisë të dhënë në vepër duket se kanë qënë të përshkruajtur si instrumentistë të mirë. Pra, Beethoven me muzikë përshkruan një fagotist të "intoksikuar" nga pijet alkoolike,

I cili edhe pse vijën e vetë melodikë e ka shumë të thjesht, përsëri nuk arrinë ta luajë siç duhet(të koordinohet).

Shembulli numër 7

Mocart Simfonia 39 koha e tretë

Një tjetër shembull është ai I trios së simfonisë numër 39 e cila ka formë IC:IDC1:II. Zëvendësimi I Menuetit me Skercon

Kristalizimin simfonia klasike si formë e arriti në kohën e Hajdnit, ku zakonisht u arrit një formë e qëndrueshme muzikore, e cila ishte kompakte dhe kishte kuptim narrativ dhe kompozicional.

Por, në momentin kur u mendua se simfonia krijoi formën e saj finale dhe u përsos, L.V.Beethoven me 9 simfonitë e tij e shpuri zhanrin e simfonisë në lartësi të tjera, aq sa C.Debussy më 1903 u shpreh se çdo simfoni e kompozuar pas simfonisë së 9 të Beethovenit është një hije e zbehtë e këtij të fundit.

Nëse marrim dhe I analizojmë simfonitë e Beethovenit do ta shohim se çdo simfoni e tij është model për vetveten, pra çdo simfoni është art individual duke tejkaluar çdo lloj shablloni paraardhës.

Një ndër ndryshimet të cilat ja bëri zhanrit të Simfonisë L.V.Beethoven ishte ndryshimi I kohës së tretë nga menuet-trio-menuet, në skerco-trio-skerco, duke I dhënë më tepër dinamikë dhe duke e dramatizuar dhe më tutje simfoninë si formë. Përsëri menueti gjindet si formë në simfonitë e Beethovenit edhe atë në simfonitë numër 1,4,9.

Por edhe pse shkruan menuet, te këto simfoni tempoja e kohës së tretë është tempo skercoje, pra nuk mundemi të vallëzojmë (sipas modelit aristokrat) me atë lloj menueti Beethovenian sepse tempi është tepër I shpejtë për nje valle të vetëpërmbajtur aristokrate.

Duke ditur nga biografitë e ndryshme, Beethoven ishte karakter konfliktuoz (sidomos me aristokratët), një teori thotë se ai qëllimshëm vallen aristokrate menuet e titulloj skerco (shaka), si një lloj talljeje ndaj të gjithë traditave dhe mënyrës së jetesës që bënin aristokratët.

Një teori tjetër thotë:

“Në kontrast me këto valle(menuetin), janë skercot në metër $\frac{3}{4}$. Vallet e salloneve në kohën e klasiçizmit kërkonin butësi.Në vallet e fshatit, në kontrast me vallet e sallonit, thekset e përplasjev të këmbëve në tokë ishin të lidhura me metrin trinar. Korniza e trupit peshonte rëndë në vallet fshatare. Kështu që, skercot e Beethovenit nuk rrjedhin nga vallet e salloneve aristokrate, por nga këto origjina fshatare.”-thotë Boris Asafiev (1977) ,krijuesi I “teorisë së intonacionit”. Pra, me fjalë tjera, Beethoven zëvendësoi Menuetin si valle salloni me Skercon e cila (sipas Asafiev) ka karakter popullor.

Ndikimi i muzikës simfonike në klasiçizëm në atë popullore(teoria e transmetimit-invers)

Musikologu Michel Brenet hedh hipotezën e teorisë të transmetimit-invers, pra; duke qënë tepër popullore muzika klasike ka depërtuar në masën popullore dhe si e tillë, është përkapur nga masa (si krijim I saj) dhe është popullarizuar.

Një shembull konkret kemi me temën e skercos të simfonisë Eroika, e cila pasi filimisht u dha si supozim nga Mr.A.B.Marx se ishte marrë nga Beethoven dhe ishte adaptuar në simfoni nga muzika popullore. Por, më vonë I njëjti autor ⁶ hedh poshtë

⁶ A.B.Marx,Beethoven (ed.1)Vol.I.273;II,23

pretendimet e veta duke pranuar se kënga ushtarake është më e vonë se simfonija e Beethoven-it dhe se sipas të gjitha gjasave kënga është bazuar mbi temën e simfonisë. Shembulli 8

No. 36.

This has been supposed by Mr. A. B. Marx to have been adopted from a soldier's song—

No. 37.

Was ich bei Tag mit der Lei - er ver - dian', das geht bei der Nacht in den Wind, Wind, Wind, Wind, Wind.

Op. 36. in G major.

Beethoven Simfonia 3 koha 3(36)/Kënga ushtarake(37)

Përfundimi

Simfonia ishte forma më reprezentive e një periudhe kur folklori kishte ndikimin më të zbehtë në artin muzikor dhe në art në përgjithësi. Ishte forma ku sistemi funksional/harmonik arriti kulmin e ndikimit në artin muzikor dhe u imponua si një lloj gramatike muzikore (kod), gjuhë universale shenjash dhe gjestesh, ku nga ai rridhnin: meloditë (temat muzikore), dramaturgjia e veprës, konstrukti I veprës. Vetëm nëpërmjet sistemit funksional/harmonik arti muzikor mund të komunikonte me publikun dhe të spjegohej kuptimi I plotë I veprës muzikore.

Duke qënë kështu, mundësitë dhe ndikimet jashtë këtij sistemi kanë qënë të pakta. Edhe muzika folklorike e cila nuk ishte shkruar me këtë sistem ishte shumë pak prezente në veprat e periudhës klasike.

Të kishim ndikime popullore do të thotë të kemi ndikime të cilat nuk shkojnë përshtati një unifikimi të sistemit artistiko-muzikor. Sistem I cili është ndërtuar “për të gjithë popujt”. Pra, të kesh ndikime të ndryshme popullore do të thotë të kesh ndikime të më shumë “gjuhëve popullore”, në një kohë ku tentohej të arrihej një gjuhë për të gjithë popujt dhe masat.

Por, edhe pse nuk ishte prezente sa periudhat tjera të historisë së muzikës (psh si në Romantizëm), përsëri përvoja popullore arriti të lërë gjurmët e saja në formësimin e zhanrit më “absolut” muzikor simfonisë, nëpërmjet skercos, trios dhe temave popullore, të cilat me homogjenitetin e tyre e gjetën vendin e tyre në kohët e treta dhe të katërta të simfonisë, kohë të cilat nga karakteri I tyre ishin jopërpunuese.

Pra, tonaliteti në klasicizëm shkriu folklorin dhe u bë gjuhë universale shenjash dhe gjestesh, por edhe perkundrejt kësaj muzika folklorike depërtoi në simfoni.

Dhuna në familje, fenomen shumë i përhapur në Shqipëri, forcimi i masave dhe ashpersimi i dënueshmërisë për këtë vepër penale

Av. Asllan Dogjani
Deputet në Kuvendin e Shqipërisë

Abstrakt

Ky punim ka si qëllim që të trajtoj ndryshimet ligjore për sa i përket dënueshmërisë, ashpersimit të masave, lehtësisë të procedurave, mundësisë që u jep ligji viktimave të dhunës në familje për tu mbrojtur në mënyrë të menjehershme nga dhunuesi, si dhe sa kanë ndikuar ndryshimet ligjore në reduktimin e dhunës në familje, fenomen shumë i përhapur në vendin tonë. Rritja e vazhdueshme e dhunës në familje solli domosdoshmërinë e ndryshimeve ligjore, dhe konkretisht në ndryshimet që ju bene ligjit nr. 9669, date 18.2006 është parashikuar shtimi dhe forcimi i masave, lehtësimi i procedurave dhe dhenien e një mundësie më të madhe viktimave të dhunës në familje për tu mbrojtur nga dhuna. Mbi këtë sistem ligjor bazohet edhe puna që kryhet për të luftuar dhunën në familje që shfaqet në të gjitha format e saj, dhunë fizike dhe psikologjike. Shërbimet e ofruara nga punonjësit e shtetit viktimave të dhunës në familje gjejne mbështetje të gjërë në kornizën ligjore, por shumë pak prej kësaj mbështetje ligjore përkthehet në zbatimin e tyre në praktike. Mangësia në praktike në zbatimin e ligjeve referues për dhunën në familje është e ngjashme me mungesën e një kornizë ligjore që ofron edhe më pak mundësi rehabilitimi apo trajtimi për dhunuesit e pjesëtarëve të familjes. Fenomeni i dhunës në familje është i vështirë për tu çrrënjësuar nga shoqëria Shqiptare në të gjitha trevat ku ajo shtrihet, por nuk konsiderohet një mision i pamundur. Ky mision nuk i përket vetëm sistemit të Drejtësisë për ta përfunduar, por duhet domosdoshmërisht edhe përfshirja e shoqërisë civile.

Ky studim bën një përpjekje për të ofruar zgjidhje të mundshme dhe realiste që mund të ndikojnë ndjeshëm në minimizimin e numrit të incidenteve të abuzimit ndaj pjesëtarëve të familjes. Për të arritur tek këto përfundime që i shërbejnë kornizës ligjore në luftën ndaj këtij fenomeni, dhe institucioneve me përgjegjësinë që mbartin për të adresuar këtë plagë të shoqërisë Shqiptare moderne, më parë është bërë një analizë e historikut dhe aspekteve të ndryshme që ndikojnë në ekzistencën e këtij fenomeni.

Fjalë kyçe: urdher mbrojtje, urdher i menjehershëm mbrojtje, masat, dhunë, viktimat të dhunës, gjykata, ligji, familje, Kushtetuta, Kodi Penal.

Hyrje

1. Konceptet bazë për dhunën në familje

Dhuna në familje është një plagë për shoqërinë njerëzore. Për fat të keq shoqëria shqiptare nuk përbën përjashtim. Sistemi dhe profesionistët e drejtësisë po përballen gjithnjë e më shumë me raste të ndryshme të dhunës në familje, në forma nga më të ndryshmet.

Dukuria e dhunës në familje ka një shtrirje të konsiderueshme globale. Pasojat e dhunës në familje ndaj grave janë të konsiderueshme. Ajo vë në rrezik jetën, shëndetin, integritetin psikologjik dhe lirinë e tyre. Për profesionistët e drejtësisë një sy i nxirë apo një krah i thyer janë shenja që kuptohen më kollaj, mirëpo është e gabuar të mendojmë që meqë nuk ka një shenjë fizike, gruaja nuk është e dhunuar.

Shpeshherë dhunuesi e pengon gruan t'u drejtohet strukturave përgjegjëse, pa iu shëruar njëherë plaget që ajo të mos ketë mundësi të provojë se ka qenë e dhunuar. Mirëpo profesionistët e drejtësisë duhet të jenë shumë të vëmendshëm ndaj pasojave psikologjike të dhunës në familje. Shpeshherë te gruaja ndeshen shenja të stresit post-traumatik dhe një profesionist i mirë i fushës së drejtësisë mund të kërkoj ndihmën e një kolegu nga fusha e psikologjisë apo punës sociale, për të bërë një vlerësim dhe një raport profesional që të dëshmojë pikërisht këto pasoja, jo edhe aq të dukshme në pamje të parë. Dhuna ndaj grave në familje është konsideruar si shkelja më e shpeshtë e të drejtave të njeriut, por në të njëjtën kohë dhe më e paadresuara. Dhuna ndaj grave në familje është një formë e dhunës me bazë gjinore pasi rrjedh nga pozita më e ulet e gruas në shoqëri. Ndonëse gratë në familje janë rëndom viktimat të dhunës, ato nuk janë viktimat e vetme të saj. Edhe kategori të tjera si të moshuarit, personat me paaftësi apo fëmijët janë kategori që preken prej saj. Është detyrë e profesionistëve të drejtësisë që të vlerësojnë me shumë kujdes këto raste. Statistikat flasin për një nivel më të lartë të dhunës tek fëmijët të krahasuar me dhunën ndaj grave. Me ndryshimet ligjore dhe me ashpersimin e denimeve për veprën penale të dhunës në familje jo vetëm te burrit ndaj gruas por dhe te femijeve ndaj prindërve që fatkeqesisht janë bere shume te shpeshta ne vendin tone.

Disa nga karakteristikat e fëmijëve që kanë qenë dëshmitarë të dhunës në familje të ushtruar nga prindi i tyre: Fëmijët mund të paraqesin një sjellje agresive apo të dhunshme ndaj vëllezërve dhe motrave të tyre, ndaj shoqërisë, dhe ndaj prindërve, kjo është më e dukshme tek djemtë. Ndërsa vajzat kanë prirjen për të qenë më të pjekura, më pasive dhe më të tërhequra. Ato mund të shfaqin qëndrimin e viktimes. Mund të kemi një lloj lufte për pushtet mes fëmijëve dhe prindërve për dominimin e familjes. Kur vijnë në strehë fëmijët mund të bëjnë hapa mbrapa. Sidomos me të vegjlit kjo mund të shoqërohet me një sjellje akoma më të papjekur. Këta fëmijë kanë strategji të pakta për tu përballur me problemet në shoqëri, kështu kemi zënka të shpeshta me motrat dhe vëllezërit, ose me shoket e shoqet. Ekziston mundësia që këta fëmijë të mos jenë në kontakt me emocionet e tyre. Ata mund të mos kenë shumë miq, madje ata nuk kanë shumë strategji dhe aftësi për të krijuar miq dhe nuk kanë sesi të mbajnë shoqërinë kur nuk e krijojnë. Ka mundësi që tek ata të paraqesin një sjellje të papërshtatshme apo të pakontrolluar në shoqëri, pasi mund të mos e kenë të qarte se çfarë konsiderohet e pranueshme në shoqëri. Gjatë natës mund të përjetojnë tmerrim, mund të vuajnë nga crregullime si dhimbje barku, koke etj. Përgjithësisht paraqesin një nivel më të ulet frenimi të impulsive të tyre. Mësuesit mund të vërejnë probleme serioze me sjelljen dhe mbarëvajtjen nën mesatare me mësuesit. Këta fëmijë mund të kenë problem me ushqyerjen. Kanë rrezik të krijojnë varësi ndaj drogës dhe alkoolit. Mund të përmbysin rolet, duke marrë pershembull rolin e përkujdesjes dhe mbrojtjes së të ëmës. Dhuna në familje përkufizohet si një seri sjelljesh abuzive ose kërcënuese që përfshijnë dhunën fizike, psikologjike, ekonomike dhe seksuale si dhe forma të tjera të frikësimit, izolimit dhe shtrëngimit.

II. Trajtimi i dhunës në familje nga legjislacioni penal

Legjislacioni shqiptar ofron mundësi për individët që mund të ndeshen në situatë të dhunës në marrëdhëniet familjare. Neni 15 I Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ngarkon me detyrë organet shtetërore të kontribuojnë aktivisht në realizimin e të

drejtave njerëzore. Kushtetuta, si ligji themelor i vendit, i ofron mbrojtje jetës së njeriut, lirisë, integritetit fizik, dinjitetit, dhe personalitetit të tij si dhe lirisë dhe të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore. Kodi Penal I Republikës së Shqipërisë mund të gjejë përdorim në shumë aspekte për t'u ofruar mbrojtje viktimave të dhunës në familje, për të frenuar fenomenin dhe për të vënë përpara përgjegjësinë, dhunuesit. Në nenin 130 të Kodit Penal të ndryshuar dhuna në familje është parashikuar si veper penale e ndare në tre paragrafe: Rrahja, si cdo veper tjetër dhune, ndaj personit që është bashkeshort, ish- bashkeshort, bashkejetues apo ish-bashkejetues, gjini e afert me autorin e veprës penale, me pasoje cenimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij, denohet me burgim gjere ne dy vjet.

Kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rende, ndaj personit që është bashkeshort, ish-bashkeshort, bashkejetues apo ish-bashkejetues, gjini e afert ose krushqi e afert me autorin e veprës penale, me pasoje cenimin e integritetit psikik të tij, denohen me burgim gjere ne tre vjet.

Plagosja e kryer me dashje, ndaj personit që është bashkeshort, ish-bashkeshort, bashkejetues apo ish-bashkejetues, gjini e afert ose krushqi e afert me autorin e veprës penale, që ka shkaktuar paaftesi të perkohshme në punë me tepër se nëntë ditë, denohet me burgim gjere ne pese vjet.

Po këto vepra, të kryera në mënyrë të perseritur, ose në praninë e femijëve, denohen nga një deri në pesë vjet.

Kush mbrohet nga ligji?

Ligji mbron një person mbi të cilin është ushtruar dhunë, e cila ndodh gjatë tij dhe personave që janë ose kanë qenë në lidhje familjare me të. Mbron gjithashtu pjesëtarë të tjerë të familjes së këtij personi ose të afërmit e tjerë të tij, kur ata vetë bëhen viktimë të dhunës në familje. Sipas ligjit, anëtarë të familjes janë:

- bashkëshortët ose partnerët bashkëjetues, ose ish-bashkëshortë ose ishpartnerë bashkëjetues;
- vëllezërit, motrat, gjinia në vijë të drejtë, përfshirë prindërit adoptues dhe fëmijët e adoptuar; fëmijët dhe bashkëshortët e këtyre personave;
- gjinia në vijë të drejtë, përfshirë prindërit dhe fëmijët e adoptuar të bashkëshortëve ose partnerëve bashkëjetues;
- vëllezërit dhe motrat e bashkëshortëve nëse këta kanë jetuar bashkë gjatë 3 muajve të fundit;
- fëmijët e bashkëshortëve ose partnerëve bashkëjetues;

Si mund të më mbroj ligji nga dhuna në familje?

Sipas ligjit të ri kundër dhunës në familje, gjykatat civile mund të vendosin masa mbrojtëse për viktimat përmes një procedure të shpejtë, të përballeshme dhe të thjeshtë. Urdhrat e mbrojtjes ju japin juve mundësi për të marrë masa dhe për të mbrojtur veten nga dhuna. Ata mund t'ju sigurojnë lehtësim, duke e urdhëruar personin që ju ka abuzuar që të bëjë ose të mos bëjë gjëra të caktuara.

Ka dy lloje urdhrash mbrojtjeje:

Një urdhër mbrojtjeje: është një vendim gjykatë dhe përcakton një sërë masash mbrojtëse për viktimën/viktimat e dhunës në familje. Gjykata lëshon urdhrin e

mbrojtjes nëse gjen prova të mjaftueshme për të besuar se dhunuesi mund të kryejë një veprim dhune në familje ose kur lëshimi i urdhrit të mbrojtjes është i domosdoshëm për të mbrojtur sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien e viktimës ose anëtarëve të familjes. Një urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje: është një urdhër i përkohshëm gjykate i vlefshëm deri në lëshimin e një urdhri mbrojtjeje. Mund të lëshohet nëse abuzuesi paraqet një “rrezik të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm ndaj sigurisë, shëndetit ose mirëqenies së viktimës ose anëtarëve të familjes së saj/tij”. Atëherë kur personi i dëmtuar nga dhuna është i mitur, gjykata ka vetëm 24 orë për të marrë një vendim nga paraqitja e kërkesës. Në rastet kur ky person nuk është i mitur, gjykata duhet të vendosë brenda 48 orëve. Gjukata do të caktojë gjithashtu një datë për vazhdimin ose ndërprerjen e urdhrit brenda 20 ditëve nga lëshimi i tij. Të dy urdhrat hyjnë në fuqi menjëherë pas lëshimit nga gjykata dhe janë të vlefshëm pavarësisht faktit nëse abuzuesi është njoftuar ose jo. Ekzistojnë një sërë mënyrash përmes të cilave mund t’ju mbrojë një urdhër mbrojtjeje. Megjithëse lloji i mbrojtjes mund të luhet në varësi të rrethanave individuale, një urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje mund të përfshijë një ose më shumë nga masat e mëposhtme: Urdhëron dhunuesin që të ndalojë së kryeri ose së kërcënuari se do të kryejë një akt të dhunës në familje kundër paditësit (viktimës) ose anëtarëve të tjerë të familjes të viktimës. Detyron dhunuesin që të mos cenojë, ngacmojë, kontaktojë ose të komunikojë drejtpërdrejt ose të tërthorazi me viktimën apo pjesëtar të familjes së viktimës. Largon dhunuesin nga banesa për një afat kohor të caktuar me urdhër gjykate dhe e pengon të rihyjë në banesë pa autorizimin e gjykatës. Pengon dhunuesin që t’i afrohet përtej një distance të caktuar viktimës apo pjesëtarëve të familjes së viktimës. Ndalon dhunuesin që t’i afrohet shtëpisë, vendit të punës, banesës së familjes së origjinës ose banesës së ardhshme të çiftit ose banesës së personave të tjerë, dhe për më tepër shkollës së fëmijëve apo çdo vendi tjetër të frekuentuar shpesh nga viktimja, me përjashtim të rasteve kur frekuentimi bëhet për arsye pune. Vendos viktimat dhe të miturit në qendra strehimi të përkohshme. Kufizon ose ndalon dhunuesin që të takojë fëmijën e viktimës. Ndalon dhunuesin që të hyjë ose qëndrojë në banesën e përkohshme ose të përhershme të viktimës, ose në çdo pjesë të banesës, pavarësisht nga të drejtat e zotërimit apo pronësisë që dhunuesi mund të ketë mbi këto objekte. Urdhëron një person të autorizuar nga gjykata (polic ose përmbaues) që të shoqërojë viktimën ose dhunuesin në banesën e viktimës dhe të mbikëqyrë marrjen e sendeve personale. Urdhëron punonjësit e policisë që të sekuestrojnë çdo armë në zotërim të dhunuesit dhe të gjetur gjatë kontrollove të policisë, ose urdhëron dhunuesin që të dorëzojë çdo armë në zotërim të tij ose të saj.

Kujt duhet ti drejtohem për një urdhër mbrojtjeje?

Nëse keni pësuar dhunë nga një anëtar i familjes ose nga dikush me të cilën jeni në një marrëdhënie intime, mund të kërkontë një urdhër mbrojtjeje në ÇDO KOHË në ÇDO GJYKATË CIVILE (seksioni i familjes). Për ta bërë këtë, mund të shkoni në gjykatën e rrethit ku banoni (vendi i banesës së përhershme), edhe nëse jetoni atje përkohësisht (vendi i banesës së përkohshme), ose në gjykatën e vendit të banesës së përhershme ose të përkohshme të dhunuesit tuaj. Orari i gjykatave të rrethit është nga e hëna në të premte, ora 08:00-16:00. Ligji I jep mundësi të dhunuarin të drejtohet edhe në komisariat me të afert, në organin e akuzës (prokurori) dhe këta të fundit

ti drejtohen gjykates per urdher mbrojtje. Viktimat e dhunes mund te shkojne dhe ne qendren shendetesore apo dhe ne spital dhe keta te fundit kane detyrim te njoftojne policine.

III. "Ligji për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", ligji nr.9669, datë 18.12.2006

Ky ligj ka për qëllim: Parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore. Garantimin e mbrojtjes me masa ligjore të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimat të dhunës në familje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuar.

Ky ligj ka si objekt: Krijimin e një rrjeti të koordinuar institucionesh përgjegjëse për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave, lehtësimin e pasojave dhe parandalimin e dhunës në familje. Orientimin e punës për krijimin e strukturave dhe organeve përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor për mbështetjen e viktimave dhe parandalimin e dhunës në familje. Fuqizimin e gjyqësorit për marrjen e masave të mbrojtjes ndaj dhunës në familje. Sigurimin/garantimin për viktimat e dhunës në familje të shërbimit të shpejtë, të pakushtueshëm dhe të thjeshtë në përputhje me ligjin, pranë gjykatës apo organeve të tjera kompetente për zbatimin e ligjit.

Autoritetet përgjegjëse: Autoriteti kryesor përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Autoritete të tjera përgjegjëse të linjës janë: a) njësitë e qeverisjes vendore; b) Ministria e Brendshme; c) Ministria e Shëndetësisë; ç) Ministria e Drejtësisë.

III. Gratë më të prekura ndaj dhunës

Jo të gjitha kategoritë e grave përjetojnë dhunën e ushtruar ndaj tyre qoftë në një marrëdhënie apo qoftë edhe në një familje. Pozita e pabarabartë e grave në shoqëri është ajo që ndikon në të shumtën e rasteve edhe në viktimizimin e tyre. Arsimi është elementi kryesor i kësaj pozite që kanë gratë në shoqëri, i cili ndikon mbi ushtrimin e dhunës ndaj tyre. Gratë me arsim të mesëm ose më të ulët ka më shumë të ngjarë të përjetojnë dhunë në familje sesa ato me arsim të lartë. Gjithashtu, gratë që nuk punojnë jashtë shtëpisë kanë më shumë të ngjarë të pësojnë dhunë sesa ato që punojnë jashtë shtëpisë. Referuar edhe shifrave të grave të dhunuara, rezultojnë se 19% e grave të dhunuara në Shqipëri nga dhuna në familje pësojnë lëndime, të tilla si: çarje/nxirje, plagë të thella, kocka/dhëmbë të thyera, humbje ndjenjash, lëndime në kokë dhe në zonën e barkut. 14% e grave të dhunuara në Shqipëri ishin të pamundura të bënin punë shtëpie ose të kujdeseshin për fëmijët, për shkak të plagëve të marra nga dhuna në familje, si dhe 44% e grave të përdhunuara kishin sëmundje seksualisht të transmetueshme. Por ajo që ndryshon më së shumti në përdorimin e dhunës, është edhe perioda kur gratë në vendin tonë nisin që të përjetojnë dhunën. Një në katër gra nisin ta përjetojnë dhunën që në vitin e parë të martesës, ndërsa një në dy gra, sipas studimit të bërë në vendin tonë, pohojnë se dhuna ndaj tyre ka nisur në vitin e dytë ose të tretë të martesës.

Ne një studim të bërë nga komisioni për mbrojtjen e diskriminimit për vitin 2015 rezultojnë se 59% e grave kanë pesuar dhunë në familje. Vetëm gjatë viti 2015 janë

dhunuar 53% e grave, po nga ky studim rezulton se 59.4% e grave, me shume se 1 ne dy gra jane shprehur se kane pesuar dhune ne familje, gjate martese, marrdhenie intime, apo gjate gjithë jetes . Gjate vitit 2015 po sipas ketij studimi jane denancuar ne polici 3094 raste nga keto 1292 jane konsideruar vepra penale. KLD publiko nje permbledhje per rishikimin e rasteve te dhunes ne familje ne 38 gjykata dhe rekomandoi ndryshime ne ligj dhe praktikat gjyqesore pasi rezultoi se jane zvarritur proceset gjyqesore duke shkelur afatet kohore per shqyrtimin e leshimin e urdherave te mbrojtjes. 1882 gra te dhunuara kane kerkuar mbrojtje deri ne fund te shtatorit e ndersa 2/3 e kerkesave per urdher mbrojtje jane terhequr por dhe aty ku eshte leshuar urdheri I mbrojtjes nuk jane zbatuar.

Nje studim tjetër I bere ne vitin 2014 nga zyra e botimeve te BE ne Luksemburg per dhunen ne familje dhe sipas nje buletini informues te publikuar ne faqen zyrtare te Ministrise mirqenies sociale pergatitur nga Dr. Robin Haar per parandalimin e dhunes ndaj grave, pas vrojtimit te bere nga zyrat e botimeve te BE rezulton se 59.4% e grave te moshes 18-55 vjec pejetojne dhune ne familje. Kjo e krahasuar me vitin 2007 nje vit pas ndryshimeve ne ligj ka rritje te dhunes me 3% ndersa krahasuar me vitin 2015 kemi te njetin nivel me 59.4%

Dhuna te fëmijët

Dhuna në familje nuk prek vetëm njërin prej partnerëve, por në të shumtën e rasteve janë edhe fëmijët ata që bien viktimë e ushtrimit të saj. Në studimin e kryer në vendin tonë për vitin që lamë pas, rezulton se 58% e fëmijëve rrihen nga një anëtar i familjes, si dhe një numër i lartë prej 86% e fëmijëve bëhen dëshmitarë të dhunës në familje. Kjo “dhunë e dyfishtë” te fëmijët sigurisht që sjell edhe pasoja negative në jetën sociale të tyre apo dhe në integrimin e tyre në shoqëri. Përveçse traumave psikologjike që mbeten në mendjen e tyre, kjo dhunë reflekton negativisht në arsimin e tyre, duke bërë që 43% e fëmijëve të hasin vështirësi në shkollë, 31% e fëmijëve të jetojnë me frikë, për shkak të dhunës në familje, 6% e fëmijëve të largohen nga shtëpia për të jetuar me të afërmit. Referuar këtij studimi, një në dy fëmijë në 86% të rasteve kërkon më shumë ndihmë ndaj dhunës së ushtruar ndaj tij te njëri nga prindërit, si dhe në asnjë rast të vetëm nuk është kërkuar nga fëmijët e dhunuar ndihmë nga mjekët ose policia.

Arsyet e dhunës

Në raportet e ndryshme nga organizata që mbrojnë të drejtat e grave të dhunuara apo dhe familjarëve të tjerë në familje, theksojnë se dhunuesit janë në kërkim të një ndjenje pushteti dhe kontrolli ndaj partnereve, ose kanë ndonjë lloj varësie ndaj gruas, kështu që ndihen të kërcënuar nga çfarëdo lloj përpjekjeje e saj për të qenë e pavarur. Referuar studimit të bërë për vendin tonë, thuhet se “disa burra ushtrojnë dhunë, pasi kjo është rruga e vetme që njohin për të pasur lidhje me një partnere”. Ndërkohë që, arsyeja kryesore e përdorimit të dhunës nga ana e burrave, vjen edhe për shkak se disa burra janë rritur në familje të dhunshme, ku ata kanë parë nënën t’u dhunohet nga babai dhe ku kanë pësuar dhunë edhe për vete si dhe kushtet e veshtira te jeteses dhe gjendja e veshtire ekonomike.

Konkluzione

Ne perfundim te ketij punimi arrijme ne perfundimin se: Megjithese ndryshimet ligjore te vitit 2006 kane forcuar masat dhe lehtesuar procedurat duke ju dhene mundesi me te medha per tu mbrojtur viktimave te dhunes ne familje perseri kemi te njetin preceptim dhe pothuajse kemi te te njetat statistika te dhunes ne familje. Megjithese eshte rritur numri I kallezimeve pak ka ndikuar ne reduktimin e dhunes. Viktimat jane terhequr nga kerkesat per urdherin e mbrojtjes edhe kur nuk jane terhequr urdherat e mbrojtjes nuk jane zbatuar. Ka patur rate te zvarritjes se proceseve nga gjyqtaret duke shkelur afatet kohore per shqyrtimin e leshimin e urdherave te mbrojtjes. Pak eshte bere per informimin e opinonit public dhe subjektet e ketij ligji me ndryshimet ligjore dhe me mundesite qe u krijohen viktimave te dhunes ne familje per tu mbrojtur nga dhuna. Mungesa e arsimit, gjendja e veshitire ekonomike, tradita, kultura, paftesia, mosnjohja e moszbatimi ligjit dhe mungesa e specialiteve e zvarritja e proceseve gjyqesore jane disa nga arsyet qe kemi pothuajse te njetin nivel dhune ne familje.

Rekomandime

Krijimin e seksioneve te qendrueshem e te specializuare me officer policie te zote, te afte nga ana profesionale e te atashuar prane cdo komisariati policie me qellim qe te merren vetem me rastet e dhunes ne familje. Bashkepunimi me organizatat joqeveritare qe merren me te drejtat e grave e femijeve, me median, arsimin me qellimi informimin e opinonit public dhe subjekteve te ketij ligji me ndryshimet ligjore. Te shikohet mundesia e ndryshimeve ne ligj duke bere permisimet e nevojshme duke u nisur nga mangesite qe jane evidentuar gjate zbatimit te ligjit dhe unifikimin e praktikës gjyqesore.

Referenca

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

“Lligji nr.9669, date 18.12.2006”, “Per masat ndaj dhunes ne marrdheniet familjare”.

Kodi Penal, i Republikës së Shqipërisë.

Raporti I Komisionerit per mbrojtjen nga diskriminimi, V. (2015), 39-41).

Zyra e botimeve te BE, V.(2013), 33.

From \leq -semigroups to po -semigroups

Msc.Aida Shasivari

Polytechnic University of Tirana

Assoc. Prof.Elton Pasku

University of Tirana

Abstract

There are numerous evidences to support the claim that the theory of po -semigroups based on ordered ideals and the theory of le -semigroups based on ideal elements are parallel to each other in the sense that results on le -semigroups based on ideal elements are expressed in \leq -semigroups in terms of ideals, and conversely. The aim of this paper is not only to offer new evidence on this but most importantly to introduce a mechanism which allows us to pass from po -semigroups to le -semigroups without having the need to reprove theorems on \leq -semigroups by just mimicking the proofs of their counterparts of le -semigroups but instead obtaining them as corollaries of the latter by using the mechanism established. This mechanism is based on the embedding theorem of a po -semigroup into a le -semigroup proved earlier from Kehayopulu, Pasku and Tsingelis (Kehayopulu & Pasku & Tsingelis, 2006, 55).

Keywords: Ordered semigroups, Green's relation, quasi-ideal elements, ordered ideals, semilattice decomposition.

Introduction

In her paper (Kehayopulu, 2015, 144) Kehayopulu makes the following observation: *the theory of ordered semigroups based on ideals and the theory of le -semigroups based on ideal elements are parallel to each other. All the results on le -semigroups based on ideal elements are expressed in ordered semigroups in terms of ideals, and conversely. It is surprising that, for the results on ordered semigroups based on ideals, points do not play any essential role but the sets.*

Apart from making this observation and giving several results that support it no effort is made to find a connection between the two classes deeper than the fact that le -semigroups are a proper subclass of po -semigroups.

The aim of this paper is to introduce a mechanism by which we can obtain results on po -semigroups whose counterparts in le -semigroups are known to be true thus passing from the smaller class of le -semigroups to the wider one of po -semigroups. The key result that makes this possible is the embedding theorem of Kehayopulu, Pasku and Tsingelis proved in (Kehayopulu & Pasku & Tsingelis, 2006, 55) which interprets every po -semigroup S as an ordered subsemigroup of a le -semigroup Σ . The inclusion i of S into Σ is such that left, right and quasi-ideals

of S are mapped via i onto left, right and quasi-ideal elements of Σ . A partial converse of the above is also proved to be true. Both correspondences are in fact the heart of our mechanism which allows us to prove that several interesting results from (Kehayopulu, 1994, 267), (Kehayopulu & Tsingelis, 2013, 411) and (Kehayopulu, 2015, 74) have their own analogues for po -semigroups as well. Differently from many papers of Kehayopulu and Tsingelis, we do not reprove these results by just mimicking their proofs from the corresponding papers (Kehayopulu, 1994, 267), (Kehayopulu & Tsingelis, 2013, 411) and (Kehayopulu, 2015, 74), but instead obtain them as consequences of the corresponding results of the above papers by using the mechanism established.

Recall that a po -semigroup (ordered semigroup) is a triple (S, \cdot, \leq) where \leq is an order relation in S and \cdot is a multiplication in S that satisfy the properties

$$a \leq b \Rightarrow xa \leq xb \text{ and } ax \leq bx \text{ for all } x \in S$$

If (S, \cdot, \leq) is a po -semigroup possessing a greatest element e , then it will be called a poe -semigroup and it is called a $\vee e$ -semigroup if (S, \leq) is an upper semilattice. If in addition it happens that (S, \leq) is a lattice (the meet \wedge and the joint \vee of any two elements of S exists), then S will be called a le -semigroup. The standard notation for the le -semigroup in this case is $\langle S, \cdot, \vee, \wedge \rangle$. Here the order relation is not made explicit but it is understood that $a \leq b$ iff $a \wedge b = a$. An element x of a poe -semigroup S is regular if $x \leq xex$, and it is intra-regular if $e \leq ex^2e$. S is called regular (resp. intra regular) if every element of S is regular (resp. intra-regular). A poe -semigroup S is called semisimple if for all $x \in S, x \leq exexe$. An element x of a poe -semigroup S is regular if $x \leq xex$, and it is intra-regular if $e \leq ex^2e$. S is called regular (resp. intra regular) if every element of S is regular (resp. intra-regular). An element $t \in S$ is called semiprime if for every $a \in S$ such that $a^2 \leq t$, then $a \leq t$. An element of S is called a right (resp. left) ideal element if $xe \leq x$ (resp. $ex \leq x$). It is called an ideal element if it is both a left and a right ideal element of S .

A nonempty subset A of a po -semigroup S is called left (resp. right) ideal of S if

(1) $SA \subseteq A$ (resp. $AS \subseteq A$) and

(2) if $a \in A$ and $b \in S, b \leq a$, then $b \in A$, that is if $(A] = A$.

A is called an ideal of S if it is both a left and a right ideal of S . For an element a of S , we denote by $L(a)$ (resp.) $R(a)$) the left (resp. right) ideal of S generated by a and by $I(a)$ the ideal of S generated by a . We have

$$L(a) = (a \cup Sa], R(a) = (a \cup aS], \text{ and } I(a) = (a \cup Sa \cup aS \cup SaS].$$

A nonempty subset Q of a po -semigroup S is called a quasi-ideal of S (Kehayopulu, 1994, 74) if

(1) $(QS] \cap (SQ] \subseteq Q$ and

(2) if $a \in Q$ and $b \in S, b \leq a$, then $b \in Q$, that is if $(Q] = Q$.

An ordered semigroup (S, \cdot, \leq) is called regular if for every $a \in S$ there exist $x \in S$ such that $a \leq axa$, equivalently if $a \in (aSa]$ for every $a \in S$.

An ordered semigroup (S, \cdot, \leq) is called intra-regular if for every $a \in S$ there exist $x, y \in S$ such that $a \leq xa^2y$, equivalently if $a \in (Sa^2S]$ for every $a \in S$. A *po*-semigroup S is called left simple if S is the only left ideal of S . We say that a *po*-semigroup S decomposes as a semilattice of left simple *po*-semigroups if there exists a semilattice Y and a family $\{S_\alpha : \alpha \in Y\}$ of left simple *po*-subsemigroups of S such that:

1) $S_\alpha \cap S_\beta = \emptyset$ for all $\alpha \neq \beta$ in Y ,

2) $S = \cup \{S_\alpha : \alpha \in Y\}$,

3) $S_\alpha \cdot S_\beta \subseteq S_{\alpha\beta}$

The main results

The mechanism we mentioned in the introduction uses the embedding of an ordered semigroup into a *le*-semigroup developed from Kehayopulu, Pasku and Tsingelis in (Kehayopulu & Pasku & Tsingelis, 2006, 55). We will give below some details on how this embedding is done.

If (S, \cdot, \leq) is an ordered semigroup, then we can extend S to an ordered semigroup with a least element which is at the same time a multiplication zero. This is done by adding to S an element 0 and defining to $S^0 = S \cup \{0\}$ a new multiplication $*$ and a new order \leq_0 by

$$a * b = \begin{cases} ab & \text{if } a, b \in S \\ 0 & \text{if } a = 0 \text{ or } b = 0 \end{cases} \quad \text{and} \quad \leq_0 := \leq \cup \{(0, x) \mid x \in S^0\}$$

Now if (S, \cdot, \leq) is an ordered semigroup and $\emptyset \neq A \subseteq S^0$, we denote

$$(A]_0 := \{x \in S^0 \mid x \leq_0 y \text{ for some } y \in A\},$$

It is obvious that $(A]_0 := (A] \cup \{0\}$ where $(A] := \{x \in S \mid x \leq y \text{ for some } y \in S\}$

.Further we let

$$\Sigma = \{(A]_0 \mid \emptyset \neq A \subseteq S^0\}$$

In Σ define a multiplication \circ and a partial order \leq by

$$(A]_0 \circ (B]_0 := (A * B]_0 \text{ and } (A]_0 \leq (B]_0 \text{ iff } (A]_0 \subseteq (B]_0$$

It is proved in (Kehyopulu & Pasku & Tsingelis, 2006, 55) that $(\Sigma, \circ, \subseteq)$ forms a *le*-semigroup with the biggest element S where the meet and join are given by

$$(A]_0 \wedge (B]_0 = (A \cap B]_0, (A]_0 \vee (B]_0 = (A \cup B]_0$$

Also it is proved that (S, \cdot, \leq) embeds into $(\Sigma, \circ, \subseteq)$ by the map $a \mapsto (a]$.

The result of the following lemma is crucial in the rest of the paper.

Lemma 2.1. *If Q is a quasi-ideal of S , then $(Q]_0$ is a quasi-ideal element of Σ .*

Conversely, if $(Q]_0$ is a quasi-ideal element of Σ , then $Q = Q, \{0\}$ is a quasi-ideal of S .

Proof. For the if part we see that

$$\begin{aligned} (Q]_0 \circ S \wedge S \circ (Q]_0 &= (Q * S \cap S * Q]_0 && \text{from the definition of } \circ \text{ and of } \wedge \\ &\subseteq ((QS] \cap (SQ])_0 && Q \subseteq S, QS \subseteq (QS], SQ \subseteq (SQ] \\ &\subseteq (Q]_0 && Q \text{ is quasi-ideal.} \end{aligned}$$

For the converse we have

$$\begin{aligned} (Q'S] \cap (SQ'] &\subseteq ((Q'S] \cap (SQ'])_0 \\ &\subseteq ((Q * S]_0 \cap (S * Q]_0)_0 \\ &\subseteq (Q]_0 \circ S \wedge S \circ (Q]_0 && \text{from the definition of } \circ \text{ and of } \wedge \\ &\subseteq (Q]_0 && (Q]_0 \text{ is quasi-ideal element.} \end{aligned}$$

But $(Q'S] \cap (SQ'] \subseteq S$, hence $(Q'S] \cap (SQ'] \subseteq (Q'] = Q'$ proving the claim.

We remark that the above lemma holds true if we replace the word quasi-ideal by left (resp. right, two sided) ideal. The proof of this is similar to that of the above lemma and is omitted.

Let (S, \cdot, \leq) be a *po*-semigroup and $(\Sigma, \circ, \subseteq)$ the *le*-semigroup of (Kehyopulu & Pasku & Tsingelis, 2006, 55) where S embeds. We will denote by $Q(S)$ the set of all quasi-ideals of S and by $Q(\Sigma)$ the set of quasi-ideal elements of Σ .

Theorem 2.1. *A *po*-semigroup (S, \cdot, \leq) is regular if and only if $Q(S)$ forms a von Neumann regular semigroup.*

Proof. Assume that S is regular. We prove first that Σ is regular as well.

Indeed, let $(A]_0 \in \Sigma$ and $a \in (A]_0$. If $a = 0$, then $0 = a0a \in (ASA]_0$ proving that $0 \in (ASA]_0 = (A]_0 \circ S \circ (A]_0$. If $a \neq 0$, then $a \in S$ and as S is regular then there is $a' \in S$ such that $a \leq aa'a$. But $aa'a \in (ASA]_0 = (A]_0 \circ S \circ (A]_0$ proving that once

(1) $(QS] \cap (SQ] \subseteq Q$ and

(2) if $a \in Q$ and $b \in S, b \leq a$, then $b \in Q$, that is if $(Q] = Q$.

An ordered semigroup (S, \cdot, \leq) is called regular if for every $a \in S$ there exist $x \in S$ such that $a \leq axa$, equivalently if $a \in (aSa]$ for every $a \in S$.

An ordered semigroup (S, \cdot, \leq) is called intra-regular if for every $a \in S$ there exist $x, y \in S$ such that $a \leq xa^2y$, equivalently if $a \in (Sa^2S]$ for every $a \in S$. A *po*-semigroup S is called left simple if S is the only left ideal of S . We say that a *po*-semigroup S decomposes as a semilattice of left simple *po*-semigroups if there exists a semilattice Y and a family $\{S_\alpha : \alpha \in Y\}$ of left simple *po*-subsemigroups of S such that:

- 1) $S_\alpha \cap S_\beta = \emptyset$ for all $\alpha \neq \beta$ in Y ,
- 2) $S = \cup \{S_\alpha : \alpha \in Y\}$,
- 3) $S_\alpha \cdot S_\beta \subseteq S_{\alpha\beta}$

The main results

The mechanism we mentioned in the introduction uses the embedding of an ordered semigroup into a *le*-semigroup developed from Kehayopulu, Pasku and Tsingelis in (Kehayopulu & Pasku & Tsingelis, 2006, 55). We will give below some details on how this embedding is done.

If (S, \cdot, \leq) is an ordered semigroup, then we can extend S to an ordered semigroup with a least element which is at the same time a multiplication zero. This is done by adding to S an element 0 and defining to $S^0 = S \cup \{0\}$ a new multiplication $*$ and a new order \leq_0 by

$$a * b = \begin{cases} ab & \text{if } a, b \in S \\ 0 & \text{if } a = 0 \text{ or } b = 0 \end{cases} \quad \text{and} \quad \leq_0 := \leq \cup \{(0, x) \mid x \in S^0\}$$

Now if (S, \cdot, \leq) is an ordered semigroup and $\emptyset \neq A \subseteq S^0$, we denote

$$(A]_0 := \{x \in S^0 \mid x \leq_0 y \text{ for some } y \in A\},$$

It is obvious that $(A]_0 := (A] \cup \{0\}$ where $(A] := \{x \in S \mid x \leq y \text{ for some } y \in S\}$

.Further we let

corresponding element in Σ . The regularity of the latter implies that there is an $(A]_0 \in \Sigma$ such that

$$(a]_0 = (a]_0 \circ (A]_0 \circ (a]_0 = (\{a\} * A * \{a\}]_0,$$

which implies that there is $a' \in A$ such that $a \leq aa'a$, hence S is a regular *po*-semigroup.

Corollary 2. *A po-semigroup (S, \cdot, \leq) is regular and intra-regular if and only if $Q(S)$ forms a band.*

Proof. Assume that S is regular and intra-regular. From the proof of theorem 2.1 we know that Σ is a regular *le*-semigroup. Now we prove that Σ is intra-regular. Let $(A]_0$ be any non zero element of Σ and a be any non zero element of A . Since S is intra-regular, it follows that there are $x_a, y_a \in S$ such that $a \leq x_a a^2 y_a$ and then we have

$$(A]_0 \subseteq (X_A]_0 \circ (a^2]_0 \circ (Y_A]_0 = (X_A]_0 \circ (a]_0^2 \circ (Y_A]_0 \subseteq S \circ (a]_0^2 \circ S$$

where $X_A = \{x_a \mid a \in A\}$ and similarly $Y_A = \{y_a \mid a \in A\}$. This means that $(A]_0$ is intra-regular as claimed. Corollary of (Kehayopulu, 1994, 267) implies that $Q(\Sigma)$ is a band.

We will prove that this implies that $Q(S)$ is a band as well. Indeed, let Q be any quasi-ideal of S and let $(Q]_0$ be the corresponding quasi-ideal element in Σ which from above is idempotent, hence

$$(Q]_0 = (Q]_0 \circ (Q]_0 = (QQ]_0$$

Since $Q \subseteq S$ and $Q(S)$ forms a semigroup (cf. theorem 2.1), the above implies

$$Q = (Q] = (QQ] = QQ,$$

which proves that Q is an idempotent.

Conversely, assume that $Q(S)$ is a band and therefore a von Neumann regular semigroup in particular. Theorem 2.1 implies that S is regular. To prove that S is intra-regular we proceed as follows. We first prove that $Q(\Sigma)$ is a band. For this let $(Q]_0$ be any quasi-ideal element. Writing $Q' = Q$, $\{0\}$ we know from lemma 2.1 that Q' is a quasi-ideal of S which is assumed to be idempotent, hence $Q' = Q'Q'$. This implies easily that

$$(Q]_0 = (Q * Q]_0 = (Q]_0 \circ (Q]_0,$$

which proves that $(Q]_0$ is an idempotent. Corollary of (Kehayopulu, 1994, 267) implies that Σ is intra-regular. We will use this to prove that S is intra-regular as well. Let $a \in S$ and $(a]_0$ its corresponding element in Σ . The assumption for Σ implies that

$$(a]_0 \subseteq S \circ (a]_0^2 \circ S = S \circ (a^2]_0 \circ S,$$

from which we get that there are $x, y \in S$ such that $a \leq x_a a^2 y_a$. This obviously means that a is an intra-regular element thus finishing the proof.

Definition 2.1. A po-semigroup (S, \cdot, \leq) is called a semisimple if for every non empty subset A of S , we have $A \subseteq (ASASA]$.

Proposition 2.1. Let S be a po-semigroup, The following are equivalent:

- (1) The ideals of S are idempotent.
- (2) If I and J are ideals of S , then $I \cap J = (IJ]$.
- (3) For every $A, B \subseteq S, ((A)_r)_l \cap ((B)_r)_l = (((A)_r)_l \cap ((B)_r)_l]$.
- (4) For every $A \subseteq S, ((A)_r)_l = ((A)_r)_l^2$.
- (5) S is semisimple.

Proof. (1) \Rightarrow (2) If the ideals of S are idempotent, then ideal elements of Σ are idempotents. This follows easily from the correspondence of lemma 2.1 and the definition of \circ in Σ . Proposition 9 of (Kehayopulu, 2015, 74) applied to any pair of ideals I, J of S shows that

$$(I \cap J]_0 = (I]_0 \wedge (J]_0 = (IJ]_0,$$

From this we get

$$I \cap J = (IJ],$$

as claimed.

(2) \Rightarrow (3) This is obvious since $((A)_r)_l$ and $((B)_r)_l$ are ideals of S .

(3) \Rightarrow (4) This is obvious.

(4) \Rightarrow (5) Let $A \subseteq S$. From our assumption the ideal $(A \cup AS \cup SA \cup SAS]$ of S generated from A is an idempotent, hence an idempotent of Σ is its corresponding ideal element $(A \cup AS \cup SA \cup SAS]_0$ generated from $(A]_0$. Proposition 9 of (Kehayopulu, 2015, 74) implies that Σ is semisimple. Let $A \subseteq S$ and $(A]_0$ its corresponding element in Σ . Since the latter is semisimple, then

$$(A]_0 \subseteq S \circ (A]_0 \circ S \circ (A]_0 \circ S = (SASAS]_0.$$

from which we get that

$$A \subseteq (SASAS]$$

proving that S is semisimple.

(5) \Rightarrow (1) We prove that Σ is semisimple. Indeed, let $(A]_0 \subseteq \Sigma$ where $A \subseteq S^0$.

From our assumption for S applied for $A' = A$, $\{0\}$ we have that

$$A' \subseteq (SA'SA'S],$$

which implies that

$$(A]_0 \subseteq (S^0 * A * S^0 * A * S^0]_0 = S \circ (A]_0 \circ S \circ (A]_0 \circ S$$

proving the semisimplicity of Σ . Proposition 9 of (Kehayopulu, 2015, 74) implies that any ideal element of Σ has to be an idempotent. We prove that any ideal of S is an idempotent as well. Indeed, let I be an ideal of S and $(I]_0$ be the corresponding ideal element in Σ which is an idempotent, hence

$$(I]_0 = (I]_0 \circ (I]_0 = (I^2]_0,$$

which implies that

$$I = (I] = (I^2] = (I](I] = (I]^2 = I^2,$$

proving that ideals of S are idempotent.

Definition 2.2. Let (S, \cdot, \leq) be a po-semigroup. A non empty subset A of S is called a prime subset if for every pair of subsets A_1, A_2 of S , $A_1 A_2 \subseteq (A]$ implies that $A_1 \subseteq (A]$ or $A_2 \subseteq (A]$.

A subset A is called weakly prime if for every pair of ideals I, J of S , $IJ \subseteq (A]$ implies that $I \subseteq (A]$ or $J \subseteq (A]$. Finally, A is called semiprime if for any $B \subseteq S$, $B^2 \subseteq (A]$ implies that $B \subseteq (A]$.

The analogues of propositions 10, 11, theorem 12, propositions 13, 14, 15 and theorem 16 of (Kehayopulu, 2015, 74) hold true for po-semigroups.

Proposition 2.2. Let S be a po-semigroup. If the ideals of S are weakly prime, then they are idempotent and they form a chain.

Proof. Let us first show that every ideal element $(I]_0$ of Σ is weakly prime.

Indeed, assume $(I_1]_0 \circ (I_2]_0 \subseteq (I]_0$. If $I_1 = \{0\}$ or $I_2 = \{0\}$, then the result follows.

If non of the above equals zero, then take, I'_1, I'_2 and I' the corresponding ideals of S of lemma 2.1. Our assumption implies that $I'_1, I'_2 \subseteq I'$, from which we get that either $I'_1 \subseteq I'$ or $I'_2 \subseteq I'$ since ideals

of S are weakly prime. If for example $I'_1 \subseteq I'$, then it is clear that $(I_1]_0 \subseteq (I]_0$ proving that $(I]_0$ is weakly prime. Now proposition 10 of (Kehayopulu, 2015, 74) implies that every ideal element of Σ is idempotent. We prove that the same holds

true for ideals of S . Let I be any ideal of S and let $(I]_0$ its corresponding element in Σ for which we know that is an idempotent, so $(I]_0 = (I]_0 \circ (I]_0 = (I^2]_0$. This clearly implies $I = I^2$ proving that I is an idempotent. Again the fact that ideal elements of Σ are weakly prime and proposition 10 of (Kehayopulu, 2015, 74) imply that ideal elements of Σ form a chain.

We finally prove that the same holds true for ideals of S . Let I, J be ideals of S and $(I]_0, (J]_0$ be their corresponding ideal elements in Σ . If for instance $(I]_0 \subseteq (J]_0$, then obviously $I \subseteq J$ proving the claim.

Proposition 2.3. *Let S be a po-semigroup. If for any two ideals I, J of S , $I \cap J = (IJ]$ and the set of ideals form a chain, then each ideal is weakly prime.*

Proof. We prove first that for every two ideal elements $(I]_0, (J]_0$ of Σ , $(I]_0 \wedge (J]_0 = (I]_0 \circ (J]_0$. This is obviously true if any of the above ideal elements equals zero. If not, then take I', J' be the corresponding ideals of S . The assumption applied for I' and J' states that $I' \cap J' = (I'J']$ and this clearly implies

$$(I]_0 \wedge (J]_0 = (I' \cap J']_0 = (I'J']_0 = (I * J]_0 = (I]_0 \circ (J]_0,$$

proving the claim. Secondly, since the ideals of S form a chain, the ideal element of Σ form a chain too. Indeed, if $(I]_0$ and $(J]_0$ be two non zero ideal elements of Σ and I', J' be the respective ideals of S , then from the assumption $I' \subseteq J'$ or $J' \subseteq I'$. In either case we obtain that $(I]_0 \subseteq (J]_0$ or $(J]_0 \subseteq (I]_0$. Now Σ satisfies both the conditions of proposition 11 of (Kehayopulu, 2015, 74) hence its ideal elements are weakly prime. We will use this to prove that the same holds true for the ideals of S . Let I be an ideal of S and I_1, I_2 a pair of ideals of S such that $I_1 I_2 \subseteq I$. It follows that

$$(I_1]_0 \circ (I_2]_0 = (I_1 * I_2]_0 = (I_1 I_2]_0 \subseteq (I]_0,$$

This and the assumption imply that for instance, $(I_1]_0 \subseteq (I]_0$, hence $I_1 \subseteq I$ proving the claim.

The following is a combination of propositions 2.1, 2.2 and 2.3.

Theorem 2.2. *Let S be a po-semigroup. The ideals of S are weakly prime if and only if they form a chain and one of the five equivalent conditions of proposition 2.1 is satisfied.*

Proposition 2.4. *A po-semigroup S is intra regular if and only if the ideals of S are semiprime.*

Proof. From the proof of corollary 2.1 we know that if S is intra regular then Σ is such. Proposition 13 of (Kehayopulu, 2015, 74) implies that the ideal elements of Σ are semiprime. Now let I be an ideal of S and $(I]_0$ its corresponding ideal element of Σ . If $B \subseteq S$ such that $B^2 \subseteq I$, then for $(B]_0$ we have that $(B]_0^2 = (B^2]_0 \subseteq (I]_0$, hence from above we get that $(B]_0 \subseteq (I]_0$. This implies that $B \subseteq I$.

Conversely, if the ideals of S are semiprime, then the ideal elements of Σ are such. Indeed, let $(I]_0$ be an ideal element of Σ and $(B]_0$ such that $(B * B]_0 = (B]_0^2 \subseteq (I]_0$. For $B' = B$, $\{0\}$ and the ideal $I' = I$, $\{0\}$ of S we have that $B'^2 \subseteq I'$. The assumption for S then implies that $B' \subseteq I'$, hence $(B]_0 \subseteq (I]_0$. Now proposition 13 of (Kehayopulu, 2015, 74) implies that Σ is intra regular and then from the proof of corollary 2.1 we see that S is intra regular.

Proposition 2.5. *Let S be a po-semigroup. If the ideals of S are prime, then they form a chain and S is intra regular.*

Proof. If the ideals of S are prime, then they are weakly prime and semiprime, hence from proposition 2.2 the ideals form a chain. Further, since the ideals are semiprime, then from proposition 2.4 S is intra-regular.

Proposition 2.6. *Let S be an intra regular po-semigroup. If the ideals of S form a chain, then they are prime.*

Proof. The proof of proposition 2.3 shows that if the ideals of S form a chain, then the ideal elements of Σ form a chain too. Proposition 15 of (Kehayopulu, 2015, 74) then implies that the ideal elements of Σ are prime. We prove that it follows from this that the same holds true for the ideals of S . So let I be an ideal of S and $A, B \subseteq S$ such that $AB \subseteq I$. It follows that

$$(A]_0 \circ (B]_0 = (A * B]_0 = (AB]_0 \subseteq (I]_0,$$

hence $(A]_0 \subseteq (I]_0$ or $(B]_0 \subseteq (I]_0$. In either case we would have that $A \subseteq I$ or $B \subseteq I$ finishing the proof.

As a combination of propositions 2.5 and 2.6 we obtain the following.

Theorem 2.3. *Let S be a po-semigroup. The ideal elements of S are prime if and only if they form a chain and S is intra regular.*

The result of theorem 2.3 holds true if the order relation in the po-semigroup there is just the equality, or in other words if S is a plain semigroup. It is clear that in this case our concept of prime ideals coincide with the usual concept of prime ideals in semigroup theory and an intra regular po-semigroup with the order being the equality is just an intra regular semigroup in the usual sense. From this remark we get as a corollary a result of Szasz in (Szasz, 1970, 209).

Corollary 2.2. *Let S be a semigroup. The ideals of S are prime if and only if they form a chain and S is intra regular.*

The authors of the present paper have studied in their previous preprint (Shasivari & Pasku, 2015, arXiv) those le -semigroups in which every two left ideal elements commute. This condition is called there Λ . They have proved among other things that semisimple le -semigroups that satisfy Λ are characterized as those le -semigroups in which the decomposition into \mathcal{J} -classes forms a semilattice of left simple $\vee e$ -semigroups. It is claimed that Λ is a natural condition and to support this claim it is mentioned the similarity of Λ to that of theorem 6 (2) of (Kehayopulu & Tsingelis, 2013, 411) which gives eight equivalent characterizations of po -semigroups which decompose as semilattices of left simple semigroups. It turns out that the above mentioned similarity is not merely a coincidence but an example of a deeper connection that exists between po -semigroups and le -semigroups.

To this end we prove the following.

Theorem 2.4. *A po -semigroup S is a complete semilattice of left simple semigroups if and only if Σ in which S embeds is semisimple and satisfies the condition Λ .*

Proof. From theorem 6 (2) of (Kehayopulu & Tsingelis, 2013, 411) S has to satisfy the following property: if L_1, L_2 and L are left ideals, then $(L_1L_2] = (L_2L_1]$ and $(L^2] = L$. It follows that Σ is semisimple. Indeed, from proposition 9 of (Kehayopulu, 2015, 74) we have to prove that every ideal element of Σ is idempotent. Let $(I]_0$ be an ideal element in Σ and let I' be its corresponding ideal of S for which we know that $(I'^2] \subseteq I'$.

Turning back to Σ we have for $(I]_0$ that

$$(I]_0^2 = (I]_0 \circ (I]_0 = (I']_0 \circ (I']_0 = (I' * I']_0 = (I'I']_0 = (I']_0 = (I]_0,$$

proving that it is an idempotent. We proceed by showing that Σ satisfies Λ . For this let $(L_1]_0, (L_2]_0$ be two left ideal elements of Σ and L'_1, L'_2 be their corresponding left ideals of S . We know that $(L'_1L'_2] = (L'_2L'_1]$. For their counterparts in Σ we have

$$\begin{aligned} (L_1]_0 \circ (L_2]_0 &= (L'_1]_0 \circ (L'_2]_0 = (L'_1 * L'_2]_0 \\ &= (L'_1L'_2]_0 = (L'_2L'_1]_0 && \text{from the above} \\ &= (L'_2 * L'_1]_0 = (L'_2]_0 \circ (L'_1]_0 = (L_2]_0 \circ (L_1]_0 \end{aligned}$$

which proves Λ .

Conversely, assume that Σ is semisimple and satisfies Λ and want to prove that S satisfies (2) of theorem 6 (Kehayopulu & Tsingelis, 2013, 411). We first observe that

in le -semigroups satisfying Λ any left ideal element is a right ideal element as well and so an ideal element. Let now L be a left ideal of S and let $(L]_0$ be its corresponding left ideal element in Σ which from the above observation is also an ideal element hence an idempotent from the assumptions. So

$$\left(L^2 \right]_0 = (L * L]_0 = (L]_0 \circ (L]_0 = (L]_0,$$

which shows that $\left(L^2 \right] = (L] = L$.

Further if we are given L_1, L_2 left ideals of S and want to prove that $(L_1 L_2] = (L_2 L_1]$. Take the corresponding left ideal elements $(L_1]_0$ and $(L_2]_0$ in Σ which from our assumption commute and so

$$\left(L_1 L_2 \right]_0 = (L_1]_0 \circ (L_2]_0 = (L_2]_0 \circ (L_1]_0 = \left(L_2 L_1 \right]_0,$$

which shows that $(L_1 L_2] = (L_2 L_1]$ thus finishing the proof

References

- Kehayopulu, N., (1994), *Remarks on ordered semigroups*, Abstracts AMS.
- Kehayopulu, N., (1994) *On regular le-semigroups*, S. Forum.
- Kehayopulu N, Tsingelis M., (2013), *On ordered semigroups which are semilattices of left simple semigroups* Mathematica Slovaca.
- N. Kehayopulu, E. Pasku, M. Tsingelis, (2006), *An embedding of an ordered groupoid into a le-groupoid*, S. Forum.
- Kehayopulu N., (2015), *Remark on quasi-ideals of orderend semigroups*, PU. M.A.
- Kehayopulu N.(2015), *On le-semigroups*, Turk J. Math.
- Petro P, Pasku E., (2002), *The Green-Kehayopulu relation \square in le-semigroups*. Semigroup Forum.
- Shasivari A, Pasku E, (2015), *A note on the relation \mathcal{J} in le-semigroups*, arXiv [math.RA].
- Szasz G., (1970), *Eine charakteristik der primidealhalbgruppen*. Publ Math De-brecen.

Self-expression values and freedom in post-communist Albania

Dr. Ina K. Zhupa
European University of Tirana

Abstract

Self expression values create citizens who have tolerance to diversity, self-expression in public, they can hold public positions, they are inclined toward freedom and participation and are characterized by interpersonal trust. Values change as a result of other changes, especially economic ones, but not so fast and immediate like in other areas. Inglehart explains that the change of values is a result of greater economic development, an economic development in a society influence to fulfill the basic requirements that people have to live, and in this way they have the tendency to require for another value orientation. (Inglehart,1997). The changes that took place in Albania in the economic, political and social field, after the fall of communism and the phases of democratic construction will be reflected in the value patterns. The increase of the self expression values among the people makes possible to gain a sense of autonomy that leads to question the unlimited authority over them and makes them be receptive to ideas of individual freedom and equality. The link between freedom and self expression is clearly strong, and this paper try to explain the situation in Albania. Based on a quantitative methodology, surveys have been conducted to understand the values, under the model used by Ronald Inglehart. These data are analyzed in this paper and bring us the view of freedom and the measure of self expression values. Analysis of these data will help us to understand better what kind of values we share in relation to the conception of freedom in albanian society.

Keywords: freedom, liberties, self expression, values, post-communism. Albanian society.

Hyrje

Njerëzit në të shumtën e herëve marrin vendime e kryejnë veprime të ndryshme duke u orientuar më shumë nga emocionet e gjykimet vlerore se sa të nisur nga një bazë e mirfilltë logjike, domethënë racionale e pastër. Po ashtu testimi e njohja e ndryshimeve vlerore në shoqëri shërben për të treguar se ku po shkon shoqëria në fjalë, çfarë problemesh e përfytyrimesh ka ajo në përgjithësi për të ardhmen e saj, gjë që shprehet mjaft mirë në vlerat e saj, duke e ditur se shpesh një shoqëri e caktuar orientohet nga vlera të cilat i mendon si tepër të rëndësishme për të. Vlerat e zgjedhura plotësojnë instiktin si motor i njerëzve. Nëse nuk ka vlera, sjellja njerëzore nuk ka drejtim, është kaotike dhe vetëshkatërruese. Vlerat personale janë shumë të rëndësishme, pa vlera nuk mund të jetohet dhe aq më pak të kesh një ekzistencë të kënaqshme dhe plotësuese. Për rëndësinë e vlerave flet edhe studiuesi Angell, ku sipas tij vlerat i japin kuptim ekzistencës së shoqërisë “përbërësi më i rëndësishëm për ta bërë jetën në grup për çdo anëtar të dobishme është masa në të cilën ata kanë një set të përbashkët vlerash dhe qëllimesh, drejt të cilave të gjithë janë të orientuar dhe sipas së cilave është organizuar edhe jeta në grup” (Angell, 1951:2). Markus S. Schulz thotë që studimi i vlerave është jo vetëm i rëndësishëm për kohezionin social por gjithashtu edhe për transformimin social. Ai po ashtu shton se

studimi i vlerave mund të luaj një rol të rëndësishëm edhe në përmirësimin e cilësisë së jetës (Bachika, Schulz, 2011). Vlerat janë parë si një nga faktorët determinues për sjelljen e individëve (Rokeach, 1973; Super, 1990) si të tilla ja vlen që të studiohen jo vetëm për të kuptuar sjelljen e individëve, por ç'është më e rëndësishme për ta parashikuar atë, në mënyrë të tillë që shoqëria mos të gjendet përpara problemeve madhore por ti asimiloj ato duke i parakuptuar dhe zbutur në kohën e duhur Nikollai Hartman thotë: "Njeriu është një qenie që i përket njëkohësisht dy botëve, asaj reale, me ligjet e saj ontologjike dhe botës së vlerave që përbëhet nga kërkesat për të bërë diçka. Te kjo e fundit një sjellje mund të konsiderohet e mirë apo e keqe vetëm kur ajo buron nga liria e mendimit dhe e veprimit" (Hartmann, 1965:267). Në këtë thënie gjejmë të theksuar idenë se nuk mund të kemi vlera absolute përderisa vetë vlera është një formë e shfaqur e lirisë njerzore, ne kemi të drejtë të zgjedhim atë çka përbën vlerë për ne. Në këtë kuptim mund të themi që nuk bëjmë dot gjykim vleror mbi individin apo shoqërinë, në rast se subjektit të gjykuar i mungon liria e mendimit dhe e veprimit. Prandaj studimi i vlerave ka kuptim në postkomunizmin shqiptar, ku ekziston liria e mendimit dhe e veprimit.

Metodologjia

Si fillim duhet thënë ky punim ka limitimin e tij territorial që lidhet me rastin studimor të popullsisë mbi 15 vjeç të Tiranës. Metodologjia e përgjedhur janë metodat sasiore si gjithmonë në shërbim të kërkimit tonë, duke tentuar të masin sa e kanë ndjenjën e lirisë për të marr përgjegjësi mbi vete dhe për të rrezikuar që del nga niveli i vlerave të vetafirmimit që kanë të anketuarit.

Ideja është që punimi të mund të flas për shoqërinë shqiptare por mundësia për ta kryer në gjithë Shqipërinë ishte e pamundur në kuadër të nevojave të shumta për burime njerzore, për burime financiare, për burime materiale. Kufizime këto objektive dhe që nuk mund të zgjidheshin pavarësisht vullnetit apo dëshirës. Zgjidhja u mendua të ishte Tirana dhe kjo zgjidhje ishte jo sepse mund të quhet më e afërta falë punësimit dhe jetësën këtu por sepse ne besojmë që një studim i kryer sipas rregullave të metodave kërkimore në Tiranë mund të na jap rezultate që ne mund të kemi të drejtë që ti përgjithësojmë më pas për gjithë shoqërinë. Arsyet pse mendojmë se Tirana mund të shërbej me rezultatet e saj për shoqërinë shqiptare: Së pari sepse duke u bazuar nga CENSUSI i fundit i bërë në vendin tonë nga INSTAT në Tiranë jetojnë 1/3 e popullsisë së vendit tonë (Census, 2012: 134). Së dyti, parë nga pikëpamja demografike duke u nisur nga migrimi i brendshëm i këtyre viteve të demokracisë, Tirana përfaqëson një lloj konglomerati që i përkasin subkulturave të ndryshme nisur nga zonat në të cilat kanë jetuar dhe së fundmi Tirana është e vetmja që të ofron akses të lehtë infrastrukturor për të mundësuar lëvizjen dhe mundësinë për të ndaluar njerëzit në rrugë dhe për të marrë përgjigje nga ta.

Kampionimi i përdorur është kampionimi me kuota. Sipas metodave kërkimore, "një kampionim me kuota është një lloj tepër i përdorshëm i kampionimit me strate, në të cilin ne përzgjedhim njesitë në renditjen në të cilën ato ndodhen në popullsi, por që imponon shtrengesën që vetëm një farë numri nga çdo prej nëngrupeve të specifikuar të jetë përzgjedhur" (Kocani, 2006:63)

Anketa është përdorur e përkthyer edhe e përshtatur në shqip, sipas modelit të anketimit të Inglehart që është modeli jonë referues për matjen e vlerave. Në

anketimin maten edhe boshtet e tjera vlerore por në këtë paper merren parasysh vetëm pjesa e lidhur me këtë studim.

Liria ne vlerat e veteafirmimit ne Shqiperi

Vlera të vetëafirmimit lidhen me vlera që shprehin sindromën e besimit, të tolerancës, mirëqënien subjektive, aktivizmi politik, të pranimit të diversitetit, të të huajit dhe të ndryshimit, duke ndjerë edhe një nivel të lartë sigurie (Inglehart, Baker, 2000). Vlerat e vetëafirmimit krijojnë qytetarë që kanë tolerancë për të ndryshmen, vetëshprehje në publik, pra mbajnë qëndrime publike, janë të prirur drejt lirisë dhe pjesmarrjes dhe karakterizohen nga besim ndërpersonal. Prirja drejt lirisë është edhe elementi bazë që bën të mundur marrëdhënien e pashmangshme me demokracinë efektive. Sepse kur njerëzit kanë vlerat e vetëafirmimit janë të prirur të kërkojnë më shumë nga vetja dhe nga tjetri, nuk kanë frikë nga ndryshimi, duan të jenë të lirë në zgjedhjet e tyre dhe të pandikuar nga asnjë formë autoriteti. E kundërta e tyre janë vlerat e mbijetesës. *Vlera të mbijetesës* lidhen me vlera që i japin më shumë rëndësi sigurisë ekonomike dhe fizike përmbi qëllimeve të tjera dhe ndjehen të kërcënuar nga të huajt, nga diversiteti etnik dhe ndryshimi kulturor. (Inglehart, Baker, 2000)

Fillimisht në kuadër të vetëperceptimit dhe mënyrës së si njerëzit e shikojnë veten e tyre dhe jetën që janë duke bërë, ju drejtuan edhe pyetje në lidhje me kënaqësinë njëherë nga të ardhurat dhe njëherë nga jeta që bënin, duke ju dhënë mundësinë që të përgjigjeshin në një shkallë më të gjërë nga 1- 10. “Në ç’masë jeni i kënaqur ose jo nga gjëndja financiare e familjes tuaj? Në se jeni krejt i pakënaqur zgjidhni 1 ose një numër afër 1, në se jeni krejt i kënaqur zgjidhni 10 ose një numër afër 10. Ju mund të zgjidhni numrat e ndërmjetëm për të nuancuar opinionin tuaj”

Aspak i kënaqur shumë i kënaqur
 01 02 03 04 05 06 07 08 09 10

Përgjigjet 1 deri në 4 i klasifikojmë në krahun atyre që mbartin vlerat e mbijetesës, ndërsa përgjigjet nga 7 deri në 10 i klasifikojmë në krahun e atyre që mbartin vlerat e vetëafirmimit. Të anketuarit janë përgjigjur në krahun e mbijetesës në masën 26.2% dhe në krahun e vetëafirmimit në masën 41%. Për secilën mundësi përgjigje në tabelë gjejmë përqindjen e sakta:

kënaqësi nga të ardhurat	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	Nuk e di	Pa përgjigje
përqindja	3.7	3.7	6.1	12.7	15.6	17.2	15.6	12.3	6.1	7.0	0	0

Në lidhje me kënaqësinë pyetje tjetër ishte: “Në përgjithësi në ç’masë jeni i kënaqur apo i pakënaqur nga jeta që bëni në këtë çast?”

Aspak i kënaqur shumë i kënaqur
 01 02 03 04 05 06 07 08 09 10

E njëjta llogjikë e dekriptimit të përgjigjeve vlen edhe në këtë pyetje në lidhje me klasifikimin në një bosht vleror ashtu si në kënaqësinë nga të ardhurat. Këtu gjejmë që 19.2% janë përgjigjur në krah të vlerave të mbijetesës dhe 54.2% në krah të vlerave të vetëafirmimit. Tabela na njeh me të gjitha variacionet në përqindje të përgjigjeve të së anketuarve:

kënaqësi nga jeta	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	Nuk e di	Pa përgjigje
përqindja	2.9	2.9	4.1	9.9	15.7	10.3	17.8	20.7	7.0	8.7	0	0

Pyetjet e tjera dalin nga vetëperceptimi dhe pyesin konkretisht për qëndrimet edhe mendimet e të anketuarve. “Në përgjithësi, a do të thonit që mund t’i besohet shumicës së njerëzve apo që duhet të jesh i kujdesshëm kur ke të bësh me të tjerët? 1. Mund t’i besohet shumicës së njerëzve; 2. Duhet të jesh i kujdesshëm; 88. Nuk e di; 99. Pa përgjigje. Kjo ishte pyetja tjetër, që dedekton vlerat, nëse përgjigjet janë se mund ti besohet shumicës së njerëzve kemi vlera të vetë afirmimit, ndërsa duhet të jesh i kujdesshëm kemi vlera të mbijetesës. Tabela na jep përqindjen e sakta duke na treguar anim në 93% nga mbijetesja.

Besimi	Mund ti besosh shumicës	Duhet të jesh i kujdesshëm	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	5.8	93.0	0.8	0.4

Ndërkohë personat që mbartin vlerat të mbijetesës janë më të prirur që ndjejnë frikë se mund të humbasin vendin e tyre të punës, frikë se mund të kenë një ulje të nivelit të tyre të jetesës. Nuk është e rëndësishme nëse kjo frikë është e barazuar në realitetin e vështirë ekonomik të përgjithshëm, apo është thjesht një perceptim mbi realitetin e vështirë ekonomik. Sigurisht kjo është e lidhur me atë që këta persona e konsiderojnë punën si të rëndësishme në jetën e tyre. Ndërsa personat që mbartin vlerat e vetëafirmimit janë më të prirur për të mos pasur frikë se mund të humbasin punën ose se mund të kenë ulje të nivelit të tyre të jetesës.

Pyetja e parë në lidhje me këtë ishte: “A keni frikë se së afërmi do të humbni apo duhet të ndryshoni vendin e punës?” 1. Jo; 2. Po, kam frikë se do humbas vendin e punës; 3. Po, kam frikë se duhet të ndryshoj vendin e punës; 4. Nuk punoj 88. Nuk e di; 99. Pa përgjigje. Nga përgjigjet e të anketuarve doli që 51.4% nuk kanë frikë se mund të humbin apo të duhet ta ndryshojnë vendin e punës, përgjigje kjo në krahun e vlerave të vetëafirmimit, dhe në krahun e mbijetesës që përgjigjen po, pavarësisht nëse e humbin apo e ndryshojnë janë 28%. Mirëpo siç do ta shikojmë edhe nga tabela e përqindjeve më poshtë tek përgjigjet vëmë re që 11.9% janë pa punë dhe nuk i klasifikojmë dot, ndërsa një përqindje që nuk haset në pyetjet e tjera janë përgjigjur pa përgjigje, dmth 6.2% kanë thënë që nuk duan të japin përgjigje për këtë pyetje. Që në fakt ne mund të aludojmë që kjo mund të jetë një lloj frike tjetër që lidhet me humbjen e vendin të punës, sepse ata që ishin pa punë cilësohen si të tillë, edhe dalin edhe nga pyetjet e tjera të anketës që kërkon ku punojnë, të ardhurat etj. Këta që përgjigjen, me opsionin pa përgjigje janë të punësuar por mesa duket frika është më e madhe sesa thjesht ta thuash. Ky është një aludim dhe nuk supozon që ne gjetem aryen e vërtetë se përsenë janë përgjigjur kështu por ama nuk mund ta lëmë pa thënë që duke matur përgjigjet nuk e di, nuk punoj dhe pa përgjigje arrijmë në 20.6%. Që nëse do ti bashkangjiteshin këto shifra njëri nga krahëve të boshteve vlerore do na ndryshonin panoramën që na paraqitet. Tabela tregon konkretisht rezultatet:

Frikë për punën	JO	Po kam frikë se do e humbas do e ndryshoj	Po kam frikë se do e ndryshoj	Nuk punoj	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	51.4	21.8	6.2	11.9	2.5	6.2

Ndërsa pyetja tjetër lidhet me frikën për uljen e nivelit të jetesës: “A keni frikë se së afërmi do të keni një ulje të nivelit tuaj të jetesës?” 1. Po; 2. Jo; 88. Nuk e di; 99. Pa

përgjigje. Kësaj pyetje janë përgjigjur 42.9% po, një drejtim që të çon drejt vlerave të mbijetesës, ndërsa 47.8% janë përgjigjur me jo, një drejtim që të çon drejt vlerave të vetëafirmimit. Përsëri vëmë re një përqindje të konsiderueshme për opsionin nuk e di dhe pa përgjigje që sëbashku shkojnë në 9.3%. Tabela na njeh me rezultatet:

Frikë nga ulja e nivelit të jetesës	PO	JO	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	42.9	47.8	8.2	1.1

“Në ç’masë mendoni se keni lirinë për të zgjedhur dhe kontrollin mbi jetën tuaj?” ishte një nga pyetjet e anketës duke ju dhënë mundësinë që të përgjigjeshin në një shkallë nga 1 deri në 10, ku 1 fillonte me aspak dhe kuptohej një shkallë rritëse deri në 10 ku ishte shumë. Sigurisht edhe opsionet nuk e di dhe pa përgjigje. Ku përgjigjet nga 1 deri në 4(përfshirë) na indikojnë për mundësinë e vlerave të mbijetesës dhe nga 7 deri në 10(përfshirë) na indikojnë për mundësinë e vlerave të vetëafirmimit. Në analizë të këtyre na del që 6.9% mund të klasifikohen nga përgjigjet e tyre në krah të boshtit të vlerave të mbijetesës dhe 77.2% e tyre në krahun e vlerave të vetëafirmimit, ndërsa kemi 19.6% që qëndrojnë në mes të këtyre dy prirjeve. Tabela e mëposhtme na njeh me përgjigjet për secilën nga nivelet e shkallës 1-10.

Liri dhe kontrolli në jetën tuaj	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	Nuk e di	Pa përgjigje
përqindja	1.2	0.4	4.1	1.2	11.8	7.8	10.6	15.9	10.6	35.1	0.8	0.4

Tashmë të anketuarve ju bëhen pyetje në lidhje me lirinë për të qënë pjesmarrës edhe për të marr pjesë në vendimarrjet politike. Të anketuarve ju paraqit një listë me aktivitete të ndryshme politike sic është peticioni, bojkoti, greva etj dhe për këto u kërkua që të mund të cilësonin nëse tashmë e kanë bërë një gjë të tillë, nëse do ta bënin, ose nëse s’do ta bënin kurrë. Vlerat aktuale na dalin tek pjesa nëse e kanë bërë një gjë të tillë deri sot ose nuk e kanë bërë, nëse e kanë bërë atëherë mbartin vlera të vetëafirmimit, nëse nuk e kanë bërë atëherë mbartin vlera të mbijetesës. Nëse pjesa tjetër e pyetjes është për të parë nëse në një të ardhmen do ta bënin ose sdo ta bënin kurrë një veprimtari të tillë politike duke na ndihmuar neve të kuptojmë nëse do të anojnë nga vlerat e mbijetesës apo nga ato të vetëafirmimit në të ardhmen. Pyetja konkretisht ishte: Këtu keni një listë me disa forma të veprimtarisë politike dhe për secilën do të na thoni nëse tashmë e keni bërë, nëse do të mund ta bënit, ose nëse nuk do ta bënit, cilatdoqofshin rrethanat?”

- Nënshkrimi një peticion
- Pjesëmarrje në një bojkot
- Pjesëmarrje në një manifestim të lejuar
- Pjesëmarrje në grevë spontane
- Urëmbim armësh dhe rebelim ndaj shtetit

Realiteti i këtyre viteve të tranzicionit demokratik i ka dhënë mundësinë shqiptarëve që të mund të merrnin pjesë në secilën nga këto veprimtari politike, qoftë edhe atë më ekstremen të rrëmbimin të armëve dhe rebelimin ndaj shtetit nëse sjellin ne mend vitin 1997. Fillojmë me nënshkrimin e një peticioni, duke parë në rradhë të parë vlerat e sotme dhe më pas tendencën për të ardhmen dhe në këtë mënyrë do veprojmë me të gjitha veprimtaritë. Kësaj pyetje 30% i janë përgjigjur që tashmë e kanë bërë në krahun e vlerave vetëafirmimit, që do të thotë që pjesa tjetër prej 65.9% (në këtë rast

përqindjen e nxjerrim duke mbledhur së bashku ata që janë përgjigjur do ta bëja ose sdo ta bëja kurrë, dhe duke mos marrë në konsideratë ata që janë përgjigjur nuk e di ose pa përgjigje, e njëta metodë do të jetë për çdo përgjigje të tillë në veprimtaritë e tjera që do shqyrtojmë më pas) nuk e kanë bërë ndonjëherë këtë gjë që qëndrojnë në krahun e vlerave të mbijetesës.

Peticion	Tashmë e kam bërë	Nuk e kam bërë
Përqindja	30	65.9

Nga qytetarët që nuk e kanë bërë një peticion (pra duhet të kujtojmë që kjo pjesë mbart aktualisht vlera të mbijetesës dhe ne kështu duam të kuptojnë nëse do mund të ndryshojnë apo do qëndrojnë në krahun që janë) shprehen 53.1% që do ta bënin me vlera të pritshme vetëafirmimi dhe 12.8% që nuk do ta bënin kurrë, me vlera të pritshme mbijetese. Tabela e mëposhtme na përmbledh rezultatin:

Peticion	Tashmë e bërë	Do ta bëja	S'do ta bëja kurrë	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	30.0	53.1	12.8	3.3	0.8

Veprimtaria tjetër është pjesmarrje në një bojkot, të anketuarit janë përgjigjur 14.5% që tashmë e kanë bërë një gjë të tillë, duke na dhënë neve përkatësinë tek vlerat e vetëafirmimit dhe 74.8% nuk e kanë bërë një gjë të tillë, duke na dhënë neve përkatësinë tek vlerat e mbijetesës.

Bojkot	Tashmë e kam bërë	Nuk e kam bërë
Përqindja	14.5	74.8

Ata që nuk e kishin bërë tashmë një bojkot janë shprehur 50% e tyre që do ta bënin pra drejt vlerave të vetëafirmimit dhe 24.8% e tyre që nuk do ta bënin kurrë pra drejt vlerave të mbijetesës. Tabela e mëposhtme na tregon rezultatet e plota për këtë veprimtari:

Bojkot	Tashmë e bërë	Do ta bëja	S'do ta bëja kurrë	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	14.5	50.0	24.8	9.5	1.2

E treta në listë është pjesmarrja në një manifestim të lejuar, për këtë 27.3% e të anketuarve janë përgjigjur që tashmë e kanë bërë, duke treguar vlera të vetëafirmimit dhe 67.8% nuk e kanë bërë, nuk kanë marrë pjesë një manifestim të lejuar, duke treguar vlera të mbijetesës.

Manifestim i lejuar	Tashmë e kam bërë	Nuk e kam bërë
Përqindja	27.3	67.8

Kjo pjesë që nuk ka marrë pjesë në një manifestim të lejuar, 55% e tyre shprehën që do ta bënin një gjë të tillë që treguan mundësinë për adaptimin e vlerave të vetëafirmimit dhe 12.8% shprehën që nuk do ta bënin kurrë duke treguar persistencë në vlerat e tyre të mbijetesës. Tabela na jep rezultatet:

Manifestim i lejuar	Tashmë e bërë	Do ta bëja	S'do ta bëja kurrë	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	27.3	55.0	12.8	3.7	1.2

Më pas kemi pjesmarrje në një grevë spontane, ku të anketuarit janë shprehur që

tashmë e kanë e bërë 13.2% e tyre duke treguar vlera të vetëafirmimit dhe që nuk e kanë e bërë 74% duke treguar vlera të mbijetesës.

Greve spontane	Tashmë e kam bërë	Nuk e kam bërë
Përqindja	13.2	74

Duke menduar që greva dhe më pas rrëmbimi i armëve janë veprimtari deri diku ekstreme, që nuk ndodh shpesh dhe nuk mund të jetë vendim që domosdoshmëri mund ti ketë lindur nevoja që ta merrnin të anketuarit. Atëherë ne gjykojmë si studiues që për këto dy veprimtari, pjesa nëse do ta bëjë ose sdo ta bëja kurrë na tregon për vlera të tashme dhe jo vetëm të asaj që do të jetë në të ardhmen si në rastin e veprimtarive më lart. Kështu ata që tashmë nuk e kishin bërë një grevë janë shprehur që do ta bënin 26.9% e tyre që tregojnë vlera të vetëafirmimit dhe 47.1% që nuk do ta bënin kurrë duke na treguar përsëri persistencë në vlerat e mbijetesës. Rezultatet konkrete në tabelë:

Grevë spontane	Tashmë e bërë	Do ta bëja	S'do ta bëja kurrë	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	13.2	26.9	47.1	10.3	2.5

E fundit është pjesmarrja në një rrëmbim armësh dhe rebelim ndaj shtetit, si një formë ekstreme por e njohur e veprimtarisë politike të qytetarit. Ndoshta ky konsiderim si ekstreme na ka bërë që të merrnin edhe përgjigje ekstremisht në krahun e vlerave të mbijetesës qoftë në gjykimin mbi ata që kanë bërë ose jo, qoftë nëse do ta bënin ose sdo ta bënin kurrë. Vetëm 5.4% e kanë bërë tashmë duke treguar vlera të vetëafirmimit, pavarësisht se konteksti në të cilin ndodhi, shkaqet etj vlejnjë për një analizë të thelluar, e rëndësishme është që konsiderohet formë reagimi kur qeverisja nuk të garanton liritë e tua dhe 84.4% nuk e kanë bërë një gjë të tillë duke qëndruar në anën e vlerave të mbijetesës.

Rrëmbim armësh	Tashmë e kam bërë	Nuk e kam bërë
Përqindja	5.4	84.4

Nga kjo mazhorancë absolute në drejtim të vlerave të mbijetesës, vetëm 5% shprehen që do ta bënin duke dhënë shenjat për vlera të vetëafirmimit dhe përsëri mazhoranca ruhet me 79.8% që shprehen që nuk do ta bënin kurrë një gjë të tillë. Në tabelë gjejmë rezultatet:

Rrëmbim armësh	Tashmë e bërë	Do ta bëja	S'do ta bëja kurrë	Nuk e di	Pa përgjigje
Përqindja	5.4	5.0	79.8	6.2	3.7

Përfundime

Duke parë rezultatet e pyetjeve që ishin të lidhura me ndjenjën e lirisë edhe vlerat e vetëafirmimit në shoqërinë shqiptare postkomuniste mund të arrijmë në konkluzionin që:

Kur të anketuarve ju lihet të vetëpërcaktohen se si do ta gjykonin veten e tyre përgjigjet e tyre anojnë nga boshti i vlerave të vetëafirmimit. Pra ata kanë dëshirën e brendshme edhe nevojën për të përjetuar lirinë edhe për ta quajtur veten të lirë në zgjedhjet e tyre, në jetën e tyre të përditshme.

Kur të anketuave ju bëhen pyetje konkrete nëse e kanë bërë ose jo një veprim, nëse do

ta bënin ose jo, nëse kanë frikë ose jo përgjigjet e tyre anojnë nga vlerat e mbijetësës dhe jo nga ata të vetëafirmimit. Pra në këtë rast ndjenja e lirisë nuk shfaqet në aksione konkrete sepse mungojnë vlerat e vetëafirmimit.

Gjykohet që këto rezultate të jenë normale për një shoqëri postkomuniste si kjo shqiptare që ka vuajtur nga mungesat e theksuara ekonomike por edhe sociale edhe politike që formësojnë më pas ndjenjën e lirisë dhe vlerat e vetëafirmimit. Një vend si Shqipëria me një ekonomi që nuk mundi kurrë deri tani të kapte majat, ose të paktën një qëndrueshmëria dhe një formalitet, mirëqënia materiale e individëve është relativisht e ulët. Kjo ndikon në ndenjen e pasigurisë materiale që shton frikën për të ardhmen edhe për të reaguar.

Sipas Inglehart një nga shpresat e ndryshimit të vlerave nga ato të mbijetësës në ato të vetëafirmimit dhe nga ato materialiste në post-materialiste është ndryshimi i brezave. Siç përcakton Inglehart (Inglehart, 1990) do të pritet diferenca mes grup-moshave të ndryshme sepse këto grupe kanë jetuar eksperiencë të ndryshme formuese. Në këtë kuptim Shqipëria ka shpresë tek brezi i ri për rritjen e qasjes dhe kërkimit të lirisë, pasi të jenë rritur niveli i vlerave të vetëafirmimit.

Bibliografia

- Angell, R. C. (1951) *The moral integration of american cities*. Chicago: University of Chicago Press.
- Anketa "Profili i Vlerave" Tirane.
- Bachika, R. & Schulz, S.M. (2011) Values and culture in the social shaping of the future. *Current Sociology* 59(2) 107–118.
- Censusi i popullsisë dhe i banesave (2012) Tiranë: Instat.
- Hartmann, R. (1965) *The structure of value: foundations of scientific axiology*. Southern Illinois University Press.
- Inglehart, R. & Baker, W. (2000) Modernization, cultural change and persistence of traditional values. *American Sociological Review*, Vol 65, No.1 :(19-51).
- Inglehart, R. (1990) *Culture Shift in Advanced Industrial Society*. Princeton, NJ: Princeton University Press.
- Inglehart, R. & Welzel, Ch. (2005) *Modernization, cultural change, and democracy : the human development sequence*. New York : Cambridge University Press.
- Inglehart, R. (1977) *The Silent Revolution: Changing Values and Political Styles Among Western Publics*. Princeton, NJ: Princeton University Press.
- Inglehart, R. (2008) Changing Values among Western Publics from 1970 to 2006. *West European Politics* 31 (January-March): 130-46.
- Kocani, A. (2006) *Metodat e kërkimit sociologjik*. Tiranë: Universiteti UFO.
- Rokeach, M. (1973) *The nature of human values*. New York, Free Press.
- Rokeach, M. (1979) *Understanding human values*. New York, Free Press.
- Super, D. E. (1990) *A life-span, life-space approach to career development*. D. Brown & L. Brooks (Eds.) San Francisco: Jossey-Bass.

Kosova ndërmjet Demokracisë Centripetale dhe Centrifugale

PhD (C.) Behar Haziri

Abstrakt

Në këtë punim do të merremi me analizën e dy formave të demokracisë siç janë: modeli i demokracisë centripetale dhe modeli i demokracisë centrifugale dhe ndikimin e tyre në kulturën politike. Këto dy forma do të na mundësojnë të kuptojmë se nga shtrihen forcat vepruese në sistemin politik kosovar. Me modelin centripetal do të paraqesim kulturën politike e cila vepron në funksion të shtetndërtimit të Kosovës, ndërsa me modelin centrifugal do të paraqesim kulturën politike e cila vepron në kahe të kundërt të shtetndërtimit dhe duke penguar zhvillimin normal të një shteti të ri siç është Republika e Kosovës. Punimi analizon ndryshimet dhe ndarjet e mëdha të shoqërisë kosovare si dhe sjelljen e elitës në periudhën pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Analiza do të përqendrohet edhe në identifikimin e forcave qoftë centripetale dhe centrifugale të cilët bëjnë presion të vazhdueshëm në sistemin politik kosovar, më konkretisht në efektet që vijnë nga këto dy modele prej të cilave varet edhe stabiliteti politik. Propozimi gjithëpërfshirës i Martti Ahtissari ka pasur shumë elemente të paqarta të cilat janë bartur edhe në Kushtetutën e Kosovës, siç është komuniteti politik prej nga shkalla e konfliktit dhe thyerjeve në sistemin politik mund të krijojë arsye të forta të përbashkëta të identifikimit politik (Easton, David, 1965:326). Në analizë të punimit do të jetë edhe mënyra e vendimmarrjes në sistemin politik dhe ndikimi i drejtpërdrejtë i forcave ndërvepruese me qëllim të arritjes së objektivave, që në rastin tonë vijnë nga forcat centrifugale të fuqishme, duke kontestuar edhe legjitimitetin demokratik të sistemit politik.

Fjalët kyçe: demokracia centripetale, demokracia centrifugale, fragmentarizimi, segmentimi, kultura politike homogjene, kultura politike heterogjene.

Hyrje

Ekzistojnë shtete të cilat kanë një sistem politik mjaft funksional dhe po ashtu shtete të cilat në vetvete funksionojnë por kanë probleme të shumta, disa për shkak të ideologjisë për të cilën është përcaktuar vetë shteti, apo për shkak se në përbërjen e shtetit ekzistojnë kultura të ndryshme, gjuhë të ndryshme, fe të ndryshme. Disa shtete kanë arritur me sukses që të tejkalojnë problemet që paraqiten brenda sistemit politik duke krijuar një sistem politik efikas, përderisa ka raste të shumta të cilat shtetet nuk kanë arritur të tejkalojnë këto probleme dhe ku pengesa më e madhe është paraqitur nga subkultura. Në krahasimin e sistemeve të ndryshme politike mund të vërejmë qasje dhe forma të ndryshme të kulturës politike. Për të paraqitur disa prej problemeve të cilat i hasin shtetet dhe mënyrën se si ju qasen problemeve duke krahasuar veprimet politike të cilat i ndërmarrin shtetet që të krijojnë një ambient sa më të mirë në hapësirën brenda shtetërore, si dhe për të paraqitur kulturën politike homogjene apo heterogjene dhe për t'ju ikur emërtimeve gjeografike të përdorura nga Gabriel Almondi si p.sh modeli anglo-amerikan, evropian (pa Anglinë), paraindustriale apo pjesërisht industriale dhe totalitare (Almond, Gabriel, 1956:391-409), janë shfrytëzuar emërtimet si demokracia centripetale dhe demokracia centrifugale (Lijphart, 1992). Në krahasimin e demokracive të shteteve të Zvicrës, Austrisë, Belgjikës dhe Holandës që i përkasin modelit konsociativ si

problem kryesor është vendos ndarja ideologjike, religjioze, gjuhësore. Sipas Arendt Lijphart të gjitha shtetet e lartpërmendura të cilat në vitet e pesëdhjeta kishin një segmentim të lartë, arritën që të zvogëlojnë ndarjet e thella duke ju ofruar strategjisë jo-konsociative siç merret rasti i Holandës me aplikimin e modelit “qeveri në hije” (Lijphart, Arendt, 1992:108-9). Në kapitullin 2 kemi shpjeguar për aplikimin e modelit *governing in the shadow* dhe që është pjesë e traditës së modelit Westminster por që më shumë është përdorur për të mbizotëruar legjislativin se sa si pjesë për të ikur nga modeli konsociativ. Në sistemin politik të Kosovës, demokracia centripetale do të shfrytëzohet për të kuptuar funksionimin e modelit të kulturës politike homogjene, që nënkupton se të gjithë kanë besimin e njëjtë për politikën, etikën, religjionin etj. Ndërsa me demokracinë centrifugale do të provojmë për të kuptuar kulturën politike heterogjene, në rastin tonë modelin e Kosovës me një fragmentarizim të lartë dhe ndikim të madh të subkulturës dhe forcave centrifugale që shpeshherë vejnë në diskutim çështjen e legjitimitetit demokratik.

Modeli i demokracisë centripetale

Demokracia centripetale është model i analizës për të parë nëse qytetarët brenda hapësirës shtetërore kanë arritur që të tejkalojnë thyerjet mëdha dhe ndarjet e thella që kanë ndërmjet veti. Centripetalizmi parashikon demokracinë si një proces të vazhdueshëm të menaxhimit të konfliktit, një cikël të përsëritur të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në të cilën çështjet e diskutueshme duhet përfundimisht të zgjidhen me anë të negociatave dhe bashkëpunimit reciprok, në vend të rolit të shumicës së thjeshtë (Reilly, Benjamin, 2004:7). Karakteristikë e një demokracie të qëndrueshme është roli i ekonomisë dhe rritja e mirëqenies. Në rastin e analizës së Kosovës së periudhës së protektoratit kemi një ekonomi të rrënuar për shkak të periudhës së regjimit totalitar serb që nga viti 1990-1999. Gjatë kësaj periudhe elita politike ishte e orientuar në gjetjen e formave të mbijetesës. Pas vitit 1999 krijohet mundësia e ndërtimit të institucioneve, por që në rrugëtimin e shtetndërtimit, kultura politike kosovare përballet me një fragmentarizim të lartë. Gjatë kësaj periudhe paraqiten çarjet e mëdha ideologjike si dhe fragmentarizimi i lartë brenda etnive. Sipas Oliver H. Woshinsky (2008), bazuar në sjelljen e kulturës politike janë identifikuar tre lloje të sistemeve politike: a) sistemi politik pluralist me një kulturë politike aktive-homogjene, që paraqet një shoqëri që negocimin e zhvillon me një kulturë të unifikuar, me qytetarët që kanë një identitet të përbashkët, duke parë veten e tyre si anëtarë të njëjtë të një grupi apo kombi; b) sistemi politik autoritar me një kulturë politike pasive-homogjene, që është një lloj i kulturës që posedon një qytetari që është me kohezion social dhe thellësisht joaktiv dhe që bie dakord në vlerat kryesore; dhe c) sistemi politik anarkik me një kulturë politike aktive-heterogjene, ku qytetarët janë aktive dhe përfshihen në politika për promovimin e qëllimeve të tyre, për të përmirësuar kushtet e tyre të jetës. Për fat të keq, ata e gjejnë veten në mosmarrëveshje të plotë me njëri-tjetrin lidhur me vlerat themelore të jetës (H. Woshinsky, Oliver, 2008:47-54).

Kultura politike kosovare mund ta radhitet ndërmjet sistemit politik autoritar dhe ku mund të vendosim edhe modelin e demokracisë centripetale. Vlerat e përbashkëta të identifikuara në sistemin politik të Kosovës sipas sistemit autoritar janë krijimi i shtetit, përpjekja për ngritjen e mirëqenies dhe pa ndonjë reagim të madh ndaj

dukurive negative të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ky lloj i sistemit politik ka qenë i pranishëm deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Pas krijimit të shtetit janë paraqitur problemet të cilat edhe kanë qenë të pritshme nga mospajtimet e minoritetit dhe shtetit serb që Kosova të jetë e pavarur dhe e pakontrolluar nga Serbia. Ndërsa, sistemin politik të Kosovës sipas sistemit politik anarkik e klasifikojmë me modelin e demokracisë centrifugale, sepse në rastin tonë forcat vepruese centrifugale që paraqiten nga minoriteti serb janë të ndryshme dhe se përveç kërkesave për të përmirësuar kushtet e jetës së tyre, promovojnë edhe qëllimet e tyre dhe që janë në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës. Në fig 1 është paraqitur skema e sjelljes së sistemit politik para dhe pas shpalljes së pavarësisë.




Fig 1. Modeli i kulturës politike kosovare kundrejt formave të veprimit të forcave në sistemin politik të Kosovës.

Burimi: Hulumtimi i Autorit

Karakteristikë e sistemit politik të Kosovës është sepse ndarja e thellë qëndron vetëm ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve. Ky dallim vjen nga mospranimi i realitetit të ri nga minoriteti serb duke kontestuar të gjitha vendimet e dala nga sistemi politik. Duke mos pasur zgjidhje të qëndrueshëm bashkësia ndërkombëtare bëri gjithçka vetëm që të tejkaloheshin ndarjet e thella ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve. Te shumica shqiptare nuk ka ndarje të thella. Ka vetëm një problem dhe që është sanksionimi i së drejtës për referendum nga bashkësia ndërkombëtare, sepse në të kundërtën do të organizohej bashkimi kombëtar shqiptar, çka nënkupton se Lëvizja Vetëvendosje e konteston shtetin e Kosovës vetëm nga dëshira për të qenë e bashkuar me Shqipërinë. Në klasifikimin për të zgjidhur problemin e segmentimit Giovanni Sartori (1976) bënë ndarjen në: a) pluralizmin e moderuar që paraqet shoqëritë që janë të fragmentarizara por jo të polarizuara, dhe b) pluralizmin e polarizuar që paraqet shoqëritë që janë edhe të fragmentarizuara edhe të polarizuara (Sartori, Giovanni, 2005:111). Kosova mund të rradhitet në grupin e dytë, një shoqëri me pluralizëm të polarizuar që është edhe e fragmentarizuar edhe e polarizuar. Centripentalizmi është edhe një teori normative e projektuar për të nxitur tre fenomene të lidhura por të ndryshme në shoqëritë e ndara: a) nxitje elektorale që përdorin politikanët për të tërhequr vota nga grupet e ndryshme etnike, duke i inkurajuar që të lënë anash retorikën përçarëse në mënyrë që të zgjerojnë pozicionet e tyre; b) për të krijuar arenën e bisedimeve ndërmjet partive dhe ndërmjet etnive duke nxitur grupet e ndryshme për të negociuar në çështje që mund të çojnë në diskutimin e shumë çështjeve tjera substanciale; c) në krijimin e koalicioneve me mbështetje multientnike duke paraqitur një gamë të larmishme të alternativave të politikave të elektoratit dhe që janë në gjendje për të bërë pazaret e ndryshme ndëretnike mbi platformat programore (Reilly, Benjamin, 2004:11). Në periudha të ndryshme të historisë kemi forma të ndryshme të elitave. Së pari, elita e ngritur mbi reputacionin e bartur nga periudha e RSFJ, nga personat të cilët bartnin funksione të larta politike, akademike, sportive. Së dyti, elita e ngritur nga periudha e pasluftës ku postet e larta politike,

akademike, kulturore ishin të garantuar për shtresën e cila kishte fituar luftën. Së treti, elita e re në krijim e sipër që vjen nga shkollimi nëpër universitetet përëndimore. Ndonëse raportet në mes të këtyre grupeve elitare shpeshherë paraqiten shumë të polarizuara, sipas sociologut amerikan C.Wright Mills fuqia e elitës është ajo që ndikon shumë në institucione.

Struktura e institucioneve shtetërore definohet si mundësi nga ata që zënë postet e tyre komanduese. Pasi këto mundësi janë të njohura, njerëzit mund të përfitojnë prej tyre. Disa njerëz nga secili prej zonave dominuese institucionale, më largpamëse se të tjerët, promovojnë në mënyrë aktive lidhjen e tyre para se ajo të merr formën e saj të vërtetë. Por sapo koordinimi është një dozë shqetësuese, njerëzit e rinj vijnë lehtë në të dhe pranojnë ekzistencën pa fjalë.

(Mills, C.Wright, 1956:293)

Sjellja e elitës politike kosovare për të krijuar stabilitetin politik ka qenë e orientuar që nga vendosja e protektoratit ndërkombëtar. Kjo masë e detyruar e elitës politike është vënë në funksion të rehabilitimit të shoqërisë kosovare pas luftës së vitit 1998-1999. Kjo periudhë mund të shënohet edhe si periudhë e kulturës politike homogjene sepse të gjitha partitë politike dhe minoritetet përjashtuar minoritetin serb ishin për pavarësimin e Kosovës. Për shkak të kundërshtimit të subkulturës serbe ndërkombëtare ishin të detyruar të krijojnë një mekanizëm institucional që do të garantonte përfaqësimin e minoritetit serb me pjesëmarrje në zgjedhje lokale dhe qendrore dhe me përfaqësim në sistemin politik. Në fig. 2 është paraqitur modeli i regjimit demokratik me strukturën shoqërore dhe sjelljen e elitës politike.




Fig. 2. Modeli i regjimit demokratik

Burimi: Lijphart, Arendt, 1992:110

Në klasifikimin e Arendt Lijphart për shtetet me kulturë politike homogjene shtetet skandinave si Suedia, Norvegjia, Danimarka dhe Finlanda janë vendosur në grupin e vendeve homogjene. Megjithatë, Finlanda emërtohet si në vend me një shoqëri plurale për shkak të disa pakicave që flasin gjuhën suedeze (Lijphart, Arendt, 1992:114). Nëse e vendosim në krahasim Kosovën dhe Finlandën, atëherë sa i përket statistikave shohim se nuk ka ndonjë dallim të madh që është i paraqitur edhe në fig. 3, popullsia sa i përket shumicës dhe pakicave duket i njëjtë.

Shteti	Përbërja e popullsisë					
Kosova	Shqiptar 92%	Serb 5,8%	Turq 0,5%	B o s h n j a k 0,5%	Ashkali 0,3%	Romë 0,6%
Finlanda	F i n l a n d e z 93,4%	S u e d e z 5,6%	Rus 0,5%	Estonez 0,3%	Romë 0,1%	Sami 0,1%

Tabela. 1. Krahasimi statistikor i popullsisë së Kosovës dhe Finlandës
Burimi: Enti Statistikor i Kosovës (<http://ask.rks-gov.net/sq/popullsia/category/91-struktura-e-popullsisë>), dhe për Finlandën (http://www.indexmundi.com/finland/demographics_profile.html), qasur më 17.06.2016

Një argumentet për kulturën politike homogjene të Finlandës qëndron në atë që quhet lidhja e fortë e konceptit të shoqërisë që i referohet një entiteti të integruar i cili vepron si një subjekt dhe përcjell supozimin se progresi zhvillohet në kuadër të shoqërisë dhe shtetit komb. Kultura politike finlandeze ka mbetur identike dhe bashkësitë fetare dhe politike kanë mbetur identike (Ihalainen, Pasi, 2005:242). Një element tjetër që përshkruan orientimin e Finlandës në kulturën politike homogjene është edhe nacionalizmi shtetëror një konceptim territorial-qytetar për të mbrojtur nga Rusia dhe Suedia (Eatwell, Roger, 1997:213). Finlanda i takon shteteve të modelit nordik me një qëndrueshmëri ekonomike dhe zhvillim të demokracisë për shkak të sundimit të gjatë të partive social-demokrate duke kontribuar në një integrim të përgjithshëm të shtetit, kombit dhe klasave (po aty, 1997:215), duke e bërë të parëndësishme subkulturën dhe ndikimin e minoriteteve në orientimin e shtetit në modelin e demokracisë konsociative ose në modelin e kulturës politike heterogjene. Për dallim nga kultura politike e Finlandës ku bashkësitë fetare dhe politike kanë mbetur identike, në Kosovë bashkësitë fetare janë të fragmentarizuara kur bëhet fjalë për dy etnitë, atë shqiptare dhe serbe. Bashkësitë fetare të shqiptarët janë në harmoni të plotë dhe për këtë element shqiptarët shquhen si populli me tolerancën fetare më të lartë në botë, ku të gjitha komunitetet fetare si mysliman, katolik, ortodoks, bektashi janë të lidhura së pari me kombin shqiptar dhe pastaj me përkatësinë fetare. Krahasimi statistikor në mes Kosovës dhe Finlandës duket pothuajse i ngjashëm. Edhe nëse e marrim kriterin e nacionalizmit shtetëror në Kosovë krahasimi me Finlandën do të jetë i ngjashëm. Nëse Finlanda përdori nacionalizmin shtetëror për tu mbrojt nga Rusia dhe Suedia, atëherë e njëjta metodë u provua edhe nga Kosova vetëm se për tu mbrojt nga Serbia dhe tendenca e shndërrimit të identitetit shqiptar në identitetin multikulturor Jugosllav (Flere, Sergej, 1988:439-53), por që dështoi për shkak se populli shqiptarë ishte i kujdesshëm duke mos pranuar identitetin jugosllav.

Modeli i demokracisë centrifugale

Modeli i demokracisë centrifugale shpjegon sistemet politike të paqëndrueshme duke filluar që nga Republika e tretë dhe e katërt e Francës, Republika e Vajmarit dhe për të vazhduar me Austrinë, Belgjikën e pas LDB (Lijphart, Arendt, 1992:117). Në grupin e shteteve të lartpërmendura bën pjesë edhe Kosova për shkak të paqëndrueshmërisë të sistemit politik. Rasti i dy presidentëve të detyruar nga Gjykata Kushtetuese për të dhënë dorëheqje, shpërbërja e Kuvendit nëpërmjet mocioneve të mosbesimit duke detyruar qeverinë të dorëzohet pa e përmbushur mandatin katërvjeçar, koalicionet e paqëndrueshme për shkak të ndarjeve ideologjike (majtë-djathtë), politizimi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore, si dhe subkulturat që refuzojnë komunikimin me sistemin politik të Kosovës janë kritere që e vendosin Kosovën në modelin konsociativ me një fragmentarizim dhe fraksionalizim të lartë. Nëse kultura politike gjatë periudhës së protektoratit ndërkombëtar karakterizohet centripetale dhe e depolitizuar për shkak të orientimit drejt shpalljes së pavarësisë, periudha pas krijimit të shtetit është me një kulturë politike heterogjene dhe e modelit centrifugal.

Republika e katërt e Francës dështoi për shkak të paaftësisë për të kontrolluar krizën me Algjerinë, si dhe për shkak të thyerjeve të socialistëve, radikalëve, të krishterëve, demokratëve dhe konservatorëve duke bërë një fragmentarizim dhe segmentim të partive të dobëta dhe të forta ku jetëgjatësia e qeverisë nuk arrinte më shumë se një vit (Knapp, Andrew., Wright, Vincent, 2006:50). Në krahasim në mes të Republikës së katërt të Francës e cila i takon llojit të modelit centrifugal dhe Kosovës mund të gjejmë shumë elemente të përbashkëta. Së pari, në legjislaturën e tretë (2007-2010), përbërja e saj ishte fragmentarizuar shumë, sepse përkundër që PDK kishte fituar zgjedhjet e vitit 2007 ka qenë e detyruar që institucionin e Presidentit ta lë për liderin e LDK. Koalicioni i madh i ndërtuar për të shpallë shtetin e Kosovës, nuk ishte zgjidhja më e mirë. Së dyti, fillimi i bisedimeve me shtetin Serb duke mos vendosur një agjendë të qartë se çka do të bisedohet dhe si do të bisedohet ndryshoi strukturën e partive politike duke krijuar Lëvizjen VV e cila paraqet edhe fillim e vërtetë të llojit centrifugal, kur përveç subkulturave krijohet një forcë e cila asnjëherë nuk do të pajtohet me modelin e vendimmarrjes në sistemin politik duke krijuar një fraksionalizim të lartë. Së treti, fragmentimi i elitës politike kundrejt sistemit politik për formën e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore të trashëguar nga periudha komuniste duke sjellë një model të dështuar ekonomik. Sipas Arend Lijphart modeli i koalicionit të madh është karakteristikë e modelit të demokracisë konsociative (Lijphart, Arendt, 2012:95). Për dallim nga Lijphart për koalicionin e madh, Mcgarry dhe O'Leary japin tre variacione të ndryshme të koalicioneve në demokracitë konsociative: a) koalicioni i njëzëshëm (unanimous consociations) që nënkupton koalicionet e mëdha; b) koalicionet bashkëvepruese (concurrent consociations) në të cilin ekzekutivi ka shumicën e mbështetjes në çdo segment të rëndësishëm; dhe c) koalicioni i pafuqishëm (weak consociations) ku ekzekutivi mund të ketë vetëm një nivel të mbështetjes në mesin e një ose më shumë segmenteve (Mcgarry, John., O'Leary, Brendan, 2004:15). Të tri format janë të pranishme në sistemin politik, por që ekzekutivi paraqitet si mbizotërues kundrejt legjislativit, duke mos përfillur parlamentin si organin më të lartë në sistemin politik. Modeli centrifugal mund të trajtohet edhe në nivelin lokal të qeverisjes dhe në nivelin qendror. Sistemi zgjedhor në nivelin lokal jep mundësinë që kryetari i komunës të zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë, ndërsa kuvendi komunal të formohet në bazë të koalicioneve për shkak të pamundësisë që një parti të fitojë shumicën në kuvend. Vendimmarrja në nivel lokal e tejkalon modelin centrifugal dhe më shumë i ofrohet modelin centripetal sepse mirëqenia e qytetarit është e lidhur më shumë me nivelin lokal se sa me nivelin qendror.

Gerhard Lembruch (1975) paraqet kushtet e jashtme dhe të brendshme gjenetike të sjelljes së elitave të cilat janë shfaqur në shtetet e ndryshme me model të demokracisë konsociative. Sipas Lembruch lidhja shpjeguese ndërmjet kushteve gjenetike dhe sjelljes së elitave mundëson të kuptojmë sistemet konsociative. Ekzistimi i sistemeve konsociative mundësohet atëherë kur në shoqëritë e segmentuara konfliktet janë të rregulluara në atë formë në mënyrë që rezultatet të jenë të favorshme për secilën prej grupeve rivale. Në këtë rast strategjia bashkëpunuese për rregullimin e konflikteve, mund të miratohet me anë të procesit "të mësuarit me sukses", duke u përvetësuar si normë e cila do të ishte e transmetuar në procesin e socializmit institucional te elitat politike dhe sidomos në organet përfaqësuese parlamentare (Lembruch, Gerhard, 1975:379-80), a) disa simbole themelore kombëtare janë pranuar nga të gjitha grupet

e elitës në sistem; b) dhuna nga e kaluara në mes të subkulturave perceptohet si një përvojë traumatike. Prandaj, menaxhimi i konfliktit me dhunë konsiderohet si jo e dobishme për të gjitha grupet; c) në mesin e elitave ekzistojnë komunikimet intensive joformale e të gjitha subkulturave të cilat mund të jenë të mbyllura për ndërhyrje nga jo-elitat (po aty, 1975:380-1). Në grupin e kushteve të jashtme gjenetike të sjelljes së elitës të perceptuara si kërcënuese janë: a) demokracia konsociative është modeli që shfaqet zakonisht te shtetet e vogla. Perceptimi i një kërcënimi të jashtëm mund të çojë në segmentimin kulturor të shoqërisë, në pritje nga ana e elitës të shkeljeve të mundshme në integritetin e njësisë politike: të vendosjes së një subkulture kundër ndarjes territoriale që mund të shërbejë si mjet për dominim nga fqinjët më të fuqishëm; b) kur konfliktet e brendshme në mes të subkulturave korrespondojnë me konfliktin kulturor ndërmjet njësisë politike fqinje, kjo rezulton në një përgjigje të brendshëm të konflikteve ndërkombëtare, sidomos në rastin e konflikteve fetare dhe etnike; c) në rast se strategjitë consocionale janë zhvilluar dobët, atëherë distanca në mes të elitave të brendshme do të priren të jenë më të mëdha, ndërsa distanca në mes të elitave të brendshme dhe elitave përkatëse të jashtëm (p.sh. udhëheqësve fetare apo etnik në vendet fqinje) do të jenë më të vogla, dhe identifikimi me adresimin e grupeve me shtrirje ndërkufitare nga njësitë politike do të mbizotërojnë (po aty, 1975:381-4).

Modeli centrifugal në sistemin politik të Kosovës ka prodhuar kriza të njëpasnjëshme, duke filluar nga pranimi i fusnotës në emërtimin e shtetit, pengimin në anëtarësimin në organizata ndërkombëtare, demarkacioni, asociacioni i komunave me shumicë serbe. Kjo tregon për një kohezion të fortë brenda subkulturës që e orienton sistemin politik në modelin centrifugal. Në demokracitë centrifugale nuk ka vend për marrëveshje afatmesme dhe afatgjate të cilat do të rezultojnë në prosperitetin e të gjitha grupeve sociale dhe shteteve, siç është rasti në demokracitë consocionale, por ka një tendencë të mohimit të pluralizmit. Si rezultat i kësaj, tensionet në mes të elitave transferohen në të gjitha grupet shoqërore, marrëdhëniet reciproke të cilave prishen dhe shndërrohen në pengesa të fuqishme (Pepiç, Ivan., Raos, Visheslav, 2015: 109). Në fakt, modeli kosovar është një model i mungesës së aftësisë së elitës për tu përballur me problemet e natyrave të ndryshme dhe gjetjen e formave për të përballuar dhe dalë nga kriza, por edhe nga modeli konsociativ që si duket më shumë është i pranuar nga bashkësia ndërkombëtare se sa nga qytetarët e Kosovës. Koalicioni i madh me pjesëmarrjen e garantuar të minoritetit serb ka vendosur rregullat e lojës të cilat deri më tani kanë mbet të pandryshuar p.sh. ndryshimet kushtetuese për themelimin e ushtrisë ose shtrirjen e ndikimit të qeverisë në tërë territorin duke e përfshirë edhe veriun, kanë krijuar një regjim politik të polarizuar.

Kultura politike në demokracinë centripetale dhe centrifugale

Kultura politike kosovare është thellësisht e fragmentarizuar dhe kjo vjen nga ndarja etnike shqiptarë dhe minoritete (serb, boshnjak, turq, romë, ashkali) dhe nga thyerjet e mëdha që vijnë brenda shumicës shqiptare. Kultura politike paraqitet edhe si shoqërizim politik (political socialization) ku i referohet rrugës në të cilën janë formuar vlerat politike dhe kultura politike e transmetuar nga një gjeneratë në tjetrën (Almond, Powell, Jr., Dalton, Strom, 2008:67). Në vështrimin retrospektiv vlerat politike kosovare janë formuar nga shkolla komuniste, por edhe kultura politike është bartë nga gjenerata në gjeneratë. Rëndësia e shoqërizimit politik

në përcaktimin e kulturës politike kosovare për të vendosur ndërmjet modelit centripetal dhe centrifugal është e madhe, sepse me një kujdes të veçantë në faktorët e saj siç janë: shkollimi, institucionet religjioze, grupet shkollore (peer groups), klasat sociale, grupet e interesit, partitë politike, mediat (po aty, 2008:68), mund të paraqesim qëndrimet, lëvizjet dhe ndryshimet që janë përfshirë në formësimin e kulturës politike.

Kultura politike nuk është një fenomen statik, që do të thotë se të kuptuarit e kulturës politike duhet të jetë një proces dinamik (po aty, 2008:76). Rëndësia e shoqërizimit politike është shumë e dukshme sepse pa të çdo kulturë politike do të humbiste një gjeneratë. Nëpërmjet shoqërizimit politik, çdo individ në familje mëson qëndrimet sociale themelore, si besimin në njerëz dhe qëndrimin karshi autoriteteve, çka do të ishte e rëndësishme për të formuar reagimin e tyre të mëvonshëm kundrejt politikës (Shively, W.Philips, 2012:256).

Demokracia centripetale dhe centrifugale ndryshojnë jo vetëm nga fragmentarizimi i kulturës politike të ndarë edhe në subkulturën politike, por ndryshojnë edhe për nga kriteri i shtrirjes gjeografike, p.sh. vendet e Ballkanit dhe vendet Skandinave, ose fragmentarizimi në baza etnike kundrejt fragmentarizimit në baza religjioze. Nëse defunksionalizimi i sistemit politik në vendet me traditë të demokracisë liberale është lehtë i riparueshëm, në vendet e dala nga komunizmi dhe sidomos në vendet e Ballkanit ku formësimi kulturor ka kaluar ndërmjet perandorive të perëndimit dhe lindjes është shumë më i vështirë. Nëse kësaj i shtojmë edhe përpjekjet e vazhdueshme të serbëve për të mbajtur si zonë të shërbimeve territorin e Kosovës, dhe përpjekjen e shqiptarëve për të qenë të lirë dhe jo skllëvër të askujt tregon se përplasjet ndërmjet këtyre etnive dhe kulturave do të jenë të vazhdueshme. Kjo rrugë e gjatë e stabilitetit demokratik do të vazhdojë deri në momentin që minoriteti i serb e pranon përfaqësimin e saj pa kushte në institucionet e shtetit, dhe me këtë rast edhe kalimin nga modeli centrifugal në modelin centripetal të funksionimit të sistemit politik.

Përfundime

Në përfundim të analizës së rregullimit të brendshëm veçuar se sistemi politik i Kosovës për shkak të fragmentarizimit të lartë dhe polarizimit të madh më shumë i përshtatet modelit centrifugal dhe kulturës politike heterogjene. Përpjekjet e vazhdueshme të politikës kosovare që nëpërmjet bisedimeve të gjejnë një mirëkuptim për të shpërbërë sistemin funksional paralel të serbëve nëpër komunat ku kanë shumicën mbetet ende vetëm si përpjekje. Thyerja e pozitës dhe opozitës për shkak të demarkacionit dhe asociacionit të komunave me shumicë serbe e bën sistemin politik jo të qëndrueshëm.

Demokracia centripetale dhe centrifugale janë formë e analizës së sistemit politik për të hetuar problemet që vijnë nga polarizimi i lartë qoftë brenda etnive apo edhe brenda vetë partive shqiptare. Në modelin centrifugal si pjesë e modelit konsociativ shumëllojshmëria kulturore është pjesë e jetës së përditshme. Në Kosovë problemi që reflektohet nga subkultura qëndron në atë të mospranimin të ndryshimit të statutit të qytetarit kosovar nga ana e shtetit serb. Nëse deri në vitin 1999 shqiptarët ishin të sunduar, pas vitit 1999 ndryshon raporti i forcave dhe shqiptarët kanë shumicën dërmuese dhe nuk janë më pakicë por popull shtet-formues. Kjo formë e tranzicionit e cila ndryshon raportin e forcave në territorin e Kosovës është forma e cila kërkon

një konsensus të lartë nga ana e partive shqiptare deri në nivelin e një kulturë politike homogjene. Partitë politike e kanë provuar një herë harmonin institucionale dhe kjo ka qenë e pranishme në grupin e unitetit një formacion gjithëpërfshirës në bisedimet e Vjenës për zgjidhjen e statusit të Kosovës. Kjo periudhë ka qenë periudha e vetme e kulturës politike homogjene kur të gjitha partitë kanë pasur të njëjtin qëllim në rrugën për shpalljen e shtetit të Kosovës. Institucionet politike në Kosovë modelin centrifugal duhet ta shohin si një model tranzicioni dhe jo një model të pandryshuar. Kjo mund dhe do të arrihet me vullnetit e shoqërisë kosovare dhe institucioneve politike.

Literatura

- A.Almond, Gabriel. (1956). *Comparative Political System*, The Journal of Politics, Vol. 18, No.3. (August, 1956).
http://web.unair.ac.id/admin/file/f_23123_CP_Almond.pdf, Qasur më 12.11.2016.
- A.Almond, Gabriel., Powell,G. Bingham Jr., Dalton, Russell J., Strom, Kaare. (2008). *Comparative Politics Today - A Theoretical Framework*, Pearson Longman, New York.
- Easton, David. (1965). *A System Analysis of Political Life*, John Wiley & Sons, Inc., New York.
- Eatwell, Roger. (1997). *European political cultures - Conflict or convergence?*, Routledge, London.
- Flere, Sergej. (1988). *National (Ethnic) Identification and Preferred National (Ethnic) Identification Among Youth – the Question of Yugoslavism*, Review: *Migracijske i etničke teme*, Vol.4 No.4 Prosinac 1988, Institut za migracije i narodnosti (IMIN), Zagreb, f. 439- 453, http://hrcak.srce.hr/index.php?show=clanak&id_clanak_jezik=189614, Qasur më 09.11.2016.
- H.Woshinsky, Oliver. (2008). *Explaining Politics - Culture, institutions, and political behavior*, Routledge, New York.
- Ihalainen, Pasi. (2005). *Finnish Political Culture Reinterpreted Through Conceptual History*, Redescriptions: Yearbook of Political Thought and Conceptual History, 2005 vol.9, f. 231-250, Transaction Publishers, New Jersey.
http://www.jyu.fi/yhtfil/redescriptions/Yearbook%202005/Ihalainen_review_05.pdf, Qasur më 7.11.2016.
- Knapp, Andrew., Wright, Vincent. (2006). *The Government and Politics of France - Fifth edition*, Routledge, New York.
- Lehmbruch, Gerhard. (1975). *Consociational Democracy in the International System*, European Journal of Political Research, 3 (1975) f. 377-391, Elsevier Scientific Publishing Company, Amsterdam, <http://onlinelibrary.wiley.com/doi/10.1111/j.1475-6765.1975.tb01252.x/pdf>, Qasur më 10.11.2016.
- Lijphart, Arend. (2012). *Patterns of Democracy - Government Forms and Performance in Thirty-Six Countries - Second Edition*, Yale University Press, New Haven.
- Lijphart, Arendt. (1992). *Demokracija u pluralnim društvima* (Božica Jakovlev, Përkthimi.). Zagreb: Globus Nakladni Zavod, Školska Knjiga. (Original work published 1977).
- McGarry, John., O'Leary, Brendan. (2004). *The Northern Ireland Conflict - Consociational Engagements*, Oxford University Press Inc., New York.
- Mills, C. Wright. (1956). *The Power Elite*, Oxford University Press, New York.
- Pepić, Ivan., Raos, Visheslav. (2015). *Komparacija konsocijacijske i centrifugalne demokracije-Švicarska i Bosna i Hercegovina*, Politička misao: Časopis za Politologiju, viti 52, Nr 3, f. 105-129, http://hrcak.srce.hr/index.php?show=clanak&id_clanak_jezik=227914, Qasur më 03.11.2016.
- Reilly, Benjamin. (2004). *Democracy in Divided Societies - Electoral Engineering for Conflict Management*, Cambridge University Press, Cambridge, UK.
- Sartori, Giovanni. (2005). *Parties and Party Systems - a framework for analysis*, In Alan Ware (Eds.). ECPR Classics, Oxford University, UK.
- Shively, W.Philips. (2012). *Hyrje në Shkenca Politike*, (Shpëtim Çuçka, Elvina Jusufaj, Mirlinda Shaqiri, Përkthimi.). Tiranë: AIIS. (Original work published 2011)

Fenomeni i Bulizmit tek Adoleshentet

Anisa Koni

Abstrakt

Parimet bazë për mënyrën e funksionimit të një shoqërie në mënyrë produktive dhe të suksesshme individi i mëson që në familje. Këto parime zgjerohen, krahasohen, analizohen dhe vazhdojnë të zbatohen edhe në shkollë. Shkolla ka për detyrë t'i ofrojë individit edukimin dhe njohuritë e duhura, që i nevojiten për fazat e mëvonshme të jetës. Mësuesit janë të rëndësishëm për shoqërizimin e nxënësve me normat e kulturës gjatë periudhës së shkollimit. Gjithsesi, sic e ka vënë edhe në dukje Giddens procesi i arsimit shoqërohet prej harmonisë dhe divergjencave midis mësuesve dhe nxënësve (2007:689). Individi nuk vepron përherë në përputhje me normat sociale, por mban edhe qëndrime antikonformiste pavarësisht ndëshkimeve shoqërore apo ligjore. Meqë nxënësit e shkollave të mesme janë në moshën e adoleshencës, ata prirën të jenë antikonformistë duke u konfliktuar me njëri-tjetrin, me mësuesit dhe me prindërit. Në këtë kërkim studiohen konfliktet në shkolla që shkaktohen nga vetë adoleshentët përmes bulizmit. Ky fenomen ekziston prej vitesh dhe është studiuar herë pas here, por këto vitet e fundit është përhapur duke arritur shifra alarmante dhe ka rritur vëmendjen e studiuesve, të zyrtarëve të lartë të shtetit, të prindërve dhe të medias. Sipas një studimi të UNICEF (2014), mbi 50% e nxënësve në Shqipëri pohojnë se kanë pësuar dhunë mbrenda mjediseve të institucioneve të arsimit. Format më të përhapura të dhunës në shkolla janë të bërtiturat, ofendimet dhe shuplakat. Ndërkohë rezulton se djemtë preken më shumë nga dhuna fizike sesa vajzat dhe dhuna është më e përhapur në shkollat e qendrave urbane në krahasim me zonat rurale. Gjithashtu referuar të dhënave "Save the Children" (2013) thuhet se në 6 muajt e fundit të 2013-s shkalla e konfliktozitetit ka ardhur në rritje nga 6-8% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2012. Referuar të dhënave më të fundit të anketimit të realizuar në nivel kombëtar nga Inspektorati Shtetëror i Arsimit, i publikuar në janar të 2014, nxënësit ndjehen gjithnjë e më pak të sigurtë në mjediset e shkollave. Nga 1435 nxënës të anketuar, 28% e tyre janë shprehur se konfliktohen me njëri-tjetrin, 42% e tyre shprehen se nuk ndjehen të sigurt brenda mjediseve të institucioneve të arsimit. Konflikti në dyert e shkollave ka alarmuar opinionin publik, e për më tepër prindërit. Mbajtja e një arme të ftohtë është bërë e zakonshme dhe krijimi i konflikteve apo krimeve ndodh pikërisht në dyert e institucioneve të edukimit, ku libri duhet të jetë kryefjala.

Edhe Instituti i Shendetit Publik (2013) ka realizuar një studim perspektivë i përket fenomenit që njihet me emrin "bulizëm". Sipas këtij studimi rreth 25% e nxënësve nëpërkëmben nga moshatarët e tyre, ndërsa rreth 2% e tyre tallen e vihen në lojë në mënyrë frekvente

Fjalët kyçe : Bulizëm, Konflikt, Adoleshent, Viktimë.

Hyrje

Bulizmi është studiuar në fund të viteve 80' në vende të tilla si Norvegjia, Suedia dhe Finlanda. Në fakt, në Norvegji është një nga pionierët kryesorë, Don Olwesi, i cili botoi librin "Agresioni në shkolla" (1978). Sipas Olwes "një nxënës është duke u keqtrajtuar apo viktimizuar, kur ai ose ajo është i/e ekspozuar në mënyrë të përsëritur ndaj veprimeve negative nga një ose më shumë nxënës". Sipas tij, ngacmimi ka tre karakteristika kryesore: 1. është një sjellje e dhunshme, 2. përsëritet në kohë dhe 3. përfshin një çekuilibër të energjisë së individit.

Bulizmi tipikisht i referohet sjelljes së nxënësve në shkolla dhe bart një kuptim të *agresivitetit fizik dhe kërcënimit* (Buka, 2013:14). Bulizmi është një formë e abuzimit dhe viktimizimit ndaj një personi apo një grupi. Bullizimi shfaqet në ato situata kur një fëmijë ose grup fëmijësh duke përfituar nga forca/ fuqia, pushteti që ata mund të kenë lëndojnë, fyejnë, refuzojnë një fëmijë apo një grup tjetër fëmijësh. Disa nga format e shfaqjes së këtij fenomeni janë: thirrja e dikujt me emra fyes, tallës, shkrimi i mesazheve lëndues, lënia jashtë aktiviteteve, kërcënimi, të bërtiturit, frikësimi, vjedhja ose dëmtimi i sendeve/gjërave të tyre personale, goditja, shkelmimi, pickimi i tyre, ose detyrimi për të bërë gjëra apo për t'u përfshirë në sjellje që ata nuk do donin të përfshiheshin. Pra, bulizmi mund të jete *verbal, fizik ose social* (Psikologjia shkollore, 2012)

Një fëmijë është viktimë e bulizmit, kur në mënyrë të vazhdueshme, për një periudhë kohe, keqtrajtohet ose merret në tallje, nga një moshatar apo grup moshatarësh. Bulizmi, haset shpesh në shkolla. Në shqip do të mund të përkthehej me fjalën *harbutëri* (Kristuli, L. 2007:37)

Pavarësisht vendit dhe dallimeve kulturore, ka disa ngjashmëri sipas gjinisë, moshës, lokacionit dhe viktimave të bulizmit në SHBA dhe në vende të tjera¹

- Bulizmi është një fenomen që më shpesh ndodh në shkollë sesa rrugës për në shkollë apo në mjedise të tjera jashtë shkollës.
- Agresorët djem (bulët) janë më të prirur të përdorin dhunën/agresionin fizik më shumë sesa agresoret vajza, të cilat më shpesh përdorin ngacmimet, thashethemet dhe përhapjen e tyre, përjashtimin dhe izolimin social. Këto janë forma të dhunës psikologjike dhe cilësohet si "ngacmim i tërthortë", dhuna fizike cilësohet si "ngacmim i drejtpërdrejtë" ndërsa dhuna verbale mund të jetë "direkte" dhe indirekte". Disa studiues spekulojnë se vajzat e vlerësojnë më shumë marrëdhënien sociale sesa djemtë, kështu që agresoret vajza tentojnë që t'i prishin marrëdhëniet shoqërore nëpërmjet thashethemeve, izolimit, trajtimit të heshtur dhe përjashtimit. Vajzat kanë një tendencë që të detyrojnë dhe të dhunojnë më shumë vajzat ndërsa djemtë të dyja gjinitë, djemtë dhe vajzat njëkohësisht.
- Disa studime tregojnë se djemtë janë viktimizuar më shpesh dhe kjo më me intensitet të lartë gjatë viteve të shkollës fillore ndërsa disa studime të tjera tregojnë se vajzat dhe djemtë janë afërsisht njësoj viktimat të dhunës.
- Bulët shpesh nuk veprojnë vetëm. Në Mbretërinë e Bashkuar, dy studime të ndryshme kanë gjetur se pothuajse gjysma e incidenteve të dhunës psikologjike kanë ndodhur vetëm për vetëm ndërsa gjysma tjetër përfshin edhe nxënës të tjerë.
- Bulizmi është një fenomen që nuk përfundon në shkollën fillore. Në shkollën e mesme krijohen mundësi të shumta për ngacmim ndonëse me ritme më të vogla. Bulizmi është më shumë i pranishëm në vitet e para të shkollës së mesme.
- Bulizmi është i përhapur në shkollat e brendshme të qytetit dhe se ngacmimi racor është një problem shumë i përhapur, sidomos në Kanada dhe Angli. Në Toronto, një në tre fëmijë në shkollat e brendshme të qytetit është shprehur se ngacmimi racor është i pranishëm në shkollat e tyre. Gjithashtu viktimat e bulizmit mund të kalojnë në depresion që mund të zgjasë për disa vite.
- Raporte dhe studime të ndryshme kanë vërtetuar, se rreth 15% e nxënësve ose janë keqtrajtuar rregullisht ose janë iniciatorë të bulizmit. Bulizmi duket se zvogëlohet

¹ Bankave, R. (2013) Bulizmi në shkolla. Qendra Arsimore e Burimeve të Informacionit: Departamenti Amerikan i Shtetit

me kalimin e moshës por megjithatë, ndërsa sulmi i drejtpërdrejtë fizik duket se zvogëlohet me moshën, abuzimi verbal mbetet konstant. Gjithashtu, djemtë të cilët përfshihen më shumë në akte dhune janë edhe më shpesh viktimat të bulizmit sesa vajzat.

2.1 Format e bulizmit

Sipas Kristulit, bulizmi paraqitet në forma të ndryshme:

1. Bulizmi *emocional-psikologjik*: përjashtimi dhe veçimi me qëllim nga një grup shokësh, tallje, nofka fyese, kërcënime.
2. Bulizmi me *akte dhune (fizik)*: shqelma, shpulla, shtyrje, dhunë seksuale.
3. Bulizmi *ekonomik*: kërkesat e përsëritura të bulit për t'i dhënë të holla ose sende që i përkasin viktimës.
4. Bulizmi *elektronik*: mesazhe fyese në celular, në postën elektronike, chat (2007:39).

2.2 Viktimat e bulizmit

Më të shkurtër, më të shëndoshë, më pak të bukur, me syze apo tela në dhëmbë. Fëmijët e turpshëm që nuk u kthejnë përgjigje flakë për flakë “shigjetimeve” të shokëve më të “fortë” janë viktimat të fenomenit të bulizmit (“Gazeta Shqiptare”, 19.06.2013:15). Një fëmijë është viktimë e bulizmit, kur në mënyrë të vazhdueshme, për një periudhë kohe, keqtrajtohet ose tallet, nga një moshatar apo grup moshatarësh. Përgjithësisht mosha e viktimave të bulizmit lëviz kryesisht nga 6 deri në 17 vjeç. Nxënësit të cilët janë viktimat të bulizmit janë zakonisht të shqetësuar, të pasigurt, të kujdesshëm, vuajnë nga një vetëbesim i ulët dhe rrallë mbrojnë veten e tyre ose hakmerren ndaj nxënësve që i ngacmojnë dhe dhunojnë ata. Atyre u mungojnë aftësitë sociale për të pasur miq dhe shpesh janë të izoluar nga shoqëria. Viktimat kanë tendencë të jenë të afërt me prindërit e tyre, të cilët përkujdesen shumë ndaj tyre. Karakteristikë fizike e viktimave është se ata kanë tendencë të jenë fizikisht më të dobët sesa moshatarët e tyre ndërsa karakteristika të tjera fizike, si veshja, pesha, mbajnë syze apo jo nuk duket të jenë faktorë të rëndësishëm që mund të lidhen me dhunimin dhe viktimizimin e tyre (Esteves., Jimenez, & Musitu, 2008).

2.2.3 Agresorët e bulizmit

Ndërsa “buli” është termi që pëdoret për agresorin e fenomenit të bulizmit. Karakteristika më e spikatur e “bulit” është agresiviteti ndaj shokëve, por jo rrallë dhe ndaj prindërve e mësuesve. Ai është tip impulsiv, i papërmbajtshëm, nxehet shpejt, nuk pranon kritikën, nuk pranon rregullat, do të sundojë mbi të tjerët, mashtron dhe mburret për këtë. Qëllimi i “bulit” është të trembë dhe t'i frikësojë moshatarët ose më të vegjëlit, sepse kështu ndjehet i madh dhe i rëndësishëm. Përgjithësisht bulët veprojnë në grup. Në përbërje të grupit, ka edhe bulë pasivë, pra, që nuk marrin pjesë fizikisht në keqtrajtimin e viktimës, ose në akte të tjera dhune, por nuk bëjnë asgjë për t'i ndaluar anëtarët e tjerë të grupit, sepse pajtohen me këto sjellje prej buli ose kanë karakter të dobët. Njihet edhe një periudhë e *prebulizmit*, kur fëmija nuk godet direkt dikë, por hedh sende pa asnjë shkak kundër nënës, vëllait më të vogël, ose prish lodrat e fëmijëve të tjerë. Bulizmi femëror, merret pak parasysh, megjithëse është po aq i rrezikshëm sa edhe bulizmi i ushtruar nga djemtë. Zakonisht “bula”

sillet si një “bletë mbretëreshë” që mbledh rreth vetes vetëm ato moshatare që i rrinë për shtat, duke përjashtuar, tallur, përfolur, nëpërkëmbur, dhe trajtuar si më të ulëta, vajzat/shoqet që nuk i pëlqejnë. Është e pabesueshme kur bëhet fjalë për vajza, por ato e përdorin dhunën fizike po aq sa edhe bulët meshkuj. (Kristuli, L.2007: 37-38). Nxënësit të cilët angazhohen dhe përfshihen në sjellje të dhunshme duket se kanë një nevojë që të ndjehen të fuqishëm dhe të kenë kontroll mbi nxënësit e tjerë. Ata duket se ndjejnë kënaqësi nga lëndimet dhe vuajtjet e të tjerëve, kanë pak ndjeshmëri për viktimat dhe shpesh për të mbrojtur veten dhe veprimet e tyre pohojnë se viktimat i kanë provokuar në një farë mënyre. Studimet tregojnë se bulët vijnë shpesh nga ambjente familjare, ku ndëshkimi fizik është përdorur, ku fëmijët mësohen të përdorin dhunën fizike si një mënyrë për të trajtuar problemet dhe ku përkrahja dhe ngrohtësia e prindërve shpesh mungojnë. Nxënësit, të cilët rregullisht shfaqin sjellje të dhunës psikologjike janë përgjithësisht sfidues dhe opozitarë në drejtim të të rriturve, antisocialë dhe të prirur për të thyer rregullat e shkollës. Në kontrast me mitet ekzistuese, bulët duket se kanë pak ankth dhe se posedojnë vetë-respekt të fortë. Ka pak prova që mbështesin pretendimin se ata ngacmojnë dhe përndjekin të tjerët sepse ata ndjehen keq me veten e tyre (Esteves., Jimenez, & Musitu, 2008). Bulët karakterizohen si individë që kanë treguar nivele të larta të impulsivitetit, një nevojë të madhe për të dominuar të tjerët, besime pozitive në lidhje me përdorimin e dhunës dhe ndjeshmëri të ulët për viktimat. Për më tepër, ata kanë tendencë të jenë fizikisht më të fortë sesa viktimat e tyre dhe kanë më shumë vështirësi për të pranuar dhe ndjekur rregullat e vendosura sociale. Studime të tjera kanë treguar një lidhje të ngushtë midis qëndrimit negativ të autoritetit formal (mësues, shkolla dhe policia) dhe sjelljes së dhunshme në adoleshencë. Sipas një studimi të Sampson (2012), katër nevojat themelore të bulëve janë:

1. Nevoja për të dalë jashtë: agresori dëshiron të qëndrojë mbi të tjerët dhe sjellja e tij të pranohet dhe lavdërohet.
2. Nevoja për pushtet: agresorët duan të ndjehen më të fuqishëm se shokët e tyre dhe kanë nevojë për të dominuar.
3. Nevoja për tu ndjerë ndryshe: ai ka nevojë për të krijuar një identitet të veçantë në grupin e kolegëve.
4. Nevoja për të mbushur një zbrazëti emocionale: duke mos qenë i përmbushur emocionalisht, ai vazhdimisht kërkon ndjenja dhe eksperiencë të tjera për t’u ndjerë i përmbushur.

2.4 Pasojat e bulizmit

Sipas kërkimeve të reja e të fundit personat e prekur nga bulizmi vuajnë deri në moshën e mesme me nivele të larta të depresionit, shqetësime e ankth e deri në vetëvrasje. Efektet dhe pasojat e bulizmit kanë qënë në qendër të vëmendjes të ekspertëve të cilët e shihnin atë si një formë të abuzimit ndaj fëmijëve. Studiuesit më të njohur nga Finlanda, kanë shpjeguar se njerëzit që kanë vuajtur në fëmijëri nga bulizmi vazhdojnë të vuajnë pasojat edhe kur rriten. P.sh vajzat të rritura si viktimat të bulizmit shpesh tentojnë të kryejnë vetëvrasje nga mosha 25 vjeç, po ashtu dhe djemtë kanë gjasa të zhvillojnë dhe vuajnë ç’rregullime shqetësuese. Gjithashtu studiuesit vune ne dukje se subjektet e prekur nga bulizmi kishin çrregullime psikologjike në nivele të larta dekada pas ndodhjes së fenomenit. Pasojat e bulizmit ishin edhe ekonomike .

Kërkuesit gjetën se subjektet e prekura vazhdimisht nga bulizmi kishin më pak vite shkollimi sesa shokët e tyre. Kishte gjasa që meshkujt e këtij grupi të ishin të papunë, por edhe nëse ata kishin punë, rroga e tyre ishte më e ulët. Personat që kishin vuajtur nga bulizmi ishin të izoluar nga ana sociale. Kishte shumë pak gjasa që në moshën 50 vjeçare këta subjekte të jetonin me një bashkëshort/e ose partner/e; të kalonin kohë me miqtë e tyre madje ata nuk kishin familje dhe miq ku të mbështeteshin kur ishin të sëmurë. Në përgjithësi, ata ndjenin se cilësia e tyre e jetës ishte më e ulët se personat që nuk kishin qenë asnjëherë viktimat të bulizmit dhe ishin më pak optimist se jeta e tyre në të ardhmen do të shkonte më mirë.

Nga studimet e realizuara në vendet skandinave, duket se ekziston një lidhje e fortë mes asaj se, nxënësit të cilët kanë qenë abuzues, dhunues, gjatë viteve shkollore kanë tendencë të përjetojnë *probleme ligjore* apo penale pas përfundimit të shkollës, kur konsiderohen të rritur. Në një studim, 60% e tyre, të cilët ishin karakterizuar si bulë gjatë viteve të shkollës, kishin të paktën një dënim penal nga mosha 24 vjec. Gjithashtu, ndër të tjera, viktimat kanë frikë të shkojnë në shkollë dhe e konsiderojnë shkollën si një vend të pasigurtë dhe ndjehen të pakënaqur. Deri në 7% e nxënësve të klasës së tetë në Amerikë qëndrojnë në shtëpi të paktën një herë në muaj për shkak të bulizmit. Ky fenomen tenton të rrisë izolimin e disa nxënësve sepse shokët e tyre nuk duan që të humbasin statusin e tyre nëse shoqërohen me ta ose se së paku nuk duan të rrisin rrezikun që mund të bëhen edhe ata viktimë e bulizmit. Duke qenë se bulizmi çon në depresion dhe në vetbesim të ulët, këto janë probleme që mund t'i shoqërojnë edhe në moshën e rritur (Sampson, 2012).

2.3 Konflikti dhe bulizmi

Bulizmi në shkollë zhvillohet si pasojë e një konflikti pas një kohe të caktuar, ndonjëherë shumë shpejt, ndonjëherë pas javësh ose muajsh. Konflikti në tërësinë e tij nuk është gjithnjë shkatërrues, dhe mund të lindë, të zhvillohet dhe të zgjidhet brenda një kohe të shkurtër. Për më tepër një konflikt mund të zgjidhet dhe të ketë pasoja pozitive për të gjitha palët e përfshira në të. Ralf Dahrendorf ndër të tjera ka shkruar se: “Konflikti është burim i progresit drejt qytetërimit dhe, tekefundit, drejt shoqërisë civile të përbotshme” (1997:212).

Nga ana tjetër bulizmi në shkollë ka gjithnjë një kuptim negativ, zhvillohet me dijeninë e plotë të nxënësve që e ushtrojnë atë, si për procesin ashtu edhe për pasojat. Bulizmi nuk është një konflikt i fuqishëm një herë, por një seri ngjarjesh që vazhdojnë në kohë dhe që çojnë në shqetësime të ndryshme fiziologjike dhe psikologjike. Bulizmi nuk ka pasoja pozitive për personin që është viktimë e këtij fenomeni. As nxënësit e tjerë që nuk janë viktimat të fenomenit të bulizmit nuk mund të ndjehen tërësisht të sigurt kur vërejnë që një shok ose shoqja e tyre është viktimë e bulizmit, pasi në të ardhmen edhe ato mund të jenë viktimat e radhës.

2.4 Dhuna dhe bulizmi

Organizata Botërore e Shëndetësisë e përkufizon dhunën si: “Përdorim të qëllimshëm të forcës fizike ose të fuqisë, të kërcënimit ose të përdorimit të saj real, kundër vetes, një personi tjetër ose kundër një grupi a komuniteti, forcë e cila çon ose ka mundësi

të çojë në plagosje, vdekje, dëmtim psikologjik, keqzhvillim ose privim”.² Dhuna është një koncept më i gjërë se bulizmi. Ajo është e përhapur në pothuajse të gjitha institucionet sociale, si në shkollë, në familje, në punë dhe përfshin një numër më të madh individësh dhe grupmoshash. Ndërsa fenomeni i bulizmit është një fenomen i përhapur në shkolla dhe që i referohet dhunës ndërmjet fëmijëve, e cila është një formë e sjelljes agresive në të cilën dikush qëllimisht dhe në mënyrë të përsëritur, shkakton lëndim ose shqetësim një fëmije tjetër.

Përfundime

● Marrëdhëniet ndërmjet nxënësve të anketuar karakterizohen nga një shkallë e lartë konfliktualiteti dhe pesha specifike e djemve që përfshihen në konflikte me njëritjetrin është më e lartë se ajo e vajzave.

● Motivet e konfliktimit të nxënësve adoleshentëve me njëritjetrin janë të larmishme, duke filluar nga keqkuptimet e rastit, thashethemet, shakatë e tepruara, paragjykimet e ndryshme apo së fundi edhe komunikimi në rrjetet sociale, veçanërisht në “Facebook”.

● Tiparet që nxënësit adoleshentë çmojnë më shumë tek shoku ose shoqja e tyre më e afërt i lidhin drejtpërsëdrejti me rregullimin e marrëdhënieve të tyre individuale. Ndershmëria, takti në komunikim, përkushtimi ndaj miqve janë disa nga tiparet që çmojnë më shumë nxënësit adoleshentët tek shoku ose shoqja e tyre më e afërt.

● Fenomeni i bulizmit është i përhapur në mjediset e shkollës dhe format më të përhapura të bulizmit në shkollë janë: bulizmi psikologjik, fizik dhe verbal. Vajzat adoleshente janë më shumë objektiva të bulizmit psikologjik ndërsa djemtë objektiva të atij fizik.

● Në studim rezultoi se nxënësit meshkujt janë disa herë më shumë objekt i dhunës sesa nxënëset vajza dhe për pasojë janë viktimat kryesore të bulizmit në shkollë. Duke qenë se ka një tendencë më të madhe të ushtrimit të dhunës ndaj gjinisë mashkullore gjithashtu rezulton se janë pikërisht djemtë ato që janë më shumë ushtruesit e dhunës në shkollë në krahasim me vajzat, pra janë edhe agresorët kryesorë të dhunës në shkollë.

- Grupmosha e cila është më e predispozuar për të qenë viktime e bulizmit është ajo e 15-16 vjeçarëve, ndërsa të dhënat e studimit tregojnë për një rritje të peshës specifike të 17-18 vjeçarëve si ushtrues të dhunës ndaj bashkëmoshatarëve të tyre në shkollë. Përsa i përket vendbanimit, nxënësit me vendbanim në fshat janë më të predispozuar për të qenë viktima të dhunës në shkollë.

- Përsa i përket qëndrimit që mbajnë nxënësit kur vëzhgojnë një situatë dhune në shkollë rezulton se një pjesë e konsiderueshme e tyre, rreth 33% kanë shpërfaqur një profil human të tyre duke u shprehur se gjatë situatave të dhunës në shkollë janë përpjekur që të mbrojnë viktimën.

- Rreth 60% e nxënësve adoleshentë ndjehen të sigurt në mjediset e shkollës dhe kjo lidhet me disa arsye që janë: fakti se jetojnë në një qytet të vogël dhe homogjen ku njihen të gjithë me njëritjetrin; me përkushtimin dhe përkrahjen nga ana e stafit akademik të shkollës, si mësuesit apo drejtori; me respektimin dhe zbatimin e rregullores së shkollës apo edhe me aftësitë e tyre individuale për të mbrojtur veten dhe për të pëballuar çdo problem që iu kanoset.

² Raporti botëror mbi dhunën dhe shëndetin.2002. Krug, E.G., Dahlber, L.L., Mercy, J.A., Zëi, A.B, dhe Lozana, R. Organizata Botërore e Shëndetit, Gjenevë

- Nga përgjigjet e nxënësve të anketuar rezultoi një tendencë në rritje e interesimit për ndërmjetësim, si një metodë shumë efikase për shmangien dhe zgjidhjen në mënyrë sa më efektive të konflikteve dhe një anashkalim i rolit të psikologut, për vetë faktin se në Shqipëri dhe sidomos në qytetet e vogla nuk është përhapur shumë kultura e të kështilluarit me një psikolog dhe mungesës së besimit.

Rekomandime/Sugjerime

Fenomeni bulizmit është një çështje e rëndësishme së cilës i duhet kushtuar mjaft vëmendje. Efekti i tij është një problem shumë i madh dhe i një rëndësie të veçantë pasi ai ndikon negativisht në të ardhmen e nxënësve adoleshentë. Ai ka pasoja të rënda psikologjike, ekonomike dhe sociale. Për tu marrë me këtë problem veprimi i parë që mund të sugjerohet është rritja e vëmendjes ndaj këtij fenomeni. Nëse bëhet i ditur, për nxënësit, dhe drejtuesit e shkollës, ndryshimi mund të përfshijë parandalimin dhe ndërhyrjen në kohë në favor të viktimave bulizmit. Po ashtu lind nevoja e studimeve të mëtejshme në lidhje me këtë çështje pasi aktualisht në shkollat në vendin tonë po ndodhin një sërë konfliktesh të dhunshme ndërmjet nxënësve dhe që përsëriten në kohë, duke rrezikuar jetën e tyre dhe që kanë pasoja negative për të ardhmen e tyre. Nevoja e studimeve të mëtejshme do të ndihmojë në parandalimin apo edhe uljen e rasteve të përfshirjes së nxënësve në këto sjellje negative

Referencat

1. Basow, S. (2007) *Stereotipat dhe rolet gjinore*. Tiranë: Iliria, 78, 83, 86.
2. Cohen, L., Manion, L. & Morrison, K. (2000) *Research Methods in Education* 5th ed., London: Routledge Falmer fq. 45.
3. Dahrendorf, R. (1997) *Konflikti shoqëror modern*. Tiranë: Dituria fq. 212.
4. Dervishi, Z. (2005) *Bashkëjetesë me demonët e konflikteve*. Tiranë: Jeruzalem.
5. Delbert S. Elliot., Beatrix A. Hamburg. & Kirk R. Williams.(2003). *Violence in American Schools: A new perspective*. Cambridge University press, 17-20.
6. Dewey, J. (2003) *Shkolla dhe shoqëria*. Tiranë: Plejad fq. 15.
7. Dragoti, E. (1994) *Adoleshenti*. Tiranë: Hipokrati fq. 5.
8. Dragoti, E. (2004) *Psikologjia sociale*. Tiranë: BlueLine, 157, 241, 275-278, 301.
9. Giddens, A. (2007) *Sociologjia*. Tiranë: Çabej, 85, 370, 662-663, 667-669.
10. Karaj, Th (2005) *Psikologjia e zhvillimit të fëmijës*. Tiranë: Progres 316-317.
11. Kristuli, L. (2007) *Heshtja nuk është zgjidhje*. Tiranë: Shblsh e re, 37-39.
12. Ritzer, G. & Goodman, D. (2008) *Teoria Sociologjike*. Tiranë: Ufo prees, 237, 239-242, 263, 265-268.
13. Matthews, B dhe Ross, L (2010) *Metodat e hulumtimit*. Tiranë: Qendra për Arsim Demokratik. (CDE) 144.
14. Sokoli, L (2011) *Metodat e kërkimit*. Tiranë: Kristalina, 51, 189.
15. Shehu, A (2008) *Psikologji komunikimi*. Tiranë: DONOgraph.

Legal criminal protection of children on the Albanian legislation

PhD (C.) Adriatik Llalla
Prokuroria e Përgjithshme

PhD. Fjorida Ballauri

Abstract

The Constitution of the Republic of Albania provides specific provisions protecting the rights of children and youth. As part of fundamental freedoms and human rights, the Constitution recognizes children's rights and personal freedoms, economic, social and cultural.

Within the protection of freedoms and fundamental rights, the state has the obligation to guarantee facilitating procedures during the trial of children in court proceedings, and to ensure the protection of children from violence, abuse, exploitation and use for work, especially under the minimum age for child labour, which can damage the health, moral or risk his life or normal development.

Important objective remains the necessary measures for the enforcement of international acts in the field of human rights, the recommendations of international institutions, as well as obligations deriving from the implementation of the Stabilization and Association Agreement with the European Union.

This paper aims to make an analysis of the Albanian legislation, regarding the position in the criminal law for the children and the protection that is guaranteed for them, in cases when he is in the position of injured by a criminal act, but also when a children is involved as accused/ person under investigation.

However the legislation still needs to be improved in this area, being oriented towards the development of a new Code of Juvenile Justice.

Keywords: Children, protection, family, criminal legislation.

1. Overview on the legal regime of protection of children

Albania has had a permanent commitment, in terms of continuous improvement of standards related to the protection and respect of human rights and fundamental freedoms. A clear expression of commitment is the ratification or adherence to almost all international conventions on human rights and the UN Convention on the Rights of the Child by the Republic of Albania. Albania also signed the two optional protocols to the Convention on the Rights of the Child, Optional Protocol "On the Sale of Children, Child Prostitution and Child Pornography"¹; and Optional Protocol "On the Involvement of Children in Armed Conflicts"².

Convention on the Rights of the Child, which after ratification on the basis of the Constitution of the Republic of Albania has become part of domestic law, is the basis for taking the necessary measures to respect the rights under the Convention, also for general social reforms and policies to create a protective environment for children, which means the family environment, institutions, systems and society that surround the child. The legal framework for guaranteeing the rights and freedoms of individuals is constantly improved and had been developed social policies

¹ Approved by Law no.9834, dated 22.11.2007 of the Parliament of the Republic of Albania

² Approved by Law no.9833, dated 21.12.2007 of the Parliament of the Republic of Albania

aligned with international standards. Important objective remains the necessary measures for the enforcement of international acts in the field of human rights, the recommendations of international institutions, as well as obligations deriving from the implementation of the Stabilization and Association Agreement with the European Union.

Albania is a member state with rights and obligations in a number of international acts as:

- Hague Convention "On Protection of Children and Co Adoptions abroad"³
- Convention No. 182 "On the worst forms of child labour" and Recommendation No. 190, "The worst forms of child labour"⁴.
- European Social Charter⁵.
- European Convention "On the compensation of victims of violent crimes", Strasbourg⁶
- European Convention "On relations with children"⁷.
- European Convention "On civil aspects of international child abduction" signed in The Hague⁸.
- Hague Convention "On Jurisdiction, Applicable Law, Recognition, Enforcement and Co-operation in Respect of Parental Responsibility and Measures for the Protection of Children"⁹.
- Agreement between the Government of the Republic of Albania and the Republic of Greece for the protection and assistance of child victims of trafficking¹⁰,
- Optional Protocol to the Convention "On the Rights of the Child", "On the sale of children, child prostitution and child pornography"¹¹,
- Optional Protocol to the Convention "On the Rights of the Child", "On the involvement of children in armed conflicts"¹²,
- Agreement between the Republic of Albania and Iceland on the readmission of persons residing without authorization"¹³.
- Council of Europe Convention "On Protection of Children against Sexual Exploitation and Sexual Abuse" (Lanzarote)"¹⁴.
- European Convention "On Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms"¹⁵
- Council of Europe Convention "On the exercise of the rights of children"¹⁶.
- Council of Europe Convention "On Legal Status of Children born out of wedlock"¹⁷
- Hague Convention "On the international recovery of child and other forms of

³ Ratified by Law no.8624, dated 15.06.2000 of the Parliament of the Republic of Albania

⁴ Ratified by Law no.8774, dated 23.4.2001 of the Parliament of the Republic of Albania

⁵ Ratified by Law no.8960, dated 24.10.2002 of the Parliament of the Republic of Albania

⁶ Ratified by Law no.9265, dated 29.7.2004 of the Parliament of the Republic of Albania

⁷ Ratified by Law no.9359, dated 24.3.2005 of the Parliament of the Republic of Albania

⁸ Ratified by Law no.9446, dated 24.11.2005 of the Parliament of the Republic of Albania

⁹ Ratified by Law no.9443, dated 16.11.2005 of the Parliament of the Republic of Albania

¹⁰ Ratified by Law no.9544, dated 29.05.2006 of the Parliament of the Republic of Albania

¹¹ Adhered to by the Law no.9834, dated 22.11.2007 of the Parliament of the Republic of Albania

¹² Adhered to by the Law no.9833, dated 22.11.2007 of the Parliament of the Republic of Albania

¹³ Ratified by Law no.10 015, dated 6.11.2008 of the Parliament of the Republic of Albania

¹⁴ Ratified by Law no.10071, dated 9.02.2009 of the Parliament of the Republic of Albania

¹⁵ Ratified by Law no.8137, dated 31.07.1996 of the Parliament of the Republic of Albania

¹⁶ Law no. 10 425, dated 02.06.2011 for the Ratification of the Council of Europe "On the exercise of children's right".

¹⁷ Law no. 10 424, dated 02.06.2011, for the ratification of the Council of Europe "On the legal status of children born outside marriage"

support for other family members”¹⁸

- Convention of the Council of Europe “On Measures against Trafficking in Human Beings”¹⁹
- Cooperation Agreement on the Establishment of the National Referral Mechanism (NRM) for Identification and Improved Assistance for Victims of Trafficking in Human Beings²⁰
- Council of Europe Convention “On prevention and combating violence against women and domestic violence”²¹.
- Optional Protocol to the Convention “On the Rights of the Child” for the “Communication Procedures”²².

Despite the continues efforts to protect and guarantee the fundamental rights of children, reports of different international organizations as well as local, concludes that there are still problems in the effective implementation and institutional mechanisms that operate in this field in Albania²³.

2. Legal protection of minors in criminal legislation

The Constitution of the Republic of Albania²⁴ has provided special provisions to protect the rights of children and youth. As part of fundamental freedoms and human rights, the Constitution recognizes children’s freedoms and individual rights (protection of life), political, economic, social and cultural.

With king Zog, Albania will search the political and national unity by developing its civilization much more. (Hupchick, Palgrave Macmillan, 352). At 5:30 after the oath ceremony, king Zog returned from the royal palace, where he met with Ugo Sola, Italian minister and with representatives of Italian legates in Albania. (AMPJ, 1929, d. 266.7). "Ugo Sola congratulated Zog and declared in the name of Italian government, to enter in official relationship with Albanian royal government". (Duka, Toena, 2011, 123). After the announcement of Albanian Kingdom, began congratulation from foreign countries.

First from Italy, where recognition of Zogu as "King of Albanians" greeted the king of Italy, Viktor Emanuel III, who wrote: "In the solemn circumstance I give you the hottest wishes for the happiness of your kingdom and for the prosperity of your people. (AMPJ, 1928, d. 64, 92). Also, he thanked the king Zog for the award of decorations

“Albanian’s largest travalties”. (AMPJ,1928,d.64, 92). Ahmet Zogu answerd to “Viktor Emanuels through a telegram “He ensures that he will always follow his example of greatness and culture of his people. (AMPJ, 1928, d. 64, 92). Also, congratulations telegram came from Musolini.(AQSH, 1928, d. 1-6,1). Zogu answerd to him : “In this moment, when people are calling their king, i am happy to manifest to your excellency, how much i and albanians appreciate you”.(AQSH, 1928, d. 16, 62). Musolini in another telegram wrote to Zog: “I am happy that i have the chance to ensure your excellency, that Italy will follow in the future it’s policy its unwavering friendship to you and your government, who are not conserve their best and noble efforts for the progress of Albania”. (AMPJ, 1928, d. 64, 92). Your feelings have been so good towards me, are seen in monarchic regime stability in our national connections, which guarantee the continuation of the deep ties and honest that exist between the two countries.(Pearson, 2004, 296). The king Zog wrote to Musolini acknowledgment for the recognition, that Italy made to Albanian Kingdom, who raised up cooperation between the two countries.(AQSH. 1929, d. 858, 11).

USA government recognize the Albanian Kingdom.

The recognition from Italy happened at the same day with the announcement of Albanian Kingdom. Italy firmly upheld Zog to meet it’s economic interests for the strategic position that Albania had. Italy was safer to realize an eksasioniste policy in Balkans throught Albania and furthermore governed by Zog, who was known for his filo-albanian views. The announcement of Albanian Kingdom and the coronation of Zog as king, was spread like news not only by official Tirana and the local press, but also from foreign chancellery, as those Italian diplomacy, through the American minister accredited in Albania, Charles. C. Hart, made known to the American state secretary, Castle, that Zog I, was proclaimed at 9 o’clock in the morning, as King of Albanians”.

Firstly the announcement of Albania Kingdom caused a concern in diplomatic bodies, as those french, yougoslav, turkish, german, english. (Pearson, 2004, 296). According to american diplomacy documents, the announcement of Albania Kingdom and especially the proclamation of Ahmet Zogu as “King of Albanians” sparked a concern in the international factor, especially in Yugoslavia. (AQSH. 1928, d. 14, 15). The american minister made known that his yugoslav counterpart had said to him that the issue lay in the fact, that his government would have enough time in relation to this issue and that there was nothing about this proposal and the effect that can be created for the new monarch of the albanians, both inside and outside of Albania.(FRUS, 1928 vol. I, 846)

The albanian diplomacy made efforts through the minister of foreign affairs Iliaz Vrioni, for the recognition of Albanian Kingdom from the greatest power of the world USA. Iliaz Vrioni demanded recognition of Albanian Kingdom through a diplomatic mark in which he reassured: “The government of his majesty was intended to develop good relationship that exists between the two countries . Although the Balkans will have a new kingdom, that he will serve like a peace factor in Balkans. In terms of changing the regime in Albania. I believe we’ll have good intentions for the new government”.(FRUS, 1928,vol. I. 845-846)

Also, king Zog through a telegram addressed to the american president expressed

: "My government has taken the notification regarding the decision of the national Assembly in the form of the regime change in Albania, in a constitutional monarchy and the proclamation of president Ahmet Zog, Zogu I, King of Albanians. Now i have the satisfaction to inform your majesty under instructions from my government, that the USA government will recognise the Albanian Kingdom.(FRUS, 1928, vol.I 847) . USA answered to Zogu's telegram, through it's secretary Kellog: "Is a satisfaction that i expect from your majesty and from the people in Albania, congratulations on the occasion of his enthronement . The american people will join with the best wishes for your majesty, for health, happines and prosperity in Albania. The department will communicate later the credentials papers of recognition"(FRUS, 1928, vol. I, 846- 847). The news of the recognition of Albanian Kingdom became known from the press office of Albania ministry of foreign affairs, which informed the Korce, Gjirokaster,Shkoder, Durres prefectures, in connection with the telegram arrived from the USA president , Kulixh in which was written: "The american people together with me displays the best accomplished for the health and happiness of your majesty and for the prosperity of Albania".(FRUS, 1928, vol. I, 847). The news of the recognition of king Zog from USA, was made known in international opinion also from the foreign minister Koco Kota, who thanked USA for the recognition of king Zog as "Albanians King". The Albanian Kingdom was recognised in 13 september from USA. One day later king Zog will send a congratulations letter telegram to the american president Kulixh with these words: "It was very appreciative of the friendly act from the USA. Followed by further the albanian people is very grateful for the hospitality in which the big republic of USA, done to albanians with benefits and american culture". (AMPJ. 1928. d. 64, 848-849). Since USA was first from the Biggest Powers, except Italy, that first recognised the monarchic regime in Albania. Regarding to Grate Britain and France they would recognize in 21 September.

The attitude of official Belgrade

Yugoslavs in a way imposed by circumstances that were created within the international factor, and recognised the Albanian Monarchy, even for a reason, so as not to leave a bad impression, especially in the eyes of internationals. Yugoslavia over USA ministry accredited in Belgrade, John Dyneley Prince, send a telegram to the USA secretary Kellog, in connection with the recognition of the Albanian monarchy by Belgrade, where she pointed to the recent recognition by the USA of Ahmet Zogu, as "King of Albanians".(FRUS, 1928, vol. I, 849- 850). The American foreign minister made known to USA, that the Albanian minister in Belgrade, Mr. Tahir Shtylla, has phoned him to express appreciation of the act of recognition by the USA, like a positive and friendly act. Mr. Shtylla made known to American foreign minister, that was surprised by the fact, that USA, the greatest power of the world was among the first which knew Albanian Monarchy.Tahir Shtylla was expressed from Belgrade:

"The recognition of Albania Kingdom from USA, but also from Italy, Hungary, Bulgary,Greece, has a great importance for the new regime, but by the USA a friendly action that will go to the stabilization of the government of king Zog in th eyes of the world".(FRUS, 1928, volII, 849- 850). The recognition of the Albania Kingdom from Yugoslavia, was commente quickly from the accredited Albanian minister in

Belgrade, Tahir Shtylla. He expressed the deepest gratitude in recognition of the new king Zog from Yugoslavia, which followed the USA action. The American foreign minister Prince made known that to Mr. Shtylla, that USA didn't have connection with the recognition, that the official Belgrade made to king Zog and assured him, that USA didn't have any influence, and was not part of persecution of Yugoslavia, in recognition of king Zog. (FRUS, 1928, vol. I, 850). Yugoslavia recognized the Albania Kingdom at the same day with USA. (FRUS, 1928, vol. I, 851). Mr. Tahir Shtylla smiling to the American foreign minister said: "In the end the American example stimulated Yugoslavia in recognition of king Zog. Without waiting the response and action of France and England, as Mr. Sumenikovic Yugoslav minister send me words, that he wasn't obligated to do that.

Mr. Tahir Shtylla made known that the Yugoslav minister Sumenikovic had made known to him, that he could wait for the action of France and England, who smiling and said: "We decided not to be the first to recognise the Albanian Kingdom, because if we know how to keep good relations with Italy we should know the Albanian Kingdom sooner or later. Yugoslavs accelerated to recognize the Albanian Kingdom, so that they were not the last after an exchange of diplomatic notes between Belgrade and Rome. Yugoslavia decided to recognize it, in 13 September. The Belgrade government to not further aggravated the relations with Albania, but also with Italy, recognized the Albanian monarchy regime. Yugoslavia was the fifth who recognised the Albanian monarchy regime. The recognition of the Albanian kingdom from Yugoslavia has a great importance after Belgrade has held a sceptic attitude to it. Dielli newspaper in USA wrote: "Yugoslavia has understood its mistake and from now and on with take other political". (Dielli, 1928, 1) After the announcement of Albanian Kingdom as well as Yugoslav recognized it, king Zog resumed efforts to establish relationship with Yugoslavia. King Zog appointed as minister in Belgrade, in September 1928, Mr. Xhallafer Villen. He enjoyed a great reputation in Albania, but also in Yugoslavia.

Conclusions

The announcement of Albania Monarchy, marked one of the biggest successes of political career of Zog. In diplomatic plan, the Albania Monarchy has stabilized relations with some of leading European countries. The king Zog I, will be approached diplomatically with many countries, by foreign alliances with, Italy, USA, France, England, Austria, Sweden, Hungary, Bulgaria etc. The Albania Kingdom was recognized later by Greece and Turkey. At the beginning, England and France didn't keep a positive attitude in connection of Albanian Monarchy. Regarding to England in the beginning had expressed a dissatisfaction towards the title to be held by Zog. Official Tirana had not requested an opinion to London, also not for the change of the form of regime. In Balkan, Yugoslavia, Greece and Turkey, recognized later, but the recognized of USA government to king Zog like a King of Albanians" and with her intervention, almost all of the countries will recognize king Zog I. But also, Turkey with the interference of the Great Powers would recognize the Albanian Kingdom. Later and Canada, Australia, South Africa and Ireland recognized king Zog I, "King of Albanians".

References

- AMPJ, (Albanian Foreign Affairs), Fondi 151, (1928- 1929).
AQSH, Fondi, 1, 4/6, 90, 151, 187, (1928- 1929).
Akademia e Shkencave, Instituti i Historisë. (1984), *Historia e Shqipërisë*. Tiranë.
Dielli, (1928), Boston, Massachusetts.
FRUS. (Foreign Relations of United States), vol. I, (1928).
Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Duka, Valentina. (2011). *Nga presidenca në monarki, çështje të legjitimitetit*. Tiranë, Toena.
Fischer, Bernd. (1984), *Përpjekjet e mbretit Zog për stabilitet në Shqipëri*. Tiranë, Çabej.
Hupchick, P. Dennis. *The Balkans from Constantinople to Communism*, Palgrave, Macmillan.
Pearson, Owen. (2004). *Albania and king Zog*. Tiranë.

Environmental law and its legal protection in Albania

Msc. Denisa Naqellari

Lecturer at "Aleksander Xhuvani" University in Elbasan, Albania

Msc. Griserda Topi

Ass. lecturer at "Aleksander Xhuvani" University in Elbasan, Albania

Abstract

This is a work which aims to address a relatively new matter of law, but important, exactly the Environmental Law (Fair). In this paper will be a general overview of the national environmental law, a description of terms about environmental justice, environmental crime, the manner of identification and prevention of environmental damage in Albania. The most important part is related to the impact of the implementation of environmental legislation in the implementation of human rights. Environmental laws are designed to important topics dealing mainly with conservation of nature and protection an integral part of nature. According to **Leo Stilo**, increasing awareness about limiting and extreme fragility of natural resources, which were once considered limitless, there is clear evidence of a need for greater protection and more effective environment. Rapid economic development and the flourishing of private initiative, the necessity of protecting the environment, ecosystems, biodiversity, raises questions about the ability of our society to pass the current environmental crisis and to prevent environmental crime, is happening on Earth planet. In this work is included the analysis of Albanian environmental legislation, cases of violations and the provisions of the Criminal Code (the study of the analysis of the reports of the General Prosecutor). An important part is the role of state institutions and non-governmental organizations for environmental protection in Albania. Of course, this work will also include the main environmental problems in Albania.

Keywords: *Environmental Fair, environmental condition, National Legislation, the Prosecutor General's report.*

Hyrje

*"Aktivist nuk është njeriu që thotë
lumi është i ndotur, është njeriu që e pastron atë"*

Ross Perot

Gjatë 50 viteve të fundit, një bashkësi evenimentesh të pafavorshëm, ndonjëherë katastrofikë, kanë kontribuar që qytetarët e vendeve më të zhvilluara të ndërgjegjësohen për përgjegjësitë politike që civilizimi industrial sjell dhe për prishjen e ekuilibrave (Thomollari Z., 2006). Sipas F. Antich, në këtë kontekst mbrojtja dhe përmirësimi i mjedisit janë shndërruar në prioritet të një rëndësie të veçantë, duke qënë se ato janë parakusht për mirëqënien e popujve dhe zhvillimin e gjithë botës në tërësi. Një numër i madh aktesh juridike janë miratuar në nivel kombëtar e ndërkombëtar, me synim mbrojtjen e mjedisit. Efektet negative të disa shkeljeve mjedisore, të cilat në ndonjë rast mund të sjellin edhe pasoja katastrofike për mjedisin, janë bërë shkak që e drejta dinamike e mjedisit të zgjerohet më tej në fushën e legjislacionit penal, me

synim arritjen e objektivit kryesor për një mbrojtje efektive të mjedisit nga ndotja dhe dëmtimi.

Sipas Official Journal of the European Communities, krimi i rëndë mjedisor përbën një kërcënim për mjedisin, i cili kërkon një reagim të fortë dhe një veprim të bashkërenduar midis shteteve të ndryshme për të mbrojtur mjedisin nëpërmjet të drejtës penale. Interpol Environmental Crime Programme ka argumentuar se duke u bazuar në format më tipike dhe kryesisht ato më të rënda të shfaqjes së kriminalitetit mjedisor në botë është konstatuar se krimi mjedisor parqet këto karakteristika dhe efekte kryesore: Është një nga format më fitimprurëse të kriminalitetit që shfaqet në të gjithë botën, duke nxjerrë çdo vit një fitim prej miliarda dollarësh.

Është një kriminalitet në rritje të vazhdueshme, i cili përbën një problem serioz ndërkombëtar që mund të ndikojë në ekonominë, sigurinë dhe madje edhe vetë ekzistencën e një shteti.

Një pjesë e konsiderueshme e krimeve mjedisore kryhet në kuadrin e krimit të organizuar, si një veprimtari e mirëplanifikuar. Shpesh shoqërohet me kryerjen e veprave të tjera penale si p.sh. me korrupsionin, pastrimin e parave etj. Mund të luftohet në mënyrë efikase përmes përkushtimit dhe veprimit të përbashkët të organeve të zbatimit të ligjit, organizatave mjedisore etj. Shpesh dëmton më shumë shoqërinë se sa individë të veçantë, pasi kur dëmtohet mjedisi, nuk shfaqet domosdoshmërisht një dëm i menjëhershëm në jetën apo shëndetin e njerëzve. Ka natyrë ndërkufitare.

Të dhëna të përgjithshme mbi krimin mjedisor

Të kryesh një krim mjedisor, do të thotë të dhunosh me paramendim standardet mjedisore që mbrohen me ligj. Veprime të tilla mund të rezultojnë shumë mirë në akte ligjore, pavarësisht nëse janë të natyrës administrative, penale, civile apo tregtare. Krimi mjedisor, në dallim nga krimet e tjera kërcënon mbijetesën e vetë qenieve njerëzore. Në varësi të perspektivave të ndryshme mbi krimin mjedisor si psh. ato morale, filozofike, juridike, ligjore etj, me krim mjedisor kuptohen "vetëm ato veprime ose mosveprime që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë dëmtojnë mjedisin dhe që janë të ndaluara me ligj".¹ Sipas Komisioni Europian në krim mjedisor përfshihen disa kategori veprash penale ose ndryshe "ato veprime ose mosveprime që dëmtojnë mjedisin në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë dhe që konsistojnë në një shkelje të legjisllacionit"² Krimi mjedisor mund të jetë vendor ose mbivendor, kombëtar ose ndërkombëtar, statik ose i lëvizshëm. Ai mund të kryhet nga individë ose nga një organizatë dhe, në të dyja rastet, mund të jetë i lidhur me lloje të tjera aktesh kriminale. Disa lloje të krimit mjedisor duhet të kategorizohen si 'krim organizatë', madje, më mire, si krim i 'organizatave kriminale'³. Në një studim të vitit 1995, autorët Michael Faure dhe Marjolein Visser kanë propozuar dhe analizuar katër modele të krimeve mjedisore⁴. Modeli i veprave penale të "rrezikimit abstrakt"

¹ S. Bell, D. McGillivray, *Environmental Law*, seventh edition, Oxford University Press, 2008, f254-255.

² Commission Staff Working Document, *Accompanying Document to the Proposal for a directive of the European Parliament and of the Council on the protection of the environment through criminal law*, Impact Assessment, Brussels, 9 February 2007, SEC (2007) 160, f4.

³ Frans Geysels Nathan Johnson *Manaxhimi i burimeve natyrore dhe lufta kundër krimit mjedisor*, dhjetor 2013

⁴ M. Faure, M. Visser, *How to Punish Environmental Pollution? Some reflections on Various Models of Criminalisation of Environmental Harm*, *European Journal of Crime, Criminal Law and Criminal Justice*, Vol.3, Nr.4, 1995, f316-368, S.F. Mandiberg, M.G. Faure, *A graduated punishment approach to environmental crimes: Beyond vindication of administrative authority in the United States and Europe*, f 451-452.

(Abstract Endargement), i cili inkriminon mosbindjen apo shkeljen e rregullave e kërkesave administrative. Modeli i veprave të “rrezikimit konkret” (Concrete Endargement), i cili përfshin sjellje që jo vetëm shkelin legjislacionin rregullator, por edhe paraqesin një kërcënim për dëme në mjedis. Këto vepra penale, së paku synojnë dy dëme sociale. Modeli i veprave të “dëmit konkret” (Concrete Harm) përfshin ato sjellje që jo vetëm shkelin një rregull administrative, por edhe shkaktojnë dëme konkrete në mjedis. Modeli i katërt i krimeve të “dëmit të rëndë në mjedis” (Serious Environmental Harm), përmes të cilit dënohen sjelljet që shkaktojnë dëme shumë të rënda mbi mjedisin. Përmes këtij modeli synohet të parandalohet ose të dënohet vetëm dëmi i shkatuar ndaj vetë mjedisit, pavarësisht nëse autori ka shkelur apo jo kërkesat e lejes ose rregulla të tjera të kuadrit rregullator.

Karakteristikat e krimit mjedor

Referuar informacioneve të marra nga “Libërth për Krijimin e Rrjeteve të Mjedisit”, Manaxhimi i Burimeve Natyrore dhe Lufta kundër Krimit Mjedor, me autor Frans Geysels, Kryeinspektor – Shef i Shërbimit për Krimin Mjedor në Policinë Gjyqësore Federale të Belgjikës dhe Nathan Johnson, redaktor i Green Horizon Online, REC dallojmë këto karakteristika të krimit mjedor:⁵

1. Pak shkelës, shumë viktime. Ka shumë shembuj të kësaj karakteristike të parë. Një shembull është djegia e paligjshme e mbetjeve të vajit – të cilat, me gjasa, përzihen me mbetje kimike – dhe përdoren për të ngrohur serrat ku rriten zarzavatet. Ndotësit që shkarkohen nga kaldajat e serrave paraqesin rrezik ekstrem kur përhapen në zonat përreth. Gazrat që përhapen afër tokës kërcënojnë ujin dhe ekosistemet tokësore, si edhe shëndetin e shumë banorëve të zonës. Prapa natyrës hapësinore të këtij tipi të krimit mjedor, ka, gjithashtu, edhe implikime të tjera të përkohshme. Substanca të ndryshme janë të përziera me mbetje vajrash, për të rritur kapacitetin ngrohës ose për të shtuar vlerën kalorifike të produktit të gatshëm. Këto përzierje toksike janë shumë të qëndrueshme dhe akumulohen në zinxhirin ushqimor, duke paraqitur një kërcënim afatgjatë të numrit, në rritje, të viktimave.
2. Shkelësit e padukshëm të ligjit⁶. Shkaktarët e krimit mjedor janë, relativisht, të padukshëm, ndaj shpesh është mjaft e vështirë që ata të dërgohen para drejtësisë. Gjithashtu, strukturat komplekse organizative e bëjnë të vështirë ngritjen dhe formulimin e akuzave ligjore kundër firmave të mëdha, për veprimtaritë e tyre të dyshimta, të përsëritura, kriminale ndaj mjedisit – ose, së paku, t’i ngarkojnë ato me përgjegjësi.
3. Pabarazia e pushtetit mes shkelësve/dhunuesve dhe viktimave. Zyrtaret e qeverisë ushtrojnë pushtet dhe ndikim, por industrinë ndotëse tentojnë, gjithashtu, të kenë pushtet të madh ekonomik dhe shoqëror. Kjo lloj dinamike krijon për shumë prej tyre konflikt interesi. Në terma ligjore, dy grupe qytetarësh (banorët dhe prodhuesit) hyjnë në konflikt, ndërsa qeveria duhet të veprojë si ndërmjetëse ose vendimmarrëse. Shumë shpesh, mosveprimi nga ana e qeverisë i atribuohet faktit që interesat mes prosperitetit (punësimit, përfitimit ekonomik) dhe mirëqenies (rrezikimi i saj nga ndotja mjedor), bien ndesh me njëri-tjetrin, duke krijuar shpesh përballje të ashpra mes grupeve konkurruese të interesit.

⁵ Frans Geysels Nathan Johnson *Manaxhimi i burimeve natyrore dhe lufta kundër krimit mjedor*, dhjetor 2013

⁶ Po aty.

Kështu, shumë shpesh, grupet e zhgënjyera të qytetarëve lihen të jetojnë me pasojat e dëmtimit të mjedisit.

4. Shanse relativisht të ulëta për kapjen e shkelësve të ligjit. Sigurisht që kjo përbën një nga pasojat e drejtpërdrejta të padukshmërisë relative të shkelësve të ligjit mjedisor. Kemi parë, më shumë se një herë, se krimi mjedisor është realisht i organizuar me degë dhe me struktura të errëta ndërkombëtare.
5. Mospranimi i ekzistencës së problemit. Lista jonë e karakteristikave të krimit mjedisor duhet të përfshijë edhe njohjen e faktit se krimi mjedisor nuk renditet shumë lart në listën e përgjithshme të shqetësimeve të karakterit social. Qasja e rastësishme ndaj problemeve mjedisore ka pasur një ndikim katastrofik, si në aspektin e legjislacionit, ashtu edhe në atë të organizimit administrativ dhe, pa dyshim, ka pasur edhe një mungesë harmonizimi në veprimtaritë e ndërmarra për zbatimin e legjislacionit mjedisor. Nëse kjo duhet të ndryshojë, krimi mjedisor është dicka që, si qeveria, edhe qytetarët duhet ta marrin shumë seriozisht.
6. Mungesa e vëmendjes. Përgjithësisht, krimi mjedisor është një lloj krimi që nuk raportohet gjërësisht. Në krahasim me krimet e tjera dhe me aktet e dhunës, krimi mjedisor 'lëviz' diku poshte radarit të mediave. Për rrjedhojë, prirja është që raportimet e krimi mjedisor të vijnë drejtpërdrejt nga vetë hetuesit dhe zbatuesit e ligjit.

Të dhënat e policisë lidhur me krimin tradicional janë shumë të hollësishme dhe japin një pamje të qartë të fenomenit, por nuk ndodh aspak kështu për krimin mjedisor. Për shembull, nisur nga raportet e policisë, është plotësisht e mundur të përvijohet një pamje e plotë e vjedhjes së një makine: por pak bëhet në këtë drejtim, për shembull, për prerjen dhe tregtimin e jashtëligjshëm të lëndës drusore. Mungesa e profilit fenomenologjik të një krimi të caktuar e vështirëson rolin proaktiv të veprimeve të policisë. Ndërkohë që krimi mjedisor është i padukshëm, oficerëve të policisë, që nuk janë të specializuar në fushën e mjedisit, përgjithësisht u mungon edhe trajnimi për të kuptuar se ku dhe kur ndodh ky lloj krimi.⁷

Motivet e krimit mjedisor

Krimet kryhen për arsye nga më të ndryshmet. Disa krime mjedisore përfshijnë planifikimin dhe kryhen me paramendim me qëllim të keq, ndërsa të tjerë kryhen nga injoranca (mosnjohja e ligjit), nga mungesa e përgjegjshmërisë ose nga pakujdesia. Sipas Frans Geysels, Kryeinspektor – Shef i Shërbimit për Krimin Mjedisor në Policinë Gjyqësore Federale të Belgjikës veçojmë:⁸

1. Mosnjohja e ligjit

Nje numër i caktuar shkeljesh kryhet për shkak të mosnjohjes së ligjit. Njerëzit janë shpesh të pandërgjegjshëm për pasojat e dëmshme që veprime të caktuara kanë në mjedisin e tyre. Megjithëse derdhja e lëngjeve ftohëse mund të duket e padëmshme, kjo mund të dëmtojë organizmat e gjallë, të cilët nuk mund t'u mbijetojnë luhatjeve të mëdha të temperaturës. Nëse të tilla lëngje derdhen në sasi të mëdha, këto veprime mund të shkaktojnë ndryshime në biodiversitetin dhe në qëndrueshmërinë e ekosistemeve.

2. Pakujdesia

Megjithëse gjithnjë e më të pakta, veprimet/shkeljet për shkak të pakujdesisë janë

⁷ Frans Geysels Nathan Johnson *Manaxhimi i burimeve natyrore dhe lufta kundër krimit mjedisor*, dhjetor 2013.

⁸ Po aty.

ende shkak i dëmeve të ndryshme në mjedis. Dikush mund të derdhë vajin e përdorur për skuqje në tubacionet e ujërave të zeza, për t'i kursyer vetes mundin e dërgimit të tij të një konteiner mbetjesh vaji. Veprime të tjera kriminale ndaj mjedisit që, zakonisht, i atribuohen pakujdesisë, kryhen, në të vërtetë, me synimin e qartë për të zvogëluar kostot ose për të rritur përfitimet – domethënë, duke mashtruar.

3. Shkelja e rregullave

Kompanitë shpesh orientohen drejt një numri veprimtarish që janë në kundërshtim me legjislacionin bazë të mjedisit ose me kushtet e lejes mjedisore të funksionimit të kompanive. Shumica e shkeljeve përfshijnë ndotjen e mjedisit nëpërmjet djegies ose shkarkimit të lëndëve ndotëse. Gjithashtu, duhet thënë se hedhja e jashtëligjshme e mbetjeve ka forma të ndryshme. Një kompani mund të hedhë mbetje (të dëmshme ose jo) në një vend të paautorizuar; ajo mund të shkarkojë sasi të ndryshme lëndësh të dëmshme të panjohura; mund të përdorë një 'by-pas' për të shkarkuar ujëra të ndotur në sasi që tejkalojnë normën e lejuar; ose sasi të tepërta të çdo lloji mbetjeje. Këto aktivitete që përmendëm më sipër mund të duken thjesht aksidentale, por, po t'i shohim më nga afër të dhënat administrative (policat për çdo rrugë, certifikatat e djegies, regjistrimin e shkarkimeve të mbetjeve apo të ujërave të ndotura, raportet e analizave, faturat etj.), ato mund të nxjerrin në pah se këto aktivitete të jashtëligjshme kryhen prej vitesh të tëra. Ndonjëherë, autoritetet monitoruese përpiqen të merren me të tilla krime, por përvoja tregon se asnjëherë nuk janë raportuar dhe, kështu, natyra e strukturës kriminale mbetet e fshehtë. Rregullat, kushtet dhe standardet vëzhgohen më mirë kur mekanizmat e zbatimit të tyre funksionojnë në mënyrë të efektshme. Por, sidoqoftë, ekziston gjithmonë mundësia që shkelësit të veprojnë me dredhi dhe me mashtrime për t'iu shmangur legjislacionit mjedisor – dhe, ndërsa me kalimin e kohës këto metoda sofistikohej, veprimtaria e paligjshme mund të degjenerojë shumë shpejt në krim serioz të organizuar.

4. Mashtrimi flagrant

Prapa shumë shkeljeve në dukje më të rafinuara, qëndrojnë qëllime keqbërëse. Kur synimi i mirëfilltë në kryerjen e këtyre shkeljeve është gjenerimi i përfitimeve të shpejta, dhunuesit/shkelësit vendosin në mënyrë të vetëdijshme se cilat rregulla, kushte dhe ligje do të shkelin ose për të siguruar minimumin e lejeve që kërkon veprimtaria e tyre. Këta individë nuk shqetësohen aspak për dëmin që i shkaktojnë mjedisit – një pjesë e këtij dëmi mund të jetë ndoshta i pakthyesëm. Hedhja sistematike në mjedis e mbetjeve të jashtëligjshme është një shembull bindës. Këto vitet e fundit, kostoja për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve është rritur në mënyrë të jashtëzakonshme, pjesërisht, për shkak të taksave të larta. Për rrjedhojë, një menaxher 'i pandershëm' mund të përpiqet të hedhë në mënyrë të jashtëligjshme një pjesë apo të tëra mbetjet e kompanisë së tij, për të zvogëluar kostot e trajtimit të tyre dhe për të shmangur pagesën e taksave përkatëse. Kështu, ai hedh mbetje të rrezikshme në vendgrumbullimet e mbetjeve shtëpiake/familjare. Por, nëse substancat e rrezikshme përfundojnë në venddepozitim të gabuar, ato mund të dëmtojnë cilesinë e tokës dhe të ujit të pijshëm. Po ashtu, kompanitë mund edhe t'i djegin në mënyrë të gabuar mbetjet e rrezikshme, duke shkaktuar, kështu, ndotjen e ajrit. Ato harrojnë se djegia e mbetjeve të rrezikshme ka pasoja jo vetëm në shëndetin e njerëzve dhe të popullsisë lokale, por edhe të vete punonjësve të këtyre kompanive që bëjnë djegien e mbetjeve.

Zhvillimi i legjislacionit shqiptar

Në Shqipëri fillesat e legjislacionit mjedisor shfaqen në vitin 1993, vit në të cilin u hartua plani i parë i veprimit në fushën mjedisore, që përbën dokumentin e parë zyrtar mbi politikat mjedisore në vend. Ky plan veprimi kombëtar parashikonte se qeveria duhet të krijojë kuadrin ligjor, ekonomik dhe institucional për zgjidhjen e çështjeve mjedisore.

Legjislacioni shqiptar në fushën mjedisore mund të grupohet në tri kategori:

1. Legjislacion sektorial
2. Legjislacion kuadër
3. Legjislacion penal

Legjislacioni sektorial nënkupton aspekte të ndryshme të mjedisit dhe veprimtarisë njerëzore p.sh.ligji mbi tokën, jetën e egër, mjedisin detar, parqet kombëtare etj.

Legjislacioni kuadër mjedisor është një ligj që rregullon kuadrin ligjor dhe institucional pa synuar ta rregullojë atë plotësisht atë sektor të caktuar. Legjislacioni penal përcakton përgjegjësinë në raste të caktuara lidhur me mjedisin. Provimi i faktit se dikush është përgjegjës për një vepër penale shoqërohet me një dënim penal. Veprat e ndryshme penale kundër mjedisit parashikohen në nenet 201-207.⁹ Sipas Kodit Penal përbëjnë vepër penale:

1. Ndotja e ajrit
2. Transporti i mbeturinave toksike
3. Ndotja e ujit
4. Peshkimi i ndaluar
5. Prerja e paligjshme e pyjeve
6. Prerja e drurëve dekorativë e frutorë
7. Shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve

Ligji i ri kuadër që është në fuqi¹⁰ është përafuar plotësisht me Direktivën e BE-së “Mbi përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi ambientin” të ndryshuar. Ai është hartuar si pjesë përbërëse e një pakete ligjore të propozuar nga Ministria e Mjedisit në qershor të vitit 2011. Në bazë të përcaktimeve të plota e të detajuara të këtij ligji të ri¹¹, parimet e përgjithshme të mbrojtjes së mjedisit janë:

1. Zhvillimi i Qëndrueshëm
2. Parandalimi dhe marrja e masave paraprake
3. Ruajtja e burimeve natyrore
4. Zëvendësimi dhe kompesimi
5. Qasja e integruar
6. Përgjegjësia e ndërsjelltë dhe bashkëpunim.

Rekomandime

1. Nevojiten fusha sensibilizuese nga organet përkatëse shtetërore apo nga organizata joqeveritare mjedisore për rritjen e shkallës së ndërgjegjësimit të individëve apo personave juridikë në mënyrë që veprimtaritë e tyre mbi mjedisin të sjellin sa më pak dëm për të.
2. Programet edukuese në mbrojtje të mjedisit duhet të jenë pjesë e kurrikulave që

⁹ Kodi Penal I Republikës së Shqipërisë, Ligj nr.7895, datë 27.01.1998.

¹⁰ Ligji nr.10 431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, I ndryshuar.

¹¹ Nenet I dhe 2 të ligjit nr.10 431/2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar.

- në arsimin fillor, me qëllim ndërgjegjësimin e brezave për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe rritjen e rolit të individit në këtë proces.
3. Shteti duhet të përcaktojë të drejtat dhe detyrimet që kanë banorët e zonave malore për pyjet dhe kullotat
 4. Për të realizuar zhvillim të qëndrueshëm të zonave malore, për të shmangur degradimin e mëtejshëm të natyrës dhe për të frenuar e parandaluar fenomenin shkatërrues të erozionit është e domosdoshme, që në hartimin e politikave për zhvillimin e ekosistemeve malore, të mbahen në konsideratë disa parime që harmonizojnë jetën e malësorëve me natyrën ku ata jetojnë.
 5. Zbatimi i Projektit për Shërbimet Mjedisore me tre komponentë kryesorë: mbështetje për përgatitjen dhe zbatimin e skemës së granteve IPARD-like të masave agro-mjedisore; pagesa për shërbimet mjedisore; mbështetje dhe monitorim institucional dhe zbatues.
 6. Mbështetja e fermerëve dhe komuniteteve rurale përmes futjes së pagesave për testimin e shërbimeve mjedisore
 7. Investime në kontrollin e erozionit, përfshirë ndërtimin e veprave të ujit për blegtorinë dhe për aktivitetet e përpunimit, përfshirë produktet pyjore jodrusore dhe produktet bujqësore.

Referenca

- Ligji nr.10 431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, I ndryshuar.
 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Ligj nr.7895, datë 27.01.1998.
- Antich F., Linee evolutive del diritto internazionale dell’ambiente. Verso un modello di protezione ambientale a livello mondiale” faqja në URL: www.ambientediritto.it
 Center for International Environmental Law–publications
- Dalia Abaviriciute, Environmental protection through criminal law: *The case study of Lithuania, for the degree of Master of Science*, University of Lund, May 2010.
- Environmental crime <http://ec.europa.eu/environment/legal/crime/index.htm>
- Geysels F., Johnson N., Libërth për Krijimin e Rrjeteve të Mjedisit, Qendra Rajonale e Mjedisit për Evropën Qëndrore dhe Lindore, Dhjetor 2013.
<http://www.ciel.org/Publications/pubhre.html>
http://www.pp.gov.al/web/Raporte_te_Prokurorit_te_Pergjithshem_353_1.php#.VMPMvv54ovl
- Interpol Environmental Crime Programme, Environmental Crime: its Global theft, f3, faqja në URL <http://www.interpol.int/Crime-areas/Environmental-crime/Resources>
- Raporte të Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi gjendjen e kriminalitetit”, Tiranë, 2010
- S.F. Mandiberg, M.G. Faure, A graduated punishment approach to environmental crimes. Beyond vindication of administrative authority in the United States and Europe, f 452 dhe 469.
- Stilo L., Tutela penale dell’ambiente: una breve introduzione ad un problema irrisolto, internet [www](http://www.ambientediritto.it) faqja në URL: <http://www.ambientediritto.it>
- Thomollari Z., Ekologjia humane 2006 (Ribotim) Elbasan.

Ndikimi i shpenzimeve qeveritare në zhvillimin ekonomik të Kosovës

Msc. Albina Selmanaj
Universiteti "Haxhi Zeka"

Dardan Qadraku
SMART consulting and partners

Abstrakt

Zhvillimi i çdo aktiviteti ekonomik ngërthen në vete edhe shpenzime për realizimin e tij. Shpenzimet si term ekonomik paraqesin bazën për krijimin e të mirave materiale (dhe jo materiale) në një të ardhme të afërt. Realizimi i një shpenzimi gjithmonë ka një qëllim të caktuar, i cili jo drejtpërdrejt duhet të krijojë të ardhura apo përfitime financiare, si dhe lë të hapur edhe mundësinë e përfitimeve të tjera për shoqërinë. Në këtë kontekst, shpenzimet qeveritare, të një shteti realizohen me qëllim që të realizojë rritje dhe zhvillimin ekonomik por jo përfitime direkte financiare në adresë të shtetit.

Duke parë rëndësinë dhe lidhshmërinë zingjyrore të këtyre shpenzimeve me rritjen dhe zhvillimin ekonomik, planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve qeveritare në mënyrë efektive dhe eficiente është çështje mjaftë e ndjeshme dhe kërkon kujdes të veçantë. Realizimi i këtyre shpenzimeve në situata mjaft të shpeshta nuk është i duhuri kështu duke lënë hapur mundësinë e keq menaxhimit dhe keqpërdorimit të mundshëm të tyre, e që në realitet paraqet një bazë shumë të fortë për gjendjen ekonomike aktuale në Republikën e Kosovës.

Për të pasur një pasqyrë më të pastër të ndikimit të shpenzimeve qeveritare në rritjen dhe zhvillimin ekonomik të vendit, duhet të referohemi në zërat real të shpenzimeve të planifikuara dhe të realizuara prandaj edhe duhet vlerësuar ndikimin e shpenzimeve qeveritare në rritjen dhe zhvillimin ekonomik të vendit ndër vite.

Fjalët kyçe: shpenzim qeveritar, rritje, zhvillim, menaxhim.

Hyrje

Shpenzimet publike njihen si harxhimet monetare të realizuara nga shteti me qëllim të financimit të nevojave shtetërore, me anë të tyre mundësohet finalizimi i aktiviteteve që i takojnë vetë shtetit. Krijimi i këtyre shpenzimeve është tërësisht i varur nga të ardhurat shtetërore të cilat arkëtohen gjatë një viti fiskal prandaj shtjellimi i ekzistencës së shpenzimeve është i pa mundur nëse nuk njihen edhe të ardhurat shtetërore. Përgjegjësin për menaxhimin e shpenzimeve e bartë qeveria e një shteti e cila me ndarjen e buxhetit e bartë autoritetin e saj tek njësit tjera siç janë ministrat, komunat, agjensionet etj. Realizimi i të hyrave dhe shpenzimeve janë një ndër kontribuesit më të mëdhenj në rritjen dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës. Mirë menaxhimi i këtyre dy aktiviteteve paraqet hapin e parë drejt arritjes së plotësisht të këtij qëllimi. Ky proces është pjesë e ligjit të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, i cili ka mandat një vjeçar dhe legjitimitet të plotë.

Krijimi i të hyrave dhe shpenzimeve shtetërore

Mjetet me të cilat shteti i përcakton nevojat e veta (shtetërore, shoqërore) me kompetencën e vet quhen të hyra publike ose shtetërore (Bozhidar, 1985,77). Të

hyrat publike mund të përkufizohen si të hyra në para (mjete monetare) gjatë një viti, të cilat i shërbejnë shtetit, bashkësive shoqërore për plotësimin (mbulimin) e nevojave buxhetore (Komoni, 1983, 468). Parimisht buxheti shtetëror krijohet nga të hyrat e shtetit konkretisht nga aplikimi i tatimeve, taksave dhe kontributeve të cilat i arkëton nga personat juridik dhe fizik. Një prej treguesve më të saktë për matjen e mirëqenies së një shoqërie janë të hyrat (Myles, 2001,62). Në procesin e krijimit të planit vjetor të buxhetit merr pjesë çdo organizatë buxhetore e cila në detaje paraqet se cilat janë burimet e saj të hyrave dhe cilat janë shpenzimet e saj të ndara nëpër kategori të ndryshme ndërkaq pala kryesore është Ministria e Financave që është përgjegjëse për përcaktimin e politikave ekonomike dhe fiskale dhe njëkohësisht për menaxhimin e financave publike. Të hyrat kryesore në BKK realizohen përmes inkasimit të tatimeve në të cilat janë dy grupe kryesore të hyrat nga tatimi në kufi në të cilën bëjnë pjesë: TVSH kufitare, akciza, norma doganore ndërkaq në të hyrat e tatimeve vendore bëjnë pjesë: TVSH e mbledhura brenda vendit, tatimi në të ardhurat e korporatave, në të ardhurat personale, të hyrat nga bizneset individuale, të hyrat jo tatimore siç janë rastet e licencimit të telefonisë mobile, dividendëve të PTK –së, taksat, licencat, gjobat etj dhe kategoria e të hyrave vetanake paraqet hyrjet e realizuara nga nivelet qendrore dhe ato lokale.

Mjetet e grumbulluara në BKK çdo vit ndahen dhe shpenzohen për kategori të ndryshme me qëllim të përmbushjes së obligimeve shtetërore ndaj shërbyesve civil dhe në investimet kapitale për përmirësimin e jetës për qytetarët e vendit. Shpenzimet publike nuk nënkuptohen vetëm si mbulesë e shpenzimeve por investim në rritjen ekonomike të vendit në vazhdimësi çdo vit me radhë, ky proces përfshinë plotësimin e nevojave sociale të komunitetit në tërësi, investimet e ndryshme me qëllim të rigjenerimit të vendeve të reja të punës kështu duke kontribuar në uljen e nivelit të papunësisë. Rritja e shpenzimeve publike është një tregues për zhvillimin e mëtejshëm ekonomik të vendit. Buxheti i Republikës së Kosovës funksionon i ndarë nëpër kategori të ndryshme të cilat përfaqësojnë një qëllim të caktuar apo mbulojnë një shpenzim të caktuar, këto kategoritë janë:

- Paga dhe mëditje – përfshin pagesat në para të gatshme për të punësuarit që ofrojnë shërbimet shtetërore, këtu hyjnë pagat dhe mëditjet të cilat paguhen për punën apo orët e punës shtesë;
- Mallra dhe shërbime – kjo kategori mbulon shpenzimet të cilat krijohen për mirëmbajtjen e pasurive fikse, këto shpenzime konsumohen nga nënpunësit shtetëror;
- Subvencionet dhe transferet – shpenzime për qëllime jo kapitale, janë të pakthyeshme të cilat dedikohen për sektorin publik dhe privat;
- Investimet kapitale – shpenzime të cilat realizohen për asete fikse dhe në të njëjtën kohë për zhvillimin ekonomik të vendit njihen si kategoria më e rëndësishme e shpenzimeve.

Duhet pasur parasysh që rritja e kategorisë për paga dhe mëditje ndikon pozitivisht në rritjen e konsumit vendor kështu duke stimuluar prodhimin i cili si pasojë ka rritje të nivelit të ardhurave e rrjedhimisht rritje të nivelit të hyrave tatimore të cilat kontribuojnë në rritjen e buxhetit për vitin e ardhëm fiskal mirëpo si kategoria më e rëndësishme cilësohet të jetë ajo e investimeve kapitale ndërkaq kategoria që duhet të ketë nivelin më të ulët të shpenzimeve është ajo për mallra dhe shërbime.




Fig 1: Shpenzimet e RKS sipas kategorive

Burimi: BQK

Gjashtë vitet e fundit shpenzimet buxhetore të Republikës së Kosovës nuk kanë pasur ndryshime thelbësore kështu si kategoria më e rëndësishme ajo e investimeve kapitale ka shkuar duke rënë vazhdimisht në vitet e fundit e kjo është vërejtur sidomos në dy vitet e fundit, kjo ulje ka ardhur si rezultat i mos investimeve sidomos në infrastrukturë. Kategoria paga dhe mëditje ka pasur rritje të lartë sidomos prej vitit 2014 si shkak të rritjes së të ardhurave të sektorit publik. Trendi i kategorisë mallra dhe shërbime vazhdon të jetë pothuajse çdo vit i njëjtë çka do të thotë që edhe pse është apeluar vazhdimisht që kjo kategori të mirë menaxhohet një gjë e tillë nuk është bërë dhe në realitet përdoret edhe si mbulues i keqpërdorimit të parasë publike. Subvencionet dhe transferet si kategori e cila jep shtysë të madhe për zhvillim sidomos të sektorit privat për fat të mirë gjatë çdo viti ka pasur rritje por problemi i menaxhimit të saj qëndron në faktin që shpërndarja e mjeteve bëhet vetëm te një kategori e caktuar e përfituesve që kanë histori përfitimi të tyre apo i takojnë një territori favorizuese nga organet qeverisëse.

Zhvillimi ekonomik si proces

Gjendja aktuale e ekonomisë së Kosovës karakterizohet nga nivel i ulët i prodhimeve vendore, deficit tregtar, investime të jashtme të vogla, nivel të lartë të papunësisë të përcjella nga një destabilitet i lartë politik, sistem gjyqësor jo funksional i varur tërësisht nga politika dhe probleme të theksuara në zbatimin e ligjit. Tentimet që u bënë në shndërrimin e sektorit ekonomik shtetëror në atë privat i cili do të rifillonte prodhimet dhe njëkohësisht do të krijonte vende të reja pune është një dështim i madh pasi që shumica e ndërmarrjeve të privatizuara nuk janë funksionale dhe nuk kanë zbatuar marrëveshjet me të cilat është bërë ky proces e që aktualisht nuk ka ndonjë shpresë për përmirësim në një të ardhme të afërt. Destabiliteti i madh politik, mosmarrëveshjet me shtetet fqinjë, mosnjohja e Republikës së Kosovës si shtet nga shumë anëtar edhe të Bashkimit Evropian paraqet edhe një sërë problemesh tjera të cilat janë duke ndikuar negativisht në tërheqjen e investitorëve të rinj e si rezultat ndodhemi në një gjendje që nuk lë shumë për të dëshiruar.

Faktorë tjetër që është kontribues i madh në mos suksesin ekonomik të vendit është e struktura ligjore e cila sado që është ndërtuar së fundmi duke u bazuar në ligjet që janë të aplikueshme në shtetet anëtarë të BE – së me qëllim të përmbushjes së pikave

që kërkohen problemi qëndron në mos respektimin e tyre dhe njëkohësisht ndikimin e madh politik që e kanë personat udhëheqës qeveritar duke mos kontribuar në të mirë të vendit dhe në të mirë të qytetarëve por duke punuar në të mirën e një numri të caktuar të personave e kështu duke u listuar në krye të listave të vendeve më të korruptuara në vend.

Duke analizuar rritjen ekonomike të Kosovës për gjashtë vitet e fundit nuk mund të shohim ndonjë progres të theksuar por gjatë gjithë kohës ka rritje solide që si rezultat pothuajse fare nuk ka ndryshime pozitiv në standardin e jetesës. Sipas Bankës Botërore Kosova bënë pjesë në një nga katër vendet Evropiane që patën rritje ekonomike në vitet e krizës globale gjë që flet për një stabilitet dhe qëndrueshmëri ekonomike mjaftë të mirë përkundër kushteve financiare të rënda që përfshinë shumicën e ekonomive botërore, qasja e kufizuar në tregjet ndërkombëtare, remitancat e larta, rritja e vazhdueshme e buxhetit të shtetit dhe mbështetje të vazhdueshme të donatorëve. Lidhur me kriterin e ekonomisë, Republika e Kosovës është në fazën fillestare të zhvillimit të një ekonomie tregu funksionale.

Progres i vogël është arritur, në veçanti në bizneset e orientuara në eksport, përmirësimi i zbatimit të kontratave, në veçanti në sektorin financiar, si dhe qasjen në financa. Sidoqoftë, vendimet jo stabile fiskale lidhur me benefitet e veteranëve të cilat sipas projeksioneve arrijnë vlerën në rreth 50 milion Euro në vit, mund të tregojnë efekt negativ në stabilitetin makroekonomik të vendit, si dhe raportet e tij me institucionet financiare ndërkombëtare.

Deficiti i vazhdueshëm tregtar, reflekton bazë të ulët të prodhimit dhe aftësi konkurruese të dobët ndërkombëtare. Mbështetja në remitanca dhe ekonominë joformale e ulë mundësinë e punësimit, duke rezultuar në pjesëmarrje të ulët të fuqisë punëtore, me theks të veçantë tek gjinia femërore, si dhe të rinjtë të pa aftësuar për punë. Kosova është në fazë të hershme në ndërtimin e kapaciteteve për të përballur presionet konkurruese dhe forcat e tregut në Bashkimin Evropian. Nuk është arritur progres në përmirësimin e cilësisë së edukimit, i cili është mjeti kyç për përmirësimin afatgjatë të rritjes dhe konkurrueshmëris ekonomike.




Fig 2: Rritje ekonomike e RKS

Burimi: BQK

Rezultat i mos suksesit në rritjen ekonomike të Kosovës është edhe menaxhimi i pasasë publike i cili nuk plotëson as kriteret minimale kështu duke krijuar shpenzime të cilat nuk mund të përballohen nga një buxhet siç është ky i Kosovë, duke krijuar

vende të reja të punës të pa nevojshme në sektorin publik, shpenzime alarmante për mirëmbajtje dhe udhëtime zyrtare.

Përfundime

Shpenzimet buxhetore janë të domosdoshme për realizimin e çdo aktiviteti shtetëror. Rritja e shpenzimeve në parim është një tregues pozitiv, që prezanton zgjerim të aktivitetit dhe njëherit edhe zhvillim të shtetit. Në rastin kur niveli i shpenzimeve rritet, kjo rritje apo zhvillim do të duhej të tregonte sinjale të cilat janë në dobi të qytetarëve. Ndërkaq gjendja ekonomike vazhdon të jetë e njëjtë vite me radhë, ky është edhe tregues që dëshmon që këto shpenzime nuk janë të planifikuara apo realizuara mirë dhe si rezultat nuk japin efekte pozitive në shoqëri. Shpenzimet qeveritare në shumicën e kategorive janë të përcaktuara për konsum vjetor gjë që do të thotë prej këtyre shpenzimeve nuk pritet gjenerim i të ardhurave në të ardhme prandaj buxheti në këtë rast nuk është duke u planifikuar me orientim drejtë zhvillimit por konsumit. Edhe pse rritja ekonomike e Republikës së Kosovës ka tejkaluar performancat e shteteve fqinjë, ajo nuk ka qenë e mjaftueshme për të ulur normën e lartë të papunësisë, të ofrojë punësim formal, në veçanti për gratë dhe të rinjtë, apo ti kundërpërgjigjet shkallës së lartë të migracionit. Modeli i rritjes aktuale mbështetet kryesisht nga remitancat dhe mbështetja e donatorëve. Kjo varësi, së bashku me karakteristikat strukturore të Kosovës, ushtrojnë presion mbi konkurrueshmërinë dhe produktivitetin, duke kufizuar krijimin e vendeve të punës dhe zgjerimin e bizneseve. Strategjia aktuale për rritje ekonomike të Kosovës ka nevojë të përshtatet nëpërmjet reformave lidhur me qeverisjen, si dhe politikat makroekonomike, strukturore dhe sociale.

Referenca

- Dornbusch, R & Fischer, S. (2000) *Makroekonomia – Botim Ndërkombëtar*, Dituria, Tiranë.
- Hyman, D. (2010) *Public Finance A Contemporary Application of Theory to Policy, 10th Edition*, South – Western.
- Gruber, J. (2005) *Public Finance and Public Policy, First Edition*, Worth Publishers, USA.
- Jeliçiç, B. (1985), *Shkenca mbi financat dhe e drejta financiare*, Beograd.
- Komoni, S. (1983), *Financat, UP*, Prishtinë.
- Myles, G. (2001) *Public Economies*, Cambridge.
- Rosen, S. H. (2003) *Financat publike*, albin, Tiranë.
- BQK, (2016), *Raportet Vjetore për Vitet 2010 – 2015*, Prishtinë.

Kufizimet legjitime të lirisë së shprehjes në kuadër të jurisprudencës së GJEDNJ-së

MSc Florida Arrinaj
Universiteti i Shkodrës

Abstrakt

Në këtë punim do të trajtohen kufizimet legjitime në të drejtën e lirisë së shprehjes, të sanksionuara në paragrafin e dytë të nenit 10 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Çdo individ ka të drejtën për liri të shprehjes dhe kjo përbën një nga liritë më të rëndësishme, për arsye se nga realizimi i saj varen thuajse të gjitha të drejtat dhe liritë e tjera të njeriut, të garantuara nga aktet ndërkombëtare dhe ato kombëtare. Liria e shprehjes ashtu sikurse dhe liritë e tjera nuk mund të jetë absolute. Ekzistojne raste kur liria e shprehjes mund të kufizohet, sidomos në rastet kur bëhet fjalë për mbrojtjen e sigurisë kombëtare, integritetit territorial apo sigurisë publike; për parandalimin e crregullimeve apo krimet; për mbrojtjen e shëndetit apo moralit; për mbrojtjen e reputacionit apo të drejtave të të tjerëve; për parandalimin e zbulimit të informatave të marra në besim dhe për ruajtjen e autoritetit dhe objektivitetin e juridiksionit. Synimi i këtij punimi është pikërisht trajtimi i këtyre rasteve dhe shoqërimi i tyre me shëmbuj nga jurisprudenca e GjEDNJ-së, e cila në cdo rast do japë përgjigje pyetjeve nëse ndërhyrja në secilin prej rasteve ka qenë e ligjshme, ka ndjekur një qëllim legjitim dhe mbi të gjitha a ka qenë e nevojshme në një shoqëri demokratike. Në rast të ndonjë përplasje ndërmjet kësaj lirie dhe të drejtave të të tjerëve, duhet që kjo të rregullohet nga një kornizë ligjore e cila të përcaktojë shprehimisht në cdo rast konkret, se cila ka përparësi.

Fjalët kyçe: Liria e shprehjes, kufizime të ligjshme, qëllime të ligjshme, GJEDNJ, ndërhyrje të nevojshme.

Hyrje

Liria e shprehjes është një nga liritë themelore që gëzon individit dhe përbën bazën e nevojshme për progresin dhe zhvillimin e një shoqërie demokratike. Është parashikuar në instrumenta ndërkombëtarë dhe është implementuar dhe në legjislacionin e brendshëm të cdo shteti, si kusht parësor i mirëfunksionimit të një shteti. E si mund të konceptohet një shtet demokratik nëse anetarët e tij nuk kanë lirinë minimale të të shprehurit. Liria e shprehjes përfshin lirinë e mendimit, lirinë për të marrë informacione dhe mendime, si dhe lirinë për të dhënë informacione dhe mendime, pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Liria e mendimit konsiderohet një parakusht i lirisë së shprehjes dhe të tjerave të garantuara nga neni 10 dhe gëzon thuajse një mbrojtje absolute, në kuptimin që kufizimet ndaj kësaj të drejte janë të pazbatuara për të. Kjo liri përfshin edhe lirinë e shtypit dhe të mjeteve elektronike. Duhet theksuar se ky nen nuk i ndalon shtetet që të kërkojnë licencimin e ndërmarrjeve të transmetimit audio, kinematografik ose televiziv, çka nënkupton se në kushte të tilla nuk jemi para rasteve kufizuese të lirisë së shprehjes.

Liria e shprehjes duke patur një rëndësi kaq të madhe, mbart me vete dhe një burim të madh fuqie e cila mund të jetë edhe e rrezikshme dhe me pasoja negative, prandaj duhet t'i kushtohet kujdes dhe të mirëmenaxhohet pasi është e hapur për mundësi abuzimi, duke goditur shtetin apo një pjesë të popullsisë. Prandaj si në cdo të drejtë

tjetër, edhe në të drejtën e lirisë së shprehjes sanksionohen kufizime, të cilat duhet me patjetër të plotësojnë disa kushte nga ana e shteteve për t'u justifikuar ndërhyrja, të cilat duhet të jenë ndërhyrje të parashikuara nga ligji, të ndjekin një qëllim të ligjshëm dhe të jenë të nevojshme në një shoqëri demokratike. Në vijim të punimit do të trajtohen rastet në të cilat është e nevojshme ndërhyrja për mbrojtjen e interesave të ligjshme të një shoqërie demokratike, siç janë mbrojtja e sigurisë kombëtare dhe asaj publike, parandalimi i çrregullimeve apo krimet, mbrojtja e shëndetit dhe moralit etj. Në punim do paraqiten çështje nga jurisprudenca e pasur e GJEDNJ-së e rasteve kur shtetet kanë ndërhyrë në mënyrë të ligjshme në të drejtën e lirisë së shprehjes, por gjithashtu edhe rastet kur ndërhyrjet nuk kanë përmbushur kushtet e domosdoshme dhe kanë qenë jo në përputhje me paragrafin e dytë të nenit 10 të Konventës.

Përcaktimi i shkeljeve të lirisë së shprehjes

Liria e shprehjes është një nga liritë themelore që gëzon individi dhe që rënditet menjëherë pas të drejtës për të jetuar. Kjo tregon shkallen e rëndësisë së kësaj të drejte në një sistem të vërtetë demokratik (Omari & Anastasi, 2010, 124). Pa ekzistencën e një lirie të tillë, nuk mund të prezumojmë ekzistencën e një demokracie. Kjo liri është një komponent i rëndësishëm, i cili ka lidhje të ngushte edhe me liritë dhe të drejtat e tjera të parashikuara nga aktet ndërkombëtare dhe ato kombëtare (Zeno-Zencovich, 2008, 56). Mirëpo nga përvojat kushtetuese botërore, kemi të afirmuar se nuk ekzistojnë të drejta të pakufizuara dhe se të gjitha të drejtat kanë kufizimet e tyre. Liria e shprehjes është liria e cila përmban listën më të gjatë të kufizimeve të vendosura në krahasim me të drejtat e tjera të parashikuara në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Kjo listë kufizimesh paraqitet në paragrafin e dytë të nenit 10 të Konventës, ku thuhet se kjo liri mund t'i nënshtrohet vetëm disa kufizimeve, kushteve dhe formaliteteve të parashikuara nga ligji dhe të cilat përbëjnë masat e nevojshme për mbrojtjen e një shoqërie demokratike. Konkretisht, shtetet mund të ndërhyjnë vetëm nëse plotësohen tre kushte:

- Ndërhyrja të jetë e parashikuar në ligj, d.m.th. të jetë e aksesueshme dhe në mënyrë të arsyeshme e parashikuar në lidhje me pasojat që prodhohen prej saj,
- Ndërhyrja të jetë proporcionale me qëllimin legjitim që synon të arrijë, dhe
- Të jetë e nevojshme në një shoqëri demokratike, d.m.th të korrespondojë me “nevojën shtytëse sociale” dhe të jetë në përpjesëtim me qëllimin legjitim të ndjekur.

Shtetet kanë në një masë të caktuar të drejtë për të rregulluar lirinë e shprehjes. Masa e kësaj shtrirje, e cila është objekt mbikëqyrje sipas GJEDNJ, është e ndryshueshme. Shtetet kanë të drejtë të kufizuar në lidhje me shprehjen politike dhe të drejtë më të zgjeruar për ndjenjën njerëzore dhe fenë në lidhje me moralin. Kjo shpesh shpjegohet me mungesën e konsensusit evropian në lidhje me faktin nëse dhe sa duhet të rregullohen çështjet. GJEDNJ nuk zë vendin e autoriteteve kombëtare, por rishikon vendimet e marra nga autoritetet kombëtare duke marrë parasysh nivelin e tyre të vlerësimit sipas Nenit 10 të KEDNJ. Pra, Gjykata shqyrton shprehjen për të cilën është drejtuar një ankesë në rrethanat më të gjëra të çështjes dhe përcakton nëse arsyet e dhëna nga autoritetet kombëtare për kufizimet dhe mënyren e zbatimit janë “të drejta dhe të mjaftueshme” në kuadrin e interpretimit të Konventës. Gjykata njeh kategori të ndryshme të shprehjes, si ato politike, artistike dhe komerciale. Nga këto,

shprehja politike gëzon mbrojtjen më të madhe dhe shprehja komerciale mbrojtjen më të vogël.

Kufizimet legjitime të së drejtës së lirisë së shprehjes

Në nenin 10 të Konventës, lista e ndalesave të mundshme është edhe më e gjatë edhe pse më precize. Ajo shpall se ushtrimi i lirisë së të shprehurit mund të jetë subjekt i *“kushteve, ndalesave dhe denimeve (gjobave), siç është e shkruar me ligj dhe janë të nevojshme në shoqërinë demokratike”*. Këto ndalesa mund të justifikohen nga: interesat e sigurisë kombëtare, integritetit territorial apo sigurisë publike; për parandalimin e crregullimeve apo krimet; për mbrojtjen e shëndetit apo moralit; për mbrojtjen e reputacionit apo të drejtave të të tjerëve; për parandalimin e zbulimit të informatave të marra ne besim; për ruajtjen e autoritetit dhe objektivitetin e juridiksionit (paanshmërise së gjyqësorit).

Një ndërhyrje në të drejtat e përcaktuara në nenin 10 (1) mund të justifikohet vetëm nëse ajo është në përputhje me një nga qëllimet legjitime të përmendura në listën e mësipërme. Ja vlen të theksohet se kategoritë e kufizimeve të ligjshme janë përcaktuar më së miri dhe gjerësisht, dhe nuk ekziston zakonisht ndonjë vështirësi në përcaktimin e qëllimit të ligjshëm. Gjykata shpesh vëren se një ndërhyrje ndjek më shumë se një qëllim të ligjshëm. Megjithatë, një kufizim i cili nuk është brenda listës së mësipërme, nuk do të jetë i lejueshëm nga ana e shteteve kombëtare dhe si rrjedhojë do të përbëjë një shkelje të nenit 10.

Interesat e sigurisë kombëtare, integritetit territorial apo sigurisë publike

Sa i përket interesave të sigurisë kombëtare, integritetit territorial apo sigurisë publike, Gjykata pranon se një shtet mund të marrë masa për të trajtuar veprimet e grupeve kryengritëse dhe se duke vepruar kështu mund të kufizojë lirinë e shprehjes. Ekziston një potencial domethënës për konflikt ndërmjet parimeve të përgjithshme të nenit 10 të cilat mbrojnë një interpretim të gjerë të së drejtës për lirinë e shprehjes dhe veprimeve të grupeve të cilët mund të kërkojnë të përmbysin qeveritë e zgjedhura në mënyrë demokratike nëpërmjet mjeteve të dhunshme. Në përgjithësi, shteteve iu është dhënë një hapësirë e gjerë vlerësimi në këtë fushë dhe nëse demonstron një lidhje ndërmjet veprimeve të marra dhe një kërcënimi ndaj sigurisë kombëtare, gjykata heziton të konstatojë një shkelje. Megjithatë, duhet të theksohet se ashtu si në të gjitha fushat e tjera, veprimet e shtetit mbeten subjekt i mbikqyrjes së gjykatës. Për shëmbull në *Zana kundër Turqisë (1997)* paraqitet rasti i një figure politike në Turqinë jug-lindore, i cili kishte bërë deklaratë në një gazetë kombëtare të përditshme, duke mbështetur një organizatë të armatosur, qëllimi i së cilës kishte qenë ndarja e territorit kombëtar. Ankuesi kishte deklaruar se nuk mbështeste masakrat, por gabime mund të bëjë cdo kush dhe sipas tij kjo organizatë kishte vrarë pa dashje. Ankuesi u dënua me burg për mbështetje ndaj aktiviteteve të kësaj organizate të armatosur. Shteti argumentoi se deklaratat e një figure politike të njohur në rajon mund të kishte efekte negative, e sidomos në kohën kur në vend po ndodhnin shqetësime serioze, prandaj u shpreh se deklaratat përbënin një rrezik ndaj sigurisë kombëtare dhe asaj publike. Ndërhyrja në lirinë e tij të shprehjes ndiqte një qëllim të ligjshëm dhe përmbushte kushtet e justifikimit të ndërhyrjes sipas nenit 10(2). Edhe në çështjen *Rekvényi kundër*

Hungarisë (1999), na paraqitet një rast tjetër i ngjashëm i ndërhyrjes së justifikuar në lirinë e shprehjes për arsye të mbrojtjes së sigurisë kombëtare dhe asaj publike dhe në parandalimin çrregullimeve. Kështu shteti i paditur pretendonte se qëllimi i një amendamenti të Kushtetutës që i privon anëtarët e policisë nga angazhimi në aktivitete politike ishte të depolitizonte policinë, në një kohë kur Hungaria ishte duke u transformuar nga një regjim totalitar në një demokraci pluraliste. Gjykata vërejtë se një numër i shteteve kontraktuese kufizojnë aktivitete të caktuara politike nga ana e policisë së tyre. Duke marrë në konsideratë pushtetet shtrënguese dhe faktin se forcat policore janë në shërbim të shtetit, anëtarët e publikut kanë të drejtë të shprehin që policia të jetë politikisht neutrale. Ky qëllim ishte në përputhje me parimet demokratike. Gjykata më tej theksoi rëndësinë e vecantë historike në Hungari për arsye të eksperiencës së atij shteti në një regjim totalitar që mbështetet në një masë të madhe në angazhimin e policisë në partinë në pushtet. Si pasojë, gjykata arriti në perfundimin se kufizimi në fjalë ndiqte qëllime të ligjshme, kryesisht mbrojtjen e sigurisë kombëtare dhe asaj publike dhe parandalimin e çrregullimeve. Gjatë analizimit të rasteve të ndryshme të kufizimit të lirisë së shprehjes, mund të identifikohen raste kur një shprehje e caktuar mund t'u shkaktojë dëm qëllimeve të cilat janë të mbrojtura në mënyrë legjitime. Ky mekanizëm bën të mundur që të mos kemi abuzime të lirisë së shprehjes dhe të mos sjellë efektin e kundërt të kësaj lirie: gjuhën e urrejtjes, e cila është dhe forma më serioze e abuzimit të mundësisë së shprehjes (Mikajlova & Baçovska & Shekerxhiev, 2013, 24). Përkufizimi i gjuhës së urrejtjes në mënyrë implicite është përcaktuar në Rekomandimin nr. R (97) 20 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për "gjuhën e urrejtjes" nga viti 1997. Në Shtojcën e Rekomandimit theksohet se nocioni "gjuha e urrejtjes" duhet të kuptohet si një nocion i cili i përfshin të gjitha format e të shprehurit me të cilat përhapet, nxitet, promovohet ose arsyetohet urrejtja racore, ksenofobia, antisemitizmi ose forma të tjera të urrejtjes, të bazuara mbi mostolerancë, përfshirë edhe: mostolerancën e shprehur në formë të nacionalizmit dhe etnocentrizmit agresiv, diskriminimin dhe armiqësinë ndaj minoriteteve, migrantëve dhe personave me origjinë imigrante. Vëmendje e veçantë në këto raste duhet kushtuar edhe nga media. Në situata të gjuhës së urrejtjes dhe tensionit, gazetarët mbajnë përgjegjësi të vecantë sepse ato mund të konsiderohen si mjet për përhapjen e fjalimeve që shperndajnë urrejtje dhe dhune. Cështja *Surek* (Nr 1) është një shembull i mirë i kesaj. Aplikuesi në këtë rast ishte pronari i një gazete e cila u penalizua dhe u dënua me gjobë për publikimin një seksioni 'letra për lexuesin' rreth konfliktit me Kurdet. Këto letra dënonin autoritetet dhe forcat ushtarake për sulmet kundër kurdëve në juglindje të Turqisë dhe i akuzonin ata për shtypje brutale të popullsisë kurde si kundërpërgjigje e përpjekjeve të tyre për liri dhe pavarësi. Në një nga letrat thuhej se shteti i kishte burgosur, torturuar dhe vrarë disidentet në emër të demokracisë së Republikës. Letrat e tjera i referoheshin dy masakrave të cilat letërs shkruesi pretendonte se ishin kryer qëllimisht nga autoritetet si pjesë e një fushate strategjike për zhdukjen e kurdëve. Gjykata theksoi se ka kufizime në aplikimin e nenit 10 (2) për kufizimet në fjalimet politike apo në debate mbi cështje të interesit publik dhe se lejueshmëria e kesaj është shumë më e gjerë në lidhje me kritikën e bëra ndaj qeverisë sesa ndaj personave privatë apo edhe politikanëve. Shtetet duhet të jenë të kujdesshëm kur japin masa dënuese të rënda ndaj fjalimeve apo shprehjeve që nxisin dhunë apo urrejtje, sidomos atëherë kur ka mënyra të tjera në dispozicion për t'ju përgjigjur kritikave të pajustificuara.

Sidoqoftë, sipas gjykatës letrat e dërguara rezultojn në 'një thirrje për hakmarrje gjakderdhëse duke zgjuar dhe thelluar ndjenja dhe paragjykime të cilat historikisht kanë perfunduar në konflikte masive'. Duke pasur parasysh situatën delikate dhe të tensionuar në juglindje të Turqisë në atë kohë, autoritetet ishin të justifikuar në penalizimin e bërë nga publikuesit e letrave.

Parandalimi i çrregullimeve apo krimet

Shtetet shpesh përmendin qoftë interesat e sigurisë kombëtare dhe parandalimin e çrregullimeve apo krimet si justifikim për ndërhyrjet e tyre në lirinë e shprehjes. Kjo është vecanërisht e zakonshme në rastet kur veprimet e marra nga shteti janë të drejtuara drejt kufizimit të dhunës apo nxitjes së dhunës. Gjykata pranon se të tilla rrethana mund të përbëjnë një kërcënim ndaj sigurisë kombëtare dhe në të njëjtën kohë përbëjnë një kërcënim për rendin publik dhe përfshijnë kryerjen e krimeve. Është sfiduese për Gjykatën që të mbikqyrë mënyrën se si shtetet zbatojnë ushtrimin e balancimit ndërmjet të drejtave të individëve ndaj lirisë së shprehjes dhe interesit të gjerë publik në ruajtjen e rendit publik sic ilustron nga disa shembuj në vijim. Në *Incal kundër Turqisë (1998)*, ankuesi ishte një anëtar i Komitetit Ekzekutiv të një partie politike që perfaqësonte interesat kurde. Partia vendosi të publikonte një broshurë në të cilën kritikonte masat e marra nga autoritetet vendore, në vecanti kundër tregtisë së paligjshme në shkallë të vogël. Broshurat përshkruanin masat si akte të shtypjes dhe u bënte thirrje kurdëve dhe anëtarëve të proletariatit të formonin komitetete të lagjes për të kundërshtuar këto veprime. Leja u kërkuar nga autoritetet shtetërore për të shpërndarë fletushkat (fletëpalosje, broshura), por leja iu mohua dhe pamfletët u konfiskuan dhe u ndërmorën procedura penale ndaj anëtarëve të komitetit ekzekutiv të partisë politike në fjalë. Ankuesi u dënua për veprën penale të tentimit për të nxitur urrejtjen racore dhe u dënua me më shumë se gjashtë muaj burg dhe me gjobë. Ankuesi gjithashtu u përjashtua nga shërbimi civil dhe u ndalua të merrte pjesë në një sërë aktivitetesh në organizatat politike, shoqatat apo në sindikata. Ndërsa shteti i paditur dështoi të argumentonte se cilat nga qëllimet e nenit 10(2) kishte ndjekur, gjykata u shpreh se kufizimi ishte bazuar në një qëllim të ligjshëm që kishte të bënte me parandalimin e çrregullimeve. Ndërsa në *Groppera Radio AG dhe të tjerët kundër Zvicrës (1990)*, Groppera Radio AG, një shoqëri aksionere zviceriane, përdori një transmetues të fuqishëm, të vendosur në Itali në Pizzo Groppera, për të transmetuar programe radioje drejtuar dëgjuesve në Zvicër. Programet ishin kapur nga ana e pronarëve të receptorëve individuale si dhe nga ana e shoqërive të përdorimit të rrjeteve kabllore, të cilat i ritransmetonin këto programe. Groppera Radio AG dhe tre qytetarë zvicerianë (përfaqësues dhe gazetarë të shoqërisë), pohuan që ndalimi për të ritransmetuar në rrugë kabllore në Zvicër emisionet e tyre të transmetuara nga Italia çënonte të drejtën e tyre - të garantuar nga neni 10 i Konventës - për të komunikuar informacione dhe ide pa marrë në konsideratë kufijtë. Ata pretendonin se ishin viktimat të një shkelje të nenit 13 për shkak të pamundesisë të një mjeti ankimi efektiv kundër një urdhërese të Këshillit Federal. Në raportin e 13 tetorit të vitit 1988, Komisioni arriti në përfundimin se ka pasur një shkelje të nenit 10. Përsa i përket nenit 10 të Konventës, bëhej fjalë së pari për t'u siguruar për ekzistencën e një ndërhyrjeje. Gjykata nuk e gjykojti të nevojshme të përcaktonte me saktësi se çfarë duhej kuptuar në këtë rast me 'informacione' ose 'ide'. Lidhur me çështjen nëse ndërhyrja ishte e justifikueshme në bazë të paragrafit

të parë të nenit 10, gjykata konstatoi se, në qoftë se stacioni i Pizzo Groppera do të gjendej në vetëvete në juridiksionin italian, ritransmetimi i programeve të tij nga ana e shoqerive kooperative ishte nën juridiksionin zviceran. Ndalimi ishte bërë plotësisht sipas sistemit të rregullimit zviceran të radiove lokale. Sa i përket qëllimit legjitim, gjykata konstatoi se ndërhyrja ndiqte qëllime plotësisht të pajtueshme me Konventën: mbrojtjen e rendit ndërkombëtar të telekomunikacionit si dhe mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Duke e përmbledhur këtë çështje mund të themi se shtetet jo vetëm kanë të drejtë të vendosin sisteme licencimi dhe kushtëzimi për transmetimet zanore dhe pamore por edhe mund të kufizojnë transmetime të caktuara në respektim të së drejtës së brendshme ndërkombëtare.

Mbrojtja e shëndetit apo moralit

Sa i përket kufizimit të lirisë së shprehjes për arsye të mbrojtjes së shëndetit apo moralit, rastet janë relativisht të pakta në shqyrtimin e gjykatës. Shembujt më të dukshëm të varësise në mbrojtjen e moralit si justifikim për ndërhyrjen në lirinë e shprehjes kanë qënë sa i përket kufizimeve të materialeve apo veprave të konsideruara të turpshme. Shembuj të tjerë kanë lidhje me ofrimin e këshillimit mbi abortin. Në *Muller dhe të tjerët kundër Zvicrës (1988)*, ankuesi i parë ishte një artist i cili mori pjesë në një ekspozitë të organizuar nga nëntë shokët e tij edhe këto ankues. Një numër i konsiderueshëm i pikturave të ankuesit të parë u konfiskuan për arsye se konsideroheshin të turpshme. Ankuesit më vonë u dënuan për publikim të materialeve të turpshme. Shteti i paditur pretendoi se qëllimi i ndërhyrjes ishte të mbrohej morali dhe të drejtat e të tjerëve. Gjykata pranoi se neni 204 i Kodit Penal të Zvicrës është hartuar me qëllim mbrojtjen e moralit publik, dhe nuk ka arsye të supozohet se në zbatimin e kësaj dispozite në rastin konkret, gjykatat zvicerane kanë objektiva të tjera të cilat duhej të kishin qënë në kundërshtim me Konventën. Për më tepër, ashtu sikurse Komisioni e ka vënë në dukje, ekziston një lidhje natyrore ndërmjet mbrojtjes së moralit dhe mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve. Si pasojë, dënimi i akuesit ndiqte një qëllim të ligjshëm sipas nenit 10§2. Ndërsa në *Open Door Counselling dhe Dublin Ëell Ëoman kundër Irlandës*, ankuesit ishin kufizuar nëpërmjet një urdhëri nga gjykata që të jepnin informacione për gratë shtatëzëna rreth klinikave të abortit jashtë territorit të Irlandës. Sipas të drejtës irlandeze aborti përbënte një vepër penale (krim). Gjykata pranoi se mbrojtja e ofruar në bazë të së drejtës irlandeze ndaj të drejtës së jetës së foshnjës së palindur bazohej në vlera të thella morale që kanë lidhje me natyrën e jetës të cilat reflektohen në qëndrimin e shumicës së irlandezëve kundër abortit, sic u shpreh në referendumin e vitit 1983. Kufizimi në rastin konkret për dhënie informacioni ndiqte një kufizim të ligjshëm mbi lirinë e shprehjes të bazuar në mbrojtjen e moralit e cila sanksionohet në legjislacionin irlandez. Në *Murphy kundër Irlandës (2003)*, gjykata duke arsyetuar vendimin, arriti në perfundimin se një ndalim mbi reklamat fetare nuk përbente shkelje të nenit 10, sidomos kur kemi të bëjmë me ofendime të bindjeve personale brenda sferës së moralit apo të fesë.

Mbrojtja e reputacionit dhe të drejtave të të tjerëve

Ligjet mbi shpifjen dhe ligjet të cilat ndalojnë fyerjen ndaj të tjerëve mbi baza fetare justifikohen normalisht duke iu referuar mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve. Sipas kësaj kategorie, gjykata mori gjithashtu në konsideratë ndërhyrjet në të drejtat

kontraktore dhe ligjore të të tjerëve të cilat mund të lindin vecanërisht në konteskte komerciale. Shëmbujt në vijim demonstrojnë qasjen e Gjykatës në këto çështje. Në çështjen *Otto-Preminger-Institut k. Austrisë*, Gjykata arriti në konkluzionin se liria e shprehjes me anë të veprave artistike mund të kufizohet nga autoritetet shtetërore kur këto vepra cenojnë të drejtat e të tjerëve. Ndër të tjera Gjykata vendosi se bllokimi dhe sekuestrimi i disa materialeve justifikoheshin si të nevojshme në një shoqëri demokratike, duke qenë të ligjshme dhe duke pasur si qëllim legjitim mbrojtjen e interesave të të tjerëve. Ndërsa në *Tolstoy Miloslavsky kunder Mbreterise se Bashkuar (1995)*, ankuesi shkroi një artikull, ku pretendohet se një kujdestar i një shkollë angleze për djem, ishte përgjegjës për vrasjen e qindra burrave, grave dhe fëmijëve gjatë luftës së dytë botërore. Artikulli i cili ishte publikuar në një broshurë ishte shpërndarë tek prindërit e djemve të cilët studionin në atë shkollë dhe tek anëtarët e të dy dhomave të parlamentit dhe tek gazetarët. Ankuesi u shpall fajtor për shpifje. Gjykata u shpreh se ndërhyrja ndiqte një qëllim të ligjshëm të mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve. Në *Tammer kunder Estonise (2001)*, kufizimet ndaj lirisë së shtypit mund të jenë të justifikueshme kur preket dinjiteti ose fyehen persona të tjerë.

Parandalimi i zbulimit të informatave konfidenciale

Kjo kategori i ka dhënë shkas lindjes së një jurisprudence të kufizuar. Megjithatë, Konventa parashikon se kur dokumentet konfidenciale të qeverisë bëhen të ditura në sferën publike pa miratim (pëlqim), shtetet kanë të drejtë, në mënyrë që të mbrojnë një numër të madh interesash, të ngrejnë padi me arsyetimin e interferimit në lirinë e shprehjes. Për më tepër, në rastet kur gjykatat e vendit ndërhyjnë në lirinë e shprehjes për të mbrojtur interesat private, mund të mështetet mbi të njëjtat baza. Për shëmbull, në rastet ku një raport konfidencial biznesi bëhet i ditur për publikun, vendimi i një gjykate të vendit për të dhënë një urdhër kundër publikimit të materialeve që ndodhen në Raport, mund të justifikohet me këtë arsyetim. Megjithatë, gjykata do të shqyrtojë kontekstin në të cilin është zbuluar informacioni dhe natyrën e informacionit. Në *Autronic AG kunder Zvicres (1990)*, ankuesi ishte ndaluar nga marrja e transmetimeve nga një satelit Rus. Shteti i paditur bëri padi, dhe gjykata pranoi se ndërhyrja ndiqte qëllime të ligjshme për parandalimin e çrregullimeve dhe gjithashtu parandalimin e zbulimit të informatave të marra në besim. Shteti argumentoi se fshehtësia e telekomunikacionit, e cila mbulonte transmetimet televizive në fjalë dhe që garantohej në nenin 22 të Konventës mbi Telekomunikacionin Ndërkombëtar duhet të mbrohet. Në *Fressoz dhe Roire kunder Francës (1999)*, ankuesit ishin drejtor botimit dhe një gazetar i një gazete. Një artikull ishte botuar në një gazetë gjatë një periudhe të trazirave industriale në kompaninë e makinave Peugeot, kur menaxheri refuzoi të paguante rrogat e kërkuara nga fuqia punëtore. Artikulli, duke cituar kthimin e taksës së bosit të Peugeot, dha detaje mbi pagesën substanciale që përgjegjësi (bosi) kishte marrë për vete gjatë dy viteve të fundit. Ankuesit u dënuan për veprën penale të zotërimit të fotokopjeve të pagesës së bosit të Peugeot, të marra në shkelje të konfidencës profesionale nga një zyre tatimi e paidentifikuar. Gjykata pranoi se ky kufizim i lirisë së shprehjes së ankuesit ndiqte një qëllim të ligjshëm që lidhej me parandalimin e informacionit të marrë në besim. Gjykata gjithashtu pranoi edhe një justifikim tjetër të ligjshëm të këtij kufizimi lidhur me mbrojtjen e reputacionit apo të drejtave të të tjerëve.

Ruajtja e autoritetit dhe paanshmeria e gjyqësorit

Sundimi i ligjit është një parim qëndror i çdo demokracie dhe varet në aplikimin efektiv të së drejtës nga ana e Gjykatës. Në këtë aspekt, shteti ka një detyrim për të siguruar se cdo njeri ka drejtën e një procesi të drejtë në përputhje me nenin 6 të Konventës. Shteti ka një interes të veçantë i cili njihet nga neni 10 i Konventës për të mbrojtur paprekshmërinë e proceseve gjyqësore dhe për të kufizuar natyrën dhe masën e cdo kritike të procedurave aktive. Është gjithashtu e njohur se gjykata merr në konsideratë rrethanat në të cilat komentet e gazetarëve mbi vlerën e të dhënave (dëshmime) apo të verdiktit të ngjashëm në procedurat penale kanë qenë të kufizuara. Sundimi i ligjit gjithashtu kërkon që gjyqësori të gëzojë konfidencën e njerëzve që shërbejnë aty. Është e nevojshme për të frenuar të drejtën e një gazetari për të komentuar mbi sjelljen e tyre në gjykime dhe performancën e përgjithshme të punës. Gjykata ka pranuar se mbrojtja e të drejtave të palëve në procedura ligjore përbën një mbrojtje të autoritetit të gjyqësorit, qyshse palët janë, në cilësinë e tyre si ndërgjyqëse, të përfshira në makinerinë e drejtësisë. Gjykata i shqyrton gjithmonë domosdoshmërinë e të tilla kufizimeve në mënyrë shumë të ngushtë. Në *çështjen Do Roy-Malaurie kundër Francës (2000)*, ankuesit ishin një gazetar dhe një redaktor gazete. Gazeta publikoi një artikull nga një gazetar, që kritikonte G, një ish drejtor i kompanisë përgjegjëse për ndërtimin e shtëpive të punëtorëve, dhe raportin e tij me menaxherin e ri të kompanisë. Menaxheri i ri kishte ngritur një padi penale kundër G dhe kishte aplikuar për të qenë pjesë e proceseve si palë civile. Ankuesit ishin shpallur fajtorë për publikimin e informacioneve që kishin lidhje me aplikimet e menaxherit të ri për të marrë pjesë në proceset penale si palë civile, gjë që ishte veper penale. Gjykata e Apelit u shpreh se dispozitat në bazë të të cilave ato ishin dënuar kishin qëllim të mbronin personat kundër të cilëve ishte ngritur një padi, për të mbrojtur prezumimin e pafajësisë dhe për të parandaluar çdo influencë të jashtme në dhënien e drejtësisë. Gjykata pranoi se ndërhyrja kishte qëllim të mbronte reputacionin dhe të drejtat e të tjerëve dhe paanshmerinë e gjyqësorit.

Konkluzione

Siç u vu re gjatë punimit, liria e shprehjes si një nga të drejtat themelore të njeriut, gëzon një mbrojtje dhe një trajtim të gjerë. Ekzistojnë mënyra nga më të larmishmet për të komunikuar mendimet dhe idetë tona, për të marrë informacione dhe mendime nga të tjerët, por kjo nuk do të thotë që kjo liri është e pakufijë. Ekzistojnë raste të limiteve dhe kufizimeve, të cilat parashikohen në Konventë dhe të cilat u trajtuan më lart në punim. Në bazë të nenit 10(2) kjo liri mund t'i nënshtrohet vetëm disa kufizimeve, kushteve dhe formaliteteve të parashikuara nga ligji, të cilat përbëjnë masat e nevojshme për mbrojtjen e një shoqërie demokratike. Duhet me patjetër të kemi përmbushjen e tre kushteve, në mënyrë që të justifikohet ndërhyrja e shtetit në lirinë e shprehjes dhe kjo ndërhyrje të konsiderohet e ligjshme. Që do të thotë që ndërhyrjet duhet të parashikohen me patjetër në ligjet kombëtare të shteteve dhe është pikërisht parlamenti si përfaqësues i pushtetit legjislativ i cili vendos nëse një kufizim është i ligjshëm. Në raste të rralla, përveç ligjit kombëtar të një vendi, mund të shërbejnë edhe rregullat e të drejtës zakonore apo dhe parime të së drejtës ndërkombëtare. Kushti tjetër ka të bëjë me zbatimin e parimit të proporcionalitetit

nga ana e gjykatave vendase, ndërmjet mjetit që përdoret për të arritur një qëllim të caktuar dhe qëllimit që kërkohet të arrihet. Mjetet mund të jenë të ndryshme, një dënim penal, civil, një kontroll, sanksion etj. Qëllimet janë ato të sigurisë kombëtare dhe publike, parandalimit të krimeve apo çrregullimeve të ndryshme etj të cilat u trajtuan më lart. Duhet të gjendet dhe një ekuilibër ndërmjet interesit individual dhe atij kolektiv. Në rastet kur tre kushtet përmbushen, ndërhyrja konsiderohet e ligjshme dhe është shteti ai që ka barrën e provës për të vërtetuar përmbushjen e tyre. Konkluzion tjetër i rendësishëm është se përveç listës së kufizimeve të përcaktuara në nenin 10, autoritetet vendase nuk mund të sjellin të tjera arsye për të legjitimuar një ndërhyrje eventuale. Gjithashtu, autoritetet publike kanë vetëm mundësinë dhe jo detyrimin për të urdhëruar dhe/ose vënë në zbatim një masë kufizuese ose dënuuese mbi ushtrimin e të drejtës së shprehjes. Vetë traktatet nuk lejojnë një kufizim të përhershëm të lirisë së shprehjes. Gjithashtu, vlen të përmendet se midis formave të ndryshme të ndërhyrjes, censura paraprake konsiderohet shumë e rrezikshme dhe nuk është e tolerueshme dhe as e ligjshme në shoqëritë demokratike.

Referenca

- Daci, J. (2011). Të Drejtat e Njeriut. Tiranë, Julvin 2.
- Omari, L. & Anastasi, A. (2010) E drejta kushtetuese. Tiranë, Shtëpia Botuese ABC.
- Bianku L. (2001) Të drejtat e njeriut në Europë. Tiranë.
- Curtis F.J. Doebbler. (2003) International Human Rights Law: Cases and Materials(Volume One), Washington Dc USA.
- Medarski, F. & Selmani, N. (2015) Doracak për shpifje dhe fyerje. Shkup.
- Mihajllova, E. & Baçovska, J. & Shekerxhiev, T. (2013) Liria e shprehjes dhe gjuha e urrejtjes, Shkup.
- Zeno-Zencovich, V. (2008) Freedom of expression, Acritical and comperative analysis. Oxon: Routledge-Cavendish.
- Golash, D. (2010) Freedom of expression in a Diverse World, Washington D.C., Springer.
- Macoveri, M. (2003) Liria e shprehjes, Një udhëzues për zbatimin e Nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Manualet e të drejtave të njeriut, Nr. 2, Tirane.
- Konventa Evropiane per te Drejtat e Njeriut, Keshilli i Europes, marre nga http://www.echr.coe.int/NR/rdonlyres/9D74A089-C364-456A-A23B-2C1B0725F73C/0/Convention_SQI.pdf, "Te jetuarit sebashku", Libërth për standardet e Këshillit të Evropës për kontributin e medias në kohezionin social, dialogun ndërkulturor, të kuptuarin, tolerancën dhe pjesëmarrjen demokratike, Redaktuar Nga Yasha Lange, Këshilli i Evropës 2010, marre nga http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/media/doc/livingtogether_ALBANIAN_web.pdf, Freedom of expression in Europe, Case-law concerning Article 10 of the European Convention on Human Rights, marre nga <http://www.echr.coe.int/NR/rdonlyres/BA2CB2C0-E837-4253-A1B5-5BC87D84AABE/0/DG2ENHRFILES182007.pdf>
- Të drejtat dhe liritë në praktike, marre nga http://www.coe.int/AboutCoe/media/interface/publications/fiches_dh_sq.pdf
- Ceshtjet e analizuara ne punim jane te marra nga faqja zyrtare e GJEDNJ-se [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"documentcollectionid2":\["GRANDCHAMBER","CHAMBER"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

Disa zhvillime në të drejtën penale europiane mbi parimin e prezumimit të pafajësisë si dhe të drejtës së të pandehurit për të qënë prezent në procesin penal që zhvillohet kundër tij

Msc. Odise Moçka
Kryeministria

Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), në nenet nr 6 dhe 7 të saj parashikon të drejtat kryesore të të pandehurit gjatë një procesi penal të cilat janë e drejta për një proces të rregullt ligjor, si dhe parimin nullum crimen nulla poena sine lege, pra për mos dënimin pa ligj. Po kështu në kapitullin 4 të Traktatit të Funkcionimit të bashkimit Europian(TFBE), në të cilin trajtohet bashkpunimi gjyqësor midis vendeve anëtare kërkohet vendosja e rregullave minimale gjatë procesit penal të cilat bëjnë të mundur garantimin e të pandehurit se ndaj tij do të ketë një proces të rregullt ligjor.

Në kuadrin e hapave të mëtejshëm të anëtarësimit të vëndit tonë në Bashkimin Europian është e rëndësishme të njohim këto zhvillime në aspektin penal dhe sidomos ato që kanë të bëjnë me të drejtat themelore të individëve gjatë procesit penal të zhvilluar kundër tyre.

Anëtarësimi i Shqipërisë në bashkimin Europian kërkon përafrimin e legjislacionit të saj sipas *Acquis communautaire*, e për këtë arsye është e domosdoshme që ndaj zhvillimeve ligjore, sidomos të atyre që kanë në themel të drejtat e njeriut, të tregohet vëmendje e theksuar në analizimin, kuptimin dhe më pas integrimin e tyre në legjislacionin vendas.

Keywords: Defendant, process, penal, European Union, trial.

Hyrje

Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFBE), si shtyllë të tretë të organizimit dhe funksionimit të tij, strukturës, bashkëpunimin gjyqësor dhe ato në fushën e drejtësisë. Ky bashkëpunim ndërmjet autoriteteve gjyqësore dhe policore të shteteve anëtare synon t'u ofrojë qytetarëve evropianë liri, siguri dhe drejtësi, duke parandaluar dhe luftuar së bashku krimin, racizmin dhe ksenofobinë. Bashkëpunimi gjyqësor ka të bëjë gjithashtu me lehtësimin dhe përsheptimin e bashkëpunimit në fushën e zbatimit të vendimeve penale, lehtësimin e ekstradimit ndërmjet shteteve anëtare, vendosjen e normave penale uniforme në luftën ndaj krimit të organizuar, terrorizmit dhe trafikut të drogës. Njëlloj si në fushën e politikës së jashtme dhe sigurisë së përbashkët, bashkëpunimi në fushën e drejtësisë dhe të punëve të brendshme zhvillohet jashtë kuadrit vendimmarrës të Komunitetit Evropian.

Bashkëpunimi gjyqësor në Bashkimin Evropian

Një nga themelet e këtij bashkëpunimi është besimi se zhvillimi i çështjeve penale duhet të bazohet në parimin e njohjes së ndërsjellë të aktgjyqimeve dhe vendimeve të tjera gjyqësore. Zbatimi i këtij parimi mbështetet në premisën se shtetet anëtare besojnë në sistemet e njëri-tjetrit në aspektin e drejtësisë penale. Shkalla e parimit të njohjes së ndërsjellë është e varur nga një numër i parametrave të cilat përfshijnë mekanizma për mbrojtjen e të drejtave të të dyshuarve dhe personave të akuzuar dhe të standardeve të përbashkëta minimale e të nevojshme për të lehtësuar zbatimin e këtij parimi. Megjithatë, shtetet anëtare në praktikë kanë treguar se nuk kanë arritur

gjithmonë të sigurojnë një shkallë të mjaftueshme të besimit në sistemin e drejtësisë penale. Në këto kushte është domosdoshmëri vendosja e rregullave minimale të përbashkëta për mbrojtjen e të drejtave procedurale të të dyshuarve dhe personave të akuzuar, me anë të të cilave synohet të forcohet besimi se shtetet anëtare do të mund të besojnë në sistemet e drejtësisë penale të njëri-tjetrit dhe në këtë mënyrë do të lehtësojnë njohjen e ndërsjellë të vendimeve gjyqësore në çështjet penale. Këto rregulla të zakonshme minimale do të çojnë në heqjen e pengesave për lëvizjen e lirë të qytetarëve në të gjithë territorin e shteteve anëtare.

Bashkimi Evropian i ka kushtuar shumë rëndësi të drejtave themelore procedurale që u takon personave të dyshuar për kryerjen e veprave penale. Kështu në shtator 2009, Këshilli miratoi një rezolutë joshteruese që kishte për objekt forcimin e të drejtave procedurale të personave të dyshuar apo të akuzuar në hetimet penale. Kjo rezolutë cilëson si të drejta themelore procedurale, të drejtën për përkthim dhe interpretim, të drejtën e informimit mbi të drejtat dhe informacion në lidhje me akuzat, të drejtën e ndihmësës ligjore, të drejtën e komunikimit me të afërmit, punëdhënësit, konsullatën apo ambasadën e vendit të originës etj (Flz nr.295/2009/BE, fq1). Këshilli Evropian nënvizoi karakterin joshterues të rezolutës duke ftuar Komisionin Evropian të shqyrtojë elementët e mëtejshëm të të drejtave minimale procedurale për të dyshuarit dhe personat e akuzuar, dhe për të vlerësuar nëse çështje të tjera, për shembull prezumimi i pafajësisë, duhet të adresohen për të promovuar bashkëpunim më të mirë midis shteteve.

Tri nga masat e cilësuara në udhërrëfyesin mbi të drejtat procedurale në procedurë penale, janë të miratuara në ditët e sotme me direktivat 2010/64 / EU , 2012/13 / EU dhe 2013, / 48 / EU të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit.

Zhvillimet e reja ligjore në të drejtën penale evropiane

Në plotësim të rezolutës së 2009, Parlamenti Evropian dhe Këshilli kanë miratuar së fundmi direktivën nr.343/2016, të marsit 2016. Kjo direktivë forcon dhe përcakton vendosjen e masave minimale për forcimin e aspekteve të caktuara të prezumimit të pafajësisë dhe të së drejtës së të pandehurit për të qenë i pranishëm në procesin gjyqësor penal që zhvillohet kundër tij.

Kjo direktivë duhet të zbatohet vetëm për procedurën penale siç interpretohet nga Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian (Gjykata e Drejtësisë), pa rënë ndesh me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Kjo direktivë nuk duhet të zbatohet për procedurat civile (Hentrich kundër Francës, 1995) ose procedurat administrative (Lutz kundër Austrisë, 1987, 123). Pra direktiva përjashton procedurat e tjera që kanë lidhje me sanksione për shkelje të konkurrencës, tregtisë, problematikat e transportit, shërbimet financiare dhe sidomos ato të taksave dhe tatimeve.

Direktiva duhet të zbatohet për personat fizikë idividë të cilët janë të dyshuar apo persona të akuzuar në procedurat penale. Ajo duhet të zbatohet nga momenti kur një person është i dyshuar ose i akuzuar për kryerjen e një veprë penale, ose një vepër të dyshuar penale. Zbatimi i kësaj direktive do të fillojë edhe përpara se personi i dyshuar për kryerjen e veprës penale të jetë vënë në dijeni nga autoritetet kompetente të një shteti anëtar, me anë të një njoftimi zyrtar, ose përpara se ai/ajo të jetë në dijeni se ka marrë statusin e një personi të dyshuar ose të akuzuar. Kjo direktivë duhet të

zbatohet në të gjitha fazat e procedurës penale deri në vendimin përfundimtar, pra kur vendimi ka marrë formë të prerë.

Kjo direktivë pranon nevojat dhe nivelet e mbrojtjes së aspekteve të caktuara të prezumimit të pafajësisë të ndryshme për sa i përket trajtimit të personave fizikë dhe juridikë. Në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut mbrojtja që i është bërë personit fizik është shumë herë më e mirë se për personat juridikë. Është e kuptueshme përse gjykata ka bërë një diferencim të tillë në trajtimin e personave fizikë duke qenë se këta persona kanë mbi vete të gjithë përgjegjësinë në rastin e sanksioneve penale.

Në fazën aktuale të zhvillimit të së drejtës kombëtare dhe të jurisprudencës në nivel kombëtar dhe të Bashkimit, është ende herët për të nxjerrë ligje në nivel të Bashkimit Evropian për prezumimin e pafajësisë në lidhje me personat juridikë. Kjo direktivë nuk duhet, pra, të zbatohet për personat juridikë. Në veçanti, parimi i prezumimit të pafajësisë sipas KEDNJ-së dhe siç është interpretuar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe duhet të respektohet pa paragjykim në rastin e personave juridikë për çështjet që paraqiten për shqyrtim pranë Gjykatës së Drejtësisë (Flz nr 295/2009/BE, fq2). Sipas nenit 6, të KEDNJ-së, “çdo person që akuzohet për një veprë penale prezumohet i pafajshëm derisa të provohet ligjërisht fajësia e tij. Siç vihet re ky prezumim ndërthuret mirë me parimin për proces të rregullt ligjor (D.Spilman, 1995, 657).

Prezumimi nënkupton këndvështrimin e gjyqtarit që do të gjykojë çështjen, aftësinë e tij për të evituar çdo paragjykim. Fillimisht prezumimi supozon një akuzë në fushën penale, dmth duhet një njoftim zyrtar lëshuar nga autoriteti kompetent lidhur me faktin se ai ka kryer një veprë penale (Dewer kundër Belgjikës, 1980, 42).

Prezumimi i pafajësisë do të shkelet nëse deklaratat publike të bëra nga autoritetet publike, referuar një të dyshuari apo një personi të akuzuar kanë formën apo japin idenë se personi është fajtor. Për aq kohë sa ndaj atij personi nuk është provuar fajësia në bazë të ligjit, këto deklaratat duhet të jenë të kuptueshme qartë dhe tejet objektive. Deklaratat e tilla dhe vendimet e ndërmjetme gjyqësore nuk duhet të pasqyrojnë një mendim se ai person është fajtor. Kjo duhet të respektohet pa asnjë paragjykim po ashtu edhe për aktet e prokurorisë të cilat synojnë të provojnë fajësinë e të dyshuarit ose të akuzuarit. Organet e aktakuzës nuk duhet të deklarojnë paraprakisht në media apo në njoftime publike se personi i arrestuar është fajtor dhe çështja të konsiderohet e zgjidhur. Po kështu, të gjitha vendimet paraprake të natyrës procedurale të cilat janë marrë nga autoritetet gjyqësore ose të tjera kompetente dhe janë bazuar në dyshimin ose mbi elementë të dëshimive inkriminuese siç janë vendimet për paraburgim, është kusht që këto vendime mos të kenë nënkuptime dhe të japin idenë se i dyshuari apo personi i akuzuar është fajtor për veprën penale. Para se të marrë një vendim paraprak të natyrës procedurale, autoriteti kompetent duhet të verifikojë nëse ka prova inkriminuese ose elementë të mjaftueshëm kundër të dyshuarit apo personit të akuzuar për të arsyetuar vendimin në fjalë. Vendimi mund të përmbajë referenca për këto elementë por pa krijuar mëdyshjet se ky vendim është i ngjashëm me një vendim fajësie.

Detyrimi që të mos i referohen të dyshuarit ose personit të akuzuar si fajtor, nuk duhet të pengojë autoritetet publike të shpërndajnë publikisht informacion mbi hetimin penal që është në proces kur kjo është e nevojshme për arsye që lidhen me hetimin penal. Këtu mund të përmendim rastin kur autoritetet publike mund të publikojnë

video apo foto të personit të dyshuar ose mund të shpërndajnë informacion në zonën e caktuar në të cilën ka ndodhur krimi. Organet procedurale të kryerjes se hetimit policia, hetuesia, prokuroria etj., gjatë dhënies së informacionit duhet të kujdesen që ky informacion të jetë objektiv sa i përket prezumimit të pafajësisë të personit në kerkim. Duhet pasur kujdes gjatë shpërndarjes së informacionit dhe kur personi është në kerkim apo i arrestuar, nuk duhet të konsiderohet si autor i veprës penale por duhet të konsiderohet si i dyshuar për kryerjen e saj. Në çdo rast, mënyra dhe konteksti në të cilin shpërndahet informacioni nuk duhet të krijojnë përshtypjen se personi është fajtor para se të jetë provuar fajësia e tij në bazë të ligjit. Kështu policia nuk mund ti japë shtypit fotografi individësh të paraqitur si “anëtarë të një organizate të paligjshme”, nëse fotografitë nuk shoqërohen me emra. Gjyqari hetues nuk mund të kërkonte që i dyshuari të paraqitej para një vrasësi në seri (Pandy kundër Belgjikës, 2006, 45). Në të njëjtën mënyrë autoritetet gjyqësore nuk mund të tolerojnë që i akuzuari të paraqitet me veshje penitenciare enkas për të burgosurit në një seance lidhur me paraburgimin. Kështu edhe kryetari i trupës gjyqësore kur do të japë vendimin final duhet të tregohet tejet i kujdesshëm dhe objektiv ndaj argumenteve të akuzës dhe mbrotjes (Pradel, Corstens, Vermuelen, 2010, 363).

Pra, prezumimi i pafajësisë do të sjellë pasoja për disa prej organeve të procesit. Organe të procesit do të konsiderohen të gjitha ato organe të cilat marrin pjesë në një procedurë dhe kanë disa detyrime lidhur me këtë procedurë. Kështu në vitin 1995 pas vrasjes së një ish-ministri francez, ministri i brendshëm i asaj kohe mbajti një konferencë për shtyp në të cilën citoi emrin e z. De Ribemont, duke e paraqitur si bashkëpunëtor të krimit. Ai menjëherë u padit dhe u paraburgos. Pas tre vitesh procedurë ai fitoi pushimin e gjykimit. Më pas me në lidhje me këtë rast GJEDNJ-ja, mbajti qëndrimin e saj në lidhje me prezumimin e pafajësisë, duke mos e ngushtuar këtë koncept vetëm tek organet gjyqësore por edhe tek organet e tjera publike. Lidhur me këtë çështje GJEDNJ-ja theksoi se “fusha e aplikimit të nenit 6, nuk kufizohet vetëm në rastin e cenimit të prezumimit të pafajësisë nga një autoritet gjyqësor, por edhe në cenimet që mund të vijnë nga autoritetet e tjera publike”. Vendimi për z. de Ribemont ngriti edhe pyetjen nëse parimi i prezumimit të pafajësisë shtrihet edhe mbi organet e shtypit. Problemi shtrohet sepse nëpërmjet insistimit të tyre, këto fushata ndonjëherë mund të dëmtojnë drejtësinë duke prekur njëherësh parimin e prezumimit dhe parimin e paanshmërisë siç është thënë edhe më lart. (Pradel, Corstens, Vermuelen, po aty 2010, 364).

Gjatë procesit gjyqësor autoritetet kompetente duhet të kujdesen për paraqitjen e të dyshuarit apo të akuzuarit në gjykatë ose në publik. Këto autoritete nuk duhet të lejojnë veshje të cilat përdoren nga të burgosurit të cilët janë duke vuajtur dënimin. Pra, shmangia nga veshjet me uniformë burgu nuk duhet të lejohen të përdoren për sa kohë që i pandehuri nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë.

Kur është e mundur, autoritetet kompetente duhet ti përmbahen një paraqitje sa më të rregullt të të dyshuarit apo të akuzuarit në gjykatë ose në publik. Autoritetet duhet të shmangin veshjet e personave të akuzuar apo dyshuar për kryerjen e veprës penale, veshje me rroba të burgut, në mënyrë që të shmangët përshtypja se ata persona janë të fajshëm.

Barra e provës për përcaktimin e fajit të të dyshuarve dhe personave të akuzuar është në ndjekjen penale, dhe çdo dyshim duhet të shkojë në favor të dyshuarit apo të akuzuarit. Prezumimi i pafajësisë do të cenohet nëse barra e provës zhvendoset

nga prokuroria te pala mbrojtëse. Ruajtja e pavarësisë së gjyqësorit gjen zbatim gjatë vlerësimit të fajësisë apo pafajësisë së të dyshuarit apo të akuzuarit. Gjatë zhvillimit gjyqësor gjykatësit duhet të kenë kujdes në përdorimin e supozimeve juridike ose faktike lidhur me përgjegjësinë penale të një të dyshuari apo të personit të akuzuar. Supozime të tilla duhet të kufizohen brenda kufijve të gjykimit të arsyeshëm, duke marrë parasysh rëndësinë e asaj që është në rrezik dhe asaj marëdhënie juridike që është dëmtuar. Megjithatë garatimi dhe ruajtja e të drejtave të palës mbrojtëse, është detyrim i përhershëm i organeve publike. Sa i përket mjeteve të kërkimit të provës gjatë gjykimit duhet të kihet parasysh se ato duhet të jenë të arsyeshme dhe në proporcion me qëllimin legjitim të zhvillimit të procesit. Supozimet juridike të përdorura nga gjyqtarët, gjatë gjykimit, duhet të jenë të hapura për bisedim apo të tilla që të lejojnë kundërshtimin e palës mbrojtëse ose vetë të të pandehurit.

Organet publike në proceset penale kanë gjithmonë detyrimin të respektojnë parimin e prezumimit të pafajësisë. Ky prezumim pafajësie përfundon në momentin kur vendimi i dënimit bëhet përfundimtar për të pandehurin dhe pasi të jenë shtuar të gjitha rrugët e rekursit ose afati për ushtrimin e tyre nga ky i fundit. (O kundër Norvegjisë, 2003, 8).

Një parim tjetër shumë i rëndësishëm në të drejtën penale është respektimi i të drejtave të të pandehurit gjatë gjykimit në mungesë që zhvillohet ndaj këtij të fundit. Direktiva e re e Bashkimit Evropian detyron shtetet anëtare të bashkimit të parashikojnë mundësinë e mbajtjes së gjykimeve në mungesë të të dyshuarve ose personave të akuzuar vetëm nëse kushtet janë plotësuar. Shtetet anëtare duhet të japin garancinë se vendimi i marrë në mungesë ndaj personit të akuzuar, ka ardhur si pasojë e mos gjendjes së personit të akuzuar. Për të vertetuar mosgjendjen e personit të akuzuar organet publike duhet të provojnë se në janë bërë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për gjetjen dhe dërgimin e të pandehurit përpara trupit gjykues. Për shembull, për shkak se personi ka ikur ose është arratisur, ndaj organeve të drejtësisë lind nevoja për zhvillimin dhe marrjen e vendimit në mungesë. Përpara së të bëjnë këtë organet proceduese duhet të japin prova bindëse para trupës gjyqësore se në kërkimin e të pandehurit janë përdorur të gjitha menyrat e arsyeshme të kërkimit të tij. Për shkak se këto mënyra kërkimi nuk kanë dhënë rezultate atëherë organet proceduese kanë të drejtën e kërkimit të zhvillimit të procesit gjyqësor në mungesë. Megjithatë gjatë zhvillimit të gjykimit në mungesë shtetet anëtare duhet të sigurojnë apo të garantojnë të dyshuarit se nga momenti i ndalimit të tyre do të vihen në dijeni për vendimin e marrë ndaj tyre dhe në mënyrë të veçantë t'u vihet në dispozicion informacioni se ata mund të apelojnë vendimin e gjykatës i cili është dhënë në mungesë të tij. Personit të arrestuar por të dënuar në mungesë, i shpjegohen të gjitha mundësitë ligjore që i garanton legjisllacioni për të drejtën e një gjykimi të ri si dhe çdo mjet tjetër juridik që ai ka të drejtë të shfytëzojë për shfajësimin dhe rrëzimin e akuzave ndaj tij. Një informacion i tillë duhet të jepet me shkrim. Informacioni mund të jepet me gojë me kushtin që informacioni i dhënë është i shënuar në përputhje me procedurën e kërkuar sipas ligjit kombëtar.

Veç të tjerash kjo direktivë jep sigurinë se deklaratat e bëra nga të dyshuarit ose të akuzuarit gjatë fazës hetimore si dhe të gjitha provat të marra në shkelje të së drejtës për të heshtur ose të drejtës së mosfajësimin të vetes, nuk do të përdoren nga gjykatat dhe gjyqtarët. Këta të fundit duhet të respektojnë të drejtat e mbrojtjes së të pandehurit si dhe ndershmërinë e procesit. Në këtë kontekst, duke pasur parasysh jurisprudencën

e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut si dhe nenin 3, të KEDNJ-së, në të cilin përcaktohet se pranimi si provë i deklaratave të marra si rezultat i torturës ose i keqtrajtimit të të pandehurit, jo vetëm që nuk është i tolerueshëm por do të rrëzojë edhe të gjitha faktet e tjera të paraqitura, duke i konsideruar edhe ato si të marra në kundërshtim të plotë me rregullat e procedimit penal. Konventa e OKB-së kundër torturës dhe trajtimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese përcakton se çdo deklaratë e cila është përpiluar si rezultat i torturës nuk duhet të përdoret si provë në asnjë procedurë. Pranimi i kësaj të fundit si provë e rregullt në gjykim, mund ta çojë gjykimin drejt rrëzimit të plotë të tij nga një gjykatë më e lartë kompetente.

Bashkimi European përfaqëson një formë të veçantë bashkpunimi midis shteteve. Në themel të këtij organizimi qëndron bashkpunimi vullnetar midis shteteve rreth një bashkimi të përbashkët ekonomik, politik dhe shoqëror. Në këtë formë organizimi shtetet anëtare hyjnë në marrëdhënie të ndërsjellta të drejtash dhe detyrimesh mes njëra tjetrës. Funksonimi dhe organizimi i këtij bashkimi shtetesh kërkon ndër të tjera respektimin e të gjitha detyrimeve që bashkimi european ka vendosur për zbatim prej shteteve anëtare. Rruga e përbashkët e shteteve europiane duhet të garantohet nga zbatimi i legjislacionit të njëjtë ose të përafuar me të drejtën komunitare (*Acquis communautaire*). Të drejtat kryesore që ka në themel ky bashkim shtetesh janë ato që lidhen me respektimin e individit si dhe të drejtat që lidhen në mënyrë të pandarë me të (e drejta e jetës, lirisë, trajtimit njerëzor, respektimit etj). Për garantimin e këtyre të drejtave dhe për të rritur besimin midis shteteve për çështjet e drejtësisë bashkimi European ka miratuar këtë direktivë. Kushtetutat e shteteve anëtare karakterizohen nga fryma demokratike dhe ajo e respektimit të të drejtave kryesore të individit. Megjithatë bashkimi European kërkon implementimin e menjëhershëm të kësaj direktive nga shtetet anëtare, duke plotësuar dhe garantuar më tej të drejtat e individit në procesin penal të zhvilluar kundër tij. Ky detyrim qëndron edhe për shtetet që janë në rrugën e anëtarësimit sic është rasti i vendit tonë. Në këto kushte legjislatori shqiptar duhet të marrë masa për implementimin e kësaj direktive dhe përditsimin e legjislacionit penal në përputhje të plotë me të. Implementimi i kësaj direktive do të garantojë më tej individët për një proces sa më të rregullt ligjor si dhe do të rrisë nivelin e besimit në organet e drejtësisë.

Referenca

Direktiva nr 343/2016, botuar në fletoren zyrtare nr 65 datë 11.3.2016, www.eur-lex.europa.eu
Consolidated Version of The Treaty on the Functioning of the European Union, Official Journal of the European Union nr 326, 26.10.2012, www.eur-lex.europa.eu

Konventa Evropiane për të drejtat e Njeriut.

Flz nr.295/2009/BE, fq1, www.eur-lex.europa.eu

Pradel& Corstens&Vermuelen, E Drejta Penale Evropiane, papirus, 2010.

D.Spilman, Proces equitable et presumption d'innocence, RTDH 1995.

GJEDNJ, 22 shtator 1994, Hentrich kundër Francës, JCP 1995,, J.F.legall

GJEDNJ, 25 gusht 1987 Lutz kundër Austrisë, seria A.

GJEDNJ, 11 shkurt 2003, O kundër Norvegjisë, JCP 2003, I.160.

GJEDNJ, 27 shkurt 1980 ,Dewer kundër Belgjikës, 1980, seria A.

Simfonia në kohën e Romantizmit

Ass. Prof. Fatos Lumani

Simfonia klasike pas vitit 1799 më nuk mundej të përfaqësojë estetikisht realitetin e ri që u krijua në art. Tani më kishte lindur kategoria estetike "heroike". Pas performancës së parë publike të simfonisë "Eroika" të Beethovenit më 7 prill 1805 në Vienë¹, fillon edhe periudha romantike në muzikë. Asgjë më nuk ishte si dikur, Beethoven kishte thyer të gjitha rregullat e stilit klasik vienez dhe kishte hapur një dritare ku shprehja e individualitetit dhe vetë ekspresivitetit në muzikë kundërshtonte atë lloj muzike që primare e kishte komunikimin universal, përmes një gjuhe universale, tani kishim muzikë e cila në mënyrë intime komunikonte individualisht me publikun. Muzika mori karakteristikat ekspresive të kohës, ku çdo artist mund të kishte lirinë individuale për të shprehur vetveten, pa marrë parasysh rregullat e formës dhe harmonisë përmes të cilave komunikonte me gjithë botën.

"Pra, romantizmi vuri thekse mbi dinjitetin e individit dhe lirinë e emocioneve dhe minimizoi konsideratën formale për një qasje më subjektive të të gjithë artit. Ky aspekt (i individualitetit), që në disa mënyra kërcënoi rritjen e simfonisë, në të njëjtën kohë ishte përgjegjës për kompozimin e muzikës më tërheqëse orkestrale të shekullit."²

Këtë e dëshmon edhe biseda e Beethoven me mikun e tij, violinistin Karl Holz. Pasi Beethoven në atë periudhë e humbi shqisën e dëgjimit, gjatë bisedës miqtë e tij e shkruanin në fletore bisedën, kurse ai ua kthente përgjigjen gojarisht. Për këtë shkak mbeten fjalët e Holz të shkruara, kurse përgjigjet e Beethoven mbeten të panjohura:

HOLZ: Ajo është çfarë mua çdo herë më mungon te muzika instrumentale e Mozart-it...

BEETHOVEN:_____.

HOLZ: Veçanërisht te muzika instrumentale. -Karakter specifik në një vepër instrumentale. Atë gjë, nuk mund ta gjejmë te veprat e tij (të Mozart-it), përfaqësim të ngjashëm të shpirtit, siç e gjejmë te veprat tua.

BEETHOVEN:_____.

HOLZ: Unë çdo herë pyes vetveten kur dëgjoj diçka se çfarë përfaqëson ajo?

BEETHOVEN:_____.

HOLZ: Veprat e tua kudo kanë karakter të jashtëzakonshëm.

BEETHOVEN:_____.

HOLZ: Unë do të spjegoja dallimin midis Mozart-it dhe veprave tua instrumentale në këtë mënyrë. Për një nga veprat e tua instrumentale poeti mund të shkruajë vetëm një poezi, kurse për veprat e Mozart-it mund të shkruajë tre ose katër poezi të ngjashme.³

Beethoven dhe ndikimi i tij në simfoninë e romantizmit

Impakti që bëri Beethoven në muzikën simfonike, jo domosdoshmërisht ndikoi te kompozitorët tjerë të talentuar në mënyrë pozitive. Simfonitë e tij u bënë një pengesë e pakapërcyeshme nga kompozitorët tjerë, që përveç se si inspirim ato u kthyen në makth për një pjesë të tyre.

"Për herë të parë në historinë e muzikës e ardhmja e një zhanri të tërë ishte vënë në dyshim, jo për shkak se ai perceptohej si i modës së vjetër, por për shkak se arritjet në këtë zhanër nga një kompozitor i vetëm ishin perceptuar si të pakalueshme."⁴

¹ Beethoven, Kegan, Paul, Trench, Trubner & Co., London, 1930, f. 112.

² Stedman, Preston, The Symphony, Prentice Hall, New Jersey, 1992, F. 96.

³ Beethoven, Konversationshefte, edited by Karl-Heinz Köhler, Grita Herre, Dagmar Beck, and Günter Brosche, Leipzig, 1968-2001.

⁴ Evan Bonds, Mark, The Cambridge Companion to the Symphony, Beethoven's shadow: the nineteenth century, Cambridge University Press, Cambridge 2013, F.331.

Këtë gjë mund ta dëshmojnë edhe disa kompozitor të mëdhenj klasik si psh.:

“Në mënyrë sekrete në zemrën time unë shpresoj të bëj diçka me veten time, por kush mund të bëj diçka pas Beethovenit”, i ishte rrëfyer Schuberti shokut të tij Jozef von Spaw. Kurse, Brahmsi tek në moshën 43 vjeçare e kompozoi simfoninë e tij të parë. “Unë asnjëherë nuk do kompozoj simfoni! Nuk e keni konceptin se si ata, si ne (kompozitorët), ndjehemi kur dëgjojmë zhurmën e hapit të një gjigandi si ai pas nesh”, iu rrëfye Brahmsi dirigjentit dhe shokut të tij Herman Levy në vitin 1870.

Nga ana tjetër, kompozitori gjerman Wagner, pas një tentative të pasuksesshme të simfonisë in c (e shkruar në moshë relativisht të re), u “fsheh” në mënyrë shumë interesante duke simfonizuar zhanrin e operës dhe të njëjtën duke e titulluar “dramë muzikore”.

Beethoven kishte dhënë shembullin ideal për çdo gjë. Me simfoninë e parë kishte treguar se di të kompozojë në stilin klasik. Në simfoninë e dytë, e cila kontraston stilistikisht me të parën, Beethoven heq dorë nga menueti duke e dramaturgizuar dhe perfeksionuar simfoninë e së ardhmes.

“Simfonia "Eroica" njoftoi me tone të forta, që ditët e muzikës si një art të lartësuar që i afrohet religjionit kishin ardhur. Muzika kurrë nuk do të ishte e njëjtë që atëherë.”⁵ Në simfoninë numër tre, ai përfundimisht largohet nga stili klasik, duke hyrë në një botë heroike revolucionare të kohës.

Simfonia numër pesë është shembulli më i lartë i vetë ekspresivitetit të artistit. Aty Beethoven integroi temën në të katër kohët. Këtu tonaliteti përdoret si retorikë dhe për herë të parë shohim unifikim total të materialit tematik në të katër kohët.

Simfonia numër gjashtë është e kundërta e simfonisë së pestë, në të cilën inspirimi dilte nga vetë ekspresiviteti i brendshëm; këtu ambienti i jashtëm është faktori kryesor i ndërtimit të veprës. Pra, kemi të bëjmë me një vepër programore, e cila përshkruan ambientin dhe jetesën në fshat dhe në natyrë. Para Beethovenit kemi patur vepra programore, por zakonisht ato shkruheshin nga kompozitorë të cilët ishin në rang të ulët dhe për përfitime të vogla. Beethoven, me kompozimin e simfonisë numër gjashtë, ngriti në pedestal muzikën programore.

Simfonia numër shtatë në të njëjtën kohë është simfonia e cila është në një zhvillim të vazhdueshëm ritmik. Aq shumë është i pranishëm ritmi në këtë simfoni, sa që Wagner atë e quajti si “apoteozë e valles”.

Simfonia numër tetë është homazh për simfoninë e klasicizmit. Këtu Beethoven edhe njëherë i kthehet menuetit si formë, edhe pse menueti është në tempo skerceze.

Simfonia numër nëntë në të njëjtën kohë është edhe kryevepra e Beethoven, aty ku Beethoven shkriu zhanrin e muzikës absolute të simfonisë me zhanrin e muzikës vokale. Është vepër e cila përfaqëson gjithçka në muzikën e Beethoven.

Aspektet kompozicionale te Beethoven dhe kompozitorëve tjerë romantik

Nëse dëgjojmë Beethoven, gjëja e parë që vërejmë është se në çdo pikë të muzikës së tij kemi tingëllim optimal harmonik. Kjo vjen ngaqë Beethoven ngadalsoi në simfoni progresionet harmonike dhe i mbushi ato me ritëm energjik dhe repetitiv, për tu dhënë rëndësi, për t'i zgjeruar ato dhe për ta bërë harmoninë rrugën kryesore dramaturgjike. Duke ngadalsuar progresionet harmonike kjo gjë mundësoi që të dëgjohen më mirë akordet më komplekse; akordet, të cilat tek Hajdn kalonin tepër

⁵ Cycler, Louise, The Symphony, Harcourt Brace Jovanovich-INC, Neë York, 1973, F. 59.

shpejt për tu dëgjuar mirë. Beethoven zakonisht përdorte akorde të thjeshta, përherë duke ua nënshtruar efektin e tyre special drejt planit më të gjërë, edhe pse ndodhte kjo, përsëri progresionet harmonike të Beethovenit duken më të intensifikuara sesa ato të J.Haydn, sepse ato ishin të planifikuara dhe kishin koordinim kohor.

Zgjerimi i gamës tonale bëri që të dobësohet graviteti ndaj qendrës tonale, tash më filluan të depërtojnë dhe mode tjera përveç maxhorit dhe minorit. Kjo gjë bëri që dominantat në modet përkatëse mos të jenë akorde maxhore dhe si rrjedhojë mos të kenë tercën e tyre si gjysëmton (tingull sensibil), i cili do të zgjidhet në tingullin tonik, duke e bërë jo të domosdoshëm progresionin dominantë-tonikë. Nëse qartësia tonale, zgjedhjet e qarta kadencore D-T dhe polariteti midis këtyre dy sferave funksionale ka bërë që muzika klasike të jetë e qartë dhe të ketë një kurbë të qartë të zhvillimit dramatik që përkonte me rregullat e qarta harmonike, kjo qartësi harmonike dhe ky polaritet nisi të zbehet tek kompozitorët e romantizmit, të cilët qëllimshëm i largoheshin qartësisë harmonike (e cila nisi të përdoret dhe si retorikë te kompozitorët klasik), duke i lënë vend paqartësisë modale e cila stimulonte edhe zgjidhje më subjektive melodiko-harmonike dhe formale.

Një gjë të tillë mund ta shohim edhe te shembulli numër një te simfonia “Italiene” e Mendelsonit te koha e dytë, ku tek tema e parë nuk kemi përdorimin e tingullit sensibil në melodi. Kjo gjë i jep temës karakter modal-arkaik, duke kundërshtuar rregullat e qarta të klasicizmit, ku minori duhet të ketë sebsibël të qartë. Gjegjësisht, në këtë shembull në re-minor, në vend te do-së duhej të përdoret do#. Siç shohim, në këtë shembull mjegullimi i tonalitetit ndodh edhe te kompozitori i cili vazhdoi t’i ndjekë rregullat estetike klasike edhe në romantizëm, i quajtur ndryshe edhe si “Klasiku i Romantizmit”-Felix Mendelson.

Shembulli 1.

Paqartësitë e modaliteteve vazhduan edhe te kompozitorë tjerë, si Shuman. Në simfoninë e katërt të tij, finalja është totalisht e paqartë në aspektin tonalo modal, duke na krijuar dyshim nëse është në re mazhor apo në re minor. E njëjta gjë ndodh te Brahms, simfonia numër një te tema e parë, ku kemi përdorimin e dy modeve në të njëjtën melodi, atij të do mazhorit dhe të do minorit.

Shembulli 2

Një gjë e njëjtë ndodh edhe te tema e parë e simfonisë numër 3, ku kemi përsëri bimodalitet.



Shembulli numër 3

Një tjetër mjet për “dobësimin” e tonalitetit ishte edhe “shtresëzimi struktural”. Këto janë ato pasazhe të cilat janë bitonale, pra dy shtresa në tonalitete të ndryshme. Në rastin e simfonisë numër një, koha e katërt të Brahms, ku figurat te violinat, çelot, kontrabasët, tromba, timpani dhe kontrafagoti kanë figura të cilat na sygjerojnë tonalitetin e Do mazhorit, kurse në të njëjtën kohë, instrumentet frymore të drunjta, kornot dhe violat janë në tonalitetin e Mi mazhorit.

Shembulli numër 4

Një ndryshim i madh të Brahms në planin tonal, në krahasim me simfonitë klasike ndodhi në pikëpamjen e planit më të gjërë strukturoro-simfonik. Nëse simfonitë para Brahms-it kishin plan të qartë tonal ku në katër kohë, tre ishin në tonalitetin kryesor dhe koha e ngadaltë ose e dyta është në tonalitetin paralel. Brahms e zgjeroi këtë gamë duke krijuar një strukturë tonale, ku për bazë kishin afërsinë e tercave. Pra, nëse e marrim për bazë simfoninë numër 1 të Brahms do shohim një plan tonal të ndryshëm nga ai klasik.

Këtu, koha e parë fillon në Do minor, e dyta është në tonalitetin e Mi mazhor (tercë të madhe telart), koha e tretë është La bemol mazhor (tercë të madhe teposhtë), për të mbaruar me kohën e katërt, e cila është në tonalitetin e Do mazhorit, ku tonaliteti është i njëjtë, kurse modi ndryshon nga koha e parë, nga minori në mazhor, një traditë kjo e bazuar në simfoninë e pestë të Beethoven, në të cilën koha e fundit është në një mod tjetër nga koha e parë. Këtë zgjidhje kompozicionale mund ta vërejmë edhe te simfonia e Cezar Frank, e cila fillon në re minor dhe mbaron në Re mazhor. Tonaliteti sa vinte dhe e zbehte rëndësinë e tij, aq sa te kompozitori i fundit

simfonik i kohës së Romantizmit, Mahler, tek simfonia numër 4 shohim se tonaliteti fillestar i simfonisë Sol dhe tonaliteti konkludues i kohës së katërt (të fundit) është Mi, tonalitete të ndryshme të cilat as që mund të mendonim se mund t'i gjejmë në kohën e klasikizmit.

Një mënyrë tjetër e dobësimit të qendrës tonale është edhe nëpërmjet shmangjeve të kadencave perfekte autentike në fund të veprave muzikore. Mungesa ose përdorimi i një tjetër progresioni në vend të këtyre zgjidhjeve dobëson funksionin dhe zbeh qartësinë harmonike. Progresioni i cili u bë tepër i pëlqyeshëm nga Brahms ishte kadencia plagale ose subdominantë-tonikë. Kjo lloj kadence nuk u përdor asnjëherë në veprat e klasikëve vinez (Haydn, Mozart, Beethoven), për shkak se brenda kësaj kadence mungonte zgjidhja e tingullit sensibil në tingullin finalis (ose tonikë). Tre nga katër kohët (1,2,4) në simfoninë e parë mbarojnë me kadencë plagale.



Shembulli numër 5

Shembulli numër 6

Një tjetër karakteristikë e simfonisë së romantizmit ishte dhe mënyra e arritjes së unitetit të veprës, ku uniteti arrihej nëpërmjet mënyrës se si tema përdorej. Te Beethoven temat nuk kishin as karakter as rëndësi në fillimin e veprës, por këto kualitete i fitonin në vazhdim të veprës. Kjo ndjenjë e rritjes u bë kohezion i fuqishëm,

nga i cili tema u bë shenja. Kompozitorët romantik Berlioz dhe Shubert morën “idenë fikse” (temën) si element kryesor dhe jo përpunimin, duke ia atribuar temës forcën unifikuese të veprës, gjë e cila i përkiste zhvillimit dhe procesit të përpunimit të materialit, pra te sonata dhe simfonia e klasicizmit zhvillimi tematik është elementi kryesor i ndërtimit të veprës, kurse te Shubert dhe Berlioz tema shfaqet si ngjarje kryesore.

Në veprat e klasikëve Beethoven kishte mësuar se si nëpërmjet zhvillimit të figuracionit të shkatërrojë frazat e rregullta; Beethoven kishte shtyrë këto fraza të parregullta drejt vrrullit të skajshëm ritmik, duke u dhënë ndjenjën sikur frazat nuk ekzistojnë më.

Papritur frazat e rregullta (kuadrate) te Shumani dhe te Mendelsoni rishfaqen duke e prishur vrrullin zhvillimor në simfoni. Këto fraza kuadrate u rishfaqën si ndikim i këngëve solo me përcjellje pianistike, të cilat ishin gjetje e kohës. Ndikimi i letërsisë në muzikë solli edhe ndikimin e muzikës vokale, nga e cila ndërtimi simetrik i vargut dhe sintaksës së fjalisë u pasqyrua edhe në ndërtimin simetrik të muzikës (nisën të përdoren tema periudha). Shumani u mundua që të kompensojë për figuracionin e dobët ritmik, duke e pajisur simfoninë me pasurim harmonik të cilën ai e përdorte mjaft mirë në pjesët e tij pianistike, por pasurimi nënkupton spikatjen e akordeve të veçanta ose progresione të ndërlikuara akordike. Duke qënë se çdo akord është ngjarje në vetvete, kjo gjë e zbeh kuptimin e tij strategjik në raport me tërësinë e veprës muzikore.

Këtë problematikë me frazat kuadrate të cilat ishin prezente në simfonitë e Shumanit, Listi arriti që t’i hjekë. Duke solemnifikuar progresionet harmonike të cilat gjendeshin te Vagneri, ai arriti që tu ikë periudhave muzikore të cilat ishin karakteristike për ariet operistike tradicionale. Por, përsëri as Listi nuk arriti që të bëjë unifikim figurash (si Beethoveni).

Pas Beethovenit, unifikimin nëpërmjet figuracionit tematik, ritmik dhe harmonik arriti ta bëjë Brahms në simfonitë e tij. Për ta bërë këtë unifikim, Brahms duhej të sakrifikojë pasurimet harmonike, të cilat ishin pjesë e kohës së romantizmit, ku forca tërheqëse e akordit duhej të jetë e vogël (akord joatraktiv), me qëllim që ta dobësojë sensin e frazës. Për këtë, Brahms tingëllon si kompozitor klasik.

Figuracioni, gjithashtu ishte preokupimi kryesor i Bramsit. Ai e dinte se kontrolli mbi figurën e bëri të mundur formën simfonike te Beethoven dhe në këtë pikëpamje Brahmsi tejkaloi çdo kompozitor që nga koha e Beethoven. Por, problematika që lindi te Brahmsi ishte se duke punuar ngushtë me të njëjtat figura për të krijuar unitet kompozicional, bëri që të gjithë pjesët e simfonisë të tingëllojnë ngjashëm, pra të afrohen me njëra tjetrën në karakter.

Simfonia e pambaruar në si minor Shubert

Deri në kohën e Shubert kishte patur modele simfonishë të ndryshme, atyre me tre kohë, me pesë kohë dhe më standardja me katër kohë. Por, asnjëherë ndonjë kompozitor deri atëherë nuk pati kompozuar simfoni me dy kohë si simfonia në si minor e Shubertit. Ndoshta kjo është arsyeja që kësaj simfonie shpesh i referohemi edhe si simfonia e pambaruar.

Shubert në të njëjtën kohë ishte dhe kompozitori i cili shkruajti suksesshëm solo këngë me përcjellje të pianos, zhanër i cili do të ishte një ndër të preferuarit

e kompozitorëve romantik. Inkorporimin e melodive të këngëve vokale Shuberti provoi që ta bëjë edhe në simfoni, konkretisht këtë gjë e vërejmë te simfonia e pambaruar në si-minor.

Tema e Hyrjes së simfonisë në si minor të Shubert është temë me përmbajtje të thellë, aq më tepër për shkak se kjo temë shkëputet e pakonfirmuar nga ajo çka vijon. Efekti momental është i madh, por gama e gjatë e akumulimit të karakterit këtu sakrifkohet. Kjo temë asnjëherë nuk bëhet më karakteristike se paraqitja e saj e parë. E njëjta gjë ndodh me temën e dytë të kohës së parë të kësaj simfonie. Çdo temë është interesante për vetveten, por pasazhet zhvillimore të cilat vijnë pas kësaj duken artificiale dhe jokreative.

The image shows a musical score snippet with three staves. The top staff is labeled (b) [Cellos and Basses] and the middle staff is labeled (c) [Oboe and Clarinet]. The bottom staff is labeled [Cellos]. The music is in 3/4 time, key of D major, and marked *pp*. The notation includes various note values, rests, and phrasing slurs.

Shembulli numër 7

Këto lloje temash kuadrate dhe tema këngësh zakonisht janë karakteristike për kohët e treta dhe të katërta, ku nuk kemi të bëjmë me zhvillim të formës së sonatës, por me kohë fragmentare, ku kontrasti arrihet nëpërmjet ballafaqimit tematik dhe modal.

Pra, duke i munguar ky zhvillim karakteristik për formën e sonatës në kohën e parë dhe duke ezauruar ndërtimin kuadrat tematik i cili duhej të bëhet në kohën e tretë dhe të katërt (te koha e parë) Shubert e ka parë të pakuptimtë t'i shtojë dhe dy kohë kësaj simfonie, sepse do të përsëriste vetveten. Kështu që, simfoninë në si-minor Shubert e len me dy kohë, duke i hequr mundësinë për përpunim simfonik që ndodhte zakonisht në kohët e para, pra temat këngë (kuadrate) të kësaj simfonie ia pamundësojnë zhvillimin e mirëfilltë simfonik kësaj vepre, duke e lënë të gjymtë dhe të pambaruar në zhanrin në të cilën ajo përfaqësohet si vepra e vetme e romantizmit në llojin e vet.

Simfonia Fantastike një model i ri i Simfonisë në Romantizëm

Berlioz ishte kompozitori i parë romantik, i cili arriti të kompozojë simfoni të suksesshme pas Beethovenit. Kjo ndoshta ndodhi sepse Berlioz duke qënë francez, vend ky ku tradicionalisht ishte zhvilluar baleti dhe opera, nuk kishte peshën e rëndë mbi supe të traditës simfonike gjermane që kishin kompozitorët gjerman. Kjo ndoshta ndikoi te Berlioz të ishte më original në pikëpamjet e veta dhe më i lirë në ndjekjen e ideve të tija.

Simfonia fantastike arrin që të përmbledhë ide nga tre simfonitë e Beethovenit në një.

Nga simfonia numër tre e Beethovenit ai merr trajtimin dhe dramatizimin e heroit kryesor, pra merr strukturën e të ndërtuarit e historie të bazuar mbi një personazh në muzikë.

Nga simfonia numër pesë arrin të marrë integrimin motiviko ritmik në të gjitha kohët e simfonisë. Në këtë mënyrë lindi edhe teknika kompozicionale “idea fikse”, ku një temë e cila shfaqet në fillim të simfonisë bëhet bartësja kryesore dramaturgjike, duke ndryshuar karakterin e saj në kohët e ndryshme të simfonisë. Këtë ndryshim karakteri nga një kohë të simfonisë në një kohë tjetër, muzikologu finlandez Eero Tarasti e quan ekzagjerim.

“Ekzagjerimi ishte mjet i popullarizuar, i cili krijonte efekte ironike dhe groteske në muzikën romantike. Simfonia Fantastike e Hektor Berliozit është ndoshta shembulli më i njohur i ironisë romantike në muzikë. Ripunimi i motiveve muzikore në një kuptim ironik ndodh kur tema kryesore lirike e simfonisë, të cilën Berlioz e quan ide fikse, dramatizohet dhe shtrembërohet në fund të veprës, aty ku kjo temë përshkruan mbledhjen ose festën e shtrigave.”⁶

Nga simfonia numër gjashtë merr konstruktin programor të ndërtimit të simfonisë - simfonia e gjashtë e Beethovenit dhe simfonia Fantastike e Berliozit kanë nga pesë kohë.

Pas Berliozit simfoninë me program nisën ta ndjekin edhe kompozitorët e tjerë të romantizmit si List me Simfoninë e tij Faust dhe Dante, Mahler me simfonitë e tij 1,2 dhe 3, Rikard Shtraus me Simfonia Domestica, Çajkovski Simfonia Manfred, Brukner Simfonia numër 4, etj.

Gjithashtu, nga lidhja midis naracionit (poezisë dhe tregimit), lindi një zhanër tjetër i muzikës simfonike, i cili u bë mjaft popullor në kohën e romantizmit. Ky ishte zhanri I poemave simfonike, ku gati çdo kompozitor në romantizëm kompozoi nga një poemë simfonike. Biles kishte nga ato kompozitorë të shkollave nacionale të ndikuar nga lëvizja e nacionalizmit romantik, që injoruan formën e simfonisë duke e quajtur kulturë të prejardhur gjermane (uzurpuese) dhe në shenjë revolte kompozuan poema simfonike, të cilat inspiroheshin nga legjendat dhe tregimet popullore. Një rast i tillë ishte edhe rasti I kompozitorit çek Bedrzhih Smetanës, ku ciklin prej gjashtë poemave simfonike të bazuara në tregime popullore çeke e titulloi “Mi Vlast”(Atdheu im). Smetana gjatë tërë jetës së tij nuk kompozoi asnjë simfoni.

Përfundime

Është e vështirë dhe kontraproduktive të mundohemi të bëjmë ndarje absolute ndërmjet muzikës në klasicizëm dhe romantizëm. Koha e romantizmit pati intensifikim dhe zgjerim të elementeve ekspresive të klasicizmit, por në të njëjtën kohë nuk shënoi ndarje të qartë stilistike nga klasicizmi.

Për shumë kompozitorë të cilët punuan në shekullin 19 ose në kohën e romantizmit, përmbajtja ekspresive formësonte muzikën. Muzika e Beethovenit parashikoi dhe frymëzoi qasjen vetë-referuese dhe vetë-ekspresive ndaj kompozicionit muzikor. Kjo qasje, edhe pse lindi forma të reja muzikore, u bë dhe pengesë për zhvillimin e mëtutjeshëm të simfonisë klasike, pasi kjo qasje subjektive dobësoi dhe zvogëloi qasjen funksionale harmonike të elementeve dramaturgjike në simfoni, duke ia mbartur peshën dramaturgjike elementeve tjera kompozicionale si temës,

⁶ Tarasti, Semiotics of Classical Music -Hoë Mozart, Brahms and Eäagner Talk to Us, Publisher: Mouton de Gruyter (August 15, 2012),F.129

orkestracionit, programit, etj.

Romantikët morrën formën e simfonisë duke e anashkaluar përmbajtjen e cila i jepte jetë asaj forme, sistemin tonalo-harmonik, i cili në të njëjtën kohë krijonte vrrullin dialektik të përpunimit simfonik.

Gjuha e simfonisë ishte teknika kompozicionale e harmonisë funksionale dhe mishërimi maksimal i kësaj teknike kompozicionale ishte forma e simfonisë. Zëvendësimi ose dobësimi (edhe pse i duhur) i tonalitetit, automatikisht nënkuptonte edhe zbutjen e kontrasteve dhe përpunimin simfonik, kontraste dhe përpunim të cilat ishin qëllimet kryesore të kësaj forme instrumentale.

Human Resource Management Information System in the Republic of Kosovo-Evaluation of success and challenges – An ITPOSMO Approach

PhD (C.) Fakije Zejnullahu
Ministry of Public Administration

Prof. Asoc. Dr. Indrit Baholli
European University of Tirana

Abstract

Initiatives for implementation of the Information Systems not always end successfully; this phenomenon is expressed especially in the developed countries and those in transition. Timely assessment of the success of an Information System is an important aspect to ensure if the implementation was successful and in order that on time be addressed the deficiencies and problems.

Through this study is done evaluation of the success of the implementation of an initiative undertaken by the Ministry of Public Administration, named “Human Resource Management Information System -HRMIS”. This evaluation was done by analyzing the gap between the “real situation” in which the project is and “design of the project” based on the model design-reality gap analysis.

The research was done based on the views of the staff officials of the institutions (the managers of personnel), because in this phase the staff officials are the main users of the system and the best connoisseurs of its functionality.

During the analysis have been observed gaps along the seven dimensions (Acronyms ITPOSMO) of the model, which will lead the initiative to a “partially failed” initiative unless it taken action to reduce the width of these gaps.

Findings from this research will serve to system’s analysts in taking measures to eliminate the causes that may affect the success of the system and also will serve other researchers in identifying the failure and success factors of the Information Systems (IS), in particular, projects of e-government in developing countries. The study concludes with some of recommendations that may help in reducing or closing this gap prompting initiatives be transformed into a successful project

Keywords: ITPOSMO, Information Systems, e-Government, HRMIS.

Introduction

The revolution of Information and Communication Technology has had a great impact on how the institutions were organized and how services were delivered. The internet offered new ways of service delivery by making them available any time and any place, and at the same time led to the reorganization of institutions and modernization of processes.

Integration of Information and Communication Technology in the process of service delivery enables faster and more efficient data processing in public administrations and more efficient and lower cost public services (Davies, 2015, 4).

One of the most challenging initiatives of information technology for public sector modernization in the Republic of Kosovo is the implementation of the Human

Resource Management Information System in Civil Service (HRMIS), undertaken by the Ministry of Public Administration.

This initiative is governed not only by the tendency to improve business processes and increase the efficiency of human resource management and in planning and monitoring the implementation of policies in the Civil Service, but the delivery of government services according to the best European and international practices is a requirement for the Republic of Kosovo to withstand the process of European integration. (MAP, 2015, 7)

On the other hand, HRMIS will serve as an information register for civil servants and the organizational structures of Public Administration, which information will serve other information systems implemented and expected to be implemented in Kosovo. The successful implementation of HRMIS is critical not only for the functionality of this system, but also for all others systems that will interact with this system.

Somehow, most of IS projects in developing countries fail (Heeks, 2002, 5). IS failure is therefore a very real and very practical problem for developing countries (Heeks, 2002, 4), an evaluation of project in terms of success and failure is necessary to address in time the failure factors in order to reduce risk and increase the degree of success.

Therefore, through this study, we will try to evaluate the degree of HRMIS success from the perspective of personnel officers.

Research question to be answered in this study is:

Is the implementation of HRMIS in level of personnel officials successful?

The reason why the research is undertaken in the perspective of the personnel officers is because at this stage the personnel officers are the main users of the system and the best judges of its function.

In order to have a successful evaluation, the Design-Reality Gap Analysis Model, conducted by Richard Heeks, has been used. The gap between the “real situation” in which the project is currently and “The Project Objectivity” along the seven dimensions of (ITPOSMO) model has been analysed: **I**nformation, **T**echnology, **P**rocesses, **O**bjectives and values, **S**taffing and skills, **M**anagement systems and structure, **O**ther resources.

Success and failure of information system depends on the gap between the “real situation” in which the project is and “what is meant and modelled in project design”, concretely, the gap that exists between the “actual reality” and “Project Design” called: **design-reality gap**. By measuring the size of this gap, we assess the level of success. The smaller the gap, the higher the chance for more successful implementation of system (Heeks, 2003, 3).

Description of HRMIS

During 2013/2014, the Department of Civil Service Administration (DCSA) in the Ministry of Public Administration (MPA) has started the implementation of the pilot-project for Human Resource Management Information System (HRMIS) in MPA and in five other public institutions, thus making a significant step toward public administration reform. After the implementation and testing of this pilot project, the system has also been expanded in other institutions, and during 2015 the system has been implemented in all government institutions of Republic of Kosovo.

During this year, most of personnel officers were trained how to use the system and started to use the system only for some specific modules, mainly those modules dealing with recruitment procedures.

At this time, HRMIS had six modules in total: Recruitment Module, Civil Servant's Administration Module, Commissions Module, Reporting Module, Training Module and Self-Service Module.

During 2016, HRMIS was supplemented with three additional modules: Personnel Planning Module, On-line application Module and Module for Senior Management Positions.

To create an accurate electronic register for Civil Servants, DCSA/MPA during 2016 has undertaken the initiative to complete the files of employees from personnel officers.

Personnel officers in all institutions have to populate the files of employees of the respective institution with the following data: personal data, qualification, experience etc. constantly supervised and instructed on the process by DCSA.

To increase the ability to use the functions of HRMIS, DCSA, during May - September 2016, has re-organized the training for all Personnel Officers and IT Officers of the institutions.

Due to the inability to organize trainings for all other officers, DCSA has trained IT officials of institutions who will assist other employees in using the HRMIS.

Aside from the importance of Human Resource Management Information System for the civil service management, this system will also serve as an electronic register of civil servants which will be connected with all other systems in order to feed them with civil servants data.

Also, HRMIS will be connected with Civil Status System and Payroll System, therefore the success of this system is very critical.

Since personnel officers are the ones who will mostly use HRMIS at this time and they are the best judges of the system, so the evaluation of HRMIS should be made only by personnel officers. More comprehensive assessment will be made in the near future.

Research Framework

The assessment of the "success" of an information systems is a very important aspect to understand the IS success by assessing the effective creation, distribution, and use of information via technology. This is because every organization would like to ensure that their investments in IS field are successful and to identify whether the system meets the organization's goals (DeLone & McLean, 2016, 4)

According to Heeks(Heeks, 2002, 2), IS Initiatives may fall into one of the three outcome categories:


Total failure: The initiative never implemented, or was implemented but immediately abandoned.

Partial failure: The main goal of the initiative and/or desired result has not been achieved, or when the initiative initially is successful but after a year or so fails(may affect developing countries)

Success: The initiative is successful when we do not experience significant undesirable outcomes and in which the most of the stakeholder's major goals are attained.

One of the most used models for assessment of success factors of Information Systems is the Model: **Design-Reality Gap Analysis** developed by Richard Heeks. There are numerous articles available with regard to failure or success factors of Information Systems in developing countries, in which cases, the researchers have used design-reality gap analysis for measuring the success and failure of projects. The possibility of a project to be successful or to fail, depends on the size of gap between “current reality” in which the project is and “project design’. In order to understand this gap, gap analysis across seven dimensions of Heek’s model, summarised by the ITPOSMO acronym is necessary and sufficient. The larger design-reality gap leads to greater risk of project failure, and vice versa.

Fig.1. Design Reality Gap (Heeks, 2003,7)



Research Methodology

In this study we used quantitative method to collect data that are included in research using an structured questionnaires as research tool. (Matthews & Ross, 2010, 181). The questionnaire is conducted based on Heels model, who include seven factors and 22 variables.

The questionnaire was divided into three sections: In the first section is explained the purpose of the survey and were given instructions for filling out the questionnaire. The second section concentrated on questions that enable capture demographic information such as age, education background, work experiences and training for computer use, The last section was designed to measure 18 elements(sub-dimensions) divided into seven factors ITPOSMO. Each question contains three categories of response:

- 0- No change between the current reality and design proposal
- 5- Some degree of change between the current reality and design proposal
- 10-Radical changes between the current reality and design proposal

Statistical analysis of collected data

The population in this study is comprised of 114 personnel managers who were trained to use the system and are using it. We have distributed 45 questionnaires to some of them via email. 41 responses were received, 4 from them were disqualified and the remaining 37 responses (82 % of total) were accepted as valid.

Data collection and design-reality gap identification was not difficult, since one author “Fakije Zejnullahu” was closely involved in implementing process of system and was trainer in the whole process of training for all Personnel Officers and IT Officers of the institutions.


Demographic information

Table 1. provides demografik data for personnel managers who participated in this study.

Variable	Response	Frequency	Percent (%)
Age	26-40	18	48.6
	41-60	17	45.9
	More than 61	2	5.4
Education Level	University or	16	43.2
	Master	21	56.8
Work Experience	1-5 year	4	10.8
	6-10 year	13	35.1
	over 11 year	20	54.1
Computer Use Training	YES	35	94.6
	NO	2	5.4

Design-reality gap

In the diagram below are presented the total points for each dimension, which are a combination of sub-dimensions points. The larger design-reality gap is in the dimensions: Processes, Objectives & Values and Staffing & Skills.



Based on this study, the success of implementation of HRMIS is scored 16.25. The score under this study falls under the category of “partial failure” - The project might be a partial failure unless action is taken to close design-reality gaps. See Table.2

below.

Table 2. Risk Assessment layout (Heeks, 2003, 7)

Overall Rating	Likely Outcome
57 – 70	The project will almost certainly fail unless action is taken to close design-reality gaps.
43 – 56	The project may well fail unless action is taken to close design-reality gaps
29 – 42	The might fail totally, or might well be a partial failure unless action is taken to close design-reality gaps.
15 – 28	The project might be a partial failure unless action is taken to close design-reality aps.
0 – 14	The project may well succeed.

Information: Personnel managers estimate that HRMIS generally provides sufficient information, accurate, relevant and which can be obtained in the form of appropriate. 43.2% of respondents assess that the information must be more completed and 59.5% considers that access to information should be available for other actors, depending on the right of access. 70.3% of surveyed managers assess that the circulation of information from one person/office/organisation to another become in convenient and easy way. Gap=2.11.

Technology: 59.4% of personnel managers involved in the study estimated that the scanning devices were inadequate or were with weak performance. 5.4% of respondents said that their institutions were not connected in the governmental network. Regarding computer performance, only 27% of personnel managers estimate that the computer they own is a poor performances. Gap=2.52

Processes: 64% of respondents estimate that work processes must be corrected slightly and to be more completed. Gap = 3.24

Objectives & Values: A large percentage of personnel managers, 73%, estimate that HRMIS, it has not yet fully achieved the objectives, while 51.4% estimate that HRMIS, it has brought more benefit in to their work. Gap=3.1

Staffing and Skills: 77.7% of personnel managers believe that the system user manuals are not enough convenient and understandable. 64.9% of personnel managers estimate that training was sufficient for them, but the trainings were necessary also for the others officers, 62.2% estimate that they have enough knowledge to use the system while 35.1% of respondents estimate that should increase the number of staff working in the personnel office. Gap=2.75

Management Systems and Structures: The gap in this dimension is not very express. Gape=0.9

Others: The support of the political and managerial factor from 62.2% of respondents assessed to be inadequate in the process of implementing the System, while as regards the budget was estimated to be no problem. Gape=1.55

Table of Results

	No change	Some degree of change	Radical changes	Rating (Sub Dimensions)	-Rating (Dimensions)
Information					2.11
Information Quantity	64.9%	35.1%	0.0%	1.76	
Information Quality	56.8%	43.2%	0.0%	2.2	
Information Flows	70.3%	29.7%	0.0%	1.5	
Information in Use	40.5%	59.5%	0.0%	2.97	
Technology					2.52
Computer Hardware	73.0%	27.0%	0.0%	1.35	
Network	56.8%	37.8%	5.4%	2.43	
Equipment for Scanning	40.5%	43.2%	16.2%	3.78	
Processes					3.24
Proces	35.1%	64.9%	0.0%	3.24	
Objectives & Values					3.1
Objectives	27.0%	73.0%	0.0%	3.65	
Value	51.4%	48.6%	0.0%	2.43	
Management Systems & Structures					0.95
Management Syst& Structures	81.1%	18.9%	0.0%	0.95	
Staffing & Skills					2.78
Staffing Numbers	64.9%	35.1%	0.0%	1.76	
Skills	62.2%	37.8%	0.0%	1.89	
Awareness	43.2%	51.4%	5.4%	3.11	
Training	35.1%	64.9%	0.0%	3.24	
Manuals of System use	24.3%	73.0%	2.7%	3.9	
Other Resources					1.55
Buget	100.0%	0.0%	0.0%	0	

Recommendations

Personnel Officers must complete the whole file of each employee in order for the data to be completed. To all civil servants and citizens should be encouraged to use the system so that the information is also available to them.

Since HRMIS operates only within the Government network, MPA should take into account all the cases of institutions who supplied with the Internet through private provider. Should make choice between two alternatives: to expand the Government

network to all institutions where HRMIS is implemented or to publish in the Internet the system by guaranteeing the security of the system. Lack of equipment for scanning or devices with poor performances, MPA must address this as problem that should be treated with emergency. Therefore not timely treatment of this problem risks that HRMIS to contain incomplete information to civil servants.

The project manager should review all work processes, to organize workshops with the personnel managers to identify needs for change / correction. During the use of the system, users continuously will be able to identify the shortcomings of the system that the manager should always to take into consideration.

To achieve the objectives, the system should be used by all employees and citizens, only then can meet the objectives of all stakeholders and to bring benefits expressed in the work of employees. MPA should organize training for other employees, especially for supervisors who must have knowledge about most of the modules of the system. The manual for use should be re-processed to be easier to understand. MPA also need to engage in awareness of employees and citizens on the advantages of the system and to motivate them to its use. To mitigate the shortage of staff, Institutions need to recruit new employees or make temporary movement of employees to engage in the process of completing the dossier.

Managerial staff should be supportive in the implementation of SMIHR.

Conclusion

Implementation of HRMIS was and continues to be a major challenge for the Republic of Kosovo. The successful implementation of HRMIS is critical not only for the functionality of this system, but also for all others systems that will interact with this system.

To assess the level of success of the implementation of this system, we have used the model design-reality gap analysis developed by Heeks. Measuring the gap between the “real situation” in which the project is located and “design project” is made along the seven dimensions where each dimension is broken down into sub-dimensions, thus creating a total of 18 variables.

From this research the success of the implementation of HRMIS is estimated to be 16.25 points, and falls into the category “partial failure”, and unless measures are taken to reduce this gap the project will be categorized “initiative partial failure”.

References

- Heeks.R (2002). *Failure, Success and Improvisation of Information Systems Projects in Developing Countries*. Institute for Development Policy and Management, UK.
- Heeks.R (2003). *Most e-Government-for-Development Projects Fail How Can Risks be Reduced?* . Institute for Development Policy and Management, UK.
- DeLone.H.W & McLean.R.E (2016), *Information Systems Success Measurement*. Now Publishers Inc. ISBN: 978-1-68083-142-9, United States.
- Davies.R(2015). *eGovernment, Using technology to improve public services and democratic participation*. EPRS PE, 565.890, ISBN 978-92-823-6814-5.
- MAP (2015). *Strategjia për Modernizimin e Administratës Publike 2015 – 2020*. Prishtinë.
- Matthews.B & Ross.L(2010), *Metodat e hulumtimit, Udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane*, CDE Tiranë.

Diferencat gjinore në simptomat e çrregullimeve të të ngrënit dhe niveleve të depresionit në adoleshencë

Semiramida Manaj
Universiteti i Tiranës

Abstrakt

Çrregullimet e të ngrënit dhe depresioni po studiohen gjithnjë e më shumë në të gjitha shoqëritë, së fundi edhe në shoqërinë shqiptare. Këto çrregullime më së shumti janë vënë re tek femrat, sidomos në moshën e adoleshencës. Rrjedhimisht pak vëmendje i është kushtuar të studiuarit të prevalencës së këtyre çrregullimeve në gjininë mashkullore. Qëllimi i këtij studimi është të evidentoj marrëdhënien midis çrregullimeve të të ngrënit dhe niveleve të depresionit dhe diferencat gjinore në simptomatologjinë e këtyre çrregullimeve.

Në këtë studim morën pjesë 150 adoleshentë 15-18 vjeç dhe kampionimi i këtij studimi u realizuar me përzgjedhje rastësore të përshkallëzuar në gjimnazet që frekuentonin. Adolehëntët plotësuan Inventarin e çrregullimeve të të ngrënit (Multidimensional eating disorder inventory) Garner, Olmstead & Polivy (1983), BDI-II-Shkallën e Depresionit të Beck (1996) dhe pyetësorin e të dhënave demografike. Hipotezat e studimit ishin: 1)Do të ketë një korrelacion pozitiv midis çrregullimeve të të ngrënit dhe nivelit të depresionit tek adoleshentët 15-18 vjeç. 2)Vajzat adolehente do të raportojnë nivele më të larta të depresionit dhe çrregullimeve të të ngrënit sesa djemtë adolehentë. 3)Do të ketë diferenca në simptomatologjinë e çrregullimeve të të ngrënit midis vajzave dhe djemve adolehentë.

Në fund të këtij studimi rezultoi se ekziston një lidhje korrelacionale pozitive statistikiqte e rëndësishme midis çrregullimeve të të ngrënit dhe niveleve të depresionit. Adolehentët me çrregullime të ngrëni ose më predispozitë për këto çrregullime kishin edhe nivele më të larta depresioni dhe anasjelltas. Gjithashtu u gjetën disa diferenca të rëndësishme midis djemve dhe vajzave adolehente në simptomatologjinë e çrregullimeve të të ngrënit dhe niveleve të depresionit. Djemtë raportuan më shumë episode mbingrënie dhe kryerjen e ushtrimeve intensive fizike për të kompesuar mbingrënien, kurse vajzat raportuan më shumë ndjenjë faji pas të ngrënit, ndjenjë e humbjes së kontrollit mbi ushqimin dhe përdorimin e laksativëve dhe nxjerrjes së ushqimit për të mos shtuar peshë. Gjithashtu vajzat ishin më tepër të predispozuara për zhvillimin e çrregullimeve të të ngrënit dhe raportuan nivele më të larta të depresionit sesa djemtë me të njëjtën predispozitë. Këto rezultate do të jenë mjaft të dobishme për profesionistët për ngritjen e planit të duhur ndërhyrës për trajtimin e tyre.

Fjalët kyçe: çrregullime të të ngrënit, depresion, adolehent, diferenca gjinore.

Hyrje

Globalisht, shëndeti i të rinjve është një çështje kryesore që po studiohet nga profesionistët e kujdesit shëndetësor në shëndetin e përgjithshëm dhe shëndetin mendor në veçanti. Organizata Botërore e Shëndetësisë (WHO, 2001) raportoi se 10% e të rinjve përballet me probleme psikologjike ose sjellore gjatë sjetës së tyre. Depresioni dhe çrregullimet e të ngrënit janë çrregullimet psikologjike më të përhapura tek të rinjtë në të gjithë botën; depresioni aktualisht parashikohet se do të bëhet shkaku i dytë progresiv i shumë sëmundjeve në vitet 2020 në të gjithë botën (WHO, 2001), në mënyrë të ngjashme, Qendra e Fondacionit Renfreë për Çrregullimet e të Ngrënit (2003) referon se rreth 24 milionë në të gjithë botën kanë çrregullime të

të ngrënit. Sipas Wade dhe Hudson (2011), në Shtetet e Bashkuara 20 milionë femra dhe 10 milionë meshkuj kanë diagnostikuar me të paktën një çrregullim të ngrëni gjatë jetës së tyre.

Çrregullimet e të ngrënit, të karakterizuara nga anoreksia nervosa dhe bulimia nervosa (WHO, 2000) janë probleme serioze somatike dhe të shëndetit mendor, të cilat mbizotërojnë ndjeshëm në moshën e rritur të hershme ose adoleshencë (Preti et al., 2009), në mënyrë të veçantë tek femrat. Termi “çrregullim të ngrëni” ka të bëjë shfaqjen e sjelljeve jonormale të të ngrënit, të cilat ndikojnë në funksionimin fizik dhe mendor të individit (Eisenberg, 2011). Periudha e rrezikut për shfaqjen e sjelljeve jo normale të të ngrënit ndodh në periudhën moshore 10-24 vjeç (Currin, Schmidt, Treasure & Jick, 2005). Tiggeman dhe McGill (2004) arritën në përfundimin se shfaqjet më befasese të problemeve me të ngrënit janë parë tek adoleshentët dhe të rinjtë, si pasojë e pakënaqësisë më pamjen trupore çrregullimet e të ngrënit janë vënë re më shumë kryesisht tek femrat në krahasim me meshkujt.

Depresioni është një problem i njohur shëndetit mendor që ndikon negativisht mbi aftësinë e individit për të funksionuar në jetën e përditshme (Instituti Kombëtar i Shëndetit Mendor, 2014). Periudha e adoleshencës dhe e moshës së rritur të hershme janë identifikuar si mosha tipike e fillimit të episodit të parë të depresionit (Kuehner, 2000; Marcus et al, 2005). Organizata Botërore e Shëndetësisë (2002) e konsideron depresionin në botë si një nga problemet me të mëdha për shoqëritë moderne dhe thekson nevojën për të identifikuar faktorët predispozues në mënyrë që të kuptojmë problemin, ta parandalojmë dhe të gjejmë mënyrat e duhura të trajtimit. Depresioni është problemi më i përhapur i shëndetit mendor në botë dhe është konsideruar më shumë mbizotërues tek femrat sesa tek meshkujt (Chen, Jiang, dhe Mao, 2009). Pacientët me depresion kanë një shkallë më të lartë të indeksit të masës trupore (BMI) dhe të çrregullimeve të të ngrënit në krahasim me pacientët pa depresion (Zhao et al., 2009).

Karakteristika të përbashkëta të çrregullimeve të të ngrënit janë probleme sociale, pagjumësi, nervozizëm, konfuzion, humor të depresuar (ndjenjë të pashpresë, faji, dhe të ndjerit i pavlerë) dhe vështirësi në kontrollin e impulseve (Abraham dhe Liewelly Jones, 2001). Faktorët e rrezikut të lidhur me simpatomat e çrregullimit përfshijnë vetvlerësimin e ulët, imazh negativ të trupi, neuroticizëm, impulsivitet, depresion dhe ankth psikologjik (Rlfhag & Morey 2003). Në mënyrë të ngjashme, Heaven et al., (2001) vunë në dukje se, kur njerëzit janë në depresion ata hanë më shumë, e cila mund të jetë një përpjekje për të larguar ndjenjat negative dhe depresionin. Megjithatë, sipas një numri të madh kërkimesh, të qënurit i depresuar lind në masë të madhe për shkak të mosmiratimit të trupit dhe depresioni mund të shkaktojë pakënaqësi ndaj trupit për shkak se ndjenjat e zakonshme negative janë kthyer në emocionet negative në lidhje me trupin dhe masën (Keel, Mitchell, Davis & Crow, 2001.; Keel et al, 2001). Për më tepër, çrregullimet e të ngrënit, shqetësimet për masën trupore, imazhin e trupit, pakënaqësi e trupit dhe vetë-perceptimi negativ janë më të vërteta tek femrat sesa meshkujt; femrat në moshën e adoleshencës ose moshën e rritur të hershme tregojnë pakënaqësi të madhe me peshën e tyre se meshkujt, mbajnë më shumë dieta dhe ashpërsia e çrregullimeve të të ngrënit është më e madhe tek femrat sesa meshkujt (Jarry, 1998). Mbi-vlerësimi nga sugjerimet idiomatike rreth formës ideale të trupit, e shoqëruar në masë me pakënaqësinë e trupit, besime e gabuara për të ngrënit dhe peshën, depresioni dhe vetë-vlerësimi i ulët janë më të zakonshme tek femrat (Garner & Bermis, 1982). Dreëonëski dhe Yee (1987) raportuan se dallimi kryesor gjinor në çrregullimet e të ngrënit mund

të jetë i lidhur me sjelljet aktuale përreth dietës dhe stërviçjeve, në vend të vetëm pakënaqësisë me peshën e tyre trupore. Femrat janë më të shqetësuara për dietën sesa meshkujt dhe dëshira e tyre për të qënë të dobëta është e lidhur direkt me frekuencën e mbajtjes së dietave.

Sipas Emmons (1996), ka një korrelacion mes imazhit negativ për masën trupore dhe depresionit. Depresioni rrit rrezikun e shfaqjes së çrregullimeve të të ngrënit (Markoëitzetal., 2008) dhe njerëzit më nivel të lartë të obezitetit kanë pasur edhe nivele të larta depresioni (Dunbar et al., 2008). Lidhja midis çrregullimeve të të ngrënit dhe depresionit është gjetur më shpesh tek femrat në krahasim me meshkujt (Chen et al., 2009). Prandaj studimi aktual ndihmon për të kuptuar se depresioni dhe çrregullimet e të ngrënit janë parashikues reciprok të rëndësishme të njëri-tjetrit.

Çrregullimet e të ngrënit

Anoreksia, bulimia dhe çrregullime të tjera të të ngrënit janë studiuar më shumë tek femrat, dhe pak vëmendje i është kushtuar studimit të simptomatologjisë së këtyre çrregullimeve tek meshkujt. Në një studim në Oregon Research Institute, Eugene, Peter M. Lewinsohn dhe kolegë të tij përdorën një pyetësor vetraportues (Eating Disorders Symptoms Questionnaire, or EDSQ) dhe intervista të ndryshme për të studiuar sjelljet dhe zakonet e të ngrënit në një komunitet prej 1056 adoleshentë të moshës 14-18 vjeç të zgjedhur nga nëntë shkolla në Oregonin perëndimor. Pyetjet që ata shtruan ishin : 1)A kanë femrat më shumë çrregullime të të ngrënit se meshkujt? 2) A janë disa sipmtoma specifike të çrregullimeve të të ngrënit në shumë të evidentuara tek femrat se sa tek meshkujt? 3)A është struktura e çrregullimeve të të ngrënit e ndryshme midis meshkujve dhe femrave? 4) A janë meshkujt me çrregullime të të ngrënit më pak të gatshëm për të kërkuar trajtim sesa femrat?

Nga ky studim rezultoi se kishte diferenca gjinore domethënëse në pesë shkallët e EDSQ. Femrat morën më shumë pikë në nënshkallët e dëshirës për të qënë sa më të dobëta fizikisht, për buliminë, pakënaqësinë për pamjen trupore dhe në sjellje të papërshtatshme kompesuese pas të ngrënit. Djemtë morën pikë më të larta në nënshkallën e ushtrimeve fizike intensive pas episodeve të mbingrënies. Në krahasim me femrat, meshkujt raportuan se kishin pasur më shumë episode mbingrënie në tre muajt e fundit (përkatesisht 28% meshkujt, 14% femrat). Meshkujt raportuan se këto episode mbingrënie ishin pasuar nga ushtrime intensive fizike pas të ngrënit. Ndërkohë femrat i kishin lidhur episode e mbingrënies me humbje të kontrollit ndaj ushqimit, ndjenjë faji pas të ngrënit dhe i konsideronin sjelljet e tyre të të ngrënit si anormale. Femrat raportuan më shumë gatishmëri dhe dëshirë për të marrë trajtim për çrregullimet e tyre sesa meshkujt (përkatesisht 16% femrat, 2% meshkujt). Gjithashtu 5% e femrave dhe 1% e meshkujve raportuan se kishin marrë një trajtim në të kaluarën për çrregullimin e tyre.

Depresioni dhe çrregullimet e të ngrënit

Rezultatet e një studimi të kryer nga Patton GC, Coffey C & Sawyer SM (2003) në Australi treguan se ekziston një lidhje midis çrregullimeve të të ngrënit dhe depresionit. Sipas këtij studimi 9% e popullsisë kishin një çrregullim të ngrëni dhe afërsisht 3 milion australian vuanin nga depresioni. Një në pesë femra dhe një në tetë meshkuj raportuan se kishin përjetuar të paktën një herë depresion gjatë adoleshencës së tyre. Njerëzit me çrregullime të të ngrënit janë dy herë më të predispozuar për

të pasur depresion se sa njerëzit e popullatës normale. Studimi tregoi se 50% e adoleshentëve me çrregullime të të ngrënit kishin nivele të larta depresioni, kryesisht adoleshentët me bulimi. Megjithatë mbetet e paqartë nëse depresioni është një faktor rreziku për zhvillimin e çrregullimeve të të ngrënit apo depresioni vjen si pasojë e të paturit një çrregullim të ngrëni. Të paturit depresion i bën adoleshentët të ndihen keq me veten e tyre, të mos pëlqejnë trupin e tyre, të kenë vetvlerësim të ulët dhe kjo mund t'i çoj ata drejt rrezikut për të zhvilluar një çrregullim të ngrënit. Nga ana tjetër, çrregullimet e të ngrënit mund t'i bëjnë adoleshentët të përjetojnë depresion, kryesisht nëse ata përjetojnë humbje të madhe të peshës, mosushqyerje dhe humbje të kontrollit mbi ushqimin (Patton GC, Coffey C & Sawyer SM, 2003).

Studimi tregoi se adoleshentët me anoreksi kishin patur një fëmijëri problematike dhe kanë karakteristika personaliteti si obsesion dhe perfeksionizëm, të cilat mund të jenë faktor që predispozojnë çrregullimet e të ngrënit dhe depresionin. Nga studimi dolën në pah disa faktor predispozues të të paturit depresion dhe çrregullime të të ngrënit: faktorët biologjik, faktorët gjenetik (histori familjare të problemeve të shëndetit mendor), faktorët social (presioni i media me theksimin e standarteve të së bukurës), faktorët psikologjik (vetvlerësimi i ulët, aftësit të ulëta përshatëse dhe përbalueset të problemeve dhe marrëdhëniet problematike me të tjerët) (Patton GC, Coffey C & Sawyer SM, 2003).

Qëllimi dhe objektivat

Qëllimi i këtij studimi është të eksploroj marrëdhënien midis çrregullimeve të të ngrënit dhe depresionit tek adoleshentët dhe të evidentoj dallimet gjinore në predispozitën për të pasur depresion dhe çrregullime të ngrënit. Objektivat e këtij studimi janë: 1)Të eksploroj nivelin e simptomatologjisë së çrregullimeve të të ngrënit dhe depresionit tek adoleshentët 15-18 vjeç. 2)Të evidentoj marrëdhënien korrelacionale (nëse ekziston) midis çrregullimeve të të ngrënit dhe depresionit tek adoleshentët. 3)Të eksploroj diferencat gjinore në simptomatologjinë e çrregullimeve të të ngrënit dhe niveleve të depresionit tek adoleshentët. Hipotezat e këtij studimi janë: 1)Do të ketë një korrelacion pozitiv midis çrregullimeve të të ngrënit dhe nivelit të depresionit tek adoleshentët 15-18 vjeç. 2)Vajzat adoleshente do të raportojnë nivele më të larta të depresionit dhe çrregullimeve të të ngrënit sesa djemtë adoleshentë. 3)Do të ketë diferenca në simptomatologjinë e çrregullimeve të të ngrënit midis vajzave dhe djemve adoleshentë.

Metodologjia

Kampioni i këtij studimi përbëhet nga 150 adoleshentë të moshës 15 deri 18 vjeç. Moshë e kampionit u vendos të ishte e tillë pasi targeti i këtij studimi janë individët në adoleshencën e mesme dhe në atë të vonë. 23% e adoleshentëve janë të moshës 15 vjeç dhe 27% prej tyre të moshës 16 vjeç dhe 29% janë të moshës 16 vjeç dhe 21% janë të moshës 18 vjeç. Nga 150 adoleshentë që morën pjesë në studim 53% prej tyre janë femra dhe 47% janë meshkuj. Të gjitha të dhënat e mbledhura nga studimi ishin të vlefshme. Pjesëmarrësit në këtë studim janë nxënës të shkollave të mesme të qytetit të Tiranës. Të gjithë pjesëmarrësit në këtë studim morën pjesë vullnetarisht.

Kampionimi i këtij studimi u realizua me përzgjedhje rastësore të shkallëzuar duke e parë këtë mënyrë përzgjedhje si më të përshtatshen për studimin që po realizohej. Së pari, emrat e shkollave u shkruajtën në letra të bardha dhe prej 46 shkollave u

përzgjedhën rastësisht 5 shkolla të mesme. Shkollat që u përzgjedhën për të realizuar ky studim janë : Partizani, A.Z. Çajupi, S.Tafaj, I.Qemali, Sami Frashëri. Së dyti u vendos që në secilën prej shkollave të përzgjedhura më parë do të merrnin pjesë 30 adoleshentë të përzgjedhur rastësisht. Pra, në çdo shkollë të përmendur më sipër është përzgjedhur një kampion prej 30 nxënësish. Së treti në secilën nga shkollat u morën rregjistrat e klasave të 10-ta, 11-ta dhe 12-ta dhe prej tyre përzgjidheshin 30 nxënës në secilën shkollë në mënyrë rastësore.

Instrumentet

Për të realizuar këtë studim janë përdorur tri instrumente: BDI-II (Shkalla e Depresionit Beck); IÇN-Instrumenti i Çrregullimeve të të Ngrënit i ndërtuar nga Garner, Omstead & Polivy (1983) dhe Pyetësi i të Dhënave Demografike.

Instrumenti IÇN është ndërtuar nga autorët Garner, Omstead & Polivy (1983) dhe është përdorur gjerësisht në studime të ndryshme për çrregullimet e të ngrënit. IÇN mat shfaqjen e simptomave të çrregullimeve të të ngrënit dhe shërben si një instrument primar për identifikimin e individëve të cilët rrezikojnë të zhvillojnë çrregullime të të ngrënit. Instrumenti përmban 40 pohime lidhur me simptomat e çrregullimeve të të ngrënit. Totali i pikëve që mund të merrët nëpërmjet këtij instrumenti është 120 pikë dhe është i ndarë në tre nivele pikësh. Individët që marrin nga 0-29 pikë kategorizohen si individ normal dhe që nuk kanë simptomat e çrregullimeve të të ngrënit dhe as rrezik për të zhvilluar këto çrregullime. Individët që marrin nga 30-50 pikë kategorizohen si individ që janë në kufi me çrregullimet e të ngrënit dhe që shfaqin simptomat e çrregullimeve të të ngrënit të cilat mund të çojnë në çrregullime të pastra të të ngrënit. Kurse individët që marrin më shumë se 50 pikë kategorizohen si individ që kanë çrregullime të të ngrënit dhe që duhen diagnostikuar për të përcaktuar llojin e çrregullimit specifik që mund të kenë si: anoreksi nervore, bulimi nervore etj. Shkalla matëse në këtë instrument për shpeshinë e simptomave është Shkalla Likert me një shkallëzim nga 1 në 5, ku 1 i korrespondon përgjigja "asnjëherë", 2 i korrespondon përgjigja " shumë rrallë", 3 i korrespondon përgjigja "rrallë", 4 i korrespondon përgjigja "shpesh" dhe 5 i korrespondon përgjigja "gjithmonë". Koha e administrimit është 20 minuta.

BDI-II (Shkalla e Depresionit Beck, 1996) është një instrument i hartuar nga Beck (1996) për matjen e depresionit. BDI-II (Shkalla e Depresionit Beck) është i përbërë nga 21 grupe pohimesh dhe secili pohim mat një variabël të depresionit. Gjatë plotësimit të tij çdo individ duhet të zgjedhë nga një pohim në secilin grup pohimesh. Për çdo pohim që zgjidhet individ mund të marrë 0, 1, 2 apo 3 pikë. Sa më shumë pikë që merr një individ gjatë plotësimit të BDI-II (Shkalla e Depresionit Beck) aq më e rëndë është gjëndja e tij depressive. Ky është një instrument që përdoret gjerësisht ndërkomëtarisht për matjen e depresionit në studime të ndryshme.

Instrumenti për të Dhënat Demografike është ndërtuar nga unë. Instrumenti përmban 15 pyetje. Nëpërmjet këtij instrumenti synohen të merren karakteristika të përgjithshme përshkruese të kampionit të zgjedhur. Instrumenti përmban pyetje lidhur me moshën, klasën që frekuenton, vendlindjen, më kë jetojnë në familje, rradhën e lindjes së respondentit, statusin, nivelin e përgjithshëm ekonomik në familje, nivelin arsimor të prindërve dhe besimi fetar të individëve pjesëmarrës në studim. Gjithashtu individët pyeten në këtë pyetësor nëse duan të jenë pjesëmarrës në studime të tjera në të ardhmen dhe nëse ata janë dakort, ju kërkohen të shkruajnë

kontaktet e tyre personale si adresa e e-mailit ose numrin e telefonit. Në këtë studim nuk do të përdoren të gjitha të dhënat e marra nga të dhënat demografike, por do të përdoren vetëm ato të dhëna që janë në funksion të studimit. Të dhënat e tjera janë në funksion të studimeve të ardhshme që unë mund të bëj në këtë fushë.

Analiza e të dhënave

Të dhënat e mbledhura nga pyetësorët u futën në një bazë të dhënash duke përdorur paketën statistikore, SPSS 20. Të dhënat u futën në bazën e të dhënave nga një person i vetëm. Analiza e të dhënave konsistonte në një analizë deskriptive të realizuar nëpërmjet programit SPSS, duke llogaritur frekuencat, mesataret dhe përqindjet. Statistikat e përfshira në këtë program bazë janë korrelacionet dhe statistikatat deskriptive, si: frekuencat, krostabulimet, përqindjet etj.

Etika

Gjithë informacioni i mbledhur nga studimi është subjekt i anonimitetit të plotë. Është marrë leje nga të gjithë subjektet që kanë kontribuar në realizimin dhe finalizimin e këtij studimi. Gjithashtu përpara aplikimit të instrumentave, u informuan subjektet pjesëmarrës mbi fokusin e studimit, qëllimet e studimit dhe përmbajtjen e instrumentave të përdorur. Është shmangur rreziku i dëmtimit fizik ose psikologjik të personave të përfshirë në studim.

Limitet e studimit

Kampioni i studimit është përzgjedhur vetëm në qytetin e Tiranës, është kampion relativisht i vogël dhe studimi nuk mund të përgjithësohet. Kampioni i studimit nuk është përfaqësues i popullatës, sepse është përzgjedhur vetëm një grupmoshë. Nevojiten metoda dhe instrumenta efikasë të pilotuara dhe të standartizuara në përputhje me kulturën tonë. Shkalla e depresionit e Beck dhe IÇN Instrumenti i Çrregullimeve të të Ngrënit gjithashtu nuk janë standartizuar për kulturën shqiptare. Koha në dispozicion është një tjetër faktor që ndikon dhe që lë vend për diskutime, sepse vlerësimi i depresionit dhe i çrregullimeve të të ngrënit, janë dimensionet të cilat kërkojnë një shtrirje më të madhe kohore për të bërë një vlerësim të plotë të tyre.

Rezultatet

Tabela 1. Moshat e adoleshentëve pjesëmarrës në studim

Mosha	Përqindje	Përqindje e vlefshme	Përqindje kumulative
15 vjeç	23	23	23
16 vjeç	27	27	50
17 vjeç	29	29	79
18 vjeç	21	21	100
Total	100	100	

Në tabelën 1. Shohim shpërndarjen moshore të pjesëmarrësve adoleshentë në

studim; 23% i përkasin moshës 15 vjeç, 27% moshës 16 vjeç, 29% moshës 17 vjeç dhe 21% moshës 18 vjeç.

Tabela 2. Gjinia e pjesëmarrësve në studim në përqindje

Gjinia	Përqindje	Përqindje e vlefshme	Përqindje kumulative
Djemë	47	47	47
Vajza	53	53	100
Total	100	100	

Në tabelën 2. Shohim shpërndarjen gjinore të adoleshentëve pjesëmarrës në studim. Vihet re se diferenca midis numrit të pjesëmarrësve djem dhe vajza është shumë e vogël. Rrjedhimisht është edhe më e lehtë të bëhet krahasimi gjinor për çrregullimet e të ngrënit dhe nivelet e depresionit.

Në tabelën 3 dhe 4 vihet re se vajzat janë më tepër të predispozuara për zhvillimin e çrregullimeve të të ngrënit dhe raportuan nivele më të larta të depresionit sesa djemtë me të njëjtën predispozitë.

Tabela 3. Niveli i depresionit tek vajzat dhe djemtë adoleshentë

	Djemë	Vajza	Total
Mungesë depresioni	36%	26%	62%
Depresion i lehtë	6%	15%	21%
Depresion i moderuar	4%	8%	12%
Depresion i rëndë	1%	4%	5%
Total	47%	53%	100%

Tabela 4. Çrregullimet e të ngrënit tek adoleshentët

	Djemë	Vajza	Total
Normal	39%	32%	71%
Në kufinj me çrregullimet e të ngrënit	8%	19%	27%
Çrregullime të të ngrënit	0%	2%	2%

Tabela 5. Çrregullimet e të ngrënit dhe nivelet e depresionit

		Mungesë depresioni	Depresion i lehtë	Depresion i moderuar	Depresion i rëndë
Normal	71%	55%	13%	2%	1%
		16%			
Në kufinj me rregullimet e të ngrënit	27%	5%	7%	10%	5%
		22%			
Çrregullime të të ngrënit	2%	0%	0%	1%	1%

Nga tabela 5 vihet re se adoleshentët me çrregullime të ngrëni ose më predispozitë për këto çrregullime kanë edhe nivele më të larta depresioni.

Tabela 6. Diferencat gjinore në simptomatologjinë e çrregullimeve të të ngrënit

Disa pohime nga Inventari i Çrregullimeve të të Ngrënit Garner, Omstead & Polivy (1983)		Në kufij me çrregullimet e të ngrënit ose me çrregullime të të ngrënit	
		Vajza 21%	
Djemë 8%			
Unë jam i/e tmerruar nga ideja e të qenurit mbipeshë		4%	19%
Unë ndjej se kam probleme me të ngrënit, sepse ndjej se nuk jam në gjendje të ndaloj së ngrëni dhe humbas kontrollin kur ha.		7%	12%
Unë informohem gjithmonë mbi përmbajtjen e kalorive të ushqimeve që ha.		3%	20%
Unë marrë laksativë / medikamente për të vjellë ushqimin.		0%	15%
Ndihem jashtëzakonisht fajtor/e pasi kam ngrënë.		1%	18%
Unë jam shumë i/e shqetësuar nga dëshira ime për të qënë sa më i/e dobët.		4%	15%
Unë ushtrohem shumë fizikisht për të djegur kaloritë.		8%	5%
Unë peshohem disa herë në ditë.		1%	17%
Unë mendoj se ushqimi ka kontroll të madh mbi jetën time.		7%	18%

Nga tabela e mësipërme vihen re disa diferenca të rëndësishme midis djemve dhe vajzave adoleshente në simptomatologjinë e çrregullimeve të të ngrënit dhe niveleve të depresionit. Djemtë raportuan më shumë episode mbingrënie dhe kryerjen e ushtrimeve intensive fizike për të kompesuar mbingrënie, kurse vajzat raportuan më shumë ndjenjë faji pas të ngrënit, ndjenjë e humbjes së kontrollit mbi ushqimin dhe përdorimin e laksativëve dhe nxjerrjes së ushqimit për të mos shtuar peshë.

Tabela 7. Korrelacioni

		Në kufi me çrregullimet e të ngrënit	Çrregullime të të ngrënit	Depresion
Në kufi me çrregullimet e të ngrënit	Pearson Correlation	1	0.363**	0.352**
	Sig. (2-tailed)		.000	.004
	N	287	287	287
Çrregullime të të ngrënit	Pearson Correlation	0.363**	1	0.453**
	Sig. (2-tailed)	.000		.000
	N	287	287	287
Depresion	Pearson Correlation	0.352**	0.453**	1
	Sig. (2-tailed)	.004	.000	
	N	48	48	48
**. Correlation is significant at the 0.01 level (2-tailed)				

Nga tabela 7. shohim se ekziston një lidhje korrelacionale pozitive statistikisht e rëndësishme midis çrregullimeve të të ngrënit dhe niveleve të depresionit ($r=0.453$).

Gjithashtu ekzistonin një lidhje korrelacionale pozitive statistikisht e rëndësishme midis çrregullimeve të të ngrënit dhe niveleve të depresionit ($r=0.352$) Adoleshentët me çrregullime të ngrëni ose më predispozitë për këto çrregullime do të kenë edhe nivele më të larta depresioni dhe anasjelltas.

Diskutim

Qëllimi i këtij studimi ishte të eksploronte marrëdhënien midis çrregullimeve të të ngrënit dhe depresionit tek adoleshentët dhe të evidentonte dallimet gjinore në predispozitën për të pasur depresion dhe çrregullime të ngrënit. Hipotezat e këtij studimi ishin: 1)Do të ketë një korrelacion pozitiv midis çrregullimeve të të ngrënit dhe nivelit të depresionit tek adoleshentët 15-18 vjeç. 2)Vajzat adoleshente do të raportojnë nivele më të larta të depresionit dhe çrregullimeve të të ngrënit sesa djemtë adoleshentë. 3)Do të ketë diferenca në simptomatologjinë e çrregullimeve të të ngrënit midis vajzave dhe djemve adoleshentë. Hipotezat e studimit u konfirmuan

Në fund të këtij studimi rezultoi se ekzistonin një lidhje korrelacionale pozitive statistikisht e rëndësishme midis çrregullimeve të të ngrënit dhe niveleve të depresionit. Adoleshentët me çrregullime të ngrëni ose më predispozitë për këto çrregullime do të kenë edhe nivele më të larta depresioni dhe anasjelltas. Sipas Shoqatës Psikiatrike Amerikane (2006) individët me çrregullime të të ngrënit kanë pasur një rrezik të lartë për zhvillimin e depresionit gjatë jetës së tyre në një rang nga 50-75%. Në një tjetër studim, 29% e pacientëve me çrregullime të të ngrënit raportuan prezencën e depresionit të madh (Halmi *et al.*, 1991). Një studim sugjeron se 70% e pacientëve me çrregullime të të ngrënit kanë bashkëshoqërues edhe çrregullime të humorit(Halmi *et al.*, 1991.). Herva dhe Laitinen *et al.*, (2006), kanë gjetur rezultate kontradiktore, duke mos gjetur ndonjë lidhje midis çrregullimeve të të ngrënit dhe depresionit.

Gjithashtu disa diferenca të rëndësishme midis djemve dhe vajzave adoleshente në simptomatologjinë e çrregullimeve të të ngrënit dhe niveleve të depresionit. Djemtë raportuan më shumë episode mbingrënie dhe kryerjen e ushtrimeve intensive fizike për të kompesuar mbingrënien, kurse vajzat raportuan më shumë ndjenjë faji pas të ngrënit, ndjenjë e humbjes së kontrollit mbi ushqimin dhe përdorimin e laksativëve dhe nxjerrjes së ushqimit për të mos shtuar peshë. Gjithashtu vajzat ishin më tepër të predispozuara për zhvillimin e çrregullimeve të të ngrënit dhe raportuan nivele më të larta të depresionit sesa djemtë me të njëjtën predispozitë. Pakënaqësi më e madhe për trupin, peshën dhe mbajtja e dietave drastike është gjetur më shumë tek femrat dhe ashpërsia e simptomave të çrregullimeve është më e lartë tek femrat sesa meshkujt (Jarry, 1998). Duke ju referuar Atlantis & Baker, 2008; Chen *et al.*, (2009), lidhja midis çrregullimeve të të ngrënit dhe depresionit është gjetur të të jetë më e fortë për femrat në krahasim me meshkujt. Kohëzgjatja e anoreksisë ishte 0.3% në një kampion kombëtar të meshkujve adoleshentë dhe në një kampion adoleshentesh femra prevalenca e anoreksisë është 0.5- 1% dhe rastet e bulimisë është 1-3%. Çrregullimi i depresionit madhor varion sipas gjinisë, nga 10 deri në 25% në kampionin e popullsisë së femrave dhe nga 5 në 12% tek meshkuj (APA, 2006). Në një studim, Eisenberg dhe Kirz (2011) kanë gjetur se 46% e femrave paciente me çrregullime të të ngrënit kanë përmbushur edhe kriteret për depresion madhor. Një tjetër studim tregon se depresioni dhe vetë-vlerësimi i ulët janë më të zakonshme tek femrat (Garner & Bermis, 1982). Ky studim tregoi se niveli i përgjithshëm i

depressionit e femrave ishte më i lartë se niveli i depressionit të meshkujve.

Konkluzione

Në fund të këtij studimi rezultoi se ekzistonin një lidhje e ndërsjelljtë midis çrregullimeve të të ngrënit dhe niveleve të depressionit. Adoleshentët me çrregullime të ngrëni ose më predispozitë për këto çrregullime do të kenë edhe nivele më të larta depressioni dhe anasjelltas. Gjithashtu ekzistojnë disa diferenca të rëndësishme midis djemve dhe vajzave adoleshente në simptomatologjinë e çrregullimeve të të ngrënit dhe niveleve të depressionit, ku vajzat shfaqen më tepër të predispozuara për zhvillimin e çrregullimeve të të ngrënit dhe raportuan nivele më të larta të depressionit sesa djemtë me të njëjtën predispozitë. Sigurisht që qëllimi final i këtij studimi është që rezultatet e këtij kërkimi tu vijnë në ndihmë profesionistëve të shëndetit mendor për hartimin e planit të duhur ndërhyrës për trajtim gjatë punës së tyre me djemtë dhe vajzat adoleshente.

Referenca

- Abraham, S. and Lewellyn-Jones, D. (2001). *Eating disorders: the facts* (5th ed). New York: Oxford University Press.
- American Psychiatric Association, (2006). Treatment of Patients with eating disorders. *American Journal Psychiatry*, 163, 4-45.
- Atlantis, E. and Baker, M. (2008). Obesity effect on depression: Systematic review of epidemiological studies. *International Journal of Obesity*, 32, 881-891.
- Beck, A.T., Steer, R.A., Ball, R. and Ranieri, W. (1996). Comparison of Beck Depression Inventories. IA and-II in Psychiatric out patients. *Journal of Personality Assessment*, 67(3), 588-597.
- Chen, Y., Jiang, Y. and Mao, Y. (2009). Association between obesity and depression in Canadians. *Journal of Women's Health*, 18(10), 1687-1692.
- Currin, L., Schmidt, U., Treasure, J. and Jick, H. (2005). Time trends in eating disorder incidence. *British Journal of Psychiatry*, 186(2), 132-135.
- Drewnowski, A. and Yee, D. K. (1987). Men and body image: are makes satisfied with their body weight. *Psychosomatic Medicine*, 49, 626-634.
- Dunbar, J. A., Reddy, P., Davis-Lameloise, N. and Philpot, B., Laatikainen.(2008). Important comorbidity with metabolic syndrome in a general population. *Diabetes Care*, 31(12), 2368-2373.
- Eisenberg, D. and Kirz, N. E. (2011). Eating disorder symptoms among college students. *Journal of American College Health*, 59, 700-707.
- Emmons, L. (1996).The relationship of dieting to weight in adolescents, *Journal of Abnormal Psychology*, 13(3), 167-178.
- Garner, D.M. and Bermis, K. M. (1982). A Cognitive – behavioral approach. *Cognitive Therapy and Research*, 6(2), 123-150.
- Garner, David M.; Olmstead, Marion; Polivy, Janet (Spring 1983). "Development and validation of a multidimensional eating disorder inventory for anorexia nervosa and bulimia".*International Journal of Eating Disorders* 2 (2): 15-34. Retrieved 7 December 2009.
- Garner, D.M., Olmsted, M.P., Bohr, Y. and Garfinkle, P. E. (1982). The eating attitudes test: Psychometric features and clinical correlates. *Psychological Medicine*, 12(4), 871- 878.
- Halmi, K., Eckert, E., Marchi, P., Sampugnaro, V., Apple, R. and Cohen, J. (1991). Comorbidity of psychiatric diagnosis in eating disorders. *Archives of General Psychiatry*, 48, 712-718.
- Heaven, P. C. L., Mulligan, K., Merrilliees, R., Woods, T. and Fairouz, Y. (2001).Neuroticism and conscientiousness as predictors of emotional, external, and restrained eating behavior. *International Journal of Eating Disorders*, 30, 161-166.
- Herva, A., Laitinen, A. H., Miettunen, J., Veijola, J., Karvonen, J. T., La`ksy, K. And Joukamma,

- M. (2006). Obesity and depression: Results from the longitudinal northern Finland 1966 birth cohort study. *International Journal of Obesity*, 30(3), 520–527.
- Jarry, J. L. (1998). The meaning of body image for women with eating disorders. *Can J Psychiatry*, 43(4), 367-374.
- Keel, P. K., Mitchell, J.E., Davis, T.L. and Crow, J. S. (2001). Relationship between depression and body dissatisfaction, and psychological distress: a prospective analysis. *Journal of Abnormal Psychology*, 114, 117-125.
- Kuehner, C. (2003). Gender differences in unipolar depression: An update of epidemiological findings and possible explanations. *Acta Psychiatrica Scandinavia*, 108(3), 163–174.
- Marcus, S. M., Young, E. A., Kerber, K. B., Kornstein, S., Farabaugh, A. H., Mitchell, J. and Rush, A. J. (2005). Gender differences in depression: Findings from the STAR study. *Journal of Affective Disorders*, 87, 141–150.
- Markowitz, S., Friedman, M. A. and Arent, S. M. (2008). Understanding the relation between obesity and depression. *Causal mechanisms and implications for treatment. Clinical Psychology: 15(1), 1-20.*
- National Institute of Mental Health (2011). Eating Disorders. U.S: Department of Health and Human Services. [Online available] <http://www.nimh.nih.gov/health/publications/eating-disorders/eating-disorders.pdf>
- National Institute of Mental Health (2014). What are the different forms of depression? [Online available] www.nimh.nih.gov/health/publications/depression/index.shtml
- Oregon Research Institute (2003). Gender Differences in Eating Disorder Symptoms. [Online available] www.eatingdisordersreview.com/nl/nl_edr_14_3_5.html
- Patton GC, Coffey C & Sawyer SM (2003). The outcome of adolescent eating disorders: findings from the Victorian Adolescent Health Cohort Study. *European Child & Adolescent Psychiatry* 12: I/25-9.
- Preti, A., Girolamo, G., Vilagut, G., Alonso, J., Graaf, R., Bruffaerts, R. and Morosini, P. (2009). The epidemiology of eating disorders in six European countries: Results of the ESEMeD-WMH project. *Journal of Psychiatric Research*, 43 (4), 1125–1132.
- Rifhag, C.G., Cooper, Z. and Shafrin, R. (2003). Cognitive behavior therapy for eating disorders a transdiagnostic theory and treatment. *Behavior research and therapy*, 41, 509-528.
- The Renfrew Center Foundation for Eating Disorders, (2003). Eating Disorders 101 Guide: A Summary of Issues, Statistics and Resources. [Online Available] <http://www.Renfrew.org>
- Tiggemann, M., & Williamson, S. (2000). The effect of exercise on body satisfaction and self-esteem as a function of gender and age. *Sex Roles*, 43(1/2), 119-127.
- Wade, T. D., Keski-Rahkonen A. and Hudson J. (2011). Epidemiology of eating disorders. In M. Tsuang and M. Tohen (Eds.), *Textbook in Psychiatric Epidemiology* (3rd ed.). New York: Wiley, 343-360.
- World Health Organization (2000). *Obesity: Preventing and managing the global epidemic. Report of a WHO consultation on obesity, WHO Technical Report Series*. Geneva: WHO.
- World Health Organization (2001). *The World Health Report-2001. Mental health: new Understanding, new hope*. Geneva: WHO.
- Zhao, G., Ford, E. S., Dhingra, S., Li, C., Strine, T. W. and Mokdad, A. H. (2009). Depression and anxiety among US adults: Associations with body mass index. *International Journal of Obesity*, 33(2), 257–266.

Faktorët që Përcaktojnë Nivelin e Motivimit të të Punësuarve në Sektorin Publik në Shqipëri

PhD (C.) Eduina Guga

Lecturer at "Eqrem Cabej" University, Gjirokastra, Albania,

Abstrakt

Ky studim ekzaminon empirikisht lidhjen ndërmjet shpërblimeve, kënaqësisë në punë, trajnimit efektiv të perceptuar, transferimit të njohurive dhe përkushtimit organizacional, dhe motivimit të punonjësve në sektorin Publik në Gjirokastrë. Mostra e studimit tonë ishin të dhënat e mbledhura nga pyetësorë të vetë-administruar nga punonjësit e sektorit publik. Mostra e zgjedhur ishte 170 persona, pra u shpërndanë 170 pyetësorë por vetëm 149 u përgjigjën. Analiza u krye me ndihmën e koeficientit të korrelacionit dhe analizës së regresionit. U kontrollua në nivelin e rëndësisë nga (0.01-0.05). Rezultatet treguan se ka një lidhje të rëndësishme ndërmjet shpërblimeve të brendshme dhe motivimit të punonjësit, por edhe lidhja ndërmjet shpërblimeve të jashtme dhe motivimit nuk është e parëndësishme. Kënaqësia në punë ka gjithashtu lidhje të rëndësishme me motivimin e punonjësve. Por, nga ana tjetër TEP (trajnimi efektiv i perceptuar) kanë lidhje të parëndësishme dhe negative me motivimin e punonjësve. Motivimi ka lidhje të rëndësishme me transferimin e njohurive dhe gjithashtu edhe me përkushtimin organizacional.

Fjalët kyce: Motivimi I punonjësve, Shpërblime të brendshme, Shpërblime të jashtme, Kënaqësia në punë, Trajnimi Efektiv I perceptuar, Transferimi I njohurive, Përkushtimi organizacional, korrelacioni I sektorit publik, regresioni.

Hyrje

Në ditët e sotme kompanitë po përballen me shumë sfida në mjedisin konkurrues dhe një nga problemet është që të gjejnë punonjës efficient, dhe që t'i bëjnë ata të përkushtuar, është shumë sfiduese. Sot aseti më i rëndësishëm për çdo organizatë janë njerëzit. Motivimi I punonjësve është shumë i rëndësishëm për eficiencën e burimeve njerëzore. Sistemi më i mirë i shpërblimeve nga ana e menaxherëve mund të rrisë performancën e punonjësve. Organizatat duan fuqi punëtore të motivuar. Për këtë arsye manaxherët duhet të njohin forcat motivuese. Është e vështirë të identifikohen cilët janë faktorët më të rëndësishëm për motivimin, sepse natyra njerëzore është shumë komplekse dhe ajo që motivon dikë nuk motivon dikë tjetër. Studimi jonë sugjeron se paratë në vetvete nuk janë një ndër mjetet kryesore. Për punonjësit e vjetër puna interesante është faktor i rëndësishëm. Kushtet në mjedisin e punës, marrëdhënia ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit, oportunitetet për zhvillimin në karrierë, siguria e punës dhe strategjia e përgjithshme e organizatës janë faktorët e tjerë që ndikojnë mbi performancën e punonjësve.

Ekzistojnë dy kategori të mëdha të shpërblimeve, të jashtme dhe të brendshme. Shpërblimet e jashtme, të njohura gjithashtu si shpërblimet e prekshme janë paga/të ardhurat, stimujt, bonuset, promocionet, siguria e punës etj. Shpërblimet e brendshme quhen gjithashtu edhe shpërblimet e paprekshme, ose shpërblimet psikologjike të tilla si vlerësimi, arsimiti, titulli në mjedisin e punës, autoriteti, detyrat e reja, sjelje e mirë e shefit, dhe zhvendosja nga një punë në një tjetër pas përmbushjes së disa

objektivave.

Shpërblimet e brendshme janë motivuesit më të mirë pas rritjes së pagës deri në një nivel të caktuar (Frey,1997).

Kënaqësia në punë është ndjesia e të ndierit mirë për shkak të shpërblimeve dhe sjelljes së mirë ndaj punës. Sinqeriteti I punonjësit ndaj punës tregon se sa shumë I kënaqur është ai me punën. Kënaqësia në punë e një personi mund të ndikohet nga disa faktorë. Disa nga këta faktorë janë një nivel I caktuar I pagës dhe avantazhe të tjera, system I drejtë promovioni, pajisje të mira pune, marrëdhënie hierarkike, vetë puna (detyrat specifike, sfidat e gjeneruara nga puna dhe përshkrim I kuptueshëm I detyrave të punës) Kënaqësia në punë është e ndryshme nga motivimi, por padyshim është I lidhur me të.

Procesi I përmirësimit të njohurive dhe aftësive njihet si trajnim. Qëllimi I trajnimit është të fituarit e aftësive të reja, aftësi në zgjidhjen e problemeve, njohuri praktike etj. Performanca akrtuale dhe e ardhshme e punonjësve mund të rritet nëpërmjet trajnimit.

Përkushtimi organizacional është përkufizuar nga *Pool and Pool* (2007, f. 353) si "... forca relative e identifikimit të një individi dhe përfshirja në një organizim të vecantë" Trajnimi kryhet për të përgatitur punonjësin për punë. Pak organizata ofrojnë trajnime të gjata në kohë për aftësi më të mira për të përballuar situatat aktuale dhe të ardhshme. Ky lloj trajnimi I bën në vecanti më të përkushtuar ata punonjës që janë të ineresuar për zhvillimin në karrierë. Në motivimin e individëve gjithashtu ndikojnë edhe karakteristikat personale.

2. Rishikimi I Literaturës

Motivimi

Aftësia për të ndryshuar sjelljen është motivim. Motivimi është përkushtimi që e drejton dikë në një drëjtim të caktuar për të arritur objektiva specific (Baron:1983). Bazuar në hierarkinë e nevojave të Masloë (1968) : njerëzit janë të motivuar për të përmbushur pesë nivele nevojash: nevojat bazike ose fiziologjike, nevoja për siguri, nevojat sociale, nevojat për vetë-vlerësim, dhe nevojat e vetë-përmbushjes. Pra njerëzit përpiqen shumë për të përmbushur këto pesë nevoja. Për shembull njerëzit punojnë për të fituar të ardhura për të plotësuar nevojat bazë jetike si ushqimi, strehimi, veshja etj. Njerëzit punojnë për të patur ndienjën e sigurisë që në fund të muajit ata do të marrin pagën e tyre, që do t'ju lejojë atyre të jetojnë po aq të sigurt sa më parë. Disa njerëz mund të duan të punonjë sepse puna ju ofron një mjedis ku ata mund të ndërveprojnë me të tjerët, dhe në këtë mënyrë ata plotësojnë nevojat sociale. Nevoja për vlerësim mund të përmbushet kur ata marrin respect dhe mirënjohje për punën e bërë, dhe për disa njerëz me shumë fat, nevoja e vetë-përmbushjes mund të plotësohet kur ata bëjnë atë punë që e duan dhe në të cilën shkëlqejnë . Performanca, produktiviteti dhe qëndrueshmëria e punonjësit varet nga motivimi I tij. Punonjësit e motivuar janë më besnik ndaj punës së tyre dhe ndaj organizatës. Ata bëjnë më tepër përpjekje për të arritur objektivat e organizatës krahasuar me punonjësit e pamotivuar.

Shpërblimet e brendshme

Ndonjëherë organizatat fokusohen më tepër në shpërblimet e jashtme se në ato të brendshmet, por shpërblimet e brendshme janë po ashtu shumë të rëndësishme për motivimin. Vlerësimi dhe njohja janë shpërblime të brendshme që motivojnë

punonjësit dhe përmirësojnë performancën e tyre. Sipas Andreë (2004), përkushtimi I punonjësve varet nga shpërblimet dhe njohja. Kënaqësia pas përbushjes së detyrave, sjellja e mirë e shefit, rritja e autoritetit janë shpërblime jomonetare. Siapas Ajila dhe Abiola (2004) shpërblimet e brendshme jomonetare I referohen gjendjes emocionale të kënaqshme që individët marrin nga puna. Kjo mund të ekuivalentohet me atë që Kallergerg (1977) e ka quajtur kënaqësi e brendshme e punës. Termat “shpërblime të brendshme jomonetare” dhe “kënaqësi e brendshme e punës” do të zëvendësojnë njëra-tjetrën në këtë studim.

Kudo në botë është e qartë që nëqoftëse punnjësve ju ofrohet mjedis I mirë pune atëherë ata do të jenë automatikisht të motivuar ndaj punës dhe do të performojnë me potencialin e tyre maksimal. Kështu ne mund të argumentojmë që ekziston një lidhje ndërmjet shpërblimeve të brendshme dhe motivimit të punonjësve.

H1: Shpërblimet e brendshme kanë lidhje positive me Motivimin e Punonjësve.

Shpërblimet e jashtme

Shpërblimet e jashtme janë paga, bonuset, siguria, njohja, përfitimet marxhinale si transporti psh, etj. (Chen *et al.*, 1999; Malhotra *et al.*, 2007; Mottaz, 1985; Eatherly, 2002). Shpërblimet e jashtme jomonetare janë shpërblime të tilla si marrëdhënie të mira me anëtarët e tjerë, mbështetja manaxheriale dhe vlerësimi. Ky studim do të bazohet në opinionet e punonjësve për mbështetjen manaxheriale.

Paga, promocioni dhe bonuset janë përbërësit kryesor të shpërblimeve të jashtme dhe që luajnë një rol shumë të rëndësishëm në nivelin e motivimit të punonjësve

H2: Shpërblimet e Jashtme kanë lidhje positive me Motivimin e Punonjësve.

Kënaqësia në punë:

Kënaqësia në punë tregon se si gjërat e dëshiruara nga punonjësit ju ofrohen atyre, duke ju dhënë kështu kënaqësi deri në nivelin e lumturisë gjatë kryerjes së detyrave për shkak të arritjes së benefiteve të planifikuara. Niveli I ulët I kënaqësisë në punë con në nivele të larta të qarullimit të punnjësve dhe sjell si pasojë uljen e nivelit të besnikërisë të punonjësit kundrejt organizatës. Norma e qarkullimit të punonjësve të pakënaqur është gjithnjë më e larte se norma e punonjësve të kënaqur (Rusbult et al, 1988).

Është vënë re që punonjësit e kënaqur me dëshirë bëjnë përpjekjet maksimale për të arritur objektivat e organizatës.

H3: Kënaqësia në Punë ka lidhje positive me Motivimin e Punonjësve

Trajnimit Efektiv I perceptuar

Zhvillimi I shpejtë I teknologjisë dhe shfaqja e teknikave të reja ka sjellë një fenomen të ri si për menaxherët edhe për punonjësit. Ata mund të parashikojnë lehtësisht kërkesën e tyre në treg. Studimet tregojnë shfaqjen e dy trendeve të reja që shqëtesojnë menaxhimin: rritja e moshës së fuqisë punëtore dhe evolucioni shumë I shpejtë I teknologjive të reja (Tai:2006). Sipas Tai, në mënyrë që organizata të jetë konkurrese duhet të rrisë buxhetin për trajnim dhe të mbajë fuqinë punëtore të kualifikuar Trajnimi I ofruar punonjësve mund t’I ndihmojë ata të performojnë më mirë në punë dhe me më pak përpjekje, në këtë mënyrë të arrijnë më lehtë objektivat e organizatës. Punonjësit do të jenë të pamotivuar nëqoftëse nuk do të kenë njohuritë e nevojshme për punën, kjo do të sjelli mungesën e interesit të punonjësve për mbarëvajtjen e punës dhe rrjedhimisht edhe rritjen e qarkullimit të punonjësve. Punonjësit do të jenë të motivuar nëqoftëse kanë njohuri të mira për punën sepse kështu mund të japin potencialin e tyre. Pra, ne mund të argumentojmë që trajnimi ndikon në motivimin

e punonjësit.

H4: Trajnimit Efektiv të Perceptuar ka impact pozitiv mbi Motivimin e Punonjësve.
Transferimi I Njohurive

Transferimi I njohurive është mjeti kryesor që krijon koordinimin e detyrave ndërmjet punonjësve të organizatës, prandaj është esencial për menaxhimin e mirë-organizuar. Transferimi I njohurive krijon motivimin për të përballuar sfidat e reja të punës. Nga ana tjetër shpërblimet e brendshme si përkushtimi I lartë ndaj punonjësve rrit aftësinë e vendimmarrjes (Ëlash, 1995). Edhe pse benefitet e organizatës mund të sjellin disa shpërblime të p[ërkohshme për transferimin e njohurive dhe aftësive, ato nuk janë një ndër forcat kryesore që përcaktojnë sjelljen e transferimit të njohurive ndërmjet punonjësve (Lin, 2007).

H5: Eksizton një lidhje ndërmjet Motivimit të Punonjësve dhe Transferimit të Njohurive

Përkushtimi Organizacional

Përkushimi organizacional është kryesisht besimi I punonjësve ndaj organizatë, kryerja e përpjekjeve të vlefshme për arritjen e objektivave të organizatës dhe dëshira për të qënë pjesë e organizatës. Meyer dhe Allen (1991) e kategorizojnë përkushtimin organizacional në tre aspekte kryesore:

Përkushtimi afektiv: I referohet ndienjave më të mira të punonjësit dhe empatisë, lidhjes me organizatën. Punonjësit që janë shumë afektiv me organizatën e vazhdojnë punën në organizatë.

Përkushtimi I vazhduar: I referohet njohjes së kostos që lidhet me ikjen nga organizata. Lidhja kryesore e punonjësve me organizatën bazohet ne përkushtimin e vazhduar sepse ata kanë nevojë të qëndrojnë të punësuar.

Përkushtimi normativ: I referohet ndienjës së obligimit për të vazhduar të punonjë në këtë organizatë. Punonjësit me nivel të lartë të përkushtimit normative mendojnë se duhet të insistojnë të punojnë në këtë organizatë.

Motivimi I punonjësve mund të lidhet pozitivisht me përkushtimin organizacional. Punonjësit me nivel të lartë të përkushtimit afektiv janë të motivuar në nivele më të larta krahasuar me ata që deklaruan përkushtimin e vazhduar apo normativ (Broën, 2003:31).

Në këtë studim ne gjithashtu marrim në konsideratë lidhjen ndërmjet motivimit të punonjësve dhe përkushtimit organizacional.

H6: Ekziston një lidhje ndërmjet Motivimit të Punonjësve dhe Përkushtimit Organizacional.

3. Metodologjia

Ky studim ka natyrë descriptive. Studimet descriptive janë ato që përpiqen të përshkruajnë dicka, një fenomen ose një situatë të vecantë. Studime descriptive janë ato studime që përpiqen të përshkruajnë një situatë ekzistuese dhe jo të interpretojnë ose të japn gjykime (Cresëell, 1994). Objektivi kryesor I një studimi deskriptiv është verifikimi I hipotezave të hartuara që pasqyrojnë situatën aktuale.

3.1 Të dhënat e studimit

Për të realizuar mbledhjen e të dhënave për situatën e motivimit të punonjësve në sektorin public në rajonin e Gjirokastrës , një mostër prej 149 individëve ju kërkua të merrnin pjesë në një pyetësor të vetë-administruar. Popullata për këtë udim janë

punonjësit në sektorin public në rajonin e Gjirokastrës. Për zgjedhjen e mostrës u përdor teknika e zgjedhjes rastësore pa probabilitet. Zgjedhja rastësore është një teknikë për përzgjedhjen e mostrës që mbledh të dhëna nga mostra e cila është rastësisht e disponueshme (Zikmund: 1997). Zgjedhja rastësore zakonisht përdoret për të mbledhur një numër të lartë të pyetësorëve me kosto të ulët dhe në kohë të shkurtër (Lym et al, 2010).

3.2 Instrumentat dhe Matjet

Instrumenti I pyetësorit në studimin tonë adreson dy qëllime kryesore. Së pari është që të analizojë ldhjen e variablave të ndryshëm me motivimin e punonjësve, dhe së dyti, të mbledhë informacion për karakteristikat e ndryshme të individëve të pyetur, të cilat mund të përdoren për të kuptuar variacionet në dimensione të ndryshme. Instrumenti I pyetësorit përmban dy seksione. Seksioni I parë përmban informacione personale dhe demografike. Në këtë seksion do të merren informacione të tilla si gjinia, mosha, të ardhurat dhe arsimi.

